RAPORT PËRFUNDIMTAR

Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

të ushtruar në

BASHKINË SHIJAK

Tiranë, 2022

PËRMBAJTJA

SHKURTIME **3**
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **4**
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 4
2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore 4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 29
II. HYRJE **33**
1. Objekti i Auditimit 33
2. Qëllimi i auditimit 33
3. Identifikimi i çështjes 33
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 33
5. Përgjegjësitë e audituesve 34
6. Kriteret e vlerësimit 34
7. Standardet e auditimit 37
8. Metodat e auditimit 37
9. Dokumentimi i auditimit 38
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT **39**
1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Shijak 39
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit 40
2.1. Auditimi mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm 40
2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit 45
2.3. Vlerësimi i Raportimit Financiar 69
2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik 97
2.5. Mbi Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit 162
2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e IMTV 169
2.7. Të ndryshme të dala gjatë auditimit. 170
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET **172**
A. MASA ORGANIZATIVE 172
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI 187
C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE 189
D. MASA DISIPLINORE 193

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare eKontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u audituа me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të BashkisëShijak dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe tëkontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 "paga", 602 "shpenzime operative" dhe 230-231 "investime", u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Shijak nga data 01.01.2019 deri në datën 31.12.2021, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 13 Akte Konstatimi dhe 3 Akte Verifikimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

2. Përshkrim i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	**1.**Niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën 43% deri 92.1%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Shijak dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara; **2.**Vlera totale e buxhetit ka ardhur në rritje, ndërsa po t'i referohemi zërave të veçantë, vlerat e tyre ndryshojnë nga viti në vit me trend në rënie. Përjashtim bën vetëm "*Fonde të deleguara*" që paraqitet në të njëjtat vlera. **3.** Buxheti është planifikuar: *<u>për vitin 2019</u>*në vlerën 1,055,580 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 622,585 mijë lekë me një diferencë prej 432,995 mijë lekë; *<u>për vitin 2020</u>* është planifikuar në vlerën 2,437,648 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,659,663 mijë lekë me një diferencë prej 777,985 mijë lekë; *<u>për vitin 2021</u>* është planifikuar në vlerën 2,248,457 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,932,240 mijë lekë me një diferencë prej 316,217 mijë lekë. **4.**Nga Bashkia Shijak për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është krijuar fond për emergjencat civile, duke mos zbatuar kështu Ligjin nr. 45/2019 "*Për mbrojtjen civile*" neni 65/1; **5.** Realizmi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta, ku *<u>për vitin 2019</u>* është realizuar me një diferencë prej 359,004 mijë lekë ose 29%; *<u>në vitin 2020</u>* me një diferencë më të vogël në vlerë	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E lartë	Në Bashkinë Shijak, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	se viti 2019 prej 299,511 mijë lekë ose prej 43%; ndërsa në vitin 2021 me një diferencë më të vogël se dy vitet paraardhëse prej 116,063 mijë lekë ose 76.2%; **6.**Realizimi i të ardhurave vjen duke u ulur dhe *planifikimi i të ardhur*ave ka ardhur duke u rritur nga viti në vit: me 4,132 mijë lekë nga 2019 në 2020; me 7,874 mijë lekë nga 2020 në 2021 ose me 52.5% më shumë.			
2	Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2020, të ardhurat nga 223,198,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën prej 156,174,000 lekë ose 69.97 %, pra me një mosrealizim në shumën prej 67,024,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga Taksa e ndërtesës - 4,993,000 lekë; Taksa e tokës bujqësore - 7,338,000 lekë; Taksa e ndikimit në infrastrukturë - 45,488,000 lekë; Tarifa e shërbimeve - 10,606,000 lekë. Për vitin 2021, të ardhurat nga 230,936,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën prej 159,495,000 lekë ose 69.1%, pra me një mosrealizim në shumën 71,441,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga Taksa e tokës bujqësore - 15,530,000 lekë; Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja - 47,105,000 lekë; Taksa e mjeteve të përdorura - 2,214,000 lekë; Tarifa e shërbimeve - 13,892,000 lekë. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar, neni 5, "*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*", neni 54, "*Raportimi financiar*" nënpika c, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Lokale*", i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV "*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*" pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E lartë	Bashkia Shijak, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
3	Nga auditimi në Bashkinë Shijak, u konstatua se në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të	*Pika 2.2., faqe*	E lartë	Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, nuk është krijuar një bazë e plotë dhe e saktë të dhënash, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Shijak, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit Durrës. Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 7 "*Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*" dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 15 "*Parapagimi*", si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 "*Për taksat Kombëtare".*	*44-68*		subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.,) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.
4	**1.** Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 3,333,757,720 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 2,992,785,725 lekë, me një diferencë prej 340,971,995 lekë më shumë në PF të Bashkisë Shijak. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 488,155,972 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 172,782,052 lekë, me një diferencë prej 315,373,920 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 "*Disponibilitete në Thesar*", në PF në subjekt ka vlerën 286,520,157lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë. **2.**Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*" në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2020 përbëhet nga 16 studime e projektime në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat e zbatimit për 6 projekte. Nga dokumentacioni në zyrën e urbanistikës, u	*Pika 2.3., faqe 68-95*	E lartë	**1.**Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Shijak, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike. **2.** Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpas-shme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte, një pjesë e të cilave janë trashëguar nga ish komunat e bashkuara me Bashkinë Shijak. Këto projekte janë të painventarizuara dhe të pakontabilizuara. **3.**Gjendja e llogarisë 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*" në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 602,126,502 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 101,401,121 lekë nga vitit paraardhës. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 192,384,096 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. **4.**Gjendja e llogarisë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 38,877,609 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 66,311,229 lekë, me një shtesë në vlerën 27,433,620 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 38,238,078 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 28,073,151 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. **5.**Gjendja e llogarisë 215 "*Mjete transporti*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 45,102,001 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 47,999,056 lekë, me një shtese në vlerën 2,897,055 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 25,551,223 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 22,447,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Gjithashtu, nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se mjetet e punës, si ekskavatorë, skrepa, etj., janë pasqyruar në mënyrë të gabuar në këtë llogari, pasi duhet të ishin pasqyruar në llogarinë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*". **6.**Gjendja e llogarisë 218 "*Inventar ekonomik*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 28,678,471 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 29,019,247 lekë, me një shtese në vlerën 340,776 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 9,974,016lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënlerësuar për vlerën 19,045,231 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale. **7.**Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" dhe 215 "*Mjete transporti*", paraqiten			pronësia. **3.** Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventari-zuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 "*Toka, troje terrene*"; 211 "*Pyje, Kullota, Plantacione*"; 212 "*Ndërtime e konstruksione*"; 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*"; 214 "*Instalime teknike, makineri e pajisje*" dhe 215 "*Mjete transporti*". Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës. **4.**Nga Bashkia Shijak, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 "*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*".

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".			
5	Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se Bashkia Shijak, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2021 paraqitet si: - Aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a., me NUIS L62401502P e cila është shoqëri aksionare me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*". Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 35,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **3,500,000 lekë**. Kjo shoqëri është themeluar në datën 07.11.2016. - Aksionare me 11.6% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a., me NUIS J61819502V e cila është shoqëri aksionare me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*". Numri total i aksioneve është 446,968 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 446,968,000 lekë. Kjo shoqëri është themeluar në datën 30.08.2000. Bashkia Shijak zotëron 51848.2880 aksione me të drejtë vote, në vlerën totale **51,848,288 lekë**. Për sa më sipër, llogaria 26 "*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*" nuk paraqet vlerën reale për shumën **55,348,288 lekë** (3,500,000 lekë nga Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a. dhe 51,848,288 lekë nga Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a.), në kundërshtim me UMFE nr. 64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*", me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale*" pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të	*Pika 2.3., faqe 68-95*	E lartë	Nga Bashkia Shijak, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** "*Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a.*", me NUIS L62401502P, për 100% të aksioneve, në vlerën **3,500,000 lekë**; **2.** "*Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a.*" Sh.a., me NUIS J61819502V, për 11.6% të aksioneve në vlerën **51,848,288 lekë**, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **55,348,288 lekë** në debi të llogarisë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Kontabilitetit nr. 14 "*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*".			
6	Gjendja e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 16,256,336 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 30,270,542 lekë ose me rritje në vlerën 14,014,206 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme dhe gjendjen e pullave që janë likuiduar në muajin janar të vitit 2022. Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", në sistemin e Thesarit vlera është 30,311,342, pra me një diferencë në vlerën 40,800 lekë. Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Shijak, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kap II "*Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 "*Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 "*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike*" i ndryshuar pikat 42 – 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.	*Pika 2.3., faqe 68-95*	E lartë	Kryetari i Bashkisë Shijak në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.
7	Për vitet 2019-2021 janë lidhur dhe zbatuar 31	*Pika*	E lartë	**Me çeljen e fondeve/ mbërritjen**

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	kontrata në vlerën totale 1,162,219,494 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet nëllogarinë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*". Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" Aneksi 1 "*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*", Kreu I, "*Të përgjithshme*", pika 8, Kreu II, "*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, "*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pika 32.	*2.3., faqe 68-95*		**e shkresës** së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*" dhe në kredi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*". **Me konstatimin e shpenzimit,** (mbërritja e faturës shoqëruar me situcion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" dhe në kredi të llogarisë 404 "*Furnitorë për investime*". **Në momentin e pagesave** të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 "*Furnitorë për investime*" dhe në kredi të llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*". **Në fund të vitit ushtrimor,** për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proçes, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*", në kredi të llogarisë 720 "*Grant korrent i brendshëm*" dhe në kredi të llogarisë 4342, "*Operacione me shtetin (të drejta)*" për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues. **Me përfundimin e investimit,** të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 "*Aktive afatgjata materiale*" dhe

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
				në kredi të llogarisë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*". **Me kapitalizmin e aktivit,**(për aktivet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*", në kredi llogarisë 105 "*Grante të brendshme kapitale*" për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 "*Shtesa të fondit bazë*" dhe në debi të llogarisë 105 "*Grante të brendshme kapitale*" për vlerën e aktiveve të blera.
8	Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2019-31.12.2021), në drejtim të mënyrës së zhvillimit të procedurave të prokurimit, janë konstatuar shkelje të akteve ligjore/nënligjore, të cilat paraqiten si vijon: - Asnjë nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe KVO nuk vërtetohet të kenë kryer trajnime të ndryshme; - Nuk janë inventarizuar dhe numëruar të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit dhe nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit; - Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet Përmbledhëse të cilat janë miratuar nga Titullari i AK, nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit; - Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet dhe DST nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Shijak; - Nuk ka urdhër të Titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve/preventivave (të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinën e bashkisë), kontratave të punimeve/shërbimeve dhe blerjes së mallrave. - Personat që kanë përgatitur projektet, relacionet, preventivat dhe grafikët e punimeve nuk janë në të gjitha rastet të liçencuar nga autoritetet teknike përkatëse për kryerjen e projektimeve në fusha të caktuara specifike. Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr.	*Pika 2.4., faqe 95-160*	E lartë	**1.** Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar. **2.**Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit në përputhje me aktet ligjore/nënligjore, me qëllim planifikimin e saktë të fondit dhe përdorimin me efektivitet dhe eficencë të tij. **3.**Sektori i Procedurave të Prokurimit, të marrë masat për inventarizimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit dhe të zbatimit të përfunduara dhe dorëzimin e tyre në Sektorin e Arkivës, Bashkia Shijak. **4.**Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Shijak dhe jo me protokoll apo regjistër të

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 23, *"Specifikimet teknike",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, neni 52 "*Hapja e ofertave*", neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, neni 59, pika 4, "*Përllogaritja e vlerës limit të kontratës*", pikat 1 dhe 2: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 26, pika 5, "*Kontratat për punë publike*", neni 61, pika 2, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij; ligji nr. 9154, datë 06.11.03 "*Për Arkivat*" dhe aktet ligjore në zbatim të tij, nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*"; UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*" etj.			veçantë. **5.**Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që asnjë pjesë e projekteve të mos bëhet nga punonjës të pakualifikuar dhe të papajisur me liçencat profesionale përkatëse, sipas fushës specifike të profesionit. Në rast se nuk është mundësia për të prokuruar projektet e investimeve, të merren masa për të kontraktuar specialistë të jashtëm, të cilët të kenë kualifikimet e nevojshme për të bërë projektet, sipas rastit.
9	Në auditimin e procedurave me vlera të larta, në 11 raste janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve, jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me me natyrën e objektit që prokurohet, si dhe nuk janë argumentuar hollësisht në procesverbalet përkatëse, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, etj. Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: "*Hapësirë rekreative, park i qytetit Shijak*", me vlerë të fondit limit 45,387,152 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019; "*Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, Lagja Sallmone*", me vlerë të fondit limit 45,504,101 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019; "*Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "Adem Sabli" Borakë*", me vlerë të fondit limit 60,993,255 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019; "*Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Hardhishtë-Rreth*", me vlerë të fondit limit 52,163,759 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019; "*Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Shijakut*", me vlerë të fondit limit 291,715,652 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020;	*Pika 2.4., faqe 95-160*	E lartë	**1.**Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST, si dhe për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Njësia e Prokurimit, në hartimin dhe miratimin e kritereve të kërkesave për kualifikim, pjesë integrale e DST, të argumentojë me hollësi çdo kriter të kërkesave kualifikuese, bazuar mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	"*Rikualifikim i rrugës ish SMT, deri te Shala Group dhe ndërtimi i rrjetit KUZ në rrugën Xhelal Memoci*", me vlerë të fondit limit 82,993,339 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; "*Rehabilitimi i sistemit ujitës, Njësia Administrative Gjepalaj*", me vlerë të fondit limit 12,151,102 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; "*Rikonstruksion i tubacionit së dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V=2000 m^3 Shijak, rrjet shpërndarës të fshatrave Maminas – Kareç – Bilalas – Karpen – Bodinak, Loti I*", me vlerë të fondit limit 209,836,547 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; "*Sistemim, asfaltim i rrugëve lagja Rrubjekë*", me vlerë të fondit limit 62,538,053 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; "*Ndërtim i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*", me vlerë të fondit limit 43,605,497 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; "*Sipërmarrja e pastrimit, gjelbërimit e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në bashkinë Shijak*", me vlerë të fondit limit 30,993,923 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar hollësisht në procesverbalet përkatëse, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në hartimin e kritereve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për rregullat e prokurimit publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.			sipas manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, liçencave, etj, duke i pasqyruar në procesverbalin përkatës, i cili të jetë pjesë e dosjes së prokurimit. **2.**Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Shijak, të marrë masa për shmangien e kritereve të tepërta dhe të paargumentuara, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu, Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e kontratës.
10	- Nga auditimi, rezultoi se në 10 procedura, KVO ka kryer vlerësimin e ofertave në tejkalim të afatit prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.; - Nga auditimi, rezultoi se në rastet e mëposhtme të procedurave të prokurimit publik, janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon: 1. "*Hapësirë rekreative, park i qytetit Shijak*", me	*Pika 2.4., faqe 95-160*	E lartë	Bashkia Shijak, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë në kushtet e mosplotësimit të kritereve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit apo shërbimit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	vlerë të fondit limit 45,387,152 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues BOE "S.&E. K." ShPK; 2. "*Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, Lagja Sallmone*", me vlerë të fondit limit 45,504,101 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues OE "A. A.&A. K." ShPK; 3. "*Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Shijakut*", me vlerë të fondit limit 291,715,652 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fituesBOE "K. K.&K." ShPK; 4. "*Rikualifikim i rrugës ish SMT, deri te Shala Group dhe ndërtimi i rrjetit KUZ në rrugën Xhelal Memoci*", me vlerë të fondit limit 82,993,339 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues BOE "A. A. Sh.P.K &A. K." ShPK; 5. "*Rikonstruksion i tubacionit së dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V=2000 m^3 Shijak, rrjet shpërndarës të fshatrave Maminas – Kareç – Bilalas – Karpen – Bodinak, Loti I*", me vlerë të fondit limit 209,836,547 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "K. K.&K." ShPK; 6. "*Sistemim, asfaltim i rrugëve lagja Rrubjekë*", me vlerë të fondit limit 62,538,053 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "A. A.&A. K." ShPK; 7. "*Ndërtim i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*", me vlerë të fondit limit 43,605,497 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "A. A.&K. K." ShPK; - Në rastet e mëposhtme të procedurave të prokurimit publik, operatorë ekonomikë të cilët janë kualifikuar dhe shpallur fitues, nga KVO janë konsideruar si me mangësi të vogla, por kjo gjë nuk është specifikuar në Raportin Përfundimtar dhe pavarësisht kësaj, KVO mund të kishte anuluar tenderin, sepse OE nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon: 1. "*Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "Adem Sabli" Borakë*", me vlerë të fondit limit 60,993,255 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues BOE "E. A.&V. K." ShPK; 2. "*Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Hardhishtë-Rreth*", me vlerë të fondit limit 52,163,759 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues OE "E.			

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	A.&V. K." ShPK; 3. "*Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave*", me vlerë të fondit limit 31,707,810lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues OE "A." ShPK; 4. "*Rehabilitimi i sistemit ujitës, Njësia Administrative Gjepalaj*", me vlerë të fondit limit 12,151,102 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues OE "V. H." ShPK; 5. "*Sipërmarrja e pastrimit, gjelbërimit e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në bashkinë Shijak*", me vlerë të fondit limit 30,993,923 lekë/vit (92,981,769 lekë/3 vjet) pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues OE "A." ShPK. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtimme kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, germa ç), neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1, neni 53 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3 dhe pika 5, neni 55, "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", pika 1, germa a).			
11	Nga auditimi u konstatua se për kontratat e lidhura nga Bashkia Shijak, nga vlera totale prej 968,516,245 lekë është mundësuar likuidimi i vlerës prej 581,868,388 lekë ose 60.1% e vlerës së kontratave të lidhura, duke mbetur për pagesë vlera 386,647,857 lekë. Likuidimi i pjesës tjetër nuk është bërë pasi në Vendimet e KB dhe më pas në kontrata është përcaktuar likuidimi në disa vite buxhetore, e cila ka shkaktuar që kontratat të lidhen në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014. Nga auditimi, u konstatua se nga ana e titullarëve të Bashkisë Shijak nuk janë ngritur komisionet për marrjen në dorëzim të punimeve dhe rrjedhimisht punimet nuk janë marrë në dorëzim, duke shkaktuar mosregjistrimin e aseteve në kontabilitet, moskthimin e garancisë së punimeve për objektet e përfunduara dhe amortizimin e tyre para se të bëhen pjesë e inventarëve të Bashkisë Shijak. Nga intervista me personelin, u konstatua se këto objekte nuk janë marrë në dorëzim kryesisht për shkak të dëmtimeve që kanë pësuar nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe për personelin e Bashkisë Shijak ka qenë e vështirë të përcaktohet se cilat dëme janë shkaktuar nga tërmeti dhe cilat	*Pika 2.4., faqe 95-160*	E lartë	**1.**Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në të ardhmen, të mos bëhen prokurime pa pasur në dispozicion paraprakisht të gjitha fondet e nevojshme për realizimin e punimeve, si dhe të mos bëhen prokurime të reja pa likuiduar më parë të gjitha faturat dhe situacionet e paraqitura nga OE. **2.**Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK dhe Njësia e Prokurimit në Bashkinë Shijak të marrin masa dhe të analizojnë situatën, me qëllim që në të ardhmen, nga personi ose struktura organizative e caktuar si përgjegjës në emër të Autoritetit Kontraktor, të hartohen raporte të hollësishme për korrektësinë, cilësinë dhe realizimin e suksesshëm të kontratave të lidhura. **3.**Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë urdhërat për krijimin e

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	mund të kenë qenë për shkak të mangësive/defekteve dhe problemeve me cilësinë e punimeve. Për objektet e financuara nga qeveria ose nga institucione të tjera, si AKUM-i, FZHR, etj., likuidimet nuk kanë përfunduar jo për faj të AK, por për mungesën e likuidimeve nga institucionet përkatëse. Autoriteti Kontraktor, gjatë periudhës së audituar, nuk ka kryer monitorim për zbatimin e kushteve të kontratave të lidhura duke i dokumentuar me procesverbal, njëkohësisht nuk ka përgatitur e hartuar raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Në të gjitha kontratat e përpiluara dhe të miratuara, nuk ka të përcaktuar personin, ose strukturën organizative përgjegjëse në emër të palës, për të ndjekur realizimin e kushteve të kontratës të lidhura me kontraktorët, veprim në mospërputhje me Kreun IX "*Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës*", neni 77 "*Mbikëqyrja e kontratës*", pikat 3 dhe 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe kriteri i parashikuar në kontratën e lidhur me palët, neni përkatës "*Përfaqësimi i palëve*". ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij; UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*", etj.			komisioneve/grupeve të punës për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të të gjitha objekteve për të cilat kanë përfunduar punimet, duke bërë verifikimet përkatëse për zbatimin e projekt-preventivave dhe specifikimeve teknike të miratuara, si dhe dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, t'i shërbejnë sa më mirë dhe sa më shpejt komunitetit.
12	**1.** Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Adem Sabli, fshati Borakë*", Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike në vlerën 309,349 lekë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3009, datë 26.08.2019 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 2472, datë 30.07.2019. **2.**Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Muharrem Dollaku, Shijak*", Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se	*Pika 2.4., faqe 95-160*	E lartë	Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve të merren masa për të zbatuar me përpikmëri kontrollin dhe mbikëqyrjen e punimeve, situacionimin e saktë sipas volumeve të punimeve të kryera në terren në përputhje me legjislacionin e mësipërm dhe kontratës së lidhur mes tij dhe investitorit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	gjendja faktike në vlerën 302,900 lekë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3447 datë 27.09.2018 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3447/1 datë 27.09.2018. **3.**Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*", Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike në vlerën 368,190 lekë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3453 datë 01.06.2021 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3449 datë 01.06.2021. Sa më sipër, krahas kontratave përkatëse, është në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3.			
13	Nga kontrolli i dosjes teknike të ndërtimit të objektit "*Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit për qytetin Shijak*", Bashkia Shijak, u konstatuan mospërputhje mes projektit, librezës së masave dhe situacionit nr. 4, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5878 datë 27.07.2020 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 5878/1 datë 27.07.2020. Punimet janë ende të papërfunduara.	*Pika 2.4., faqe 95-160*	E lartë	Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, të merren masa për të bërë rakordimin mes situacionit të radhës, atij përfundimtar me librezat e masave dhe projektit të azhornuar të përmendur në observacionin e dërguar.
14	Nga auditimi rezultoi se mungon "*Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi*" sipas VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/leje ndërtimi*". VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, pika c, "*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP*".	*Pika 2.5., faqe 160-168*	E lartë	Në bazë të Vendimit nr. 1162, datë 24.12.2020 "*Për percaktimin e procedurave dhe afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje ndërtimi/zhvillimi*", nga ana e DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak të merren masa që subjektet të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi me pajisjen me "*Vërtetim për riskun*".
15	Planvendosja e pranuar nga DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak nuk është	*Pika 2.5., faqe*	E lartë	Nga ana e DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	e detajuar me të gjithë elementet e nevojshëm si numrat e kateve të objekteve përreth, në bazë të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, pika c, "*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP*".	*160-168*		Shijak të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa planvendosje të detajuar me të gjithë elementet e nevojshëm që janë: distancat nga kufiri i pronës dhe objektet përreth në të katër orientimet, numrat e kateve të objekteve përreth.
16	Nga auditimi i sistemit e-leje u konstatua leja e ndërtimit me objekt "*Struktura banimi 1 kat*", me zhvillues "D. Sh.", me adresë Bashkia Shijak. Në këtë praktikë u vu re se janë më shumë se një strukturë banimi. TNI për këtë praktikë është përllogaritur si objekt për përdorim vetjak. Nga ana e grupit të auditimit u kërkua të saktësohej fatura ose të argumentohej mënyra e përllogaritjes.	*Pika 2.5., faqe 160-168*	E lartë	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë të llogaritet në bazë të tipologjisë së lejes së ndërtimit, e cila mund të jetë për objekte shërbimi, shitje ose përdorim vetjak, pasi TNI për tipologji të ndryshme merr vlera të ndryshme. Këto tipologji duhet të përcaktohen saktë që edhe TNI të llogaritet saktë.
17	Nga auditimi i dokumentacionit të IMTV-së Bashkia Shijak, u konstatua se: **Për vitin 2020**, janë mbajtur 13 procesverbale konstatimi dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 13 vendime me gjobë, në vlerën 4,050,000 lekë, nga të cilat 7 gjoba me vlerë 3,500,000 lekë, 5 gjoba me vlerë 500,000 lekë dhe 1 gjobë me vlerë 50,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit. Për këtë periudhë, IMTV Shijak ka nxjerrë 38 vendime për prishje objektesh, nga të cilat 31 pallate dhe 7 objekte arsimore, si pasojë e procesit të rindërtimit, me vendime për prishje objektesh, të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike. Nga auditimi i të dhënave për penalitetet e ndryshme të vendosura nga IMTV në Bashkinë Shijak, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë vendosur gjithsej 13 gjoba, për një vlerë totale 4,050,000 lekë. **Për vitin 2021**, janë mbajtur 31 procesverbale konstatimi dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 20 vendime me gjobë, në vlerën 5,775,000 lekë, nga të cilat 8 gjoba me vlerë 4,000,000 lekë, 8 gjoba me vlerë 1,550,000 lekë dhe 4 gjoba me vlerë 225,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit. Për këtë periudhë, IMTV Shijak ka nxjerrë 3 vendime për prishje objektesh, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, të cilat janë ekzekutuar me procesverbal ekzekutimi. Gjithashtu, po për këtë periudhë, IMTV ka nxjerrë 23 vendime për prishje objektesh, nga të cilat rezulton se 20 janë për punime ndërtimi për të cilat nevojitet leje ndërtimi,	*Pika 2.6., faqe 168-169*	E lartë	**1.**Nga Bashkia Shijak, kryesisht nga ana e K/inspektorit të IMTV-së, të merren masa për përgatitjen e informacionit periodik 3-mujor për IKMT-në, në lidhje me masat e marra. Gjithashtu, K/Inspektori të miratojë aktet e kontrollit për objektet e pajisura me leje Ndërtimi. **2.**Drejtoria Juridike, në lidhje me gjobat e paarkëtuara duhet t'i drejtohet Gjykatës Administrative për kthimin e gjobave në tituj ekzekutivë. Nga Drejtoria Juridike, të kërkohet në Gjykatën Administrative rivendosja në afat e vendimeve me gjobë, të vendosura gjatë viteve të mëparshme. Për personat e dënuar me gjobë, të aplikohet kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, për mos derdhje në afat të gjobës deri në një muaj.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	si dhe 3 vendime për prishje objektesh të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike. Nga auditimi i të dhënave për penalitetet e ndryshme të vendosura nga IMTV në Bashkinë Shijak, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë vendosur gjithsej 20 gjoba, për një vlerë totale 5,775,000 lekë.			
18	Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Adem Sabli, fshati Borakë*", Bashkia Shijak, realizuar nga BOE "*E. A.&V. K.*", u konsatuan diferenca në volume konkretisht për zërat e punës, "*Punime dyer dhe dritare*" dhe "*Punime izolimi tarrace*". Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është 309,349 lekë, e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3009, datë 26.08.2019 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 2472, datë 30.07.2019.	*Pika 2.4., faqe 95-160*	E lartë	Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **309,349 lekë** nga BOE "*E. A.&V. K.*", shumë kjo e shkaktuar nga situacionimi më tepër i zërave të punës si më sipër.
19	Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Muharrem Dollaku, Shijak*", Bashkia Shijak, realizuar nga BOE "*E. A.&V. K.*", u konsatuan diferenca në volume konkretisht për zërat e punës "*Punime dyer dhe dritare*" dhe "*Punime izolimi tarrace*". Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është 302,900 lekë e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3447 datë 27.09.2018 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3447/1 datë 27.09.2018.	*Pika 2.4., faqe 95-160*	E lartë	Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **302,900 lekë** nga BOE "*E. A.&V. K.*", shumë kjo e shkaktuar nga situacionimi më tepër i zërave të punës si më sipër.
20	Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Ndërtimi i*	*Pika 2.4., faqe*	E lartë	Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak", Bashkia Shijak, realizuar nga BOE "*A. A.&K. K.*", u konsatuan diferenca në volume, konkretisht për zërat e punës "*Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=30 cm e përhapur e ngjeshur me makineri*", "*Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm me makineri*", "*Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm me makineri*". Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është **368,190** lekë e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3453 datë 01.06.2021 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 3449 datë 01.06.2021.	*95-160*		administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **368,190 lekë** nga BOE "*A. A.&K. K.*", shumë kjo e shkaktuar nga situacionimi më tepër i zërave të punës si më sipër.
21	Nga auditimi u konstatua se Bashkia Shijak nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Shijak për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësi të mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime. Nga auditimi i taksës së ndërtesës, u konstatua një vlerë debitore prej **14,849,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës deri në datën 31.12.2021. Nga auditimi i tarifës së pastrimit, u konstatua një vlerë debitore prej **12,872,000 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit deri në datën 31.12.2021. Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, kreu VIII "*Vlerësimi tatimor*", ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes*	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E lartë	**1.**Bashkia Shijak të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Shijak ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët. **2.** Bashkia Shijak të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitore prej **14,849,000** lekë nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës dhe **12,872,000 lekë** nga mos pagesa e tarifës së pastrimit.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për Taksat Kombëtare*", i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, "*Për Taksat Kombëtare*", etj.			
22	Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 "*Për tokën*", janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5171 familje për sipërfaqen toke prej 5,452 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 41.23 %. Nga 5171 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 3,532 familje ose më shumë se gjysma janë debitorë për këtë lloj takse. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e Bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit. Nga auditimi i taksës së tokës, rezultoi vlera totale debitore **47,802,000l ekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar. Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "*Kodi Civil i Republikës së*	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E lartë	**1.** Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj. Të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korresponde-ncë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, et,) për të evidentuar

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Shqipërisë" i ndryshuar; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "*Për tokën*", i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 "*Për tokat bujqësore të pandara*", VKM nr. 531, datë 21.08.1998 "*Për tokat bujqësore të pandara*", i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, UKM nr. 1, datë 18.07.2012 "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*", etj.			bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese e të dhënave. **2.**Bashkia Shijak, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Shijak dhe Qarku Durrës). Për familjet fermere debitore, të kontabilizohet vlera debitore **47,802,000 lekë,** të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën dhe vlerën e papaguar dhe për mospagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.
23	Nga auditimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë dhënë 111 leje legalizimi për 25,124 m^2 ndërtim, me vlerë investimi 479,591,000 lekë, për një vlerë totale detyrimi 3,851,000 lekë, nga e cila nuk është arkëtuar vlera 2,161,311 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak. Kjo vlerë debitore është e pa kontabilizuar. Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, "*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" i ndryshuar, neni 23, me VKM-në nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*", pika 5, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave vendore*", i ndryshuar, neni 27 "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë*", pika 2/1, si dhe me VKB vjetore përkatëse për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Shijak, etj.	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E lartë	Bashkia Shijak nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Durrës, që të mos lëshojë dhe të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Shijak. Drejtoria e financës të kontabilizojë vlerën debitore dhe Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **2,161,311 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Anekset bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.
24	Nga auditimi, rezultoi se në Bashkinë Shijak ka 336 subjekte debitorë nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E lartë	Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	(për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u ulur, kështu në fund të vitit 2018 numri i debitorëve ishte 549 subjekte në vlerën prej 17,888,557 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve ishte 336 subjekte në vlerën prej 39,179,217 lekë. Vlera progresive në fund të vitit 2021 ka qenë **39,179,217 lekë**, e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shijak. Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur vlera e gjobës (kamatëvonesës) në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë. Sa më sipër, nuk gjen zbatim ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 89 "*Njoftimi dhe kërkesa për të paguar*". Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore, strukturat tatimore të bashkisë Shijak, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008. Gjithashtu nga strukturat tatimore të bashkisë Shijak për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penalbazuar në nenin 181, "*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*", të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore*", me ndryshime, Kreut XI, "*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*", me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "*Kodi Penal i RSh*" me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 "*Për*			arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej **39,217,179 lekë** duke ndjekur rrugët e mëposhtme: ***a. T'u dërgohen bankave***të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare. ***b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit***, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme. ***c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar***, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar. ***d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset***, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Shijak, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 9 "*Të drejtat dhe përgjegjësitë*" pika 1.3., neni 35, "*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*", me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.			
25	Nga auditimi rezultoi se për periudhën 2019-2021 kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit dhe janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Shijak 89 subjekte në vlerën 1,764,610 lekë për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj., nga të cilët kanë paguar detyrimet9 subjekte në vlerën **623,433 lekë**, duke mbetur pa u arkëtuar vlera **1,222,997 lekë** për 80 subjekte, **vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak,** sipas listimit në Pasqyrat **A22, A23 dhe A24** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore*" neni 40, "*Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare*", pika 1, neni 43 "*Përditësimi i të dhënave të regjistrimit*" pika 1/1; ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*", i ndryshuar, neni 22, "*Detyrimi për regjistrim*", pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, VKB, etj.	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E lartë	Sektori i taksave dhe tarifave vendore të saktësojë listat e bizneseve të pajisura me leje ndërtimi, për projektet e investimeve të prokuruara për vitet 2019-2020, si dhe për subjektet private ose biznese, pavarësisht nëse zbatuesit e këtyre ndërtimeve e kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Shijak por ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor dhe të nxjerrë njoftim detyrimet për taksat dhe tarifat vendore. Sipas listimit në Pasqyrat **A22, A23 dhe A24** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej **1,222,997 lekë** nga këto detyrime vendore.
26	Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Shijak ushtrojnë aktivitetin 30 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi, u konstatua se është licencuar 1 subjekt i cili tregëton karburante ndërsa 27 subjektet e tjera nuk janë licencuar, duke ushtruar aktivitetin të papajisur me licencë dhe pa paguar tarifën përkatëse.	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E lartë	Nga Bashkia Shijak, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, si dhe të arkëtohet shuma debitore prej **27,000,000 lekë,** ngasubjektet të cilat ushtrojnë aktivitet për

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse janë dy, R. G. me vendndodhje në Pjezë dhe R. G. me vendndodhje në Maminas. Vlera prej 27,000,000 lekë, e cila nuk është paguar nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak.			tregtimin me pakicë të hidrokarbureve, pa u pajisur me licencën përkatëse nga Bashkia Shijak, sipas Pasqyrës A25, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.
27	Nga auditimi i dosjeve të personelit, u konstatua se për vitet 2019, 2020 dhe 2021, nga Drejtoria e Financës (tani Drejtoria Ekonomike) në Bashkinë Shijak shefi i sektorit të MZSH-së, z. A. Xh. është trajtuar me nivelin e pagës të gradës "*kryeinspektor*", ndërkohë që në strukturë, si Shefit i Sektorit të MZSH-së, ka gradën "*Inspektor zjarrfikës*". Trajtimi i tij me pagë si "*shef i sektorit zjarrfikës dhe emergjencave civile*" është bërë në kundërshtim me Urdhërin nr. 195 datë 28.04.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së "*Për emërim në detyrë si Shef i Sektorit të MZSH-së me gradën "Inspektor"*"; Shkresën e emërimit në punë me nr. 1341/1 datë 03.05.2020 nga Kryetari i Bashkisë Shijak; Urdhërin nr. 99 datë 10.01.2019 të Drejtorit të MZSH pranë Ministrisë së Brendshme "*Për gradimin e punonjësit të shërbimit të MZSH-së z. A. Xh. në funksionin e Shefit të Sektorit të Shërbimit të MZSH-së Bashkia Shijak t'i jepet grada "Inspektor Zjarrfikës"*", ku përcaktohet baza ligjore/nënligjore referuese (specifikimet e reja sipas Ligjit nr. 152/2016*)*, në zbatim të VKM nr. 895 datë 21.12.2016 "*Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën*" pika 1, 2 dhe Lidhja 1; VKM nr. 350 datë 19.04.2017 "*Për trajtimin me pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*" Lidhja 1. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë shkaktuar përfitimin në mënyrë të padrejtë të vlerës prej 9,000 lekë në muaj (në total **513,000 lekë** deri në datën 30.09.2022).	*Pika 2.3., faqe 70-101*	E mesme	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masat për trajtimin me nivelin e pagës sipas akt-emërimeve dhe akteve ligjore si dhe të arkëtojnë nga z. A. Xh. vlerën e përfituar pa të drejtë si "*kryeinspektor zjarrfikës*", emëruar në detyrë me gradën "*inspektor zjarrfikës*", në masën prej 9,000 (nëntë mijë) lekë çdo muaj, nga data e fillimit të përftimit të pagës (01.01.2018), në vlerën totale **513,000 lekë** (deri në datën 30.09.2022). Gjithashtu, në vijim, z. A. Xh. të trajtohet me nivelin e pagës "*inspektor zjarrfikës*", sipas emërimit.
28	Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për	*Pika*	E	Nga Titullari i Bashkisë Shijak, të

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë në nivelin "mjaftueshëm", përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara në sektorë të ndryshëm. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara si dhe plan-veprimi për monitorimin e Sistemit MFK. E gjithë kjo procedurë është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Shijak e miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë, me shkresën nr. 3989 prot., datë 11.11.2019 për vitin 2020 dhe shkresën nr. 550 prot., datë 19.09.2021 për vitin 2021.	*2.1., faqe 39-44*	mesme	marren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurohen programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.
29	KLSH ka konstatuar se në njësinë e auditimit të brendshëm, asnjë nga audituesit nuk është i çertifikuar dhe nuk ka eksperiencë pune, si dhe mungon trajnimi i tyre. Në dosjet e auditimeve të kryera mungojnë: letrat e punës së audituesve, si dhe vlerësimet e cilësisë. Në raportet e auditimit nuk janë përshkruar në mënyrë të plotë e të qartë gjetjet e konstatuara dhe nuk janë përcaktuar përgjegjësitë si dhe rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe nuk i referohen konkretisht çdo gjetjeje. Nuk janë kryer auditime të thelluara në sektorët me risk të lartë si prokurimet, planifikimi e zhvillimi i territorit, menaxhimi i aseteve, sektori i bujqësisë, burimet	*Pika 2.1., faqe 39-44*	E mesme	Nga Bashkia Shijak, të merren masa për çertifikimin dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve,

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	njerëzore, etj. Nuk është kontrolluar dhe dokumentuar si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë së bashkisë dhe në njësitë e varësisë. Nuk ka program angazhimi për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga auditi i brendshëm. E gjithë kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" neni 11, 20, me MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100 të MFE, datë 25.10.2016 pika 2.6, nënpika (c) dhe pika 3.5, kapitulli III, kapitulli IV, pikat 4.1.7 - 4.1.12, kapitulli IV, pika 4.1.1; kapitulli VI, pika 6.1 "*Niveli i dokumentimit*"; Kapitulli VI, I pika 7.1.1 dhe Dokumentet Standarde.			përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditimit të brendshëm të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.
30	Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 referuar VKB-ve, rezulton se buxheti vjetor i çdo viti respektiv, nuk është miratuar me vendim të veçantë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 9 të Kreut I në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*"; Bashkia Shijak nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi *programit 042* "*Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia*" në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 "*Për pyjet dhe kullotat*" i ndryshuar me Ligjin nr.57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; *për programet 051* "*Menaxhimi i mbetjeve*", *programin 052* "*Menaxhimi i ujërave të zeza*" dhe *programin 062* "*Shërbimi publik vendor*" (veçanërisht ai urban), planifikimi në rënie i fondeve nga ana e bashkisë tregon për një shërbim ku është cenuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 23/2,6,10, neni 26/1, neni 27/5 etj.	*Pika 2.2., faqe 44-68*	E mesme	Në Bashkinë Shijak, Drejtoria Ekonomike dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për të miratuar me Vendim të veçantë në Këshillin Bashkiak Planin vjetor të buxhetit, të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e strategjive kombëtare kryesisht të mjedisit, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.
31	Në praktikat e Inventarizimit Fizik të aktiveve mungon Raporti përmbyllës hartuar dhe	*Pika 2.3., faqe*	E mesme	Nëpunësi autorizues, Nëpunësi zbatues dhe Grupi i Menaxhimit

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Verifikimit Fizik të Inventarëve, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" Kapitulli IV pika 85/a, b, c; **2.** Komisioni i Verifikimit Fizik të Inventarëve (aktiveve) përbëhet nga të njëjtët anëtarë për 2 (dy) vite të njëpasnjëshme, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" Kapitulli IV pika 84; **3.** Grupi i Menaxhimit Strategjik funksionon pa hartuar një plan vjetor dhe grafik takimesh ku të përfshihen edhe hartimi e miratimi i strategjive për menaxhimin e aktiveve dhe minimizimin e risqeve të tyre.	*68-95*		Strategjik të Bashkisë Shijak të marrin masa për të zbatuar plotësisht procedurat standard të Inventarizimit të aktiveve të bashkisë me gjithë dokumentacionin e domosdoshëm raportues si dhe në miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.
32	**1.** Grupi nga Ministria e Brendshme, që ka zhvilluar inspektiminnë zbatim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 293 datë 08.09.2020, në shkresën bashkëshoqëruese me Titull "*Protokoll Inspektim - Për vlerësimin e veprimtarisë së strukturave të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi*", ku përshkruhen në mënyrë të detajuar gjithë hapat e kësaj procedure: baza ligjore, subjektet që do të inspektohen, tematika e inspektimit, metodologjia e inspektimit, nga auditimi rezulton se në përfundim të Inspektimit, nuk ka asnjë raport përfundimtar, ku të përshkruhet situata dhe një vlerësim mbi veprimtarinë dhe performancën e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, duke mos përmbushur misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara (përcaktuar te paragrafi i fundit i shkresës) si edhe ato të Ligjit nr. 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*" neni 7, pika 2, neni 25 "*Kriteret për fitimin e gradës*" dhe neni 26 "*Arsimimi dhe trajnimi për fitimin e gradës*", rezulton të mos ketë përmbushur detyrat funksionale të përcaktuara në ligj. **2.** Në lidhje me arsimin/llojin e diplomimit të personelit përbërës të Njësisë së IVMT-së, rezulton se personeli i saj nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit 183/2014 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme*", si dhe riskon performancën e aktivitetit të saj, referuar edhe përcaktimeve të VKM-së nr. 894 datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të*	*Pika 2.3., faqe 68-95*	E mesme	**1.** Kryetari i Bashkisë Shijakdhe Drejtoria e Burimeve Njerëzoretë marrin masa për të zbatuar plotësisht kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të dispozitave ligjore, për emërimin e punonjësve në njësitë e strukturës së Bashkisë, për të realizuar me efektivitet funksionet e saj në dobi të komunitetit; **2.**Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në fazën e përgatitjes së projekt buxhetit vjetor dhe PBA-ve, të shikojë mundësinë e krijimit të një fondi në buxhet për shpërblim financiar bazuar në vlerësimin 6 dhe 12 mujor në Formularin e performancës për punonjësit me "*Statusin e nëpunësit civil*" dhe përcaktimeve të VKM nr. 68/2018 për punonjësit me "*Kod pune*", me qëllim motivimin e punonjësve për realizimin me efektivitet të objektivave institucionale; **3/a.** Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme, të tregojë vëmendjen e duhur në zbatimin e detyrave funksionale për inspektimin, koordinimin, trajnimin dhe logjistikën e shërbimit të MZSH-së, në përmbushje të misionit të

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referimi në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
	kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore"; **3.** Nga auditimi mbi fondet e pagave, rezulton se nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk është planifikuar në planet vjetore dhe ato afatmesme "*fondi për shpërblime*" mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve (vlerësimi 6 dhe 12 mujor); gjithashtu për punonjësit me Kod Pune nuk zbatohet VKM nr. 68/2018 "*Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore*".			saj për inspektim e parandalim, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut. **3/b.** Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme të tregojë vëmendjen e duhur në zbatimin e detyrave funksionale për arsimimin/ kualifikimin dhe trajnimin e personelit zjarrfikës për fitimin e gradës, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

I. Opinion i Modifikuar (Kualifikuar) mbi Pasqyrat Financiare:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Shijak, për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700, ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, shprehim një Opinion të Modifikuar për llogaritë vjetore e vitit ushtrimor 2021 të Bashkisë Shijak, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të vitit 2021, të cilat justifikojnë dhënien e **Opinionit të Modifikuar.**

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10, "*Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*", si dhe ISSAI 30 "*Kodi Etik*" apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 "*Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare, Udhëzues për SAI-n*". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë

punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2021 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit 25,583,234 lekë për shpenzimet dhe 30,784,521 lekë për të ardhurat, sipas Pasqyrës PF1, në Anekset bashkëlidhur.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

1. Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 3,333,757,720 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 2,992,785,725 lekë, me një diferencë prej 340,971,995 lekë më shumë në PF të Bashkisë Shijak.

2.Në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 488,155,972 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 172,782,052 lekë, me një diferencë prej 315,373,920 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 "*Disponibilitete në Thesar*", në PF në subjekt ka vlerën 286,520,157lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.

3. Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*" në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2020 përbëhet nga 16 studime e projektime në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat e zbatimit për 6 projekte. Nga dokumentacioni në zyrën e urbanistikës, u konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte, një pjesë e të cilave janë trashëguar nga ish komunat e bashkuara me Bashkinë Shijak. Këto projekte janë të painventarizuara dhe të pakontabilizuara.

4.Gjendja e llogarisë 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*" në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 602,126,502 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 101,401,121 lekë nga vitit paraardhës. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 192,384,096 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.

5.Gjendja e llogarisë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 38,877,609 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 66,311,229 lekë, me një shtesë në vlerën 27,433,620 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 38,238,078 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 28,073,151 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.

6.Gjendja e llogarisë 215 "*Mjete transporti*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 45,102,001 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 47,999,056 lekë, me një shtese në vlerën 2,897,055 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 25,551,223 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 22,447,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Gjithashtu, nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se mjetet e punës, si ekskavatorë, skrepa, etj., janë pasqyruar në mënyrë të gabuar në këtë llogari, pasi duhet të ishin pasqyruar në llogarinë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*".

7.Gjendja e llogarisë 218 "*Inventar ekonomik*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 28,678,471 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 29,019,247 lekë, me një shtese në vlerën 340,776 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 9,974,016 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënlerësuar për vlerën 19,045,231 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale.

8. Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" dhe 215 "*Mjete transporti*", paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose

marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

9.Llogaria 26 "*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*" nuk paraqet vlerën reale për shumën 55,348,288 lekë (3,500,000 lekë nga Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.A. dhe 51,848,288 lekë nga Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.), në kundërshtim me UMFE nr. 64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*", me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale*" pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 "*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*".

10. Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Shijak, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

11. Për vitet 2019-2021 janë lidhur dhe zbatuar 31 kontrata në vlerën totale 1,162,219,494 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet nëllogarinë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*". Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike.

II. Opinion i Modifikuar (Kualifikuar) përpërputhshmërinë.

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Shijak, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Shijak, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Shijak, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin "*Baza për Opinionin e Përputhshmërisë*", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë.

Baza për Opinionin e Përputhshmërisë:

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme[1] për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000), si më poshtë:

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, **12** procedura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST.
- Në **11** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Shijak:

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

[1] ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: "*Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme*"

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 260/1, datë 09.03.2022 "*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Shijak*", i ndryshuar me shkresën nr. 260/2, datë 27.04.2022 dhe shkresën 260/3, datë 19.05.2022,të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Shijak nga data 09.03.2021 deri në datën 27.05.2022, u krye "*Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë*", për periudhën nga 01.01.2018 deri më 31.12.2021, nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. J. P., *Përgjegjës Grupi*;
2. S. J.
3. L. B.
4. E. R. dhe
5. S. D., anëtarë.

Titulli: Auditim financiar dhe Përputhshmërie.

Marrësi: Projekt raporti i drejtohet subjektit të audituar, Bashkia Shijak.

1. Objekti i auditimit

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2020 dhe 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve për periudhën 01.01.2018-31.12.2021.

2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Shijak, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. E. A., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. P. A., Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e

pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Shijak, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

6. Kriteret e vlerësimit

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";

<u>Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:</u>

- Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*"
- Ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 "*Për buxhetin e vitit 2019*", Ligji nr. 88/18.12.2019 "*Për buxhetin e vitit 2020*" dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje.
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 "*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*"
- Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 "*Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*" ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015;

- VKM 783 datë 22.11.2006 "*Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël*";
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 "*Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore*";
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*";
- UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*", etj;
- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*";
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "*Për përgatitjen e buxhetit vendor*";
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 "*Për buxhetin e vitit 2018*", pikat 82-91 "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*",
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*",
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 "*Për buxhetin e vitit 2019*", pikat 106-110, "*Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*", dhe pikat 116-117 "*Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*".
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, "*Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive*"), Fletore zyrtare 196/2014;

<u>Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:</u>

- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006*", aktualisht i shfuqizuar;
- VKM nr. 248, datë 10.4.1998 "*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*";
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*";
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 "*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj*";
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 "*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*".

<u>Në fushën e prokurimeve publike:</u>

- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*";

- VKM 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, i Agjencisë së Prokurimit Publik "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik "*Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar;
- UMF nr. 57, datë 12,06.2014, "*Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*".

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në RSH*", i ndryshuar";
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 "*Për Sistemin e Taksave Lokale*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për Taksat Kombëtare*", i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*", me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, "*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*";
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;

Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:
- Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, "*Për kundërvajtjet administrative*";
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*";
- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, "*Për lejet e mjedisit*";
- Ligji Nr. 107-2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*";
- Ligji nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*";
- VKM nr. 629, datë 15.7.2015, "*Për miratimin e manualeve të ndërtimit*";
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", e përditësuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*";
- Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*" dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, "*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*", i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, "*Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë*", i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, "*Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore*", i ndryshuar;

- *Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH";*
- *Rregullore e brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së";*

- *Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.*
- *Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;*
- *Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.*

7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
- ISSAI 2300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik"* si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
- ISSAI 400 "*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*", i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 "*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*"; si dhe ISSAI 4200 "*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*";
- INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*"; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiardhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

8. Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- ***Kontrolli aritmetik***

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një

formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- ***Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese***

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

- ***Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese***

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- ***Kontrolli i vlerësimeve***

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- ***Konfirmimi nga të tretët***

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- ***Kontrolli sipas një trequesi***

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- ***Intervista***
- ***Raporte dhe Informacione***
- ***Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK***

9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualet e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i

rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- ***Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim***

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.
Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- ***Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës***

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.
Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.
Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- ***Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese***

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi BashkinëShijak

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Shijaku kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga bashkia Durrës dhe në lindje nga bashkitë Vorë dhe Tiranë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut.
Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 27,861 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 44,103 banorë. Me sipërfaqe prej 92.19 km^2, ajo ka densitet

prej 302 banorë/km^2 sipas censusit dhe 478 banorë/km^2 sipas regjistrit civil.
Të dhëna të tjera: Bashkia e re Shijak shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore përgjatë lumit Erzen.
Shijaku është një qytet i pasur me burime ujore, ekonomia në vend është e orientuar kryesisht te tregtia, industria fasone dhe ajo përpunuese e prodhuese. Firmat private numërohen 263 subjekte nga të cilat 17 klasifikohen si biznes i madh dhe 246 si biznes i vogël. Këto biznese operojnë kryesisht në fushën e shërbimeve, tregtisë dhe më pak në fushën e prodhimit dhe ndërtimit.
Shijaku është një zonë që ka patur rritje të popullsisë gjatë dekadave të fundit si pasojë e migrimit nga zonat veri-lindore të Shqipërisë. Duke parë ndryshimin e madh midis popullsisë rezidente dhe asaj prezente në regjistrat civilë vihet re se, zona është e prekur ndjeshëm nga emigracioni. Remitancat e emigrantëve kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e zonës, kryesisht në Shijak dhe Xhafzotaj.
Rritja e popullsisë si dhe emigrimi kanë sjellë shumë ndërtime të reja përgjatë 25 viteve të fundit të cilat janë ndërtuar pa një plan të mirëfilltë zhvillimor. Bujqësia është orientuar drejt produkteve me vlerë të lartë të shtuar si kultivimi i perimeve dhe foragjereve, mbarështimi i bagëtive dhe pemëtarisë.[2]

Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative për vitin 2021, është miratuar me VKB nr. 123, datë 24.12.2020, "*Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Shijak*" dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 321, me nr. 5971 prot., datë 12.10.2021 "*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Shijak*", në numrin total 223 punonjës.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Shijak	Qyteti Shijak
Maminas	Fshatrat; Maminas, Karreç, Vlashaj, Karpen, Bodinak, Metallë, Bilalas, Rubjek
Xhafzotaj	Fshatrat; Xhafzotaj, Pjezë, Rreth, Sallmone, Koxhas, Borake, Guzaj, Vllazërim
Gjepalaj	Fshatrat; Gjepalaj, Hardhishtë, Çizmeli, Eminas i Vogël, Likesh, Kënetë, Shtrazë, Shahinaj, Shetël

Kuadri ligjor:

Bashkia Shijak e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuara në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur.
Kryetar i Bashkisë Shijak është z. E. A. dhe Këshilli Bashkiak i Shijakut përbëhet nga 21 anëtarë, të cilët janë mandatuar në datën 30 korrik 2019.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditimi mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK; Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se nuk është

[2] **Burimi:**https://portavendore.al/bashkia-shijak/pasaporta-e-bashkise-shijak/

hartuar një paketë e plotë rregullash të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", nuk janë hartuar programe për të siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar dokumente si regjistri i riskut, rregulla për ruajtjen e aktiveve, nuk ka sistem rezervë për ruajtjen e të dhënave të elektronike (back-up) për njësinë etj.

Titulli i gjetjes:KLSH ka konstatuar se në Bashkinë Shijak ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka mangësi.
Situata: Nuk janë kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:
"Mjedisi i kontrollit"
- Njësia vendore ka hartuar rregulloren e brendshme, ku janë përcaktuar në mënyrë të detajuara detyrat e secilit punonjës. Janë përcaktuar rregulla për rekrutimin e punonjëseve, por nuk u konstatuan rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përgjegjëse.
- Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, planveprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- Nuk është evidentuar puna e anëtarëve të GMS, duke u dokumentuar takimet dhe mbledhjet për hartimin e planit strategjik dhe PBA. Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme në pikën 6 të nenit 45, GMS nuk ka kryer detyrat si:
- Nuk ka vendosur rregulla të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.
- Politika dhe praktika e burimeve njerëzore nuk garanton ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit, pasi nuk ka programe trajnimi për punonjësit, për të ngritur në vazhdimësi nivelin e tyre profesional.
"Menaxhimi i Riskut"
- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut dhe si rezultat, gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar. Në Bashkinë Shijak nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut.
- Mungon urdhëri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhëri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Në raportet e auditimit të brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.
- Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në bashki në të gjitha nivelet e saj, pra mungon regjistri i riskut. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut.
- Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së bashkisë dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.
- Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike ekspozimin ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe

pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

"Aktivitetet e Kontrollit"

- Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up)
- Bashkia Shijak nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve.
- Në Rregulloren e Brendshme në Kreun IX "*Administrimi, Komunikimi dhe ruajtja e dokumentacionit*" në nenin 25 "*Të dhëna të përgjithshme*" pika 5 "*Ruajtja e dokumentacionit*" përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

"Informimi dhe komunikimi"

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.
- Komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor kryhet nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale.

"Monitorimi"

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.
- Në Bashkinë Shijak mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

Titullari i këtij institucioni për rekomandimet e lëna nga KLSH ka marrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 12-17 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", nenet 8, 16, 22, 23 dhe 24.Rregullore e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Shijak.

Ndikimi/Efekti: Mosevidentimi i aktiviteteve me risk të lartë, mosmarrja e masave të nevojshme për zvogëlimin e riskut, me qëllim mirëmenaxhimin e fondeve publike, përbëjnë risk për institucionin dhe ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të institucionit.

Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Shijak, të merren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, hartimin e regjistrit të riskut, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit. Të hartohen programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit.

Për sa më sipër, për mangësitë e konstatuara në fushën e MFK, ngarkohen me përgjegjësi z. A. K. (ish kryetar i Bashkisë Shijak), z. E. A. me detyrë Kryetar i Bashkisë Shijak, në cilësinë

e Nëpunësit Autorizues dhe znj. P. A., me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, në Bashkinë Shijak është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Nga këta, asnjë nga punonjësit nuk është i pajisur me çertifikatën e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik*", neni 11 dhe të VKM-së nr. 83 datë 03/02/2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", pika 3.

Struktura e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Shijak për periudhën e audituar, është paraqitur në **Pasqyrën AB1**, në anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit.

2.1.3. Vlerësimi i veprimtarisë të njësisë së auditit të brendshëm.

- Në vitin 2019 është miratuar plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2019-2021 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe me shkresën nr. 3284/1 datë 19.10.2018 i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.
- Në vitin 2020 është miratuar plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2020-2022 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe me shkresën nr. 3401/1 datë 18.10.2019 i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.
- Në vitin 2021 është miratuar plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2021-2023 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe me shkresën nr. 2321 datë 12.04.2021 i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Komiteti i Auditit të Brendshëm: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", neni 13 "*Komitetit të Auditimit të Brendshëm*".

Për vitin 2019 janë planifikuar 5 auditime dhe është realizuar 1 auditim në subjektin e varësisë "*Klubi Shumësportësh Erzeni*".

Për vitin 2020 nuk janë kryer auditime pasi Sektori i Auditit ka qenë pa plotësuar dhe nk ka pasur përgjegjës.

Për vitin 2021 janë planifikuar 3 auditime, të cilat janë realizuar, si më poshtë:

1. Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike;
2. Sektori Juridik;
3. Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës).

Konkluzion:

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka kryer auditime të thelluara në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si: prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, taksat dhe tarifat vendore, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave, pasi nuk janë kryer auditime bazuar në vlerësimin objektiv të riskut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM-së nr. 83, datë 03.02.2016, "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*".

Në të gjitha dosjet e auditimit mungon memo e planifikimit, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Në fund të procesit të auditimit mungojnë letrat e punës për secilin auditues, të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit, dokumentet e punës audituese.

Mungon vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NjAB, i cili kryhet nëpërmjet

procesit të vetëvlerësimit periodik. Në raportet e auditimit. nuk janë përshkruar në mënyrë të plotë e të qartë gjetjet e konstatuara. Gjithashtu për gjetjet e konstatuara nuk janë shprehur dhe përcaktuar përgjegjësitë.
Për rekomandimet e lëna nuk është bërë analiza e tyre, pasi nuk është hartuar program i veçantë për shkallën e zbatimit të tyre, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuara në raportet e auditimit.
Nga ana e Njësisë së Auditimit nuk është kryer verifikimi i zbatimit të rekomandimeve me program tematik të veçantë, por është bërë verifikimi i rekomandimeve në auditimin e radhës, gjë që vjen në kundërshtim me Manualin e auditimit të miratuar me Urdhërin nr. 100 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë 25.10.2016 "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*", pikën 4.1.13.2, "*Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve.*

Titulli i gjetjes: Mangësi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.
Situata:Për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, në Bashkinë Shijak është organizuar dhe ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga dy specialistë si dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit. Nga këta, asnjë nga punonjësit nuk janë të pajisur me çertifikatën e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik*", neni 11 dhe të VKM nr. 83 datë 03/02/2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*", pika 3.
Në të gjitha dosjet e auditimit mungon memo e planifikimit, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Në procesin e planifikimit nuk është vlerësuar si duhet risku, përllogaritja e tij si dhe përcaktimi i materialitetit. Në fund të procesit të auditimit mungojnë letrat e punës për secilin auditues, të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit, dokumentet e punës audituese. Mungon vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NjAB, i cili kryhet nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Në raportet e auditimit nuk janë përshkruar në mënyrë të plotë e të qartë gjetjet e konstatuara. Gjithashtu për gjetjet e konstatuara nuk janë shprehur dhe përcaktuar përgjegjësitë.
Nuk është kontrolluar dhe dokumentuar si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë së bashkisë dhe në njësitë e varësisë, për këtë arsye nuk janë dhënë rekomandime se si të përmirësohen procedurat e kontrollit e të jenë më funksionalë për parandalimin e mashtrimeve.
Për rekomandimet e lëna nuk është bërë analiza e tyre, pasi nuk është hartuar program i veçantë për shkallën e zbatimit të tyre, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuara në raportet e auditimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 12-17 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", neni 11, "*Punësimi i audituesit të brendshëm*", neni 19 "*Çertifikimi i audituesve të brendshëm*" dhe neni 20, "*Trajnimi i vijueshëm profesional i audituesve të brendshëm*", me MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*" pika 2.6, "*Roli dhe përgjegjësitë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm*" nënpika (c) dhe pika 3.5 "*Rishikimi i planeve strategjike dhe planit vjetor të AB*", kapitulli III, "*Drejtimet e auditimit*", kapitulli IV pikat 4.1.7-4.1.12, kapitulli IV, pika 4.1.1 "*Planifikimi i një angazhimi auditimi*", kapitulli VI "*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*" pika 6.1 "*Niveli i dokumentimit*", Kapitulli VII "*Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm*", pika 7.1.1. "*Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm*".
Ndikimi/Efekti: Mosrealizimi i objektivave dhe moskryerja e auditimit të brendshëm në

njësi, shkakton mangësi në njohjen e problemeve nga menaxhimi i njësisë dhe pengon marrjen e masave në kohën e duhur për zgjidhjen e problemeve dhe parandalimin e fenomeneve negative, si mitmarrja, mashtrimi dhe korrupsioni.
Shkaku: Mosekzistenca e një stafi profesional të NJAB dhe realizimi i auditimeve jo në shkallën dhe nivelin e duhur në mospërputhje me kriteret e pranuara.
Rëndësia:E mesme
Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për çertifikimin dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. NjAB të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. S. B. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, znj. R. H., audituese dhe znj. A. R., audituese.

2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*", ligjet vjetore "*Për buxhetin e shtetit*" të vitit 2020-2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

2.2.1. Programimi i PBA për periudhën 2020 -2022 dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2020 dhe 2021:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2019-2021, PBA 2020-2022 dhe PBA 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimi i mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve, etj.
Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si mbrojtjen e mjedisit, rritjen e sigurisë në rrugë, përmirësimin e kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimin e shërbimeve sociale, rehabilitimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës rrugore, përfshirë edhe kanalizimin e ujërave të zeza, ambienteve çlodhëse, ndërtimin e shkollave të reja, etj. Është bërë analiza e pagave dhe është llogaritur pesha specifike e këtyre llogarive (600-601) të shpenzimeve në totalin e shpenzimeve.
Çështjet dhe politikat kryesore të Bashkisë Shijak janë:

1. Kushte pune për punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë: 1 objektiv i planifikimit strategjik;
2. Përmirësimi dhe zbatimi i infrastrukturës bazë urbane: 1 objektiv i planifikimit strategjik;
3. Përmirësimi i transportit rrugor: 2 objektiva të planifikimit strategjik;
4. Sigurimi i aksesit në shërbime sociale dhe kolektive: 3 objektiva të planifikimit strategjik;
5. Zgjidhja e kërcënimeve kryesore ndaj mjedisit: 1 objektiv i planifikimit strategjik;
6. Mbrojtja dhe rritja e aseteve të vlefshëm mjedisorë: 1 objektiv i planifikimit strategjik.

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Udhëzimin e MFE dhe në shkresën e MFE nr. 8909 datë 19.06.2017, "*Mbi mendimet e PBA 2018-2020*", Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore*". Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit

financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit),* tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).*

Numri i Projekteve me të ardhurat e veta dhe Grantet/FZHR, është paraqitur në **Pasqyrën B1**, në anekset bashkëlidhur.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore, janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "*Buxhetit me pjesëmarrje*", sipas **Pasqyrës B2**, në anekset bashkëlidhur.

Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga 4 (katër) Njësitë Administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, etj., gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritaret.

Buxheti i ndarë për çdo Njësi Administrative është paraqitur në **Pasqyrën B3**, në anekset bashkëlidhur.

PBA-të dhe buxheti i vitit janë miratuar në Këshillin Bashkiak, si më poshtë:

- PBA 2018-2020/Buxheti i vitit 2018 është miratuar me VKB nr. 68, datë 20.12.2018 dhe shtesa e buxhetit për vitin 2019 është miratuar me VKB nr. 14 datë 15.03.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 291/1, datë 03.04.2019;
- PBA 2019-2021/Buxheti i vitit 2019 është miratuar me VKB nr. 98, datë 24.12.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 40/1, datë 21.01.2019.
- PBA 2020-2022/Buxheti i vitit 2020 është miratuar me VKB nr. 34, datë 24.12.2019 dhe shtesa e buxhetit për vitin 2020 me Vendimin nr. 12 datë 22.02.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 62/3, datë 10.01.2020;
- PBA 2021-2023/Buxheti i vitit 2021 është miratuar me VKB nr. 123, datë 24.12.2020.

Buxheti për vitin 2019 me shtesat në buxhet është dërguar në degën e Thesarit Durrës me shkresën nr. 1235, datë 11.04.2019; për PBA 2020-2022 dhe atë vjetor 2020 me shkresën nr. 224 datë 16.01.2020;

Konstatim:Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 buxheti vjetor i çdo viti respektiv, nuk është miratuar me vendim të veçantë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 9 të Kreut I në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*";

Planifikimet (të ardhura/shpenzime) sipas PBA-ve dhe ndryshimet janë paraqitur në **Pasqyrën B4**, në anekset bashkëlidhur.

Sipas të dhënave të **Pasqyrës B4**, konstatohet se *për vitin 2019* me të ardhurat e veta Bashkia Shijak ka planifikuar të mbulojë 35% të shpenzimeve; *për vitin 2020* rreth 13.5% dhe *për vitin 2021* rreth 12% të shpenzimeve. Nga **Pasqyra B5** rezulton se të ardhurat e trashëguara nga vitet paraardhëse vijnë duke u rritur me *11,820 mijë lekë* nga viti 2019 në vitin 2020 dhe me *14,312 mijë lekë* nga viti 2020 në vitin 2021;

Planifikimet (të ardhurat) dhe realizimet janë paraqitur në **Pasqyrën B5**, në anekset bashkëlidhur.

Kështu, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, *për vitin 2019* janë planifikuar në vlerën 218,930 mijë lekë; *për vitin 2020* në vlerën 223,062 mijë lekë dhe *për vitin 2021* në vlerën 230,936 mijë lekë. Në fakt, janë realizuar për vlerën 54,126 mijë lekë më pak se plani *në vitin 2019 ose 75.3%;* për vlerën66,888 mijë lekë më pak në *vitin 2020 ose 70%* dhe 71,411 mijë lekë më pak*në vitin 2021 ose 69.1%,* diferencë e cila ndikon në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara nga të ardhurat për të njëjtën vlerë.

Gjithashtu nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, për çdo vit ushtrimor 2019, 2020 dhe 2021 rezulton se të ardhurat e planifikuara janë:
Për vitin 2019 është 1,055,576 mijë lekë dhe përbëhet nga:

- Të Ardhura të trashëguara nga viti 2018 në vlerën 70,290 mijë lekë;
- Transferta të pakushtëzuara në vlerën 130,451 mijë lekë;
- Transferta të kushtëzuara 377,357 mijë lekë; dhe
- Transferta specifike + PAK në vlerën 258,548 mijë lekë.

Nga auditimi, rezultoi se në Bashkinë Shijak plani vjetor i buxhetit për vitin 2019 ka pasur një ndryshim (shtesë), e miratuar me VKB nr. 14 datë 15.03.2019 dhe nr. 832/6 prot. datë 18.03.2019 për shpenzimet: në *llog. 602* nga 145,740,000 lekë në 164,831,905.99 lekë (plani progresiv) pra me një shtesë prej 19,091,905.99 lekë; në *llog.231* nga 455,651,000 në 506,849,755 lekë (plani progresv) pra me një shtesë prej 51,198,755 lekë. Ndërsa realizimi i buxhetit ka qenë 707,732,000 lekëose 277,557,663 lekë më pak nga buxheti fillestar dhe 347,848,323.99 lekë më pak nga buxheti progresiv.
Për vitin 2020 është 2,363,177 mijë lekëdhe përbëhet nga:

- Të Ardhura të trashëguara nga viti 2019 në vlerën 84,265 mijë lekë;
- Transferta të pakushtëzuara në vlerën 134,908mijë lekë;
- Transferta të kushtëzuara 344,244mijë lekë;
- Transferta specifike + PAK në vlerën 254,115mijë lekë; dhe
- Transfertë për grante rindërtimi në vlerën 1,322,583 mijë lekë.

Nga auditimi, rezultoi se në Bashkinë Shijak plani vjetor i buxhetit për vitin 2020 ka pasur një ndryshim (shtesë), e miratuar me VKB nr. 12 datë 22.02.2020 dhe nr. 987/5 prot. datë 25.02.2020 për shpenzimet: ka pasur rritje të numrit të punonjësve nga 277 në 281 (referuar strukturës së re të miratuar) shoqëruar në *llog. 600* nga 164,468,736 lekë në 167,193,735 lekë (plani progresiv) pra me një shtesë prej 2,730,000 lekë; në *llog. 601* nga 26,997,927 lekë në 27,402,927 lekë (plani progresiv), pra me një shtesë prej 405,000 lekë; në *llog. 602* nga 160,402,597 lekë në 179,722,096 lekë (plani progresv) pra me një shtesë prej 19,319,499 lekë; në *llog. 231/*FZHR nga 344,244,000 mijë lekë në 415,109,433 mijë lekë (plani progresiv) pra me një shtesë prej 70,865,433 mijë lekë dhe në *llog. 231*/AV nga 68,740,000 mijë lekë në 110,550,335 mijë lekë (plani progresiv) pra me një shtesë prej 41,510,335 lekë. Ndërsa realizimi i buxhetit ka qenë 1,759,656 mijë lekëose 794,075 mijë lekë (pa grantin e rindërtimit) që është 246,466 mijë lekë më pak nga buxheti fillestar dhe 603,521 mijë lekë më pak nga buxheti progresiv.
Për vitin 2021 është 2,296,237mijë lekëdhe përbëhet nga:

- Të Ardhura të trashëguara nga v.2020 në vlerën 93,360mijë lekë;
- Transferta të pakushtëzuara në vlerën 147,139mijë lekë;
- Transferta të kushtëzuara 321,078mijë lekë;
- Transferta specifike + PAK në vlerën 258,379mijë lekë; dhe
- Transfertë grante rindërtimi në vlerën 1,245,345mijë lekë.

Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Shijak plani vjetor i buxhetit për vitin 2021 ka pasur një ndryshim (shtesë) dhe grupit të auditimit i është vënë në dispozicion vetëm Projekt-Vendimi (i pamiratuar nga VKB) për shpenzimet: ka pasur rritje të numrit të punonjësve nga 293 në 299 (referuar strukturës së re të miratuar) shoqëruar në *llog. 600* nga 174,831,891 lekë në 178,231,891 lekë (plani progresiv) pra me një shtesë prej 3,400,000 lekë; në *llog. 601* nga 28,252,104 lekë në 28,832,104 lekë (plani progresiv), pra me një shtesë prej 570,000 lekë; në *llog. 602* nga 141,211,000 lekë në 147,448,206.02 lekë (plani progresiv) pra me një shtesë prej 6,237,206.02 lekë; në *llog. 606* nga 195,300,000 lekë në 660,841,574 lekë (plani progresiv) pra me një shtesë prej 465,541,574 lekë dhe në *llog. 231*/AV nga 123,410,000 lekë në 166,562,719 lekë (plani progresiv) pra me një shtesë prej 43,152,719 lekë. Ndërsa realizimi i buxhetit ka qenë 2,020,413 mijë lekëose 949,380 mijë lekë (pa grantin e

rindërtimit) që është 48,157 mijë lekë më pak nga buxheti fillestar dhe 256,817 mijë lekë më pak nga buxheti progresiv.
Planifikimi i Buxheteve të Bashkisë Shijak për vitet 2019, 2020 dhe 2021 është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa "*dh*" të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe shkresës së MFE nr. 8909 datë 19.06.2017 "*Mbi mendimet e PBA 2018 -2020 për bashkinë Shijak*" dhe ligjit nr. 109/2017 datë 30.11.2017 "*Për buxhetin e vitit 2018*", ligjit nr. 99/2018 "*Për buxhetin e vitit 2019*", konkretisht UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 "*Për zbatimin e buxhetit 2019*", me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, në ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 "*Për buxhetin e vitit 2020*", si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkisë Shijak.
Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2019, 2020 dhe 2021, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet. Po kështu rezulton se janë bërë argumentimet e transferimeve të ndryshme të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.
Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.
Planifikimet dhe realizimet sipas programeve buxhetore janë paraqitur në **Pasqyrën B6**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga sa vërehet në **Pasqyrën B6**, ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Shijak nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës), ka programe si: Programi 042 "*Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia*", Programi 051: "*Menaxhimi i Mbetjeve*", Programi 052: "*Menaxhimi i ujrave të zeza*", Programi 062: "*Shërbimi Publik Vendor*", rezultojnë të jenë programe me fonde në rënie (si në planifikim, ashtu edhe në realizim), gjë për të cilat tregon se Bashkia Shijak nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë. Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë

jo vetëm pasaktësi në planifikimin e fondeve buxhetore në PBA, por edhe paqartësi në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale.
Nga **Pasqyra B6,** rezulton se janë në total 23 programe, të cilat janë shpërndarë: *përvitin 2019* - 22 programe, ku nuk bën pjesë programi 047, "*Emergjence tërmeti grant/bonuse*"; *për vitin 2020 dhe 2021* janë 21 programe, ku nuk bëjnë pjesë programet 053, "*Reduktimi i ndotjes*" dhe 061, "*Planifikimi Urban Vendor*".
Konstatim: Bashkia Shijak nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi programit 042 "*Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia*" në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 "*Për pyjet dhe kullotat*" i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2020 neni 23 pikat 3, 5 dhe neni 34 pika 2; për programin 051 "*Menaxhimi i mbetjeve*", 052 "*Menaxhimi i ujërave të zeza*" dhe 062 "*Shërbimi publik vendor*" (veçanërisht ai urban), planifikimi në rënie i fondeve nga ana e bashkisë tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 23/2, 6, 10, neni 26/1, neni 27/5 etj.
Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.
Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.
Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*".
Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Durrës dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.
Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.
Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuara sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2019, 2020 dhe 2021 u konstatua se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë viteve të periudhës nën auditim, buxheti i Bashkisë Shijak ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Durrës.
U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Durrës dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e Bashkisë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të

Bashkisë Shijak janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Durrës, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive.
Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve. Gjatë auditimit, rezulton se Kryetari i Bashkisë ka raportuar në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare, sipas nenit 64 të ligjit nr. 30/2015 dhe ligjit nr. 139/2015.
Nga sa më sipër, rezulton se kanë gjetur zbatim UMF nr. 1, datë 9.1.1996 "*Për procedurat e punës në sistemin e thesarit dhe institucioneve buxhetore*" dhe UMF nr. 2, datë 27.1.1999 "*Për urdhër shpenzimet dhe titullin e të ardhurave*".

Titulli i gjetjes: Planifikimi i programeve sipas prioriteteve vendore.
Situata:1. Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 referuar VKB-ve, rezulton se buxheti vjetor i çdo viti respektiv, nuk është miratuar me vendim të veçantë, në kundërshtim me përcaktimin e bëra në pikën 9 të Kreut I në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*";
2. Bashkia Shijak nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi *programit 042* "*Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia*", në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 "*Për pyjet dhe kullotat*" i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2020 neni 23 pikat 3, 5 dhe neni 34 pika 2; për programet 051, "*Menaxhimi i mbetjeve*", programin 052, "*Menaxhimi i ujërave të zeza*" dhe programin 062, "*Shërbimi publik vendor*" (veçanërisht ai urban), planifikimi në rënie i fondeve nga ana e bashkisë tregon për një shërbim ku është cenuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 23/2, 6, 10, neni 26/1, neni 27/5 etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Ligji nr. 139, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa "*dh*" të nenit 32, i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe shkresës së MFE nr. 8909 datë 19.06.2017 "*Mbi mendimet e PBA 2018 -2020 për bashkinë Shijak*" dhe ligjit nr. 109/2017 datë 30.11.2017 "*Për buxhetin e vitit 2018*", Ligjit nr. 99/2018 "*Për buxhetin e vitit 2019*", UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 "*Për zbatimin e buxhetit 2019*" me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, në ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 "*Për buxhetin e vitit 2020*", si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkisë Shijak.
Ndikimi/Efekti: Mungesa e vëmendjes në planifikimin e fondeve në buxhetet vendore për programet prioritare në Strategjitë Kombëtare, ul efektivitetin në aktivitetin e funksioneve të Bashkisë për komunitetin, në moszbatim të përcaktimeve ligjore/nënligjore në fuqi.
Shkaku: Mungesa e një analize të detajuar të mos/realizimit të buxhetit në mbyllje të vitit ushtrimor dhe nxjerrja e detyrave për planifikimin në buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm në vijim të atyre programeve që i shërbejnë realizimit të objektivave institucionale në dobi të komunitetit.
Rëndësia:E mesme
Rekomandimi:Në Bashkinë Shijak, Drejtoria Ekonomike dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për të miratuar me Vendim të veçantë në Këshillin Bashkiak Planin vjetor të buxhetit, të analizojnë çdo tregues të mosrealizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e strategjive kombëtare kryesisht të mjedisit, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

2.2.3. a) Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit:

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Durrës, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Durrës, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuara me Vendim të KB ose të diktuara nga transferta e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për secilin vit, referuar akt-rakordimeve me thesarin është paraqitur në Anekset bashkëlidhur, përkatësisht në **Pasqyrën B7** për vitin 2019, **Pasqyrën B8** për vitin 2020 dhe **Pasqyrën B9** për vitin 2021.

Referuar të dhënave të pasqyrave më sipër, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën 43% deri 92.1%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Shijak dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit, e zënë shpenzimet e PAKU-t, e ndjekur nga pagat/sigurimet dhe shpenzimet operative.

Realizimi i treguesve të buxhetit sipas burimeve të financimit (transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, fonde të deleguara dhe FZHR), për vitin 2019 është paraqitur në **Pasqyrën B10**, për vitin 2020 në **Pasqyrën B11** dhe për vitin 2021 në **Pasqyrën B12**, në Anekset bashkëlidhur.

Nga pasqyrat e realizimit të shpenzimeve të çdo treguesi buxhetor, nga burimi i financimit, rezulton se vlera totale e tij ka ardhur në rritje, ndërsa po t'i referohemi zërave të veçantë, vlerat e tyre ndryshojnë nga viti në vit me trend në rënie. Përjashtim bën vetëm "*Fonde të deleguara*" që paraqitet në të njëjtat vlera.

Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore është paraqitur në **Pasqyrën B13**, në Anekset bashkëlidhur.

Nga auditimi rezulton se Buxheti është planifikuar: *<u>për vitin 2019</u>*në vlerën 1,055,580 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 622,585 mijë lekë me një diferencë prej 432,995 mijë lekë; *<u>për vitin 2020</u>* është planifikuar në vlerën 2,437,648 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,659,663 mijë lekë me një diferencë prej 777,985 mijë lekë; Në këtë vit rezulton edhe vlera më e lartë e mosrealizimit; *<u>për vitin 2021</u>* është planifikuar në vlerën 2,248,457 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,932,240 mijë lekë me një diferencë prej 316,217 mijë lekë. Fonde nga financime të huaja nuk ka pasur. Sa më sipëru konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2019, 2020 dhe 2021 të ketë mosrealizime, të cilat janë paraqitur në **Pasqyrën B14**, në Anekset bashkëlidhur.

- **Miratimi i buxhetit faktik:**

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Shijak është miratuar buxheti faktik nga Këshilli Bashkiak, për vitet 2019, 2020 dhe 2021 bashkë me hartimin e PBA-së. Në relacionin përfundimtar të zbatimit të buxhetit është hartuar vetëm realizimi i treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk është shoqëruar me analizë të detajuar për nivelet e realizimit të fondeve si dhe me rekomandime për përmirësimin e situatës.

- **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak:**

Në zbatim të nenit 48 "*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor*" të ligjit 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 "*Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*", si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", Raportet e monitorimit janë hartuar për çdo 4-mujor të vitit 2020 dhe janë dërguar në MFE si më poshtë:
Për vitin 2019: 4 mujori i parë, 8 mujori dhe 12 mujori, të miratuar në Këshillin Bashkiak dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës raportuar në MFE;
Për vitin 2020: 8 mujori dhe 12 mujori të miratuar në Këshillin Bashkiak dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës raportuar në MFE; 4 mujori i parë, i anuluar nga situata e Pandemisë;
Për vitin 2021: 4 mujori i parë, 8 mujori dhe 12 mujori, të miratuar në Këshillin Bashkiak dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës raportuar në MFE.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/i kontigjencës, ku për vitin 2019 është planifikuar në masën 8,000 mijë lekë dhe përdorur 2,000 mijë lekë; për vitin 2020 në vlerën 22,782 mijë lekë e cila rezulton e papërdorur; për vitin 2021 në vlerën 800 mijë lekë dhe përdorur 400 mijë lekë.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:**

Konstatim: Referuar **Pasqyrave B13** dhe **B14**, rezulton se nga Bashkia Shijak për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është krijuar fond për emergjencat civile.
Fondi që bashkitë duhet të krijojnë është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, duke mos zbatuar ligjin nr. 45/2019 "*Për mbrojtjen civile*" neni 65/1.

- **Realizimi i Investimeve:**

Referuar **Pasqyrës B15** në Anekset bashkëlidhur, grupi i auditimit të KLSH-së konstatoi se realizmi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta, ku *për vitin 2019* është realizuar me një diferencë prej 359,004 mijë lekë ose 29%; *në vitin 2020* me një diferencë më të vogël në vlerë se viti 2019 prej 299,511 mijë lekë ose prej 43%; ndërsa në vitin 2021 me një diferencë edhe më të vogël se dy vitet paraardhëse prej 116,063 mijë lekë ose 76.2%.

Titulli i Gjetjes: Mosrealizimi i planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore.
Situata:1. Referuar pasqyrave të realizimit të treguesve të buxhetit për secilin vit referuar akt rakordimeve me thesarin rezulton se niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën 43% deri 92.1%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Shijak dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara;
2. Nga pasqyrat e realizimit të shpenzimeve të çdo treguesi buxhetor nga burimi i financimit, rezulton se vlera totale e tij ka ardhur në rritje, ndërsa po ti referohemi zërave të veçantë, vlerat e tyre ndryshojnë nga viti në vit me trend në rënie. Përjashtim bën vetëm "*Fonde të deleguara*" që paraqitet në të njëjtat vlera.
3. Referuar pasqyrave të realizimi faktik të buxheteve sipas periudhave ushtrimore, nga auditimi rezultoi se Buxheti është planifikuar: *për vitin 2019* në vlerën 1,055,580 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 622,585 mijë lekë me një diferencë prej 432,995 mijë lekë; *për vitin 2020* është planifikuar në vlerën 2,437,648 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,659,663 mijë lekë me një diferencë prej 777,985 mijë lekë; Në këtë vit rezulton edhe vlera më e lartë e mosrealizimit; *për vitin 2021* është planifikuar në vlerën 2,248,457 mijë lekë dhe realizuar në

vlerën 1,932,240 mijë lekë me një diferencë prej 316,217 mijë lekë. Fonde nga financime të huaja nuk ka pasur. Sa më sipëru konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, rezulton se nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektove, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2019, 2020 dhe 2021 të ketë mosrealizime;

4. Referuar evidencave dhe tabelave që iu vunë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se nga Bashkia Shijak për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është krijuar fond për emergjencat civile, duke mos zbatuar kështu ligjin nr. 45/2019 "*Për mbrojtjen civile*" neni 65/1;

5. Realizmi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta, ku *për vitin 2019* është realizuar me një diferencë prej 359,004 mijë lekë ose 29%; *në vitin 2020* me një diferencë më të vogël në vlerë se viti 2019 prej 299,511 mijë lekë ose prej 43%; ndërsa në vitin 2021 me një diferencë më të vogël se dy vitet paraardhëse prej 116,063 mijë lekë ose 76.2%.;

6. Referuar të dhënave në tabelën e të ardhurave të vet Bashkisë Shijak, rezulton se: *realizimi i të ardhurave* vjen duke u ulur dhe se *planifikimi i të ardhur*ave ka ardhur duke u rritur nga viti në vit: me 4,132 mijë lekë nga 2019 në 2020; me 7,874 mijë lekë nga 2020 në 2021 ose me 52.5 % më shumë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*"; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*", i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 9 pika 1.3 germa "c" dhe "ç"; ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*"; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*", UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*"; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak; Ligjin nr. 45/2019 "*Për mbrojtjen civile*" neni 65/1;

Ndikimi/Efekti: Planifikimi jo real i të ardhurave të veta, i zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku: Planifikim i të ardhurave dhe më pas përdorimi i tyre për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik; Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mosnxjerrja e konkluzioneve për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Në Bashkinë Shijak, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe GMS të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/ mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

2.2.3. b) Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi:

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga Bashkia Shijak gjatë vitit 2020 janë kryer në formën e ndihmës ekonomike dhe nevojave të tjera, shpenzime të nevojshme specifike të situatës në vlerën totale për të dy vitet 1,370,882 lekë, sipas **Pasqyrës B17,** në Anekset bashkëlidhur.

2.2.3. c) Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre:

Duke iu referuar të dhënave për të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak, në **Pasqyrën B16,** në Anekset bashkëlidhur, rezulton se: *realizimi i të ardhurave* vjen duke u ulur dhe se *planifikimi i të ardhur*ave ka ardhur duke u rritur nga viti në vit: me 4,132 mijë lekë nga 2019 në 2020; me 7,874 mijë lekë nga 2020 në 2021 ose me 52.5% më shumë.

Ky konstatim *sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet nuk janë realizuar,* veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë fonde dhe të realizojë procedura *(investime/ shërbime/blerje malli),* në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

Titulli i gjetjes: Mosrealizimi i planeve buxhetore sipas akt rakordimeve me thesarin dhe zbatimit të dispozitave ligjore.

Situata:1. Referuar pasqyrave të realizimit të treguesve të buxhetit për secilin vit, sipas akt rakordimeve me thesarin, rezulton se niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën 43% deri 92.1%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Shijak dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara;

2. Nga pasqyrat e realizimit të shpenzimeve të çdo treguesi buxhetor sipas burimeve të financimit, rezulton se vlera totale e tij ka ardhur në rritje, ndërsa po t'i referohemi zërave të veçantë, vlerat e tyre ndryshojnë nga viti në vit me trend në rënie. Përjashtim bën vetëm "*Fonde të deleguara*" që paraqitet në të njëjtat vlera.

3. Referuar pasqyrave të realizimi faktik të buxheteve sipas periudhave ushtrimore, nga auditimi rezultoi se Buxheti është planifikuar: *për vitin 2019* në vlerën 1,055,580 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 622,585 mijë lekë me një diferencë prej 432,995 mijë lekë; *për vitin 2020* është planifikuar në vlerën 2,437,648 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,659,663 mijë lekë me një diferencë prej 777,985 mijë lekë. Në këtë vit rezulton edhe vlera më e lartë e mosrealizimit: *për vitin 2021* është planifikuar në vlerën 2,248,457 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,932,240 mijë lekë me një diferencë prej 316,217 mijë lekë. Fonde nga financime të huaja nuk ka pasur. Sa më sipër u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, rezulton se nga të ardhurat e veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektove, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2019, 2020 dhe 2021 të ketë mosrealizime;

4. Referuar evidencave dhe tabelave që iu vunë në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se nga Bashkia Shijak për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është krijuar fond për emergjencat civile, duke mos zbatuar kështu Ligjin nr. 45/2019 "*Për mbrojtjen civile*" neni 65/1;

5. Realizmi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta, ku *për vitin 2019* është realizuar me një diferencë prej 359,004 mijë lekë ose 29%; *në vitin 2020* me një diferencë më të vogël në vlerë se viti 2019 prej 299,511 mijë lekë ose prej 43%; ndërsa në vitin 2021 me një diferencë më të vogël se dy vitet paraardhëse prej 116,063 mijë lekë ose 76.2%.

6. Referuar të dhënave në tabelën e të ardhurave të Bashkisë Shijak, rezulton se: realizimi i të

ardhurave vjen duke u ulur dhe se planifikimi i të ardhurave ka ardhur duke u rritur nga viti në vit: me 4,132 mijë lekë nga 2019 në 2020; me 7,874 mijë lekë nga 2020 në 2021 ose me 52.5% më shumë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*"; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*", i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç"; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*"; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*", UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*"; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak; ligji nr. 45/2019 "*Për mbrojtjen civile*" neni 65/1;

Ndikimi/Efekti: Planifikimi jo real i të ardhurave të veta, i zërave të shpenzimeve e investimeve dhe mos realizimi i tyre kryesisht për shkak të mosrealizimit të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.

Shkaku: Planifikim i të ardhurave dhe më pas përdorimi i tyre për mallra/ shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke u mbështetur në planifikim dhe jo në realizimin faktik; Mungesa e një analize financiare në programimin e buxheteve, mosnxjerrja e konkluzioneve për mosrealizimet e buxheteve në periudhat e mëparshme, si dhe mos respektimi i kërkesave ligjore për programimin e buxheteve vjetore dhe atyre afatmesme.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Në Bashkinë Shijak, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe GMS të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/ mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.).

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHR sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhës në buxhetet respektive është paraqitur në Anekset bashkëlidhur, përkatësisht në **Pasqyrën B18** për vitin 2019, në **Pasqyrën B19** për vitin 2020 dhe në **Pasqyrën B20** për vitin 2021:
Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të vitit çdo viti ushtrimor, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha.
Në shumën e paplanifikuar përfshihen edhe vendimet gjyqësore të mbartura ndër vite.
Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: *për vitin 2019* është raportuar me shkresën nr. 534 prot. datë 31.01.2020; *përvitin 2020* me shkresën nr. 1079 prot. datë 16.02.2021; *për vitin 2021* me shkresën nr. 765 prot. datë 15.02.2022.
Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020*", pika 106.
Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*".
- Në totalin e detyrimeve të palikuiduara *për vitin 2019*, vendimet gjyqësore në fund të vitit ngelen në vlerën e 5,589,468 lekë me 3,896,2683 lekë e krijuar këtë vit; *vitin 2020* e mbyllin në vlerën e 8,502,012 lekë me 2,912,544 lekë krijuar këtë vit; vitin 2021 e mbyllin në vlerën 7,114,212 lekë me asnjë vlerë të krijuar;
- Për artikullin 602 *për vitin 2019* paraqiten në shumën 34,134,147 lekë vlerë e krijuar këtë vit; *për vitin 2020* është likuiduar gjithë detyrimi i mbartur nga 2019 dhe nuk ka asnjë faturë të palikuiduar për 2020; për vitin 2021 nuk ka asnjë fature të palikuiduar nga 2020 dhe për 2021 janë likuiduar gjithë faturat e vitit.
- Shpenzimet për investime (nga bashkia) deri në 31.12.2021 janë likuiduar.
Bashkia Shijak ka dhënë argumentin se ka detyrime kreditore të papaguara, pasi ka vendime gjyqësore në proces.

- **Faturat e palikuiduara**

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës u konstatua se deri më 31.12.2021, janë paguar të gjitha faturat.

- **Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës, detyrimet kontraktuale dhe shpronësimet*:***

Nga auditimi për detyrimet ndaj vendimeve gjyqësore, u konstatua se vlera deri më 31.12.2018 është prej 2,491,481 lekë dhe duke iu shtuar vlera e krijuar në vitin 2019 prej 3,896,268 lekë bën që deri më 31.12.2019 të shkojë në vlerën 5,589,468 lekë, duke mundur të paguajë vetëm 798,281 lekë 3 mujorin e parë ose 12.6%; deri më 31.12.2020 me vlerën e shtuar në 2020 prej 2,912,544 lekë shkon në vlerën 8,502,012 lekë duke mos mundur të shlyejë asnjë detyrim; ndërsa deri më 31.12.2021 nuk ka pasur vlera të shtuara, por vetëm një shyerje prej 1,387,800 lekë ose 16.3%, duke e mbyllur vitin 2021 me vlerën e 7,114,212 lekë.

- **Programimi i fondeve për faturat e palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore*:***

Referuar shpjegimeve në relacionin e vitit 2019, "*Kontrata për objektin Sistemim asfaltim rruga 8 marsi dhe degëzimet Shijak*", është realizuar për shumën 19,540,749 lekë. Kështu që diferenca prej 81,123 lekë nuk do të jetë më si detyrim i prapambetur pasi kontrata është mbyllur.

2.2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre:

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për të 3 vitet 2019,

2020 dhe 2021 në lidhje me investimet publike, u konstatua se për periudhën objekt auditimi numri i projekteve nga të ardhurat e veta vjen në rritje po ashtu dhe vlera totale e tyre; ndërsa numri i projekteve nga QQ dhe FZHR vjen në rënie por në rritje vlera e tyre;
- Nga FZHR për vitin 2019 janë investuar 101,365 mijë lekë, për vitin 2020 janë investuar 81,382 mijë lekë dhe në vitin 2021 janë investuar 9,658 mijë lekë;
- nga AKUM janë investuar në 2019 asnjë projekt, në vitin 2020 janë investuar 70,865 mijë lekë, në vitin 2021 janë investuar 282,356 mijë lekë.
- Nga të ardhurat e veta, sipas paraqitjes më sipër, vlerat e investimeve kanë ardhur në rënie.
Kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara, por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Shijak nga mos realizmi i të ardhurave nga taksat/tarifat vendore.
Fondet e çelura nga grantet e qeverisë, FZHR, etj., janë paraqitur në **Pasqyrën B21**, në Anekset bashkëlidhur.

- **Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor dhe përdorimi i tyre:**

- Për vitin 2019 të ardhurat nga 218,930 mijë lekë janë arkëtuar 164,804 mijë lekë ose 75.3%;
- Për vitin 2020 të ardhurat nga 223,062 mijë lekë janë arkëtuar 156,174 mijë lekë ose 70%;
- Për vitin 2021 të ardhurat nga 230,936 mijë lekë janë arkëtuar 159,525 mijë lekë ose 69%.

Mbulimi i investimeve sipas natyrës së të ardhurave është paraqitur në **Pasqyrën B22**, në Anekset bashkëlidhur.
- Me të ardhurat e veta, për vitin 2019 bashkia ka mbuluar 54.4% të totalit të shpenzimeve;
Për vitin 2020 ka mbuluar 38.4% të totalit të shpenzimeve, ku duhet theksuar fakti se vlera totale e shpenzimeve ka pësuar rënie në krahasim me vitin 2019;
Për vitin 2021 bashkia ka mbuluar 70.6% të totalit të shpenzimeve, ku vlera totale e shpenzimeve është rritur në krahasim me vitin 2020 por më e vogël se ajo e vitit 2019, ndërsa vlera prej 83,366 mijë lekë është më e madhe se ajo e 2(dy) viteve paraardhëse.
Mbulimi i shpenzimeve operative sipas natyrës së të ardhurave është paraqitur në **Pasqyrën B23**, në Anekset bashkëlidhur.

- **Vështrim i përgjithshëm mbi Zbatimin e rregullave dhe të procedurave të përcaktuara për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të dala për menaxhimin e situatës së fatkeqësisë natyrore- tërmetit të 26 Nëntorit 2019.**

Shqipëria veriperëndimore u godit nga një tërmet i fortë me magnitudë 6.4 me një epiqendër 16 kilometra në perëndim-jugperëndim të Mamurrasit, në 03:54 më 26 nëntor 2019. Dridhja u ndje në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, si dhe në vende aq larg sa Taranto dhe Beogradi, rreth 370 kilometra në verilindje të epiqendrës. Në total 51 njerëz mbetën të vdekur nga tërmeti dhe mbi 3,000 vetë u plagosën. Për nga shkalla e magnitudës ky ishte tërmeti më i madh që ka goditur Shqipërinë në më shumë se dyzet vjet. Qeveria shqiptare mori menjëherë masa duke hartuar dhe miratuar "*Programin e Rindërtimit*", i cili po financohet me fonde të Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve të huaj. Në zbatim të tij dolën shumë akte ligjore dhe nënligjore për menaxhimin sa më mirë të situatës dhe minimizimin sa më shpejt të pasojave.
Në Bashkinë Shijak me zbatimin e procedurës së rindërtimit u angazhua Drejtoria e Urbanistikës (tani Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit).
Nga titullari i Bashkisë Shijak kanë dalë urdhërat përkatës për ngritjen e komisioneve të emergjencave civile dhe grupeve të punës për vlerësimin e dëmeve në banesa dhe në infrastrukturën rrugore, për vlerësimin e kushteve të banimit, dëmeve materiale, për caktimin e personave përgjegjës për mbledhjen dhe administrimin e dokumentacionit të familjeve që aplikojnë për përfitimin e pagesës së qerasë, etj., detajet e të cilave janë paraqitur në

Pasqyrën B24, në Anekset bashkëlidhur.
Këto komisione janë ngritur bazuar në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", ligjin nr. 8756/2001 "*Për emergjencat civile*", ligjin nr. 45/2019 "*Për mbrojtjen civile*" dhe VKM nr. 329/16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*" dhe Aktit Normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të KM "*Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvecionin e pagesës së qerasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore termetit të datës 26.11.2019*".
Në zbatim të këtyre urdhërave janë ngritur 8 (tetë) grupe pune me 46 punonjësit e Bashkisë Shijak "*të profilit arsimor inxhinier*", të cilëve iu janë bashkuar edhe pjesa tjetër e stafit "*të profilit ekonomi/financë, agronomi, menaxhim*" etj. Gjithashtu pjesë e grupeve të punës në terren janë bërë edhe stafi i OSHEE duke vënë në dispozicion edhe zyrat e saj si vend takimi për grupet e punës në terren.
Trajtimi i familjeve me grantin e Bonusit të Qerasë është paraqitur në **Pasqyrën B25** në Anekset bashkëlidhur, ku jepet një informacion mbi numrin e përfituesve nga bonusi i qerasë dhe vlerën e grantit. *Për vitin 2019* në muajin dhjetor janë trajtuar 591 familje me një vlerë totale prej 6,774,000 lekë; *për vitin 2020* janë trajtuar nga 594 deri në 914 familje me një vlerë të grantit totale vjetore prej 160,303,000 lekë; *për vitin 2021* janë trajtuar nga 631 deri në 889 familje me një vlerë totale vjetore 166,797,000 lekë. Kjo procedurë është në zbatim të Aktit Normativ nr. 8 datë 07.12.2019 "*Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, termetit të datës 26.11.2019*", me një afat kohor prej një viti (12 muaj) dhe Ligjit nr. 22/2018 "*Për strehimin social*" pas përfundimit të afatit 12 mujor. Edhe për vitin 2022 vazhdon trajtimi i familjeve që janë përfituese nga grantet e programit të rindërtimit për bonusin e qerasë.
Në zbatim të VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 "*Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model*" i ndryshuar dhe Ligjin nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", kanë dalë Urdhërat e Brendshëm nga Kryetari i Bashkisë Shijak, sipas **Pasqyrës B26** në Anekset bashkëlidhur.
Nga Bashkia Shijak janë dërguar në Komisionin shtetëror të Rindërtimit shkresat me objekt "*Kërkesë për grante*" të specifikuara sipas formularëve [DS] të klasifikuar sipas shkallës së dëmtueshmërisë, të cilat janë paraqitur në **Pasqyrën B27**, në Anekset bashkëlidhur. Kjo procedurë është në zbatim të VKM nr. 5 datë 06.01.2020 "*Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model*" i ndryshuar; VKM nr. 26 datë 15.01.2020 "*Për kryerjen e akt ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara*"; Ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*"; Gjithashtu nga auditimi rezulton se për çdo akt të miratuar në KB, është respektuar edhe afati për konfirmim të ligjshmërisë së tij nga ana e Prefektit të Qarkut Durrës.
Gjatë procedurave verifikuese dhe vlerësuese të grupeve të punës në terren, nga aplikimet e bëra kanë rezultuar aplikues të cilët janë skualifikuar duke humbur mundësinë e përfitimit nga programi i rindërtimit dhe që i përkasin Njësisë Administrative Gjepalaj. Lista e plotë dhe informacioni sipas kritereve të përcaktuara janë në përmbajtjen e shkresës nr. 375/1, të dhënat numerike të së cilës janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në **Pasqyrën B28**, në Anekset bashkëlidhur.
Konstatim: Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit që Bashkia Shijak vuri në dispozicion të grupit të auditimit dhe që janë pasqyruar në **Pasqyrën B28**, rezulton se nga numri total i aplikuesve të skualifikuar (97), 55 ose 56.7% e aplikuesve janë për "*objekte të braktisura*"; 25 aplikues ose 25.8 janë me "*2 shtëpi banimi*"; 14 aplikues ose 14.4% për "*objekte të pabanuara*"; 4 aplikues ose 4.1% janë "*pa akt konstatim*" të përpiluar nga grupet e

punës në terren; 1 aplikues për objekt banimi "*pa status*" dhe 2 aplikues për "*objekt nën një kulm*". Skualifikimi i aplikuesve "*për mungesë të akt konstatimit*", ka ardhur si rezultat i punës joefektive të grupit të punës në terren dhe të komisionit të ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 19 datë 21.01.2020 dhe me nr. 296 prot., datë 21.01.2020, duke sjellë mostrajtimin dhe mospërftimin nga "*programi i rindërtimit*" të paktën për periudhën deri në hartimin dhe miratimin e listës emërore.
Një pasqyrim statistikor i procedurave të sipërpërshkruara jepen në tabelat e mëposhtme, të cilat janë sipas formateve të përcaktuara nga Ministria për Rindërtimin dhe që NJVQV e përfshira në "*programin e rindërtimit*" raportojnë çdo muaj:
Numri i përfituesve të miratuar me VKB duke konsideruar aplikimet totale të të gjitha fazave është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në **Pasqyrën B29** në Anekset bashkëlidhur, nga ku vërehet se numri i përfituesve referuar formularit të klasifikimit sipas shkallës së dëmtueshmërisë, është 553 për DS1, 1008 për DS2 dhe 762 për DS3. Pra, numrin më të lartë e kanë përfituesit me DS2; për DS4 është 65 përfitues dhe me DS5 nuk ka asnjë të klasifikuar dhe rrjedhimisht asnjë përfitues. Gjithashtu rezulton se përfitues të tre kategorive të para kanë numrin më të lartë të përfituesve në krahasim me ata DS4.
Nga **Pasqyra B30** në Anekset bashkëlidhur, rezulton se gjithsej janë lidhur 1490 kontrata me operatorë ekonomikë për "*rikonstruksion dhe riforcime*", prej të cilëve 623 kontrata janë për kategorinë DS2 që zënë dhe numrin më të lartë të kontratave të lidhura në total ose 41.8 % të tyre, DS3 me 452 kontrata ose 30.3% ; DS1 me 353 kontrata ose 23.7% dhe DS4 me 62 kontrata ose 4.2%.
Nga **Pasqyra B31** në Anekset bashkëlidhur, rezulton se numri i kontratave të lidhura për "rindërtim" është 266 dhe i përkasin klasifikimit DS4; ndërsa për klasifikimin DS5 nuk ka asnjë kontratë të lidhur pasi nuk ka asnjë objekt të kësaj kategorie.
Nga **Pasqyra B32** në Anekset bashkëlidhur, rezulton se numri i përfituesve që kanë tërhequr grantin *cash* për rikonstruksion dhe riformim është në total 1,490 me një vlerë prej 633,484,850 lekë.
Nga **Pasqyra B33** në Anekset bashkëlidhur, rezulton se numri i përfituesve që kanë tërhequr grantin *cash* "për rindërtim të njësive individuale të banimit" është 267 të klasifikim DS4 me një vlerë prej 544,050,032 lekë në total.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor:

- **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Në Bashkinë Shijak, për vitin 2020 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB-në nr. 34, datë 24.12.2019, me ndryshime dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 20, datë 21.01.2020 dhe nr. 08. datë 07.05.2020, ku përfshihet edhe struktura e Sektori i taksave dhe tarifave vendore. Ky sektor përbëhet nga 7 punonjës, konkretisht:1 përgjegjës, 1 specialist dhe 5 inspektorë. Në Bashkinë Shijak, për vitin 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB-në nr. 123, datë 24.12.2020, me ndryshime dhe Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 21, datë 15.01.2021, me ndryshime, ku përfshihet edhe struktura e Sektori i taksave dhe tarifave vendore. Ky sektor përbëhet nga 7 punonjës, konkretisht: 1 përgjegjës, 1 specialist dhe 5 inspektorë.
Struktura e Drejtorisë të taksave dhe tarifave vendore për vitet 2020-2021 është paraqitur në **Pasqyrat A1** dhe **A2,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Titulli i gjetjes: Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.

Situata:Për vitin 2020, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Shijak është miratuar me VKB-në nr. 25, datë dt.27.11.2019, e konfirmuar nga Prefekti Durrës me shkresën nr. 1183/3 datë datë 17.12.2019.
Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt akordimeve me Degën e Thesarit Durrës, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2020 paraqitet i detajuar në **Pasqyrën A3** në Anekset bashkëlidhur.
Nga të dhënat e **Pasqyrës A3**, konstatohet se për vitin 2020, të ardhurat nga 223,198,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën 156,174,000 lekë ose 69.97%, pra me një mosrealizim në shumën prej 67,024,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga deficiti i krijuar nga:

Taksa e ndërtesës:	- 4,993,000 lekë
Taksa e tokës bujqësore:	- 7,338,000 lekë
Taksa e ndikimit në infrastrukturë:	- 45,488,000 lekë
Tarifa e shërbimeve:	- 10,606,000 lekë

Totali i mosrealizimit për vitin 2020 është 67,024,000 lekë.
Për vitin 2020 evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga: znj. E. K., në cilësinë e Specialistes së të ardhurave ne Degën e Thesarit Durrës, znj. P. A., në cilësinë e Drejtorit Ekonomik Bashkia Shijak dhe z. E. A. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shijak.
Për vitin 2021, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Shijak është miratuar me VKB-në nr. 121, datë.24.12.2020, e konfirmuar nga Prefekti Durrës me shkresën nr. 35/2, datë 19.01.2021. Referuar planit vjetor të miratuar dhe aktrakordimeve me Degën e Thesarit Durrës, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2021 paraqitet i detajuar në **Pasqyrën A4** në Anekset bashkëlidhur.
Nga të dhënat e **Pasqyrës A4**, konstatohet se për vitin 2021,të ardhurat nga 230,936,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën prej 159,495,000 lekë ose 69.1%, pra me një mosrealizim në shumën 71,441,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga deficiti i krijuar nga:

Taksa e tokës bujqësore	- 15,530,000 lekë
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja	- 47,105,000 lekë
Taksa e mjeteve të përdorura	- 2,214,000 lekë
Tarifa e shërbimeve	- 13,892,000 lekë

Totali i mosrealizimit për periudhën e audituar është 71,441,000 lekë.
Për vitin 2021, evidencat e rakordimeve me thesarin janë nënshkruar nga: znj. E. K., në cilësinë e Specialistes së të ardhurave në Degën e Thesarit Durrës, znj. P. A., në cilësinë e Drejtorit Ekonomik Bashkia Shijak dhe z. E. A. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shijak.
Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të bashkisë Shijak, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj., në dëm të interesave të publikut.
Për sa më sipër përgjegjësia është e z. E. A. Kryetar i Bashkisë Shijak, e znj. S. B., përgjegjëse e sektorit të të ardhurave si dhe e znj. E. T., specialiste e sektorit të të ardhurave. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 64, "*Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë*"; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar, neni 5, "*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*", neni 42, "*Administrimi i mjeteve monetare*", pika 1, 2 dhe 4; neni 54, "*Raportimi financiar*" nënpika c, UMFE nr. 9 datë

20.03.2018, Kreu IV "*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*" pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Vendore*", i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkaku kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Shijak, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

- **Të ardhurat nga agjentët tatimorë**

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve dhe mosndjekja e mjaftueshme e detyrimeve të familjarëve nga struktura tatimore. Probleme me vjeljen e taksës së tokës bujqësore dhe taksës së ndërtesës e tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga abonentët familjarë.

Situata:Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta. Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Durrës, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Shijak dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Durrës.

Në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, u konstatua se nga Bashkia Shijak nuk është krijuar një bazë e plotë dhe e saktë të dhënash, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Shijak, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit Durrës.

Përsa i përket rakordimeve me agjentët tatimorë, u konstatua se:

- Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet bëhet rakordim periodik i rregullt mujor me Degën e Doganës Durrës dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave. Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Nga grupi i auditimit gjykohet se korrespondenca vetëm me një degë doganore nuk është e mjaftueshme, pasi eksporte mund të bëhen edhe nga degë të tjera, gjë që e bën të domosdoshëm bashkëpunimin dhe rakordimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
- Për Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin ndiqet rakordim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.

- Për Taksën vjetore të mjeteve të përdorura janë mbajtur rakordime me D.R.SH.T.RR. Durrës në periudha të ndryshme brenda vitit.
- Taksa e kalimit të pronësisë është derdhur për llogari të Bashkisë në kohë jo periodike. Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Shijak Sh.A., nuk është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit.
- Aktet e rakordimit nuk janë mbajtur rregullisht, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 7 "*Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*" dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 15 "*Parapagimi*", si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 "*Për taksat Kombëtare.*

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur në **Pasqyrën A5,** në anekset bashkëlidhur.

- **Detyrimet e familjarëve**

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Shijak nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Shijak për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

<u>Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese</u>

Bashkia Shijak në Njësitë Administrative dhe në Zyrën me një ndalesë ka sportel të Postës Shqiptare ku pranohen pagesat e detyrimeve vendore për familjarët dhe bizneset.

Me VKB nr. 121 datë 24.12.2021, Bashkia Shijak ka miratuar pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të taksave dhe tarifave vendore. Ky vendim ka pasur si qëllim ndihmën për familjet të cilat nuk kanë mundësi financiare për pagesën e menjëhershme të këtyre detyrimeve.

Vlera prej **14,849,000 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës deri në datën 31.12.2021. (**Pasqyra A6,** në anekset bashkëlidhur).

Vlera prej **12,872,000 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit deri në datën 31.12.2021. (**Pasqyra A7,** në anekset bashkëlidhur).

Pagesat e taksave dhe tarifave vendore, si dhe numri i familjeve që paguajnë është paraqitur në **Pasqyrën A8,** në anekset bashkëlidhur.

Planifikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020 është paraqitur në **Pasqyrën A9,** në anekset bashkëlidhur.

Planifikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020 është paraqitur në **Pasqyrën A10,** në anekset bashkëlidhur.

- **Taksa e tokës**

Titulli i gjetjes: Nga auditimi rezultoi vlera totale debitore 47,802,000 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Shijak. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.

Situata: Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 "*Për tokën*", janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5,171 familje për sipërfaqen toke prej 5,452 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 41.23%. Nga 5,171 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 3,532 familje ose më shumë se gjysma janë debitorë për këtë lloj takse. Sipërfaqja e tokës dhe numri i familjeve të trajtuara me tokë nga ligji 7501, etj., sipas njësive administrative, në hektarë është paraqitur në **Pasqyrën A11**, në Anekset bashkëlidhur. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e

Bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit. (**Pasqyra A12,** në anekset bashkëlidhur).
Realizimi i vjeljes së taksës së tokës për Bashkinë Shijak, dhe numri i familjarëve debitore:
Për vitin 2019 taksa e tokës është realizuar në masën 28.4%.
Për vitin 2020 taksa e tokës është realizuar në masën 66.39%.
Për vitin 2021 taksa e tokës është realizuar në masën 28.9%.
Parashikimi për vjeljen e taksës së tokës për vitet 2019, 2020 dhe 2021 është bërë sipas të dhënave në regjistrat e tokës bujqësore. Detyrimet e prapambetura për taksën e tokës rezultojnë në masën 48% të vlerës së përgjithshme. Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 "*Për tokën*", janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5,171 familje për sipërfaqe toke prej 5,452 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 41.23%. Nga 5,171 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 3,532 familje ose më shumë se gjysma janë debitorë për këtë lloj takse. (**Pasqyra A13,** në anekset bashkëlidhur).
Nga auditimi rezultoi vlera totale debitorë **47,802,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Për sa më sipër përgjegjësia është e z. E. A. kryetar i Bashkisë Shijak, e znj. S. B. përgjegjëse e sektorit së të ardhurave dhe e znj. E. T. specialiste e sektorit të të ardhurave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri:ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për Taksat Kombëtare*", i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, "*Për Taksat Kombëtare*", etj.
Ndikimi/Efekti: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave në **vlerën debitore prej 47,802,000lekë,** nga mos pagesa e taksës së tokës bujqësore, e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shijak.
Shkaku: Ka munguar përditësimi i të dhënave të regjistrave përkatës, niveli ekonomik i familjeve, mungesa e strategjive për vjeljen e detyrimeve nga administrata, mungesa e kontratës me UK sha si agjent tatimor, etj.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi 1: Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj. Të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.,) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese e të dhënave.
Rekomandimi 2: Bashkia Shijak, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Shijak dhe Qarku Durrës). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **47,802,000lekë** dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.
Rekomandimi 3: Bashkia Shijak, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a., për kryerjen nga ana e

këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

- **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Titulli i gjetjes: Të ardhura të munguara nga pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet e legalizuara.
Situata:Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, u audituа korrespondenca shkresore e Bashkisë Shijak me ish-ALUIZNI-in, Drejtoria Durrës dhe të dhënat për lejet e legalizimit të përfituara nga individë dhe subjekte private, të disponueshme në Bashkinë Shijak.
Për vitin 2020 ky zë i të ardhurave është realizuar në shumën 720,000 lekë nga 2,363,000 lekë të planifikuara ose në masën 30.4%. Janë dhënë gjithsej 51 leje legalizimi nga të cilat 22 leje legalizimi për 4485 m^2 ndërtim, me vlerë investimi 143,990,000 lekë, kanë paguar taksën në vlerën 618,000 lekë dhe *pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) për 29 leje legalizimi, për 10,237 m^2 leje ndërtimi në vlerën 1,643,000 lekë, është arkëtuar në masën 30.5 % e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak.*
Për vitin 2021 është realizuar në shumën 0 lekë nga 518,000 lekë të planifikuara ose në masën 0%. Janë dhënë 10 leje legalizimi për sipërfaqen 3,227 m^2 ndërtim, me vlerë investimi 103,603,000 lekë, *pa u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 508,000 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak.*
Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit të Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike janë evidentuar disa shkaqe për mosrealizimin e pagesës të taksës së ndikimit në infrastrukturë për listën bashkëlidhur, konkretisht:
Shkaku kryesor është se janë dhënë leje legalizimi nga *ALUIZNI Durrës pa u pajisur më parë me vërtetim për shlyerjen e taksës pranë Bashkisë që nga muaji Gusht 2020.*
Konkluzion: Për periudhën objekt auditimi, janë dhënë 111 leje legalizimi për 25,124 m^2 ndërtim me vlerë investimi prej 479,591,000 lekë p*a u faturuar dhe arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 2,161,311 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak.* Gjithashtu, nga Bashkia Shijak gjatë kësaj periudhe janë faturuar 111 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Shijak me një detyrim prej 3,851,000 lekë, nga këto është likuiduar vlera prej 1,690,000 lekë, *duke mbetur pa shlyer nga 39 posedues të lejeve të legalizimit të një sipërfaqeje prej 13,464 m^2 me vlerë **2,161,311 lekë,** e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Shijak.* Kjo vlerë debitore është e pa kontabilizuar. Të dhënat e detajuara për TNI nga legalizimet janë paraqitur në **Pasqyrën A14**, në Anekset Bashkëlidhur. Lista e debitorëve nga TNI është paraqitur në **Pasqyrën A15**, në Anekset bashkëlidhur.
Për sa më sipër përgjegjësia është e z. E. A. kryetar i Bashkisë Shijak, znj. S. B. përgjegjëse e sektorit të të ardhurave dhe znj. E. T. specialiste e sektorit të të ardhurave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, "*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, nenet 4, 5, 9 dhe 27; VKB Shijak "*Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Shijak*", etj.
Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën **2,161,311 lekë,**nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit nga përfituesit lejes së legalizimit.
Shkaku: Mos bashkëpunimi i fortë me ASHK-në dhe mos marrja e masave të duhura për parandalimin e dhënies së lejeve të legalizimit pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë

pranë Bashkisë Shijak nga subjektet private dhe individët për objektet në proces legalizimi.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Shijak nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Durrës, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Shijak. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë.

- **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë manuale dhe elektronike regjistri për taksat dhe tarifat vendore për subjektet private dhe familjarët, si më poshtë:
1. Regjistri Elektronik për Bizneset në formatin Excel.
2. Regjistri Elektronik për taksën e Tokës në formatin Excel.
3. Regjistri Elektronik për Popullatën në formatin Excel.

Gjithashtu, regjistrat janë hartuar dhe funksionojnë edhe në formë manuale, konform me formatin përkatës të miratuar nga Ministria e Financave.
Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak janë përmbledhur në **Pasqyrën A16**, në Anekset bashkëlidhur.

- **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore:**

Titulli i gjetjes: Mangësi në evidentimin dhe vlerësimin e nivelit të detyrimeve debitore, kontabilizimet dhe procedurat e ndjekjes së borxhit tatimor për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak.
Situata: Në bazë përpunimit të të dhënave nga regjistri i taksave dhe tarifave si dhe nga informacioni i vënë në dispozicion nga Sektori i zhvillimit ekonomik në Bashkinë Shijak, rezultoi se ka 336 subjekte debitorë nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u ulur, kështu në fund të vitit 2018 numri i debitorëve ishte 549 subjekte në vlerën prej 17,888,557 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve ishte 336 subjekte në vlerën prej 39,179,217 lekë. Vlera progresive në fund të vitit 2021 ka qenë 39,179,217 lekë, e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shijak.
Vlera e debitorëve e ndarë sipas viteve, numrit dhe sipas biznesit, në mënyrë të përmbledhur është paraqitur në **PasqyrënA17**, në Anekset bashkëlidhur.
Vlera e debitorëve e paraqitur e ndarë në vlerë principali plus kamatëvonesë e përllogaritur (0,06 % për çdo ditë vonesë) dhe numrit të subjekteve është paraqitur në **PasqyrënA18**, në Anekset bashkëlidhur.
Për vitin 2020 janë bërë 242 njoftime të pagesës së debisë dhe 0 njoftime për vendosje të masave siguruese, si dhe 0 masa shtrënguese (në Bankë, në ZRPP, në KSHA, në QKB) e 0 masa ekzekutuese (kalim gjendje nga llogaritë bankare në llogarinë e Bashkisë) me efekt të mbledhjes së borxhit. (për shkak të situatave te krijuara nga Tërmetet dhe Pandemia te cilat shkaktuan vështirësi te Bizneset).
Për vitin 2021 janë bërë 321 njoftime të pagesës së debisë dhe 0 njoftime për vendosje të masave siguruese, si dhe 47 masa shtrënguese Urdhër bllokime te llogarive bankare ne te gjitha bankat me shkresën nr. 7342 datë 24.12.2021 dhe 22 masa ekzekutuese (kalim gjendje nga llogaritë bankare në llogarinë e Bashkisë) me efekt të mbledhjes së borxhit.
Vlera prej **39,179,217 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak.

Në Bashkinë Shijak nuk ka institucione debitore për taksat dhe tarifat vendore.
Numri i subjekteve dhe vlera e debitorëve gjendje në fund të vitit ushtrimor e ndarë sipas Nj.A. është paraqitur në **PasqyrënA19**, në Anekset bashkëlidhur.
Subjetet juridike debitore (biznesi i madh) për Bashkinë Shijak, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse, janë paraqitur në **PasqyrënA20**, në Anekset bashkëlidhur.
Subjetet juridike debitore (biznesi i vogël) për Bashkinë Shijak, me vlerat e debisë dhe kamatëvonesat përkatëse, janë paraqitur në **PasqyrënA21**, në Anekset bashkëlidhur.
Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur vlera e gjobës (kamatëvonesës) në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë. Sa më sipër, nuk gjen zbatim ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 89 "*Njoftimi dhe kërkesa për të paguar*".
Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore, strukturat tatimore të bashkisë Shijak, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008. Gjithashtu nga strukturat tatimore të bashkisë Shijak për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penalbazuar në nenin 181, "*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*", të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. E. A. kryetar i Bashkisë Shijak, e znj. S. B. përgjegjëse e sektorit të të ardhurave dhe e znj. E. T. specialiste e sektorit të të ardhurave.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri:Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore*", me ndryshime, Kreut XI, "*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*", me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "*Kodi Penal i RSh*" me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar neni 9 "*Të drejtat dhe përgjegjësitë*" pika 1.3., neni 35, "*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*", me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.
Ndikimi/Efekti: Krijimi i një numri të madh debitorësh në vlera të konsiderueshme. Efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Shijak.
Shkaku: Mos marrja e masave të plota për ndjekjen e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej **39,217,179 lekë** (48,974,021 lekë kamatëvonesa),duke ndjekur rrugët e mëposhtme:
***a. T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.**
b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme.
c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.
d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Shijak, të merren masa

administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- **Pajisja me NUIS sekondare e Operatorëve Ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në Bashkinë Shijak:**

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të lejeve me NUIS /sekondare e Operatorëve Ekonomikë.
Situata: Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit Shërbimeve dhe infrastrukturës Publike, konstatohet se për periudhën 2019-2021 kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit dhe janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Shijak 99 subjekte.
Nga DTTV Bashkia Shijak është vepruar për ngarkimin në bazën e të dhënave, faturimin apo nxjerrjen e njoftim detyrimit për tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim, etj.) në masën prej 623,433 lekë/vit për 9 subjekte ndërtimi që janë pajisur me "Leje Ndërtimi" mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj. Rastet paraqiten në tabelën e mëposhtme e cila përfshin të dhëna si: emri dhe mbiemri i zhvilluesit, numri dhe data e lejes së ndërtimit, vendndodhja e objektit ku janë kryer punime ndërtimi, subjekti i ndërtimit, sipërfaqja e truallit dhe sipërfaqja e ndërtimit dhe tarifa detyrim për arkëtim.
Për periudhën 2019-2021 në 35 raste subjektesh me aktivitet ndërtimi të pajisura me "*Leje ndërtimi*", mbi bazën e të cilave kanë kryer punime ndërtimi për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet e veprimtarive të objekteve, janë ngarkuar dhe janë nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën e pastri-gjelbërim-ndriçimit, por nuk janë arkëtuar, të ardhurat për 9 raste, në vlerën 623,433 lekë dhe nuk janë arkëtuar 26 raste në vlerën debitore prej 510,020 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Shijak.
Operatorët ekonomikë të cilët kanë kryer veprimtari biznesi në Bashkinë Shijak, pa hapur NUIS-e sekondare dhe shuma e debisë së tyre (për investime të Bashkisë Shijak), janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën A22**, në Anekset bashkëlidhur.
Rastet e subjekteve që kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Shijak për periudhën 2019-2021, të cilët selinë kryesore administrative të tyre e kanë jashtë territorit të Bashkisë Shijak dhe që nuk janë faturuar apo nuk është nxjerrë njoftim vlerësimi për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit paraqiten në tabelat e mëposhtme: Për periudhën 2019-2021, bazuar në dokumentet dhe evidencat e paraqitura nga Drejtoria Ekonomike, Sektori i Buxhetit dhe Financës, rezulton se janë kryer investime, ku operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit janë subjekte me aktivitet ndërtimi, të cilat kanë kryer punime ndërtimi me fondet e buxhetit të shtetit, me fonde të zhvillimit të rajoneve dhe me fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë.
Operatorët ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në bashkinë Shijak për investitorë të ndryshëm nga Bashkia Shijak dhe pagesat e kryera prej tyre janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën A23**, në Anekset bashkëlidhur.
Operatorët ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në Bashkinë Shijak, për investime të Bashkisë Shijak dhe pagesat e kryera prej tyre janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën A24**, në Anekset bashkëlidhur.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore*" neni 40, "*Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare*", pika 1, ligji nr. 9723, datë 3.5.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*", ligji nr. 9723 datë 03.05.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*", i ndryshuar, neni 22 "*Detyrimi për regjistrim*", pika 4, neni 43

"*Përditësimi i të dhënave të regjistrimit*" pika 1/1.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën **81,820 lekë** nga moskryerja e njoftimeve për detyrimet përkatëse.
Shkaku: Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka bashkëpunuar mjaftueshëm me sektorët e tjerë, ose private, të cilët nuk kanë hapur adresa/nipte sekondare në territorin e Bashkisë Shijakut, nuk ka kryer njoftimet për detyrimet përkatëse të këtyre subjekteve, duke shkaktuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shijak në vlerën **81,820 lekë**.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Bashkia Shijak të saktësojë listat e bizneseve të ndërtimit që kanë qenë zbatuese të lejeve të ndërtimit dhe të projekteve të investimeve të prokuruara për vitet 2019-2021, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Shijak dhe që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për subjektet e listuara në Anekset bashkëlidhur, si dhe të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës totale**81,820 lekë**nga këto detyrime vendore.

- **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli i gjetjes: Parregullsi në procedurat e kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve/Liçencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, Bashkia Shijak.
Situata: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Shijak ushtrojnë aktivitetin 30 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse janë dy, R. G. me vendndodhje në Pjezë dhe R. G. me vendndodhje në Maminas.
Duke qenë se lëshimi i autorizimit për tregtimin e hidrokarbureve në Bashkinë Shijak nuk bëhet nga Drejtoria e të ardhurave, drejtoria e të ardhurave nuk ka informacion të plotë për subjektet të cilat kanë shlyer detyrimet.
Subjektet për të cilat nuk ka informacion në Bashkinë Shijak në lidhje me pagesat e kryera, do të konsiderohen debitorë dhe vlera e papaguar për pajisjen me autorizime do të konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Shijak.
Për marrjen e liçencës për tregtimin me pakicë të naftës, benzinës dhe nënprodukteve të tyre. Për periudhën 2020-2021, kanë paraqitur kërkesë 17 subjekte për pajisjen me liçencë për tregtimin me pakicë të naftës, benzinës dhe nënprodukteve të tyre. Sa më sipër bazuar në Ligjin nr. 8450 datë 24.02.1999 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"*, i ndryshuar, VKM-në nr. 970 datë 02.12.2015 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*", i ndryshuar, subjektet që kanë paraqitur kërkesat për marrjen e liçencave, i është kërkuar nga ana e komisionit për shqyrtimin e liçencave, pranë Bashkisë Shijak, plotësimi i dokumentacionit të plotë dhe të noterizuar brenda afatit 45 (dyzet e pesë) ditor, sipas VKM-së të sipërpërmendur.
Gjithashtu nga Bashkia Shijak është bërë me dije nga zyra juridike Shijak se: "*Në rast se personi juridik nuk ri paraqet dokumentacionin e kërkuar, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, autoriteti liçencues në përputhje me parashikimet ligjore ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për bllokimin e aktivitetit tregtar, deri në ri paraqitjen e dokumentacionit të plotë nga ana e personit juridik, për pajisjen e tij me liçencë për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë",* pika 6.1 Kreu II i VKM-së nr. 970 datë 02.12.2015.

Duke qenë se asnjë nga subjektet që kanë paraqitur kërkesë nuk ka plotësuar brenda afatit, dokumentacionin e nevojshëm, asnjë nga këto subjekte nuk është liçencuar, nga ana e Bashkisë Shijak, për mungesë dokumentacioni nga ana e tyre. Për periudhën e auditimit janë dhënë 3 liçenca me urdhër të brendshëm:
- Dokumentacioni për subjektin O. Sh.p.k. është shqyrtuar me urdhërin nr 269 datë 18.07.2019 i përbërë nga përgjegjës sektori shërbime H. K., ing Mekanik S. H. dhe Juriste A. M..
- Dokumentacioni për subjektin R. G. Sh.p.k. me vendodhje në Maminas është shqyrtuar me urdhërin nr 183 datë 22.05.2019 i përbërë nga përgjegjës sektori shërbime H. K., ing Mekanik S. H. dhe juriste A. M..
- Dokumentacioni për subjektin R. G. Sh.p.k. me vendodhje në Pjezë është shqyrtuar me urdhërin nr 183 datë 22.05.2019 i përbërë nga përgjigjës sektori shërbime H. K., ing Mekanik S. H. dhe Juriste A. M..
Vlera prej 27,000,000 lekë, e cila nuk është paguar nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak.
Të dhënat për shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën A25**, në Anekset bashkëlidhur.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 17-42 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Kjo procedurë është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*" i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa "b", pikat 9, 15.1 dhe 15.2.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore, në vlerën 27,000,000 lekë nga mospagesa e tarifës së plotë apo të një pjese të tarifës së liçencës/autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin e shitjes me pakicë të hidrokarbureve pa rinovuar liçencën e tregtimit.
Shkaku: Mos ndjekja e procedurave në bashkëpunim me institucionet përkatëse për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë liçencën.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për të pajisur subjektet me liçenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë. Gjithashtu, rekomandohet të bashkëpunojë në mënyrë më koherente me institucionet përkatëse, të cilët kanë tagrin për mbylljen e aktivitetit të subjekteve që nuk rinovojnë liçencën.

2.3. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, në ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", si dhe udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*".

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.
2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

- **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2021**

Në fund të periudhës ushtrimore, bilanci është plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe*

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar. Bilanci i vitit 2021 është përgatitur nga znj. P. A., me detyrë drejtor i drejtorisë ekonomike dhe Nëpunës Zbatues, është konfirmuar nga Kryetari i Bashkisë Shijak, z. E. A., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, si dhe është depozituar dhe miratuar nga dega e thesarit Durrës në datën 30.03.2022 dhe numër protokolli 616, brenda limiteve të përcaktuara me ligj.
Veprimet kontabile janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh, centralizator dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme.
Janë mbajtur dhe përditësuar rregullisht partitarët analitikë të të gjitha llogarive, përfshirë llogaritë inventariale të magazinës, për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë.
Janë përgatitur formatet e mëposhtëm:

- Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
- Formati 2: Pasqyra e performancës financiare;
- Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5: Pyetësor me shënimet shpjeguese;

Pasqyrat statistikore:

- Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7, a dhe b: - Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b);
- Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Qasja dhe metodologjia e auditimit.**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2021 ka marrë në konsideratë vlerën e precizionit **25,583,234 lekë** për shpenzimet dhe **30,784,521 lekë** për të ardhurat, sipas **Pasqyrës PF1,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga grupi i auditimit cilësohet se vlera 1,071,034,219 lekë i përket granteve të dhëna nga qeveria për rindërtimin, gjë e cila ka rritur në mënyrë të konsiderueshme nivelin e materialitetit.

- **Mbi vlerësimin e riskut.**

Nga grupi i auditimit janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.
Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:
- Kontrolli i brendshëm:
Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Shijak nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.
- Konfirmimet nga të tretët:
Subjekti që auditohet ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët (me degën e thesarit) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet:

Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor.

Nisur nga ky fakt, bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur (25,583,234) u filtruan të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajin nëntor - dhjetor 2021, në vlerën 79,483,660 lekë për muajin nëntor dhe 547,365,272 lekë për muajin dhjetor.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*" për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumentet vërtetues, Dokumentet e kontabilitetit, etj.

- **Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmimi nga të tretët:

Subjekti që auditohet i ka të konfirmuara (rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, etj.*

- **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021:**

Mbajtja e kontabilitetit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 "*Paraqitja e Pasqyrave Financiare*"), të përcaktuara në ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", si dhe nëUMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*"; nenit 3 dhe 6 të ligjit

nr. 9936, datë 26.06.2008 për "*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, etj.
Nuk ka patur komunikim me MFE për aspekte të trajtimeve kontabile, apo mbyllje vjetore.
Bilanci kontabël:
Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Shijak në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2021.
Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë:Aktivet, Detyrimet dhe Kapitali.
Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare.
Kjo situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumat për periudhat përkatëse.
Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit.
Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Shijak në 31.12.2021, sipas **formatit F1**, është paraqitur në **Pasqyrën PF2,** në Anekset bashkëlidhur.
Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivit dhe të pasivit.

Titulli i gjetjes: Mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2021. Probleme dhe mospërputhje e të dhënave në PF të disponueshëm në Bashkinë Shijak, me PF të disponueshëm në Degën e Thesarit.
Situata:

- **AKTIVET**

I. Aktivet Afat shkurtra
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre:
Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 3,333,757,720 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 2,992,785,725 lekë, me një diferencë prej 340,971,995 lekë më shumë në PF të subjektit. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 488,155,972 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 172,782,052 lekë, me një diferencë prej 315,373,920 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 "*Disponibilitete në Thesar*", në PF në subjekt ka vlerën 286,520,157 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre sipas bilancit, janë paraqitur në **Pasqyrën PF3,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga **Pasqyra PF3**, konstatohet se kjo llogari ka pësuar një rënie me 271,410,892 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Nga verifikimi i zërave të bilancit dhe krahasimi me PF në thesar, u konstatua se kjo llogari nuk kuadraton me shumën e llogarive përkatëse, konkretisht të llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", për shumën 40,708 lekë, llogarisë 85 "*Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit*" dhe llogarisë 12 "*Rezultatet e mbartura*", në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar, Kreu III, pikat 29, 30, 39, 50.
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit janë paraqitur në **Pasqyrën PF4,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga auditimi i ditarit të bankës, u konstatua se në debi të llogarisë 520 janë paraqitur gjithsej

772 transaksione, për vlerën totale **1,933,962,863 lekë**, ndërkohë që planifikimi ka qenë për vlerën totale **1,951,392,138** lekë sipas **Pasqyrës PF5,** në Anekset bashkëlidhur.

2. Gjendje Inventari qarkullues:

Llogaritë e inventareve paraqiten në vlerën totale 49,998,725 lekë, me një zbritje prej 2,080,765 lekë nga viti ushtrimor parardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Llogaria 31 "*Materiale*", në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 4,461,470 lekë, me një zbritje prej 2,333,649 lekë nga viti ushtrimor paraardhës, ndërsa llogaria 32 "*Inventar i imët*", paraqitet në vlerën 45,537,255 lekë, me një rritje prej 4,414,414 lekë nga viti ushtrimor parardhës. Nga rakordimi i listave bashkëlidhur urdhërit përkatës për inventarizimet, me kontabilitetin dhe Pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca përsa i përket llogarisë 32 "*Inventar i imët*" dhe llogarisë 31 "*Materiale*".

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti, të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

- **Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për Inventarizimet**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Shijak, në përgjigje të kërkesave që grupi i auditimit u parashtroi lidhur me Procedurën e inventarizimit të aktiveve, referuar UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë publike*", të gjitha njësitë e sektorit publikkanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Nga auditimi në Bashkinë Shijak, u audituan praktikat e procedurave të inventarizmit për vitet 2019, 2020 dhe 2021, nga ku rezultoi se, referuar UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", praktika e procedurës së Inventarizimit përmban:

- Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e NA, i cili disponohet;
- Përmbledhëse e Inventarëve të Njësive Administrative, e cila disponohet;
- Relacioni ose Raporti përmbyllës përpiluar dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit të Verifikimit Fizik të Inventareve, i cili nuk disponohet;
- Bazuar nëRaportin e Komisionit tëVerifikimit Fizik të Inventareve, vijohet me hapat e mëtejshme: me Komisionin e Vlerësimit të Vlerave materialedhe Komisionin e Asgjësimit të Vlerave materiale, zbatimi i procedurave të tyre monitorohen nga NZ, i cili disponohet;

1. Ngritja dhe përbërja e komisioneve është si më poshtë vijon:

- *Për vitin 2019* kjo procedurë ka filluar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues nr. 132 datë 20.11.2019 me nr. 4156 prot. datë 20.11.2019. Emrat sipas komisioneve janë paraqitur në **Pasqyrën I1**, në Anekset bashkëlidhur.

Për vitin 2020 kjo procedurë ka filluar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues nr. 264 datë 30.09.2020 me nr. 9186 prot. datë 30.09.2020.

Për vitin 2021 kjo procedurë ka filluar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues nr. 293 datë 14.09.2021 me nr. 5428 prot. datë 14.09.2021.

Titulli i Gjetjes: Mospërmbushje e kritereve rregullatore në lidhje me procedurën e Inventarizimit të Njësisë Publike-Bashkia Shijak.

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në procedurën e inventarizimit të aktiveve në Bashkinë Shijak, nisur nga evidencat që i'u vunë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatuan këto mangësi:

1. Në praktikat e Inventerizimit Fizik të aktiveve mungon Raporti përmbyllës hartuar dhe nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Verifikimit Fizik të Inventarëve, në kundërshtim kjo me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"

Kapitulli IV, pika 85/a, b, c;
2. Komisioni iverifikimit fizik të inventarëve (aktiveve) përbëhet nga të njëjtët anëtarë për 2 (dy) vite të njëpasnjëshme, në kundërshtim kjo me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", Kapitulli IV, pika 84;
3. Grupi i Menaxhimit Strategjikfunksionon pa hartuar një plan vjetor dhe grafik takimesh ku të përfshihen edhe hartimi e miratimi i strategjive për menaxhimin e aktiveve dhe minimizimin e risqeve të tyre.
- Bashkia Shijak për vitet 2019, 2020 dhe 2021 ka realizuar inventarizimin e aktiveve të njësisë duke mos i përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në aktet e sipërcituara;
- Komisioni i inventarizimit fizik, krijuar me Urdhër të titullarit për periudhën tre vjeçare rezulton të mos i ketë përmbushur detyrimet sipas përgjegjësive të përcaktuara, duke mos paraqitur kështu një pasqyrim për kushtet e ruajtjes së aktiveve, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve te konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 42-75 të Projektraportit të Auditimit)

Kriteri: Ligjit nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin*"; UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*"; "*Manuali për Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin*".

Ndikimi/Efekti: Nga Bashkia Shijakrezulton të mos jenë përmbushur detyrimet lidhur me procedurën e inventarizimit sipas përcaktimeve ligjore/nënligjore, duke mos paraqitur kështu një pasqyrim për kushtet e ruajtjes së aktiveve, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave apo dhe dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës; gjithashtu Grupi i Menaxhimit Strategjik deri më sot kafunksionuar pa hartuar një plan vjetor dhe grafik takimesh, ku të përfshihen edhe hartimi e miratimi i strategjive për menaxhimin e aktiveve dhe minimizimin e risqeve të tyre; mungesa e të cilave riskon sistemin e kontrollit të brendshëm mbi aktivet e njësisë.

Shkaku: Gjatë periudhës nën auditim 2019, 2020 dhe 2021, Nëpunësi Autorizues dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Shijak nuk kanë treguar vëmendjen dhe përgjegjshmërinë e duhur në përmbushjen e detyrimeve ligjore/nënligjore lidhur me procedurën e inventarizmit të aktiveve të Njësisë.

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi:Nëpunësi autorizues dhe Koordinatori i Riskut të Bashkisë Shijak të marrin masa për të zbatuar plotësisht procedurat standard të Inventarizimit të aktiveve të bashkisë si dhe në miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

3. Llogaritë e arkëtueshme:

Llogaritë e arkëtueshme paraqiten në vlerën totale 142,385,983 lekë, me një rritje prej 17,521,891 lekë nga viti ushtrimor parardhës, të cilat janë analizuar në vijim.

Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*" në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën debitore 109,858,332 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari për vitin 2021 paraqitet në vlerën 124,850,012 lekë, me një rritje neto në vlerën 14,991,680 lekë, shumë e konstatuar nga debitorët për pagesat e tarifave të popullatës dhe biznesit.

Nga auditimi i të ardhurave dhe debitorëve nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat debitore të familjarëve, bizneseve, nuk janë kontabilizuar rregullisht dhe plotësisht.

Kjo llogari përbëhet nga detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2021.
Në mënyrë analitike kjo llogari është paraqitur e detajuar në **Pasqyrën PF6,** në Anekset bashkëlidhur.
Në këtë nënzë paraqiten edhe tepricat debitore të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj kur ato klasifikohen si afatshkurtra.
Vihet re se gjatë vitit 2021 janë arkëtuar gjithsej 87,498,402 lekë nga Bashkia Shijak. Për vlerën e paarkëtuar, Bashkia Shijak është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e Urdhërave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit, përcaktuar në nenin 115 të Kodit Civil në R.SH dhe nenit 203 të Kodit Punës në R.SH (prej 3 vjetësh) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligjit "*Për kundërvajtjet Administrative*" (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.
Llogaria 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*", në fund të vitit ushtrimor 2020, paraqitet në bilanc nëvlerën 17,535,971 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llogarive 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*" në vlerën 1,473,118lekë, llog. 42 "*Detyrimet ndaj personelit*" në vlerën 11,296,648 lekë, llog. 431 "*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa*" në vlerën 1,005,059 lekë, llog. 435 "*Sigurime shoqërore*" në vlerën 3,230,650 lekë, llog. 436 "*Sigurime shëndetësore*" në vlerën 530,496 lekë dhe llog. 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" për muajin dhjetor në vlerën 2,449,895 lekë. Nga auditimi nuk u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 "*Operacione me shtetin, të drejta*" dhe vlerës të pasqyruar nëllogaritë e pasivit. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilanc është pasqyruar në mënyrë të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

4. Të tjera aktive afatshkurtra

Llogaria 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 7,114,212 lekë. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari është pakësuar për vlerën 2,479,700 lekë.Vlera e kësaj llogarie në bilanc është e barabartë me vlerën e paraqitur në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.
Detyrimet e Bashkisë Shijak, sipas natyrës janë paraqitur në **Pasqyrën PF7,** në Anekset bashkëlidhur.
Analiza e detajuar e llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*", është paraqitur në **Pasqyrën PF8,** në Anekset bashkëlidhur.
Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, nga pasqyra e mësipërme vërehet se një pjesë e konsiderueshme e tyre është e trashëguar nga periudha para reformës territoriale. Bashkia Shijak është e angazhuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura duke planifikuar për t'i likuiduar shuma brenda vitit 2022.
Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitorë e kësaj llogarie, ***është e kuadruar*** me shumën e llogarisë kreditore në pasiv të bilancit, përkatësisht me llogarinë 486 "*Kreditorë të ndryshëm*" në shumën 7,114,212lekë, në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", Kap. III, pika 42 dhe Aneksi 1, "*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*".
Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

II. Aktivet Afatgjata

1. Aktivet afatgjata jomateriale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas UMF nr. 8, datë 9.03.2018 përfshin primete emisionit dhe rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, liçenca dhe të ngjashme.
Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar.
Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:
Aktivet afatgjata jomateriale janë paraqitur në **Pasqyrën PF9,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*" në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2020 përbëhet nga 16 studime e projektime në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat e zbatimit për 6 projekte.
Detajet e llogarisë 202 "*Studime e kërkime*" janë paraqitur në **Pasqyrën PF10,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga verifikimi i llogarisë 202 "*Studime e kërkime*" për vitin 2021 rezulton se 6 studime dhe kërkime në vlerën prej 14,727,922 lekë janë vënë në zbatim, si më poshtë:

1. Planifikim i instrumentave vendore, Sheshi, "M. Mihali", Bregu i Lumit;
2. Ambient çlodhës te Shkolla "Muharrem Dollaku";
3. Projekti i ujësjellësit Shijak SHA;
4. Projekte Ndikimi në Mjedis;
5. Projekte rrugë vepra ujore Xhafzotaj;
6. Hartëzim toka/Projekti bujqësia.

Për këto asete njësia publike nuk ka përllogaritur norma amortizimi duke i qëndruar Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (*SKK-05*).
Në këto aktive nuk mund të amortizohen shpenzimet e projektimit. Për aq kohë sa objekti nuk ka filluar të ndërtohet, përfshirja në shpenzime në këtë periudhë nëpërmjet amortizimit është e gabuar.
Për vitin 2021 Bashkia Shijak nuk ka realizuar investime për blerje projektesh.
Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike, u konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte dhe studime, të cilat janë të pakontabilizuara, sipas **Listës Nr. 1**, në Anekset bashkëlidhur. Këto projekte dhe sudime janë hartuar në vite, edhe përpara periudhës së konsolidimit të pushtetit vendor.
Për sa më sipër, llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*", nuk paraqet gjendjen e vërtetë.

2. Aktive afatgjata materiale:

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5, i përmirësuar.
Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar.
Përfshirja e tepricave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:
Vlera e kësaj nënrubrike është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.
Shtesat në këtë nënrubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.
Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në Bashkinë Shijak, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat e VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015 "*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*". Në Bashkinë Shijak nuk

disponohet asnjë dokument në lidhje me pasuritë publike të transferuara në vite me VKM të posaçme në komunat të cilat sot janë pjesë e Bashkisë Shijak dhe nuk është bërë asnjë regjistrim i pasurive publike të cilat tashmë i përkasin Bashkisë Shijak.
Detajet e nënrubrikës Aktive afatgjata materiale janë paraqitur në **Pasqyrën PF11,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 210 "*Toka, Troje, Terrene*" në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 24,806,885 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 121,880 lekë nga vitit paraardhës.
Detajet e llogarisë 210 "*Toka, Troje, Terrene*"janë paraqitur në **Pasqyrën PF12,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 211 "*Pyje kullota plantacione*" në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 602,126,502 lekë, me një shtesë prej 101,401,121 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Kjo llogari përbëhet vetëm nga një pasuri në NjA Xhafzotaj.
Gjendja e llogarisë 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*" në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 602,126,502 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 101,401,121 lekë nga vitit paraardhës. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 192,384,096 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF13** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*" në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 2,059,475,669 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 280,718,485 lekë nga vitit paraardhës. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.
Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF14** në Anekset bashkëlidhur.
Për këto zëra të aktivit nuk është mbajtur regjistër aktivesh ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivit, vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim. Gjithashtu identifikohet problematika e mosbërjes së inventarizimit vjetor të tyre, në kundërshtim me pikat 31 dhe 74 të udhëzimit 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" dhe 215 "*Mjete transporti*", paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

Inventarizimi i aktiveve:

Në Bashkinë Shijak inventarizimi është kryer çdo vit në bazë të urdhërave përkatës të titullarit, sipas të cilëve janë ngritur komisionet për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të pikave 73, 74 dhe pika 81 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", me ndryshime.
Për vitin 2021, nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit materiale të asnjë llogarie.
Gjendja e llogarisë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 38,877,609 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 66,311,229 lekë, me një shtesë në vlerën 27,433,620 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për instalime teknike, makineri,

pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit. Nxjerrje jashtë përdorimi nuk ka.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 38,238,078 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 28,073,151 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" është analizuar në **Pasqyrën PF15** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 215 "*Mjete transporti*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 45,102,001 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 47,999,056 lekë, me një shtese në vlerën 2,897,055 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për mjete transporti, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit. Nxjerrje jashtë përdorimit nuk ka.
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 25,551,223 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 22,447,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Gjithashtu, nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se mjetet e punës, si ekskavatorë, skrepa, etj., janë pasqyruar në mënyrë të gabuar në këtë llogari, pasi duhet të ishin pasqyruar në llogarinë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*".
Gjendja e llogarisë 215 "*Mjete transporti*" është paraqitur në **Pasqyrën PF16,** në Anekset bashkëlidhur.
Gjendja e llogarisë 218 "*Inventar ekonomik*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 28,678,471 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 29,019,247 lekë, me një shtese në vlerën 340,776 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për materiale inventari si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa pakësimet janë për vlerën e amortizimit,
Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 9,974,016lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënlerësuar për vlerën 19,045,231lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale.
Gjendja e llogarisë 218 "*Inventar ekonomik*" është paraqitur në **Pasqyrën PF17,** në Anekset bashkëlidhur.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 42-75 të Projektraportit të Auditimit)
Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*"; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*"; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", UMF nr. 64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*"; SKK nr. 5 "*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*" pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 "*Investime në Pjesëmarrje*" pika 35, etj.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Shijak.
Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi 1: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Shijak, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

Rekomandimi 2: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Rekomandimi 3: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 "*Toka, troje terrene*"; 211 "*Pyje, Kullota, Plantacione*"; 212 "*Ndërtime e konstruksione*"; 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*"; 214 "*Instalime teknike, makineri e pajisje*" dhe 215 "*Mjete transporti*". Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

Rekomandimi 4: Nga Bashkia Shijak, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 "*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*".

Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (Formati nr. 7/b) Viti 2021.

Për vitin 2020, amortizimi i AQT-ve (Llogaria 219 "*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*"), nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto janë paraqitur në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar, pika 3.7 "*Amortizimi*", si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar.

Nga auditimi i Bilancit, Formati 7, a dhe b: "*Pasqyrat mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike (a) dhe me vlerën neto (b)*", u konstatua se Amortizimi i Akumuluar në Bashkinë Shijak për Aktivet Afatgjata Materiale në fillim të vitit 2021 paraqitet për vlerën 516,982,731 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet për vlerën 639,580,446 lekë.

Nga PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera e llogarisë 219 "*Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*", është 0 lekë.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhë ushtrimore, shtesën e kostos së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabile neto të aktiveve të shitura, të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivit.

Normat e amortizimit të përdorura për vitin 2021 janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%

Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

Për aktivet në proces nuk është llogaritur amortizim, në përputhje me përcaktimet ligjore.
Formati 7/a i bilancit, "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*" është paraqitur në **Pasqyrën PF18,** në Anekset bashkëlidhur.
Formati 7/b i bilancit, "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)*" është paraqitur në **Pasqyrën PF19,** në Anekset bashkëlidhur.

3. Aktivet Afatgjata Financiare:
Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2021 paraqiten në vlerën 0 lekë. E njëjta vlerë konstatohet edhe në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.

Titulli i gjetjes: Mangësi në kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për periudhën e audituar.
Situata: Nga auditimi, u konstatua se Aktivet Afatgjata Financiare, të cilat në fund të vitit 2021 paraqiten në vlerën 0 lekë. E njëjta vlerë konstatohet edhe në PF të disponueshme në sistemin e thesarit.
Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se Bashkia Shijak, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2021 paraqitet si:
- Aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a., me NUIS L62401502P e cila është shoqëri aksionare me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*". Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 35,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **3,500,000 lekë**. Kjo shoqëri është themeluar në datën 07.11.2016.
- Aksionare me 11.6% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a., me NUIS J61819502V e cila është shoqëri aksionare me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*". Numri total i aksioneve është 446,968 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 446,968,000 lekë. Kjo shoqëri është themeluar në datën 30.08.2000. Bashkia Shijak zotëron 51,848.2880 aksione me të drejtë vote, në vlerën totale **51,848,288 lekë**.

Për sa më sipër, llogaria 26 "*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*" nuk paraqet vlerën reale për shumën **55,348,288 lekë** (3,500,000 lekë nga Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a. dhe 51,848,288 lekë nga Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a.), në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*", me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materialë*" pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 "*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 42-75 të Projektraportit të Auditimit)
Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*"; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*"; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", UMF nr. 64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*"; SKK nr. 5 "*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*" pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 "*Investime në Pjesëmarrje*" pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve financiare të Bashkisë Shijak.
Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e aktiveve financiare.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** "*Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a.*", me NUIS L62401502P, për 100% të aksioneve, në vlerën **3,500,000 lekë**; **2.** "*Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a.*", me NUIS J61819502V, për 11.6% të aksioneve në vlerën **51,848,288 lekë**, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **55,348,288 lekë** në debi të llogarisë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

4. Investimet:
Gjendja e llogarive 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale*" dhe 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" në datën 31.12.2020 paraqitet në vlerën 18,948,027 lekë dhe po aq paraqitet në datën 31.12.2021. Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 18,948,027 lekë, përkatësisht 0 lekë në llogarinë 230 "*Investime për aktive afatgjata jo materiale*" dhe 18,948,027 lekë në llogarinë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*".
Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 "*Aktive afatgjata materiale*". Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se investimi i vetëm në proces në Bashkinë Shijak është "*Ndërtimi i sallës së lojrave me dorë*", i nisur në vitin 2004 me fonde të buxhetit të shtetit, për të cilin është ndërprerë financimi.
Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021, sipas aneksit nr. 9 pika 2. Nga auditimi, u konstatua se megjithëse për disa objekte kanë përpunduar punimet, janë paraqitur situacionet përfundimtare dhe janë bërë likuidimet dhe janë kontailizuar vlerat përkatëse sipas rastit, nga Bashkia Shijak nuk janë ngritur komisionet për ndjekjen e zbatimit të kontratave dhe marrjen përpundimtare në dorëzim të objekteve, duke bllokuar rrjedhimisht edhe kthimin e garancisë së punimeve për objektet e përfunduara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë nëkundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2,"*Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël)*", "*Aktive afatgjata materiale*",etj.
Investimet sipas kontratave të lidhura në vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë paraqitur në **Pasqyrën PF20** në Anekset bashkëlidhur.

- **PASIVET**

I. Pasivet Afat shkurtra
1. Llogari të pagueshme:
Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme.
Në datën 31.12.2021, shuma e llogarive 401-408 "*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*", 42 "*Detyrime ndaj personelit*", 431 "*Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa*", 435 "*Sigurime shoqërore*", të 436 "*Sigurime shoqërore*", është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 "*Operacione me shtetin*" në vlerën 17,535,971 lekë.

Analiza e grupit të llogarive të pagueshme për vitin 2021 është paraqitur në **Pasqyrën PF21,** në Anekset bashkëlidhur.
Detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2020 për Llogarinë 401-408 "*Furnitorë e llogari të lidhura me to*", në bilanc paraqiten në vlerën 1,473,118 lekë. Në këtë llogari paraqiten detyrimet e prapambetura për muajin dhjetor të vitit 2021.
Analiza e Llogarisë 401 "*Furnitorë për mallra, produkte e shërbime*", është paraqitur në **Pasqyrën PF22,** në Anekset bashkëlidhur.
Llogaria 42 "*Personeli e llogari të lidhura me to*", analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 11,296,648 lekë, përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit për muajin dhjetor 2021. Në fund të vitit 2020 ka qenë 10,710,619 lekë, me një rritje në vlerën 586,029 lekë.
Llogaria 431"*Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa*", analizuar e kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 1,005,059 lekë përfaqëson detyrimet për tatimin mbi pagat e personelit në muajin dhjetor 2021. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.
Llogaria 435 "*Sigurime shoqërore*",e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 3,230,650 lekë përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore në muajin dhjetor 2020. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.
Llogaria 436 "*Sigurime shëndetësore*",e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabile për vlerën 530,496lekë, përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimet shëndetësore në muajin dhjetor 2021. Kjo vlerë është likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.
Në mbyllje të periudhës raportuese, llogaritë kreditore 42;431;435 dhe 436 në vlerën totale 16,062,853 lekë, përfaqësojnë detyrime të njësisë publike Bashkia Shijak për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore,shëndetësore si dhe tatimin mbi pagë, të përllogaritura për pagesë në muajin dhjetor 2021, të cilat janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2022.

2. Detyrime të tjera afatshkurtra:

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike.
Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.
Llogaritë për detyrime të tjera afatshkurtra janë paraqitur në **Pasqyrën PF23,** në Anekset bashkëlidhur.

Titulli i gjetjes: Mosmarrja në dorëzim e kontratave të investimeve të mbyllura, mbajtja e garancisë përtej limiteve kohore.
Situata: Gjendja e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 16,256,336 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 30,270,542 lekë ose me rritje në vlerën 14,014,206 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme dhe gjendjen e pullave që janë likuiduar në muajin janar të vitit 2022.
Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", në sistemin e Thesarit vlera është 30,311,342, pra me një diferencë në vlerën 40,800 lekë.
Në mënyrë analitike, Llogaria 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Pasqyrën PF24,** në Anekset bashkëlidhur.
Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Shijak, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e

Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 42-75 të Projektraportit të Auditimit)

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kap II "*Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 "*Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 "*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike*" i ndryshuar pikat 42 – 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Ndikimi/Efekti: Mosmarrja në dorëzim e objekteve janë verime të cilat nuk garantojnë nëse objekti është zbatuar sipas kushteve teknike të projekt/preventivave, si është realizuar dhe nëse është realizuar brenda kushteve teknike. Gjithashtu, moskryerja e këtij veprimi bën që nga Bashkia Shijak të mos bëhet vlerësimi i subjekteve mbi cilësinë e punimeve dhe nëse këto subjekte janë shoqëri të besueshme për kryerjen e punimeve me cilësi dhe në afatet të caktuar, si dhe vënia në vështirësi ekonomike e OE, të cilëve iu nevojiten fondet e ngurtësuara për të vazhduar veprimtarinë e tyre ekonomike.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit ligjor nga personat përgjegjës.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Gjendja e llogarisë 4341 "*Operacione me shtetin (detyrime)*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 103,505,982 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 131,651,224 lekë ose me rritje në vlerën 28,145,242 lekë.

Gjendja e llogarisë 467 "*Kreditorë të ndryshëm*"në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,682,245 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,449,895 lekë ose me rritje në vlerën 767,650 lekë.

Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

Në mënyrë analitike, Llogaria 467 "*Kreditorë të ndryshëm*" në fund të vitit 2021 është paraqitur në **Pasqyrën PF25,** në Anekset bashkëlidhur.

- **KAPITALI**

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 (shtojca 4), njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta.

Gjendja e llogarisë 101 "*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*" (Kapitali i nënshkruar) në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,653,626,526lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,753,834,209 lekë ose me rritje në vlerën 100,207,683 lekë.

Gjendja e llogarisë 85 "*Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore*" (Humbja/fitimi i ushtrimit)në

datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 542,378,071 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 256,249,615 lekë ose me zbritje në vlerën 286,128,456 lekë. Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.
Llogaritë 105 "*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*" dhe 106 "*Teprica e Granteve kapitale të huaja*", si për periudhën ushtrimore paraardhëse, ashtu edhe për periudhën ushtrimore të mbyllur, janë me vlerën 0 (zero).
Grantet kapitale të brendshme mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proçes të institucioneve (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe marrë në dorëzim.
Pasqyra e performances financiare në fund të vitit 2020 është paraqitur në **Pasqyrën PF26,** në Anekset bashkëlidhur.
Sipas SKK nr. 2, në pasqyrën e performancës duhet të përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë kontabël.
Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për rrethanat në vijim:
a. Efektet e korrigjimeve të gabimeve dhe ndryshimet në politikat kontabël paraqiten si rregullime retrospektive të periudhave të mëparshme dhe jo si pjesë e fitimit ose humbjes në periudhën në të cilën ato lindin (*SKK 1 - Parimet e Përgjithshme për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare*);
b. Si pjesë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, jashtë fitimit/ humbjes së vitit, njihen katër lloje të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;

i. fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj (*SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit*);
ii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar (*SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale);*
iii. fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje (*SKK 3 "Instrumentet Financiare";*
iv. Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet

Emërtimet e zërave duhet të respektohen, megjithëse mund të shtohen zëra të tjerë ose nënkategori të zërave, nëse ato ndikojnë në përmirësimin e qartësisë dhe lexueshmërisë së pasqyrës së performancës.
Pasqyra e përformancës tregon, minimalisht, zërat që paraqesin shumat të cilat përbëjnë fitimin ose humbjen. Fitimi ose humbja është rreshti i fundit i kësaj pasqyre.

- **<u>TË ARDHURAT</u>**

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:
Llogaria 70 "*Të ardhurat nga taksat e tatimet*", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 112,294,216 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 117,643,749 lekë ose me rritje në vlerën 5,349,533 lekë.
Të ardhurat nga taksat e tatimet janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF27,** në Anekset bashkëlidhur.
Llogaria 71 "*Të ardhura jotatimore*", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 23,923,180 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 24,062,937 lekë ose me rritje në vlerën 139,757 lekë.
Të ardhurat jotatimore janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF28,** në Anekset bashkëlidhur.
Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime

ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

2. Të ardhura të tjera:

Llogaria 72 "*Grante korente*", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 1,214,721,170 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 1,849,030,148 lekë ose me ulje në vlerën 634,308,978 lekë. Në zërin "*Të Ardhura të tjera*", në llogarinë 787 "*Tërheqje nga seksioni i investimeve*", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 84,264,834 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 542,378,071 lekë ose me rritje në vlerën 458,113,237 lekë. Nëllogarinë 73 "*Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve*", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 14,148,231 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 2,080,765 lekë ose me ulje në vlerën 12,067,466 lekë.

Së bashku këto llogari kanë pasur një ulje në vlerën 186,790,089 lekë nga viti ushtrimor i mëparshëm.

Grantet korente, të ardhurat e tjera dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve janë paraqitur të detajuara në **Pasqyrën PF29,** në Anekset bashkëlidhur.

- **SHPENZIMET**

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

Llogaria 600 "*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 148,639,943 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 159,208,477 lekë ose me ulje në vlerën 10,568,534 lekë.

Llogaria 601 "*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 25,000,272 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 26,553,137 lekë ose me rritje në vlerën 1,552,865 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Durrës me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për pagat dhe kontributet shoqërore e shëndetësore janë paraqiturtë detajuara në **Pasqyrën PF30,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Testimi i llogarisë 600 "*Paga dhe shpërblime*"**

Për vitin 2021, referuar kërkesave të VKM-së nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Shijak është miratuar me Urdhër nr. 321 datë 12.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë. Numri i miratuar i punonjësve të Bashkisë Shijak, funksioneve të transferura dhe gjendjes civile ka qenë 300 punonjës. Sipas listëpagesave janë paguar mesatarisht 281 punonjës për Bashkinë Shijak. Sa më sipër, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.

Numri i punonjësve sipas listëpagesave është paraqitur në **Pasqyrën PF31,** në Anekset bashkëlidhur.

Numri i punonjësve sipas Vendimit nr. 321 datë 12.10.2021 është i ndarë si më poshtë:

1.	Administrata e Bashkisë	181 punonjës
2.	Njësia Admnistrative Xhafzotaj	12 punonjës
3.	Njësia Admnistrative Maminas	11 punonjës
4.	Njësia Admnistrative Gjepalaj	14 punonjës
5.	Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri	14 punonjës
6.	Funksione të transferuara nga arsimi	59 punonjës
7.	Specialist pyjesh (funksion i transferuar)	1 punonjës
8.	Specialist i bujqësisë (funksion i deleguar)	2 punonjës
9.	Gjendja civile	6 punonjës
Totali:		**300 punonjës**

Sipas listëpagesave të muajve janar 2021, shtator 2021 dhe dhjetor 2021 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listëpagesat dhe përmbledhësja e listëpagesave janë nënshkruar nga Drejtoresha e Drejtorisë Ekonomike, znj. P. A. dhe nga Kryetari i Bashkisë Shijak.
Janë mbajtur listëprezencat, të cilat janë nënshkruar nga Përgjegjëse e sektorit të Burimeve Njerëzore, znj. E. Sh. dhe nga Kryetari Bashkisë z. E. A..

Hartimi i listëpagesave për vitin 2021:

Me përzgjedhje u audituan listëpagesat e muajve janar 2021 dhe dhjetor 2021, nga ku u konstatua se janë plotësuar konform rregullave të përcaktuara. Listëpagesat janë plotësuar mbi bazën e listëprezencave mujore të nënshkruara nga znj. E. Sh.. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "*Kodi i Punës*", i ndryshuar.
Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Shijak, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH*".

- **Auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës**

I. Struktura e Bashkisë Shijak dhe emërimet e personelit të saj, janë kompetencë e Kryetarit të bashkisë bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 9/c dhe neni 64/e, ë, j, k; ndërsa Këshilli Bashkiak ushtron kompetencat e tij bazuar në nenin 54/ç, dh të po këtij ligji, në miratimin e nivelit të pagave dhe buxhetit ku konfirmohet edhe numri i përgjithshëm i punonjësve në strukturë.
a. Për strukturën organizative janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë:
- *Për Vitin 2019*, me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 35, datë 04.02.2019, me nr. 453 prot., datë 04.02.2019 "*Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Shijak*";
- *Për vitin 2020*, me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 117, datë 05.11.2019, me nr. 3914 prot., datë 15.11.2019 "*Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Shijak*";
- *Për vitin 2021*, me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 280, datë 28.10.2020, me nr. 10014 prot., datë 28.10.2020 "*Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Shijak*";
- *Për vitin 2022*, me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 321 datë 12.10.2021 me nr. 5971 prot. datë 12.10.2021 "*Për miratimin e Strukturës organizative të Bashkisë Shijak*".

b. Për miratimin e nivelit të pagave dhe të buxhetit janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me:
- VKB nr. 20, datë 24.07.2017,"*Për miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruarnë Bashkinë Shijak*", për 61 pozicione në strukturë,në zbatim të VKM nr. 165 datë 02.03.2017 "*Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*";
- *VKB nr. 6, datë 31.01.2018,*"*Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr. 20, datë 24.07.2017"Për miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruarnë Bashkinë Shijak*"për 6 pozicione në strukturë;
- *VKB nr. 15, datë 15.03.2019,*me nr. 882/7 prot., datë 18.03.2019 "*Për disa ndryshime në VKB nr. 20, datë 24.07.2017 "Për miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruarnë Bashkinë Shijak*"për 5 pozicione në strukturë;
- *VKB nr. 29, datë 27.05.2019,* me nr. 1730/9 prot., datë 28.05.2019 "*Për disa shtesa në VKB nr. 20, datë 24.07.2017"Për miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruarnë Bashkinë Shijak*" për 3 pozicione në strukturë;
- *VKB nr. 39, datë 28.06.2019,* me nr. 2161/6 prot. datë 01.07.2019 "*Për disa ndryshime në VKB nr. 20, datë 24.07.2017"Për miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruarnë Bashkinë Shijak*" për 2 pozicione në strukturë;
- *VKB nr. 63, datë 13.07.2020,* me nr. 5357/5 prot., datë 17.07.2020 "*Për disa shtesa në VKB nr. 20, datë 24.07.2017"Për miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë të*

zgjedhur dhe emëruarnë Bashkinë Shijak" për 3 pozicione në strukturë;
- *VKB nr. 2, datë 29.01.2021,* me nr. 752/2 prot. datë 02.02.2021 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr. 20, datë 24.07.2017"Për miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruarnë Bashkinë Shijak*" për 2 pozicione në strukturë;
- *VKB nr. 46, datë 02.07.2021,* me nr. 4208/5 prot. datë 07.07.2021 "*Për një shtesë në VKB nr. 20 datë 24.07.2017"Për miratimin e pagave të punonjësve dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe emëruarnë Bashkinë Shijak*" për 1 pozicion në strukturë.
Nga auditimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak, rezultoi se VKB nr. 20 datë 24.07.2017 dhe VKB nr. 6 datë 31.01.2018 janë të pa regjistruara në regjistrin e protokollit të institucionit, në kundërshtim kjo me "*Normat Tekniko-Profesionale Dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë*" neni 13 dhe neni 19.
II. - *Për vitin 2019,* me V*KB nr. 68, datë 20.12.2018, "Për miratimin e PBA 2019-2021 dhe numrit të punonjësve të Bashkisë Shijak - viti 2019"*, konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 1574/1 prot, datë 07.01.2019, si dhe ndryshimet në Strukturë me Urdhërin e Kryetarit nr. 117, datë 05.11.2019 dhe nr. 3914 prot., datë 05.11.2019;
- *Për vitin 2020,* me VKB nr. 34*, datë 24.12.2019,"Për miratimin e PBA 2020-2022 dhe numrit të punonjësve të Bashkisë Shijak – viti 2020*", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Durrës me shkresën nr. 82/1 prot., datë 10.01.2020*;*
Për vitin 2021, - me VKB nr. 123 datë 24.12.2020 "Për miratimin e PBA 2021-2023 dhe numrit të punonjësve të Bashkisë Shijak - viti 2021", konfirmuar nga Prefekti Durrës me shkresën nr. 35/4 prot., datë 19/01/2021.
Numri i punonjësve sipas Njësive Administrative për vitet 2019-2021 është paraqitur në **Pasqyrën P1**, në Anekset bashkëlidhur.
Konstatim: Mbi hartimin dhe përmbajtjen e strukturës së Bashkisë Shijak. Nga auditimi rezulton se Struktura e institucionit nuk është hartuar/miratuar sipas kërkesave të Ligjit nr. 139/2015 neni 64/j, ku specifikohen elementët që duhet të përmbajë Struktura organizative e NjVQV: pozicioni, kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil, numrin e personave për çdo pozicion, në përputhje kjo me legjislacionin në fuqi.
c. Referuar strukturave të miratuara dhe buxheteve përkatëse të tyre, vihet re se është shtuar një sektor në strukturën e vitit 2020, ndërsa numri i punonjësve është rritur çdo vit.
Konstatim: Nga auditimi rezulton se në Strukturën Organizative dhe Organigramën e Bashkisë Shijak, nuk janë përfshirë njësia e MZSH (funksion i ri) dhe ajo e Gjendjes Civile (funksion i deleguar), kur këto dy njësi funksionojnë nga koordinimi i procedurave të NJVQV me Njësitë përgjegjëse (Drejtoritë e Përgjithshme) në Strukturat e Institucioneve Qendrore respektive; si dhe janë pjesë përbërëse e Listëprezencës dhe Listëpagesës së Bashkisë; në moszbatim të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 9/c; Ligjit nr. 10129/2009 "*Për gjendjen civile*" i ndryshuar, neni 60, pika 1, neni 61, pika 1/c, neni 63, pika 3, neni 68; ligjit nr. 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi*" neni 7, pikat 1, 3, 4, neni 9, neni 15, pikat 3, 4, neni 16.
Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e Bashkisë Shijak rezulton se nuk janë planifikuar pozicione me status "*ekselent*", në mos zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr. 164 datë 05.10.2017; si dhe pozicione me status "*Grup i veçantë*" ku përfshihen 17 kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ, në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*" i ndryshuar neni 5; me ligjin nr. 93/2014 "*Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara*" dhe me ligjin nr. 15/2019 datë 13.03.2019 "*Për Nxitjen e Punësimit*". Por rezulton se nga Bashkia Shijak janë respektuar aktet ligjore e nënligjore për dhënie përparësie rekrutimit të personave të grupit të vecantë dhe konkretisht punonjëse e Protokoll Arkivës në Njësinë administrative Maminas është "*person me aftësi të kufizuar*".

d. Punësimi në Bashkinë e Shijakut mbështetet në ligjin nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", ligjin nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ligjin nr. 7961 /1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu I, pikat 1 dhe 2. Ndërsa për njësitë e MZSH-së dhe Policisë Bashkiake i shtohen edhe kriteret e veçanta të përcaktuara në ligjin nr. 152/2015 "*Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin*", shoqëruar me aktet nënligjore të tij VKM nr. 895/2016 "*Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të Gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*",VKM nr. 350/2017 "*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*"; Mbi ligjin nr. 8224, datë 15. 5. 1997 "*Për policinë e bashkisë*", VKM nr. 313/2002 "*Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së Bashkisë dhe Komunës*" i ndryshuar.

Kjo procedurë rregullohet nga Strukturat e Bashkisë Shijak përshkruar si më poshtë:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM-së nr. 243/2015 i ndryshuar;
- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pikat e, ë, f, g të ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetqëverisjen Vendore*".

Numri i punonjësve sipas Strukturës në Bashkinë Shijak, është paraqitur në **Pasqyrën P2**, në Anekset bashkëlidhur.

Nga Bashkia Shijak janë miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë "*Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil*" dhe dërguar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit si më poshtë vijon:

Për vitin 2019: Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Shijak nr. 20 datë 06.02.2019 me nr. 501 prot., datë 06.02.2019 dhe dërguar në SHKP me shkresën nr. 501/1 datë 07.02.2019;

Për vitin 2020: Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Shijak nr. 23 datë 29.01.2020 me nr. 491 prot., datë 29.01.2020 dhe dërguar në SHKP me shkresën nr. 491/1 datë 29.01.2020;

Për vitin 2021: Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Shijak nr. 28 datë 19.01.2021 me nr. 426 prot., datë 19.01.2021 dhe dërguar në SHKP me shkresën nr. 426/1 datë 03.02.2021;

Planifikimi dhe plotësimi i Strukturës me Status të Nëpunësit Civil, është paraqitur në **Pasqyrën P3**, në Anekset bashkëlidhur.

e. Në Bashkinë Shijak janë punësuar punonjës me kontratë me kohë të pjesshme, konform Ligjit nr. 7961 /1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar;

Nga auditimi i listëpagesave për vitet 2019, 2020 dhe 2021 për punonjësit me kohë të pjesshme është zbatuar VKM nr. 77, datë 28.1.2015 "*Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor*" Kreu I, pika 1/a; Kreu II e III.Planifikimi dhe plotësimi i Strukturës me Kod Pune, është paraqitur në **Pasqyrën P4**, në Anekset bashkëlidhur.

f. Nga auditimi mbi punësimet me kontrata provizore, në Bashkinë Shijak nuk rezulton praktikë pune e punësimit provizor; nga DBNJ e Bashkisë Shijak, u informuam se punonjësit provizorë u punësuan në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në shërbim të nevojave të komunitetit pas fatkeqisë natyrore të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 dhe Pandemisë Covid-19.

Punësimi i punonjësve provizorë, është paraqitur në **Pasqyrën P5**, në Anekset bashkëlidhur.

g. Nga auditimi i listëpagesave dhe listëprezencave të muajve janar, shkurt, prill, maj, qershor, korrik, nëntor dhe dhjetor për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk rezulton të ketë tejkalim të numrit të punonjësve nga struktura e miratuar me Vendim të KB dhe Kryetarit.

h. Të dhënat mbi largimet dhe emërimet

e punonjësve nga puna për Bashkinë Shijak është paraqitur në **Pasqyrën P6**, në Anekset

bashkëlidhur.
Nga të dhënat në **Pasqyrën P6,** rezulton se numri i emërimeve të punonjësve në Bashkinë Shijak është më i lartë se ai i lagimeve të tyre dhe se numri i vendeve vakante në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve në strukturë është: *për vitin 2019* - 3.6%; *për vitin 2020* - 4.2% dhe *për vitin 2021* - 5.4%. Kjo si rezultat i rritjes së numrit të punonjësve në strukturë.
i. Në lidhje me personat e larguar nga puna procedura e të cilëve është shoqëruar me padi në Gjykatën Administrative, rezultoi një person, konkretisht E. Z., me profesion inxhiniere ndërtimi, e cila ka filluar marrëdhëniet e punës me Bashkinë Shijak në datën 25.06.2016 dhe është larguar në datën 21.03.2018 me masë disiplinore. Aktualisht, padia është për gjykim në Apel, pasi Bashkia Shijak ka fituar gjykimin në shkallën e parë.
j. Referuar ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", neni 21, "*Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil*", pjesë e strukturës janë edhe njësitë: Planifikimi dhe Përballimi i Emergjencave Civile dhe Krizave (PPECK), Policia Bashkiake (PB), Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH), Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit (IVMT), të cilat i nënshtrohet edhe zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore specifike, përsa i përket numrit të punonjësve dhe kërkesave të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët për t'u emëruar në këto njësi. Të dhënat për numrin e punonjësve janë paraqitur në Pasqyrën P7 në Anekset bashkëlidhur.
Lidhur me zbatimin ose jo të akteve ligjore/nënligjore të emërimeve në këto njësi, grupi i auditimit auditoi disa nga dosjet e personelit të njësive respektive.
1. Njësia e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave – (PPECK)
Kjo njësi përbëhet nga 1 Përgjegjës Sektori, me kategori page III-a/1 dhe 5 specialistë, me kategori page IV-a. Të dhënat për sektorin PPECK janë paraqitur në **Pasqyrën P8**, në Anekset bashkëlidhur.
Njësia e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Cicile dhe Krizave (PPECK) i ushtron funksionet e veta në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 "*Për Mbrojtjen Civile*"; si dhe bashkëpunimi dhe bashkërendimi me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile sipas VKM nr. 747, datë 20.11.2019 "*Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare* të *Mbrojtjes Civile*".
Nga auditimi rezulton se ka përputhje në klasifikim të kategorisë dhe nivelit të pagave konform VKM nr. 165 datë 02.03.2016 "*Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar me VKM nr. 177, datë 08.03.2017.
2. Njësia e Policisë Bashkiake – (PB)
Kjo njësi përbëhet nga 1 Përgjegjës Sektori, 6 specialistë, me pagë sipas lidhjes 8 dhe 2 shoferë. Të dhënat për sektorin PPECK janë paraqitur në **Pasqyrën P9**, në Anekset bashkëlidhur.
Njësia e Policisë Bashkiake i ushtron funksionet e veta në zbatim të ligjit nr. 8224/1997 "*Për Policinë Bashkiake*"; VKM nr. 313 /2001 "*Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës*", i ndryshuar; VKM nr. 165 datë 02.03.2016 "*Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar me VKM nr. 177, datë 8.3.2017; Nga auditimi nuk rezulton papërputhshmëri me aktet ligjore/nënligjore të sipërcituara.
3. Njësia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi – (MZSH)
Kjo njësi përbëhet nga 1 Përgjegjës Sektori, me gradë Kryeinspektor, 1 inspektor parandalimi me gradë inspektor zjarrfikës dhe 12 punonjës të nivelit bazë, me gradë asistent zjarrfikës. Të dhënat për sektorin PPECK janë paraqitur në **Pasqyrën P10**, në Anekset bashkëlidhur
Njësia e MZSH-së i ushtron funksionet e veta në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 "*Për mbrojtjen*

nga zjarri dhe Shpëtimin" si dhe Aktet nënligjore të tij VKM nr. 895/2016 "*Kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponnduese për çdo grade, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", VKM nr. 350/2017 "*Për trajtimin me pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*" etj.

Konstatim 1: Referuar Ligjit 152/2015 "*Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi*", neni 7, pika 5 "*Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin **1** zjarrfikës profesionist për **1500-2000** banorë*"; pika 6, "*Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se **14** zjarrfikës, personel profesionist*", nga auditimi rezulton se njësia e MZSH-së në Bashkinë Shijak, nuk i plotëson kriteret përsa i përket numrit të personelit profesionist; nisur nga numri i banorëve, Bashkia Shijak hyn në kategorinë nga 20000-50000 banorë dhe duhet që njësia e MZSH-së në këtë bashki të ketë personel nga 19 deri në 23 zjarrfikës profesionistë.

- Me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr. 293 datë 08.09.2020, me nr. 8589 prot. datë 16.09.2020 (të Bashkisë Shijak), është kryer inspektim në MZSH në qarkun Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Gjirokastër, me object "*Evidentimi i veprimtarisë dhe performancës së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin*".

Konstatim 2: Nga auditimi i dosjeve të personelit për njësitë që krahas kritereve bazë, duhet të plotësojnë edhe kritere të veçanta për emërimin e personelit, rezulton se Akti i emërimit të *shefit të sektorit të MZSH* të emëruar në këtë detyrë me Urdhër nr. 195 datë 28.04.2016 i Drejtorit të MZSH pranë Ministrisë së Brendshme dhe me gradën *Inspektor*; Urdhërin nr. 99 datë 10.01.2019 i Drejtorit të MZSH pranë Ministrisë së Brendshme ku i jepet grada "*Inspektor zjarrfikës"* (specifikimet e reja sipas ligjit nr. 152/2016*),* në zbatim të VKM nr. 895 datë 21.12.2016 "*Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën*" pika 1, 2 dhe Lidhja 1; VKM nr. 350 datë 19.04.2017 "*Për trajtimin me pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", Lidhja 1; Ky akt është hartuar duke mos i përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i procedurave administrative*" dhe Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e "*Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë*", Shtojca 1, Model 3, në të cilin duhet të jenë domosdoshmërisht këta 2 elementë: pozicioni i punës sipas strukturës organizative, paga bazë dhe shtesat mbi të.

Konstatim 3: Grupi që ka zhvilluar inspektiminnë zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr. 293 datë 08.09.2020, në shkresën bashkëshoqëruese me Titull "*Protokoll Inspektim - Për vlerësimin e veprimtarisë së strukturave të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi*", ku përshkruhen në mënyrë të detajuar gjithë hapat e kësaj procedure: baza ligjore, subjektet që do të inspektohen, tematika e inspektimit, metodologjia e inspektimit, nga auditimi rezulton se në përfundim të Inspektimit, nuk ka asnjë raport përfundimtar, ku të përshkruhet situata dhe një vlerësim mbi veprimtarinë dhe performancën e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, duke mos përmbushur misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara (përcaktuar te paragrafi i fundit i shkresës).

4. Njësia e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Vendor – (IMTV)

Kjo njësi përbëhet nga 1 Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor, i cili paguhet me kategorinë III-a/1, 6 inspektorë të cilët paguhen me kategorinë IV-a dhe 2 shoferë, të cilët paguhen sipas pikës 19. Të dhënat për sektorin PPECK janë paraqitur në **Pasqyrën P11**, në Anekset bashkëlidhur.

Kjo njësi funksionet e saj i mbështet në zbatim të Ligjit nr. 9780 date 16.07.2007 "*Për Inspektimin e ndërtimit*" i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*" dhe VKM nr. 894 datë 04.11.2015 "*Për unifikimin*

e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore".

Konstatim 4: Lidhur me arsimin/llojin e diplomimit e personelit përbërës të Njësisë së IMTV-së, rezulton se personeli i saj nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit 183/2014 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme*", si dhe riskon performancën e aktivitetit të saj, referuar dhe përcaktimeve të VKM-së nr. 894 datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*".

k. Mbulimi me fonde i pagave të punonjësve sipas periudhave është paraqitur në **Pasqyrën P12**, në Anekset bashkëlidhur.

Nga të dhënat e **Pasqyrës P12**, konstatohet se me fondet e veta Bashkia Shijak mbulon nga 19-36% të fondit të pagave, ndërsa diferenca mbulohet me grandet e ardhura nga Pushteti Qendror 64-81%.

Nga auditimi mbi fondet e pagave, **konstatohet** se: nuk ka fond për shpërblime mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve; gjithashtu nuk zbatohet as VKM nr. 68/2018 "*Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore*".

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.) për Bashkinë Shijak rezulton se:

- Struktura organizative dhe organigrama të hartohen sipas përcaktimeve ligjore/nënligjore në fuqi;
- Për emërimet në punë të zbatohen aktet ligjore/nënligjore lidhur me plotësimin e kritereve bazë dhe të veçanta që kërkon çdo pozicion në strukturë;
-Të zbatohen aktet ligjore/nënligjore lidhur me trajtimin me pagë të punonjësve, shpërblime/ dieta ushqimore punonjësve me Kod Pune, duke parashikuar në PBA-të dhe buxhetin vjetor të Bashkisë në Llog. 600 "*Paga dhe përfitime të punonjësve*", nënllog. përkatëse.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore:

- Neni 8 *"Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit",* si dhenenet 9, 10, 11 të ligjit nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*"
- Udhëzimi i vitit 2016 "*Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve*"
- Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*"

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime, emërime etj.), për periudhën 01.01.2019-31.12.2021) në Bashkinë Shijak.

Situata: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2019-31.12.2021) në Bashkinë Shijak, nisur nga evidencat që i'u vunë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatuan:**1.**Nga auditimi i dosjeve të personelit për njësitë që krahas kritereve bazë, duhet të plotësojnë edhe kritere të vecanta për emërimin e personelit, referuar: Propozimi i Kryetarit të Bashkisë Shijak prill 2016; Urdhër nr. 195 datë 28.04.2016 i Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së "*Për emërim në detyrë si Shef i Sektorit të MZSH-së me gradën "Inspektor"*"; Akt i Emërimit në punë me nr. 1341/1 datë 03.05.2020 nga Kryetari i Bashkisë Shijak ku përshkuhen të gjithë elemntët e nevojshëm një akti, emërimin tuaj si "*shef i sektorit zjarrfikës dhe emergjencave civile*" me vlerën e pagës bazë dhe datën e fillimit të marrëdhënieve financiare; Urdhërin nr. 99 datë 10.01.2019 i Drejtorit të MZSH pranë Ministrisë së Brendshme "*Për gradimin e punonjësit të shërbimit të MZSH-së z. A. Xh. në funksionin e Shefit të Sektorit të Shërbimit të MZSH-së Bashkia Shijak t'i jepet grada "Inspektor Zjarrfikës"*", ku përcaktohet baza ligjore/nënligjore referuese (specifikimet e reja sipas ligjit nr. 152/2016*)*, në zbatim të VKM nr. 895 datë

21.12.2016 "*Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën*", pika 1,2 dhe Lidhja 1; VKM nr. 350 datë 19.04.2017 "*Për trajtimin me pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", Lidhja 1; Listëpagesave për vitet në auditim 2019, 2020 dhe 2021, nga Drejtoria e Financës (tani Drejtoria Ekonomike) në Bashkinë Shijak shefi i sektorit të MZSH-së është trajtuar në mënyrë të padrejtë me nivelin e pages të gradës "kryeinspektor". Ndonëse në strukturë është emëruar në pozicionin e Shefit të Sektorit të MZSH-së, ka gradën "Inspektor zjarrfikës", trajtimi me pagë i tij është bërë në kundërshtim me aktet ligjore të sipërcituara;

2.Grupi nga Ministria e Brendshme, që ka zhvilluar inspektiminnë zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr. 293 datë 08.09.2020, në shkresën bashkëshoqëruese me Titull "*Protokoll Inspektim - Për vlerësimin e veprimtarisë së strukturave të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi*", ku përshkruhen në mënyrë të detajuar gjithë hapat e kësaj procedure: baza ligjore, subjektet që do të inspektohen, tematika e inspektimit, metodologjia e inspektimit, nga auditimi rezulton se në përfundim të Inspektimit, nuk ka asnjë raport përfundimtar, ku të përshkruhet situata dhe një vlerësim mbi veprimtarinë dhe performancën e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, duke mos përmbushur misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara (përcaktuar te paragrafi i fundit i shkresës) si edhe ato të Ligjit nr. 152/2015"*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*" neni 7 pika 2 ku citohet se "*Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, në varësi të ministrit, përfaqëson autoritetin më të lartë teknik, mbikëqyrës dhe drejtues të shërbimit të MZSH-së. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së organizohet në drejtori me funksione inspektimi, koordinimi, trajnimi dhe logjistike*", neni 25 "*Kriteret për fitimin e gradës*" e neni 26 "*Arsimimi dhe trajnimi për fitimin e gradës*", rezulton të mos ketë përmbushur detyrat funksionale të përcaktuara në ligj.

3. Lidhur me arsimin/llojin e diplomimit e personelit përbërës të Njësisë së IVMT-së, rezulton se personeli i saj nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit 183/2014 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme*", si dhe riskon performancën e aktivitetit të saj, referuar edhe përcaktimeve të VKM-së nr. 894 datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*";

4.Nga auditimi mbi fondet e pagave, rezulton se nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk është planifikuar në planet vjetore dhe ato afatmesme "*fond për shpërblime*" mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve (vlerësimi 6 dhe 12 mujor); gjithashtu për punonjëst me Kod Pune nuk zbatohet VKM nr. 68/2018 "*Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore*".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 42-75 të Projektraportit të Auditimit)

Kriteri:ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore";* ligji nr. 152 /2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*"; VKM nr. 895 datë 21.12.2016 "*Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën*" pika 1, 2 dhe Lidhja 1; VKM nr. 350 datë 19.04.2017 "*Për trajtimin me pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", Lidhja 1; ligji 183/2014 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme*"; VKM-së nr. 894 datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*"; ligji nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", neni 62 "*vlerësimi i nëpunësit civil*", si dhe Lidhja 2"*Formulari i vlerësimit të punës për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*"; "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar dhe VKM nr. 68/2018 "*Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës*

për pushimet vjetore"; VKM nr. Nr. 77, datë 28.1.2015 "*Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor*" .

Ndikimi/Efekti: Nga Bashkia Shijakrezulton të mos jenë përmbushur detyrimet e dispozitave ligjore qërregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime emërime etj.), për periudhën 01.01.2019-31.12.2021), duke riskuar performancën e njësive përkatëse në strukturën e saj dhe mosmotivimin në rritjen e performancës së punonjësve të Bashkisë.

Shkaku: Gjatë periudhës nën auditim 2019, 2020 dhe 2021, Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Drejtoria e Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria Juridike të Bashkisë Shijak, nuk kanë treguar vëmendjen e duhur në përmbushjen e detyrimeve të dispozitave ligjore/nënligjore qërregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime emërime etj.).

Rëndësia:E mesme

Rekomandimi 1. Kryetari i Bashkisë Shijakdhe Drejtoria e Burimeve Njerëzoretë marrin masa për të zbatuar plotësisht kriteret e përgjithshme dhe ato të vecanta të dispozitave ligjore, për emërimin e punonjësve në njësitë e strukturës së Bashkisë, për të realizuar me efektivitet funksionet e saj në dobi të komunitetit;

Rekomandimi 2. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masat për trajtimin me nivelin e pagës sipas akt emërimeve dhe akteve ligjore si dhe në përllogaritjen e vlerës së përfituar pa të drejtë të shefit të MZSH-së emëruar në detyrë me gradën inspektor në masën prej 9000 (nëntë mijë) lekë çdo muaj, nga data e fillimit të përftimit të pagës me gradën si "*kryeinspektor zjarrfikës*" deri në datën e konstatimit nga ana e grupit të auditimit të KLSH-së; gjithashtu nga data fundore e përfitimit të kësaj page e për periudhën në vazhdim të trajtohet me nivelin e pagës "*inspektor zjarrfikës*".

Rekomandimi 3. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në fazën e përgatitjes së projekt buxhetit vjetor dhe PBA -ve, të shikoj mundësinë e krijimit të një fondi në buxhet për shpërblim financiar bazuar në vlerësimin 6 dhe 12 mujor në Formularin e performancës për punonjësit me 'Status civil' dhe përcaktimeve të VKM nr. 68/2018 për punonjësit me "*Kod pune*", me qëllim motivimin e punonjësve për realizimin me efektivitet të objektivave institucionale;

Rekomandimi 4/1. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme, të tregojë vëmendjen e duhur në zbatimin e detyrave funksionale për inspektimin, koordinimin, trajnimin dhe logjistikën' e shërbimit të MZSH-së, në përmbushje të misionit të saj për inspektim e parandalim, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Rekomandimi 4/2. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme të tregojë vëmendjen e duhur në zbatimin e detyrave funksionale për arsimimin/kualifikimin dhe trajnimin e personelit zjarrfikës për fitimin e gradës, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

Llogaria 602 "*Blerje mallra dhe shërbime*", në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 103,142,272 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 118,154,279 lekë ose me ulje në vlerën 15,012,007 lekë.

Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Durrës me të njëjtën vlerë.

Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime janë paraqitur në **Pasqyrën PF32,** në Anekset bashkëlidhur.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike

në ditarin e bankës, në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dyja palët.
Urdhër-shpenzimet janë përpiluar në bazë tëdokumenteve vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit, si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin përkatës.
Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadron me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:
Me arkë janë kryer transaksione financiare të ndryshme, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa etokës bujqësore, taksat e tarifat familjare dhe gjoba të policisë bashkiake,për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim të lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore. Nëvitin 2021, nga arka janë kryer një transaksion pagese për kthime të parapagimeve të tarifës për kopshtet dhe çerdhen Shijak. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.
Për vitin 2021, janë prerë Mandat Arkëtime në vlerën 20,316,148 lekë dhe libri i arkës është mbyllur me MA nr. 2068 datë 30.12.2021, në vlerën 33,640 lekë.
Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2021 janë derdhur totalisht në mënyrë periodike në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është 0(zero) lekë. Gjithashtu, është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël, i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM-në nr. 783, datë 22.11.2006 "*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*", si dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" pikat 63,64. Nga Drejtoria e Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit Durrës për të ardhurat.

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Shijak nuk ka pasur subvencione.

4. Transferimet korente:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Transferime korente, në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 79,470,788 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 81,684,725 lekë ose me rritje në vlerën 2.213.937 lekë.

5. Shpenzimet financiare:

Përfshihen transferimet për nivele të ndryshme të qeverisë për institucione të ndryshme qeveritare. Kjo llogari per Bashkine Shijak është per vlerat zero.

Titulli i gjetjes: Probleme në lidhje me kryerjen e veprimeve kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit.

Situata:

- **Kontratat e lidhura për vitet 2019-2021:**

Për vitin 2019, janë kryer investime në total për 4 objekte, në vlerën totale të prokuruar 244,857,920 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 225,732,891 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2019 ka qenë 206,845,237 lekë ndërsa realizimi ka qenë 100%. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 18,887,694 lekë.

Me fonde të deleguara nga Qeveria dhe FZHR kanë qenë gjithsej 2 objekte, në vlerën totale të prokuruar 135,788,416 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 134,129,999 lekë, ndërsa realizimi ka qenë 126,123,856 lekë. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 7,323,133. Kjo është 10% pjesëmarrje nga të Ardhurat e Bashkisë Shijak.

Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 2 objekte, në vlerën totale të prokuruar 109,069,504 lekë, për vlerën totale të kontraktuar 91,602,892 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2019 ka qenë 80,721,381 lekë ndërsa realizimi ka qenë 100% lekë. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 10,881,511 lekë.

Për vitin 2020, janë kryer investime në total për 6 objekte, në vlerën totale të prokuruar 476,404,329 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 443,389,157 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2020 ka qenë 290,833,671 lekë ndërsa realizimi ka qenë 336,833,671 lekë. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 106,555,486 lekë.

Me fonde të deleguara nga Qeveria kanë qenë gjithsej 6 objekte, në vlerën totale të prokuruar 376,480,329 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 355,049,000 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2020 ka qenë 82,158,967 lekë ndërsa realizimi ka qenë 292,158,967 lekë. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 62,890,033 lekë.

Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 1 objekte, në vlerën totale të prokuruar 99,924,000 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 88,340,157 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 15,000,000 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2020 ka qenë 29,674,704 lekë ndërsa realizimi ka qenë 44,674,704 lekë. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 43,665,453 lekë.

Për vitin 2021, janë kryer investime në total për 4 objekte, në vlerën totale të prokuruar 382,781,946 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 369,399,872 lekë. Likuidimi në periudhat e mëparshme ka qenë për vlerën 177,759,872 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2021 ka qenë 106,027,287 lekë, i realizuar 100%. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 263,372,585 lekë.

Me fonde të deleguara nga Qeveria kanë qenë gjithsej 2 objekte, në vlerën totale të prokuruar 255,409,686 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 250,302,214 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2021 ka qenë 70,720,667 lekë, i realizuar 100%. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 179,581,547 lekë.

Me fondet e veta kanë qenë gjithsej 2 objekte, në vlerën totale të prokuruar 127,372,260 lekë, për vlerë totale të kontraktuar 119,097,658 lekë. Planifikimi për t'u likuiduar gjatë vitit 2021 ka qenë 35,306,620 lekë, i realizuar 100%. Vlera e mbetur për t'u financuar ka qenë 83,791,038 lekë.

Konkluzion: Për vitet 2019-2021 janë lidhur dhe zbatuar 31 kontrata në vlerën totale 1,162,219,494 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike

dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet nëllogarinë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*".

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" Aneksi 1 "*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*", Kreu I, "*Të përgjithshme*", pika 8, Kreu II, "*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, "*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pika 32.

U kryen procedura testimi analitik me përzgjedhje kampionesh për zona të ndryshme llogarish, duke bërë verifikim të fondeve të planifikuar dhe të përdorura, të përllogaritjeve të vlerave për transaksione financiare të kryera si rezultat i ndodhjes së ngjarjeve ekonomike si dhe verifikimi i përputhshmërisë ligjore i dokumentacionit shoqërues mbështetës nëse ato ishin kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" neni 40 "*Shpenzimet*" pika 1.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 42-75 të Projektraportit të Auditimit)

Kriteri: Ligji nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*"; VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "*Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre*" i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; UMF nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*"; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", UMF nr. 64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*"; SKK nr. 5 "*Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale*" pikat 55, 56, 57; SNK nr. 28 "*Investime në Pjesëmarrje*" pika 35, etj.

Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në vërtetësinë dhe besueshmërinë e llogarive financiare lidhur me gjendjen e aktiveve të Bashkisë Shijak.

Shkaku: Moszbatimi i plotë dhe i rregullt i procedurave kontabël për regjistrimin e veprimeve financiare.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi:Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*" dhe në kredi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*".

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situcion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" dhe në kredi të llogarisë 404 "*Furnitorë për investime*".

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 "*Furnitorë për investime*" dhe në kredi të llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*".

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për **investimet e papërfunduara/në**

proçes, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*", në kredi të llogarisë 720 "*Grant korrent i brendshëm*" dhe në kredi të llogarisë 4342, "*Operacione me shtetin (të drejta)*" për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.
Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 "*Aktive afatgjata materiale*" dhe në kredi të llogarisë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*".
Me kapitalizmin e aktivit,(për aktivet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*", në kredi llogarisë 105 "*Grante të brendshme kapitale*" për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 "*Shtesa të fondit bazë*" dhe në debi të llogarisë 105 "*Grante të brendshme kapitale*" për vlerën e aktiveve të blera.
Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. E. A., me funksion Kryetar aktual i Bashkisë Shijak, znj. P. A., me funksion Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, znj. R. K. dhe znj. B. O., me funksion Specialiste Finance.

2.4. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj, për periudhën 01.07.2020 – 31.12.2021.

2.4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve:

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021. Pas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi, mbështetur në VKB përkatëse "*Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Shijak*". Gjithashtu, në të gjitha rastet e shtesave dhe pakësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB-ve përkatëse, në përputhje me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 dhe "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 4 "*Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik*", pika 1. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4, pika 3.
Për periudhën objekt auditimi (01.01.2019 – 31.12.2021), nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat e sektorëve përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për secilin vit ushtrimor. Programimi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB-të përkatëse për çdo vit.
Pasqyrat e prokurimeve të realizuar gjatë periudhës objekt auditimi janë paraqitur në Anekset bashkëlidhur.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Shijak *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në vijim:

Në vitin 2019 janë realizuar 9 procedura prokurimi nga të cilat 2 procedura janë realizuar me fonde të buxhetit të shtetit dhe 7 procedura janë realizuar me të ardhurat e bashkisë Shijak.
Vlera e kontratave të lidhura gjatë vitit 2019 është 200,184,042 lekë pa TVSH, nga të cilat 94,407,584 lekë ose 47% e vlerës së përgjithshme janë vënë në dispozicion nga të ardhurat e bashkisë Shijak dhe 105,776,458 lekë ose 53% e vlerës së përgjithshme janë vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Procedura 2019	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratës
Gjithsej	**36**	**235,858,691**	**206,808,347**
- Të hapura	4	204,048,267	188,110,743
- Kërkesë me propozim	5	15,533,116	12,073,303
- Blerje të vogla	27	16,277,308	12,457,618
Sipas llojit			
- Investime	4	204,048,267	188,110,743
- Mirëmbajtje, shërbime, blerje	32	31,810,424	18,697,604

Burimi: *Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Shijak*

Në vitin 2020 janë realizuar 13 procedura prokurimi nga të cilat 6 procedura janë realizuar me fonde të buxhetit të shtetit dhe 7 procedura janë realizuar me të ardhurat e bashkisë Shijak.
Vlera e kontratave të lidhura gjatë vitit 2020 është 420,681,967 lekë pa TVSH, nga të cilat 119,170,567 lekë ose 28% e vlerës së përgjithshme janë vënë në dispozicion nga të ardhurat e bashkisë Shijak dhe 301,511,399.76 lekë ose 72% e vlerës së përgjithshme janë vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Procedura 2020	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratës
Gjithsej	**34**	**463,465,613**	**424,135,928**
- Të hapura	4	419,179,933	392,605,210
- Kërkesë me propozim	9	33,024,151	28,076,757
- Blerje të vogla	22	11,261,529	8,703,945
Sipas llojit			
- Investime	4	419,179,933	392,605,210
- Mirëmbajtje, shërbime, blerje	30	44,285,680	31,530,718

Burimi: *Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Shijak*

Në vitin 2021 janë realizuar 9 procedura prokurimi nga të cilat 2 procedura janë realizuar me fonde të buxhetit të shtetit dhe 7 procedura janë realizuar me të ardhurat e bashkisë Shijak.
Vlera e kontratave të lidhura gjatë vitit 2021 është 347,650,236 lekë pa TVSH, nga të cilat 137,445,058 lekë ose 40% e vlerës së përgjithshme janë vënë në dispozicion nga të ardhurat e bashkisë Shijak dhe 210,205,178.49 lekë ose 60% e vlerës së përgjithshme janë vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Procedura 2021	Nr.	Fondi Limit	Vlera e Kontratës
Gjithsej	**38**	**374,548,899**	**356,653,360**
- Të hapura	7	356,378,879	346,240,986
- Kërkesë me propozim	2	2,325,200	2,024,950
- Blerje të vogla	29	15,844,819	12,687,423
Sipas llojit			
- Investime	4	346,974,020	337,443,546
- Mirëmbajtje, shërbime, blerje	34	27,574,879	19,209,814

Burimi: *Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Shijak*

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi, 01.01.2019-31.12.2019, konstatohet se janë kryer gjithsej 108 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit 1,073,873,203 lekë, me vlerë kontrate 987,597,635 lekë ose me një zbritje nga

fondi limit prej 8.03% e fondit të prokuruar; nga të cilat 15 procedura "*Tender i hapur*", me vlerë të fondit limit 979,607,079 lekë dhe vlerë kontrate 926,956,939 lekë ose me një zbritje nga fondi limit prej 5.37% e fondit të prokuruar; 16 procedura "*Kërkesë me propozim*", me vlerë të fondit limit 50,882,467 lekë dhe vlerë kontrate 42,175,010 lekë ose me një zbritje nga fondi limit prej 8.7% e fondit të prokuruar; si dhe 78 procedura "*Blerje të vogla*", me vlerë të fondit limit 43,383,656 lekë dhe vlerë kontrate 33,848,986 lekë ose me një zbritje nga fondi limit prej 22% e fondit të prokuruar.

Mbi bazën e të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur të fondeve të prokuruar për periudhën e audituar, grupi i auditimit vlerësoi për auditim 12 procedura, me vlerë të fondit limit 970,202,220 lekë dhe vlerë kontrate 918,159,499 lekë ose 93% e vlerës totale të kontratave.

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 9 procedura prokurimi publik, nga të cilat 4 procedura të hapura dhe 5 kërkesë për propozim.

Në procedurat e realizuara kanë marrë pjesë 60 operatorë ekonomikë nga të cilët:

- 41 OE janë pjesëmarrës në procedurat e hapura, nga të cilët 6 OE janë kualifikuar dhe 35 OE janë skualifikuar. Nuk ka procedura të hapura me pjesëmarrje të vetem 1 OE.
- 19 OE janë pjesëmarrës në procedurat kërkesë për propozim, nga të cilët 10 OE janë kualifikuar dhe 9 OE janë skualifikuar. Ka 1 procedurë kërkesë për propozim me pjesëmarrje të vetëm 1 OE.

Gjatë vitit 2020 janë realizuar 13 procedura prokurimi publik, nga të cilat 4 procedura të hapura dhe 9 kërkesë për propozim.

Në procedurat e realizuara kanë marrë pjesë 73 operatorë ekonomikë nga të cilët:

- 28 OE janë pjesëmarrës në procedurat e hapura, nga të cilët 7 OE janë kualifikuar dhe 21 OE janë skualifikuar. Ka 1 procedurë të hapur me pjesëmarrje të vetëm 1 OE.
- 45 OE janë pjesëmarrës në procedurat kërkesë për propozim, nga të cilët 26 OE janë kualifikuar dhe 19 OE janë skualifikuar. Ka 3 procedura kërkesë për propozim me pjesëmarrje të vetëm 1 OE.

Gjatë vitit 2021 janë realizuar 9 procedura prokurimi publik, nga të cilat 4 procedura të hapura dhe 5 kërkesë për propozim.

Në procedurat e realizuara kanë marrë pjesë 23 operatorë ekonomikë nga të cilët:

- 10 OE janë pjesëmarrës në procedurat e hapura, nga të cilët 4 OE janë kualifikuar dhe 6 OE janë skualifikuar. Ka 1 procedurë të hapur me pjesëmarrje të vetëm 1 OE.
- 13 OE janë pjesëmarrës në procedurat kërkesë për propozim, nga të cilët 9 OE janë kualifikuar dhe 4 OE janë skualifikuar. Ka 3 procedura kërkesë për propozim me pjesëmarrje të vetëm 1 OE.

Të dhënat janë paraqitur më poshtë në formë tabelore:

Procedura të hapura				
Viti	OE pjesëmarrës	OE të kualifikuar	OE të skualifikuar	Procedura me 1 OE
2019	41	6	35	-
2020	28	7	21	1
2021	10	4	6	1
Kërkesë për propozim				
Viti	OE pjesëmarrës	OE të kualifikuar	OE të skualifikuar	Procedura me 1 OE
2019	19	10	9	1
2020	45	26	19	1
2021	13	9	4	3

Burimi:*Bashkia Shijak*

Titulli gjetjes: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2019-31.12.2021), në drejtim të mënyrës së zhvillimit të procedurave të prokurimit, janë konstatuar shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, të cilat paraqiten si vijon:

Situata:

- Asnjë nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe KVO nuk vërtetohet të kenë kryer trajnime të ndryshme;
- Nuk janë inventarizuar dhe numërtuar të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit dhe nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit;
- Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet Përmbledhëse të cilat janë miratuar nga Titullari i AK, nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit;
- Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet dhe DST nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Shijak;
- Nuk ka urdhër të Titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve/preventivave (të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinën e bashkisë), kontratave të punimeve/shërbimeve dhe blerjes së mallrave.
- Personat që kanë përgatitur projektet, relacionet, preventivat dhe grafikët e punimeve nuk janë në të gjitha rastet të liçencuar nga autoritetet teknike përkatëse për kryerjen e projektimeve në fusha të caktuara specifike.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas rasteve specifike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes";* neni 23, *"Specifikimet teknike",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, neni 52 "*Hapja e ofertave*", neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, neni 59, pika 4, "*Përllogaritja e vlerës limit të kontratës*", pikat 1 dhe 2: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 26, pika 5, "*Kontratat për punë publike*", neni 61, pika 2, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij; ligji nr. 9154, datë 06.11.03 "*Për Arkivat*" dhe aktet ligjore në zbatim të tij, nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*"; UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*": etj.

Shkaku: Mosnjohja e kuadrit ligjor dhe pakujdesia në trajtimin e materialit dokumentar.

Ndikimi/Efekti: Vendosja e personave të patrajnuar siç duhet, mangësitë në hartimin dhe ruajtjen e materialit dokumentar, mungesa e urdhërave specifikë për ngritjen e komisioneve, etj., shkaktojnë parregullsi në mënyrën e përdorimit të fondeve publike dhe lënë vend për përdorimin pa Efektivitet, Efiçencë dhe Ekonomicitet të tyre.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar.

Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit në përputhje me aktet ligjore/nënligjore, me qëllim planifikimin e saktë të fondit dhe përdorimin me efektivitet dhe eficencë të tij.

Rekomandimi 3: Sektori i Procedurave të Prokurimit, të marrë masat për inventarizimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit dhe të zbatimit të përfunduara dhe dorëzimin e tyre në Sektorin e Arkivës, Bashkia Shijak.

Rekomandimi 4: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Shijak dhe jo me

protokoll apo regjistër të veçantë.

Rekomandimi 5: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që asnjë pjesë e projekteve të mos bëhet nga punonjës të pakualifikuar dhe të papajisur me liçencat profesionale përkatëse, sipas fushës specifike të profesionit. Në rast se nuk është mundësia për të prokuruar projektet e investimeve, të merren masa për të kontraktuar specialistë të jashtëm, të cilët të kenë kualifikimet e nevojshme për të bërë projektet, sipas rastit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë paraqitur observacione me shkresën e protokolluar në Bashkinë Shijak me nr. 3502/28, datë 08.08.2022, "*Observacion (komente e shpjegime) mbi gjetjet e auditimit të reflektuara në Projekt Raportin e Auditimit "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Shijak*", protokolluar në KLSH me nr. 260/13 prot., datë 10.08.2022, ku personat e atakuar kanë shprehur objeksionet si më poshtë:

Shënim:
Meqenëse kundërshtitë e paraqitura kanë një volum shumë të madh materiali, është paraqitur vetëm thelbi i kundërshtive, në formë të përmbledhur dhe jo dokumentacioni bashkëlidhur. Kundërshtitë janë pjesë e dosjes së auditimit në formë fizike dhe në CD.
Grupi i auditimit, pasi i lexoi këto kundërshtime me shumë kujdes, pa anshmëri, me gjykim dhe skepticizëm profesional, thekson se do të marrë në konsideratë vetëm shpjegimet të cilat janë shoqëruar me dokumente dhe argumente ligjore shtesë, si dhe me prova të reja shkresore të cilat kanë mbështetje ligjore, të panjohura për grupin e auditimit gjatë zhvillimit të auditimit në terren, ndërsa ato shpjegime të cilat nuk gjejnë argumente, por janë vetëm justifikuese nuk do merren në konsideratë dhe do të trajohen përsëri në Projekt Raportin e Auditimit.

Pretendimi i subjektit:

1. *Në lidhje me konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Asnjë nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe KVO-së nuk vërtetohet të kenë kryer trajnime të ndryshme"* ***sqarojmë se*** *personi përgjegjës për prokurimin publik znj. E. O., që është njëkohësisht edhe anëtare e Njësisë së Prokurimit ka marrë pjesë në çdo trajnim të organizuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, por nuk është pajisur me certifikatë trajnimi.*
2. *Në lidhje me konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Asnjë nga dosjet e audituara nuk është e inventarizuar dhe e numëruara"* ***sqarojmë se*** *pretendimi nuk qëndron. Dokumentet e dosjeve të prokurimit publik janë të inventarizuara , të sistemuara sipas rendit kronologjik dhe numëruara" por nuk janë arkivuar (marrë në dorëzim) nga punonjësja e arkivit për shkak të volumit të madh të dosjeve dhe mungesës së hapsirës në zyrën e Arkivës. Për të provuar sa u përmend më sipër bashkëlidhur gjeni kopje të inventarit të dosjeve të prokurimit publik të zhvilluara gjatë periudhës objekt auditimi 2019-2021.*
3. *Në lidhje me konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet Përmbledhëse të cilat janë miratuar nga titullari i AK, nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajne në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit"* ***sqarojmë se*** *pretendimi nuk qëndron. Raportet përmbledhëse të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave janë hartuar duke reflektuar sipas rastit kërkesat e nenit 68, pika 2 të VKM –së nr. 914 datë 29.12.2014 ose nenit 84 , pika 2 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021. Raportet përmbledhëse përmbajnë informacion për objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/ mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); të dhënat e ofertuesve të skualifikuar, ofertën ekonomike dhe arsyet e skualifikimit; të dhënat e ofertuesve të kualifikuar, ofertën ekonomike të tyre; informacion për hedhjen e shortit (nëse ka pasur oferta me vlerë të njëjtë); të dhënat e ofertuesit fitues; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave.*
4. *Në lidhje me konstatimin se "Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet dhe DST nuk janë protokolluar në protokollin e bashkisë Shijak" sqarojmë se i qëndrojmë*

observacioneve / shpjegimeve të dhëna për akt konstatimet dhe konkretisht: ...Gjithsesi në rast se shpjegimet e dhëna në lidhje me këtë konstatim nuk do të merren në konsideratë, rekomandimet e KLSH-së do të reflektohen nga stafi i bashkisë në procedurat në vijim, me qëllim përmirësimin e punës.

5. *Në lidhje me konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Nuk ka urdhër të titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve /preventivave (të cilat janë bërë hyrje në magazinën e bashkisë) , kontratave të punimeve, shërbimeve dhe blerjes së mallrave)" sqarojmë se pretendimi qëndron pjesërisht. Nuk ka urdhër të titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve dhe preventivave të dhuruar, të cilat janë marrë në dorëzim nga stafi i Sektorit të Projekteve. ...Në të gjitha rastet e tjera titullari i AK ka urdhëruar ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të punëve, shërbimeve, mallrave.*
6. *Në lidhje me konstatimin se "Personat që kanë përgatitur projektet, relacionet, preventivat dhe grafikët e punimeve nuk janë në të gjitha rastet të licencuar nga autoritet teknike përkatëse për kryerjen e projektimeve në fusha të caktuara specifike" sqarojmë se i qëndrojmë observacioneve/ shpjegimeve të dhëna për akt konstatimet.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Grupi i auditimit është shprehur se "*Asnjë nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe KVO-së nuk vërtetohet të kenë kryer trajnime të ndryshme*", gjë e cila nuk kundërshtohet nga subjekti i audituar. Pavarësisht se nga personi përgjegjës për prokurimet mund të jenë kryer trajnime të ndryshme, kjo gjë nuk vërtetohet.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

2. Nga subjekti i audituar janë bashkëlidhur disa fletë inventari të dosjeve të prokurimit, vetëm për disa procedura, të cilat gjithsesi nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit. Ky konkluzion do të riformulohet nga grupi i auditimit.

Sa më sipër, ky objeksion merret në konsideratë pjesërisht.

3. Grupi i auditimit është shprehur se "*...nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit*". Argumentimi i fondit limit nuk evidentohet qartë dhe plotësisht në Raportet Përmbledhëse.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

4. Kjo çështje është trajtuar dhe argumentuar me detaje në Projektraportin e Auditimit. Nga subjekti i audituar nuk është paraqitur asnjëdokument shtesë apo i panjohur për grupin e auditimit deri në këtë fazë të auditimit. Në nenin 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*", përcaktohet shprehimisht: "*Procesverbalet e mbledhjeve kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Ato protokollohen.*"

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

5. Në këtë rast, grupi i auditimit konstaton se nuk janë marrë në dorëzim projektet dhe preventivat, gjë e cila nuk kundërshtohet nga subjekti i audituar.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

6. Kjo çështje është trajtuar dhe argumentuar me detaje nëAktin e konstatimit dhe nëProjektraportin e auditimit. Nga subjekti i audituar nuk është paraqitur asnjëdokument shtesë apo i panjohur për grupin e auditimit deri në këtë fazë të auditimit.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes: Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, janë vendosur kritere jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Situata:Në auditimin e procedurave me vlera të larta, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve, jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me me natyrën e objektit që prokurohet, si dhe nuk janë argumentuar hollësisht në procesverbalet përkatëse, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61, të VKM-së nr. 914,

datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, etj.
Mangësitë kryesore të konstatuara janë si vijon:

- Kërkesa që Bilancet të jenë të shoqëruara me auditimin ligjor është e pambështetur në ligj.
- Përcaktimi që vërtetimi për shlyerjen e energjisë elektrike të jetë brenda 5 ditësh nga kërkesa e OE, është i papërshtatshëm, pasi kjo kërkesë është për furnitorin e energjisë elektrike, i cili e ka detyrim lëshimin e vërtetimit brenda 5 ditëve. AK nuk ka asnjë lidhje me kërkesën e bërë nga OE për këtë vërtetim.
- Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për një vit të caktuar nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë.
- Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...*", është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për punë publike*" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
- Kriteri "*Mjek, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës dhe diplomë*". Kërkesa për mjek është e tepërt, nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
- Kërkesa për "*Specialist, ...i cili përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve...*", është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*", neni 10 "*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*", pika 5.
- Kërkesa për personel të kualifikuar, kryesisht manovratorë për makineritë teknologjike në një numër më të madh nga numri i makinerive që kërkohen ose për manovratorë të paspecifikuar sipas kodeve dhe listës së profesioneve, është e tepërt dhe e pambështetur në ligj.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
- Kërkesa që në rastin e makinerive të cilat janë marrë me qera, manovratorët "*nuk duhet të jenë të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë*" është e papërshtatshme, pasi në kontratat e qerasë specifikohet vetëm marrja me qera e makinerive dhe jo e manovratorëve. Punonjësit nuk janë objekt qeraje dhe rrjedhimisht specifikimi për mënyrën e përdorimit të makinerive me qera e bën të paqartë mënyrën e realizimit të kontratës.

- Kërkesa që "*për mjetet me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe kohëzgjatja e saj*", është e papërshtatshme dhe nuk është e mbështetur në ligj.
- Kërkesa që "*Mjeti autobitumatrice të jetë i pajisur me çertifikatë për transport mallrash të rrezikshme*" është e papërshtatshme dhe e pambështetur në ligjin nr. 118/2012 "*Për transportin e mallrave të rrezikshme*", neni 23 "*Llojet e mallrave për autorizim*", pika 1.
- Nga AK, në asnjë rast nuk është kërkuar disponimi i të paktën një rimorkiatori, i cili të bëjë transportin e mjeteve të cilat janë të patarguara dhe nuk duhet të qarkullojnë në rrugë, duke mos garantuar mënyrën e disponimit të makinerive teknologjike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes";* neni 23, *"Specifikimet teknike",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, neni 52 "*Hapja e ofertave*", neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, neni 59, pika 4, "*Përllogaritja e vlerës limit të kontratës*", pikat 1 dhe 2: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 26, pika 5, "*Kontratat për punë publike*", neni 61, pika 2, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij; ligji nr. 9154, datë 06.11.03 "*Për Arkivat*" dhe aktet ligjore në zbatim të tij, nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*"; UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*": etj.

Shkaku: Mosnjohja e kuadrit ligjor dhe pakujdesia në trajtimin e materialit dokumentar.

Ndikimi/Efekti: Vendosja e personave të pakualifikuar siç duhet, mangësitë në hartimin dhe ruajtjen e materialit dokumentar, mungesa e urdhërave specifikë për ngritjen e komisioneve, etj., shkaktojnë parregullsi në mënyrën e përdorimit të fondeve publike dhe lënë vend për përdorimin pa Efektivitet, Efiçencë dhe Ekonomicitet të tyre.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Njësia e Prokurimit, në hartimin dhe miratimin e kritereve të kërkesave për kualifikim, pjesë integrale e DST, të argumentojë me hollësi çdo kriter të kërkesave kualifikuese, bazuar mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave sipas manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, liçencave, etj, duke i pasqyruar në procesverbalin përkatës, i cili të jetë pjesë e dosjes së prokurimit.

Rekomandimi 2: Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Shijak, të marrë masa për shmangien e kritereve të tepërta dhe të paargumentuara, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, Njësia e prokurimit, ka shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Në lidhje me konstatimin se "Kriteri "Vërtetim përshlyerjen e taksave vendore për një vit të caktuar nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit", nuk i*

plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore" AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë", pika 1, germa dh) dhe konluzionin e grupit të auditimit në projekt raport se " Njësia e Prokurimit kjo kërkesë ligjore është modifikuar duke i ndryshuar kuptimin" sqarojmë se i qëndrojmë observacioneve / shpjegimeve të dhëna për akt konstatimet....

2. *Në lidhje me konstatimin se "Kriteri "Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50%e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës ..... është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "Kontratat për punë publike" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar" dhe konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "NjP duhet të zbatojë fjlaë për fjalë përcaktimet ligjore dhe jo të bëjë modifikime apo interpretime. Në këtë rast, qëllimi i LPP-së është rritja e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit dhe jo ndalimi i tyre, duke favorizuar për pasojë bisneset e mëdha dhe penalizuar të voglat. Me modifikimet e bëra, pavarsisht komenteve nga APP-ja, AK ka tjetërsuar kuptimin dhe qëllimin e aktit nënligjor, duke dëmtuar për pasojë konkurrencën" sqarojmë se i qëndrojmë observacioneve / shpjegimeve të dhëna për akt konstatimet...*
3. *Në lidhje me konkluzionin e paqyruar në projekt raport se "Grupi i auditimit nuk shprehet që kontrata është lidhur në kundërshtim me ligjet organike për buxhetin apo qeverisjen vendore, por që është në kundërshtim me aktet nënligjore për prokurimin publik", bëjmë me dije së jemi të paqartë me qëndrimin që duhet të mbajë AK në rastin fjalë, për sa kohë një pjesë e konsiderueshmë e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga bashkia Shijak është financuar nga buxheti i shtetit, duke parashikuar lëvrimin e fondeve në disa vite buxhetore dhe sanksionin për rishpërndarje fondesh në objekte të tjera ë rast mos realizimit në afatin e lënë në dispozicion të procedurës së prokurimit.*
4. *Në lidhje me konstatimin se "Kriteri "Mjek, 1 të punësuar. Kontratë individuale të punës dhe diplomë". Kërkesa për mjek është e tepërt, nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1" dhe konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Nga grupi i auditimit gjykohet se qëndron argumentimi ligjor i personave të atakuar për detyrimin e punëdhënësve për mbulimin me shërbim mjeksor, nëpërmjet mjekut të punës, por, në rastin konkret për numrin e të punësuarve ky shërbim duhet të ofrohet nga personeli i jashtëm, sipas përcaktimeve të VKM –së nr.632 datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM nr.108 datë 09.02.2011"*
5. *Në lidhje me konstatimin se "Kërkesa për specialist koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) ... për të cilin duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë e dhënë nga një organizëm i akreditуar, licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj.", është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"", neni 10 "Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve", pika 5" dhe konkluzioni i pasqyruar në projekt raport se "Argumentat e dhëna nga ana e subjektit të audituar nuk qëndrojnë, pasi në VKM –në nr.312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores"Për sigurinë në kantier" neni 10 "Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve" pika 5, përcaktohet shprehimisht që "Certifikata ..... nuk kërkohet për ata që kanë një certifikatë universitare ... ose diplomë universiteti" ...sqarojmë se i qëndrojmë observacioneve/ shpjegimeve të dhëna për akt konstatimet....*

6. *Në lidhje me konstatimin se " Kërkesa për personel të kualifikuar, kryesisht manovratorë për makineritë teknologjike në një numër më të madh nga numri i makinerive që kërkohen ose për manovratorë të paspecifikuar sipas kodeve dhe listës së profesioneve është e tepërt dhe e pambështetur në ligj" dhe konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Kërkesa për manovratorët dhe punonjësit e specializuar duhet të mbështetet në VKM –në nr.514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lkp), të rishikuar", ku për secilën nga makineritë teknologjike përcaktohet kulaifikim dhe emërtim i posaçëm i manovratorit' sqarojmë se i qëndrojmë observacioneve / shpjegimeve të dhëna për akt konstatimet....*
7. *Në lidhje me konstatimin se "Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik" ...sqarojmë se i qëndrojmë observacioneve / shpjegimeve të dhëna për akt konstatimet....*
8. *Në lidhje me konstatimin se "Kërkesa që "për mjetet me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe kohëzgjatja e saj", nga grupi i auditimit konsiderohet e papërshtatshme dhe nuk është e mbështetur në ligj" dhe konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Në këtë rast APP ka rekomanduar mirëargumentimin, por nuk është shprehur që të mos kërkohet disponimi i manovtarorëve. Psh. AK mund të kërkonte që manovratorët të disponoheshin në listë-pagesat e qiradhënësit të mjeteve " **sqarojmë se** nuk e gjejmë të bazuar kërkesën që manovratorët të disponohen në listëpagesat e qiradhënësit të mjeteve sepse në këtë rast do të rezultonte që kërkesa do t'i adresohej palëve të treta të cilat nuk janë kandidatë në procedurën konkrete të prokurimit. ...Gjithsesi AK do të reflektojë në drejtim të riformulimit të këtij kriteri duke parashikuar mundësinë e kontraktimit të manovratorëve në rastin kur makineritë disponohen me qira.*
9. *Në lidhje me konstatimin se "Kërkesa që për mjetet me qira të paraqiet kontrata noteriale e qirasë, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe kohëzgjatja e saj , është e papërshtatshme dhe nuk është e mbështetur në ligj" dhe konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Në këtë rast AK ka kërkuar një formë kontrate të cilën e lejon "Kodi Civil", por nga grupi i auditimit konsiderohet kërkesë e tepruar që dëmton konkurrencën" **sqarojmë se** AK do të reflektojë në drejtim të riformulimit të këtij kriteri duke qenë se për kontratën e qirasë nuk është kusht për vlefshmërinë forma noteriale e saj. ...Në lidhje me konstatimin se "Kërkesa që mjeti autobitumatriçe të jetë i pajisur me certifikatë për transport mallrash të rrezikshme është e papërshtatshme dhe e pambështetur në ligjin nr .188/2012 "Për transportin e mallrave të rezikshme ", neni 23 "Llojet e mallrave për autorizim", pika 1" dhe konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Në përcaktimin e kërkesës në fjalë si të papërshtatshme, grupi i auditimit i është referuar të vetmit ligj në Republikën e Shqipërisë , i cili përcakton se cilat lëndë konsiderohen të rrezikshme.... Komentet e personave të atakuar janë justifikime dhe të pambështetura në ligj" sqarojmë se i qëndrojmë observacioneve / shpjegimeve të dhëna për akt konstatimet....*
10. *Në lidhje me konkluzionin e pasqyruar në projekt raport se "Nga AK , në asnjë rast nuk është kërkuar disponimi i të paktën një rimorkiatori i cili të bëjë transportin e mjeteve të cilat janë të patarguara dhe nuk duhet të qarkullojnë në rrugë , duke mos garantuar mënyrën e disponimit të makinerive teknologjike" sqarojmë se nuk e gjejmë të bazuar kërkesën për disponimin e një mjeti rimorkiator për arsye se në asnjë nga zërat e preventivit nuk kërkohet ky mjet. Për me tepër në manualin e cmimeve të ndërtimit për zërat e preventivit nuk kërkohet rimokiatori si mjet shoqërues. Është detyrë e operatorit ekonomik që shpallet fitues të sigurojë mjetet në kantier , dhe mënyra se si i transporton ato në kantier.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Kjo çështje është trajtuar dhe argumentuar me detaje në Aktin e konstatimit dhe në Projektraportin e auditimit. Nga subjekti i audituar nuk është paraqitur asnjë dokument shtesë

apo i panjohur për grupin e auditimit deri në këtë fazë të auditimit.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

2. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

3. Grupi i auditimit është shprehur duke cituar nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, ku përcaktohet se "*...lidhja e kontratës do të bëhet ...vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor*". Pavarësisht se një investim i caktuar mund të bëhet me fonde të deleguara apo me grante, AK, përpara lidhjes së kontratës duhet të ketë fondet në llogarinë e vet.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

4. Kjo çështje është trajtuar dhe argumentuar me detaje në Projektraportin e Auditimit. Nga subjekti i audituar nuk është paraqitur asnjëdokument shtesë apo i panjohur për grupin e auditimit deri në këtë fazë të auditimit. NëVKM-në nr. 632, datë 15.7.2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", përcaktohet se: "*6. Punëdhënësit e grupeve "A" dhe "B", në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve "C" dhe "D", për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.*"

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

5. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

6. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

7. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

8. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

9. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

10. Njësoj si pika 1 më sipër. Në kushtet kur makineritë janë të pajisura me targa, është e qartë mënyra se si do të shkojnë makineritë në vendin ku do të kryhen punimet. Duke pasur parasysh që në shumicën e rasteve makineritë nuk janë të pajisura me targa, si dhe që nuk disponohet rimorkiator, nga OE nuk garantohet që makineritë do të jenë në vendin e punës.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes: Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e zhvilluara për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, janë shpallur fitues OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuara nga AK.

Situata:1. Në 10 procedura, KVO ka kryer vlerësimin e ofertave në tejkalim të afatit prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.;

2. Nga auditimi, u konstatua se kualifikimi dhe shpallja fitues e OE/BOE është bërë në mospërputhje me kuadrin ligjor për prokurimet dhe DST të miratuara nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Shijak, si më poshtë:

- Vlera e xhiros e tejkalon sasinë e kërkuar në DST, në raport me vlerën e fondit limit që prokurohet;
- Bilance të pakonfirmuara me shkresë përcjellëse nga tatimet;
- Nuk janë paraqitur vërtetime për shlyerjen e detyrimeve vendore në të gjitha vendet ku OE kanë ushtruar veprimtari biznesi;
- Nuk është bërë verifikimi i kodeve të profesioneve në listëpagesa, sipas profesioneve të deklaruara, për të garantuar që puna do të kryhet nga profesionistët e kërkuar në DST;

- Çertifikatat e trajnimeve profesionale dhe/ose për sigurinë në punë, nuk janë nga institucione të akredituara për çertifikimin e punonjësve.
- Për pajisjet/makineritë/veglat e punës të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.
- Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për makineritë teknologjike është në gjuhë të huaj, nuk është i lexueshëm dhe shumica e makinerive nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, çertifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "*Makinat teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*";

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 2, *"Parimet e përzgjedhjes";* neni 23, *"Specifikimet teknike",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, neni 52 "*Hapja e ofertave*", neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, neni 59, pika 4, "*Përllogaritja e vlerës limit të kontratës*", pikat 1 dhe 2: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 26, pika 5, "*Kontratat për punë publike*", neni 61, pika 2, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij; ligji nr. 9154, datë 06.11.03 "*Për Arkivat*" dhe aktet ligjore në zbatim të tij, nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*"; UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*": etj.

Shkaku: Mosnjohja e kuadrit ligjor dhe dokumentacionit specifik, si dhe pakujdesia në gjykimin dhe vlerësimin e dokumentacionit vërtetues të kapaciteteve teknike/ekonomike të OE.

Ndikimi/Efekti: Risk i lartë i cili mund të shkaktojë përdorim të paligjshëm të fondeve dhe punime me cilësi të dobët, jashtë kushteve të kontratave dhe standardeve të miratuara.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Bashkia Shijak, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë në kushtet e mosplotësimit të kritereve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit apo shërbimit.

Përgjegjësia për sa më sipër është specifikuar rast pas rasti për secilën procedurë.

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *Hapësirë rekreative, park i qytetit Shijak*		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 817 Prot., datë 04.03.2019	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 43/9 Prot., datë 04.12.2018 E. O., kryetare, juriste J. G., anëtare, ing. ndërtimi B. T., anëtar, arkitekt	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 818 Prot., datë 04.03.2019 N. K. kryetar D. Ç. anëtar E. V. anëtar
2. Lloji i Procedurës "Procedurë e Hapur – Punë Publike"		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 45,387,152 lekë REF-12769-03-07-2019	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "S.&E. K." 33,472,081 lekë. Kontrata nr. 2026, datë 14.06.2020, me afat 90 ditë	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 11,915,071 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 12.04.2019	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 11 OE

		b) Skualifikuar 8 OE, **c)** Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime **AK**-s'ka; **APP**–s'ka; **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK s'ka	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: s'ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 4319 prot., datë 04.12.2018, ka dalë urdhëri nr. 432 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*". Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit.
Nga njësia e prokurimit, është mbajtur procesverbal mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, pa numër protokolli, datë 24.12.2018.
Në datën 07.03.2019 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.
Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 151, datë 08.07.2019.
Në datën 03.04.2019, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit, pas rekomandimeve nga APP. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 08.04.2019 është bërë 12.04.2019.
Në datën 06.06.2019, me nr. 1941 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Kontrata është lidhur në datën 14.06.2019, me nr. prot. 2026, për vlerën 33,472,081 lekë pa TVSH dhe 40,166,497 lekë me TVSH, me afat 90 ditë.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit: Fondi limit është me të ardhurat e Bashkisë Shijak, për vlerën 45,387,152 lekë, i miratuar me VKB nr. 18, datë 21.06.2017, "*Për Miratimin e Ndërtimit të shkollës së re Muharrem Dollaku dhe ndërtimin e Parkut të Qytetit*".
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Nga observacionet e paraqitura nga subjekti në fazën e hartimit të projekt Raportit, u konstatua se projekti është hartuar nga studio e liçencuar "*B. A.*" sh.p.k. dhe i është dhuruar Bashkisë Shijak me kontratën e datës 04.06.2018. Projekti nuk është bërë hyrje në magazinë dhe nuk është kontabilizuar, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*".
Vlerësimi i kritereve: Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2018 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...",* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për*

punë publike" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
3. Në DST kërkohet: "*Mjek, 1 të punësuar.Kontratë individuale të punës dhe diplomë*". Kërkesa për mjek është e tepërt, nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.
Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Vlerësimi i ofertës fituese: **1.** Vlera e xhiros së OE E. K. dhe OE S. e tejkalon 50% të vlerës së fondit limit që prokurohet, konkretisht, xhiro e OE E. K. për vitin 2017 është 452,096,486 lekë dhe për vitin 2018 është 697,658,874 lekë, ndërsa xhiro e OE S. për vitin 2017 është 80,875,451 lekë dhe për vitin 2018 është 97,386,375 lekë, në kundërshtim me DST, pika 2.2. "*Kapaciteti teknik*". Në këtë rast KVO ka zbatuar përcaktimin në VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014.
2. Bilancet e OE S. nuk janë të konfirmuar me shkresë përcjellëse nga tatimet, sipas nenit 12 të "*Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*"
3. OE E. K. ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga Bashkia Tiranë, Ura Vajgurore, Sarandë, Kamëz dhe Vlorë, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë e tjera, ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari, si Berat, Dropull dhe Gjirokastër.
OE S. ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga Bashkia Fier, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë e tjera, ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari, si Gjirokastër, Vlorë, Tepelenë, Berat, Tiranë, Lushnjë, Mallakastër, Patos dhe Kavajë.
Sa më sipër është në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*" dhe nenin 45, pika 1, germa c) të LPP.
4. OE S. nuk ka paraqitur liçence apo kontratë me konsulentë të liçencuar që dispononjnë liçencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL, Kodi III.2.B,
5. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO, verifikimi në listëpagesa i kodit të profesioneve të punonjësve, nuk është paraqitur në procesverbal. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.
6. Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për makineritë është fotokopje e panoterizuar.
7. Makineritë teknologjike nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, çertifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "*Makinat teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*".
Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".
Konkluzion:Kualifikimi i kësaj oferte është bërë në mospërputhje me kërkesat e LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.

Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "*S.&E. K.*", i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. AK duhet të kishte anuluar tenderin, të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret për të rritur numrin e pjesëmarrësve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G. dhe B. T. dhe KVO, i përbërë nga: N. K. kryetar, D. Ç. anëtar dhe E. V. anëtar.

Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K. kryetar, D. Ç. anëtar dhe E. V. anëtar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Për pikat 1, 3, 4, 6, 7 dhe 8 të objeksioneve, për të cilat janë paraqitur kundërshti në lidhje me Akt Konstatimet e lëna nga grupi i auditimit, KVO thjesht është shprehur që "Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht" ose thjesht "është marrë në konsideratë", pa dhënë asnjë koment apo kundërshti.*
2. *2. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se bilancet e OE S. nuk janë të konfirmuar me shkresë përcjellëse nga tatimet, sipas nenit 12 të "Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" ...SQAROJMË se në pikën 2. "Kriteret e veçanta të kualifikimit" të DST, kërkohet: ...Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve ushtrimore 2017 dhe 2018 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse. ...OE "S." ka depozituar kopjet e vërtetuara të bilanceve për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018, të cilat janë të rregullta dhe të konfirmuara me vulën zyrtare të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, bashkëngjitur është dhe raporti i audituesit të pavarur. Pra, OE "S." e ka plotësuar kriterin për të dorëzuar Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve ushtrimore 2017 dhe 2018 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse. ...Nga KVO është klasifikuar si një devijim i lehtë për sa i përket mungesës së shkresës përcjellëse nga drejtoria e tatimeve, pasi Kopja e vërtetuar e bilanceve të viteve ushtrimore 2017 dhe 2018 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse është depozituar nga ana e OE me vulë institucioni dhe nënshkrim. Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.*
3. *5. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se OE S. nuk ka paraqitur licensë apo kontratë me konsulentë të licencuar që dispononjnë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL, Kodi III.2.B ...SQAROJMË se në lidhje me mosparaqitjen e licensës apo kontratës me konsulentë të licensuar që disponojnë licensë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL, Kodi III.2.B, nga ana e OE "S.", ju bëjmë me dije se ky kriter plotësohet nga OE "E. K.". ...Referuar nenit 74, pika 3, të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar: ...Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim*

apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. …Të dy operatorët ekonomikë kanë plotësuar kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të kërkuara në DST, referuar pikës 2.2 "Kapaciteti teknik", kërkesa: Ofertuesi duhet të paraqesë kontratë me konsulentë të licencuar që disponojnë licencë lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL, Kodi III.2.B është një kriter teknik, i cili përmbushet nga OE "E. K.", anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë. Në Licensën me Kod III.2.B që disponon OE "E. K.", kategoria e licensës së lëshuar nga QKB është Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis dhe nënkategoria është: Veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis. KVO në bazë të karakteristikave të mësipërme ka vlerësuar se ky OE e plotëson kriterin e kërkuar në DST. Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

4. *9. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për makineritë është fotokopje e panoterizuar. ...SQAROJMË se dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për makineritë është fotokopje e noterizuar. Ky pretendim nuk qëndron, pasi dokumentacioni i mjeteve të BOE në pronësi është depozituar i skanuar nga origjinali, kurse dokumentacioni i mjeteve jo në pronësi është depozituar bashkëlidhur me kontratën e qirasë, i vulosur me vulë noteriale dhe përputhet me karakteristikat e mjetit të përshkruara në kontratë, gjithashtu dhe dokumentacioni në gjuhë të huaj është i përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes ligjor i autorizuar. …Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.*

5. *10. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se makineritë teknologjike nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike". ...SQAROJMË se KVO e kundërshton këtë fakt, pasi sipas dy neneve të sipërcituara, detyrimi ligjor që makineritë teknologjike të jenë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion lind vetëm në rastet kur mjetet teknologjike qarkullojnë në mënyrë vetëlëvizëse në rrugë. Pra, në asnjë rast ligji nuk i detyron pronarët e mjeteve teknologjike që t'i regjistrojnë ato pranë DPSHTRR, për sa kohë këto mjete përdoren vetëm në kantierin e ndërtimit dhe transportohen me mjete të tjera. Mjetet teknologjike të kërkuara në DST, si: ekskavatori me zinxhirë, rruli vibrues dhe asfaltoshtruesja, klasifikohen në kategorinë e mjeteve teknologjike që është e ndaluar rreptësisht të vetëqarkullojnë në rrugë dhe transporti nga një destinacion në një tjetër bëhet me rimorkio, siç të gjithë e kemi ndeshur nëpër akset e ndryshme rrugore të vendit tonë, për t'ju drejtuar kantiereve të ndërtimit. …KVO ka kryer verifikimet në dokumentacionin e depozituar në SPE nga BOE dhe rezulton se të gjitha mjetet dhe pajisjet me dokumentacionin përkatës janë të përkthyer, të noterizuar dhe origjinal. …Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.*

6. *11. Në lidhje me konstatimin e bërë nga ana juaj, në lidhje me tejkalimin e afatit prej 15 ditësh të vlerësimit të procedurave të prokurimit nga ana e KVO-së, ju bëjmë me dije se, anëtarët e KVO përveç detyrës funksionale që kanë si specialistë të sektorëve të ndryshëm të institucionit, gjithashtu edhe nga mungesa e një sektori të veçantë të prokurimeve, ngarkohen me një detyrë tjetër shtesë, siç është ajo e anëtarit të KVO. ...Përveç kësaj, tërmeti i 26 nëntorit 2019, nga i cili u godit edhe Bashkia Shijak, solli si pasojë angazhimin në detyra të tjera në ndihmë të komunitetit, të gjithë stafin e institucionit tonë, duke sjellë vonesa edhe në drejtim të vlerësimit të procedurave të prokurimit. ...Po ashtu, edhe situata e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 solli vonesat e veta.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.

Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.

2. Komentet dhe objeksionet e bëra janë justifikime të paargumentuara. Objeksioni dhe komentet e paraqitura janë të njëjta me trajtimin e bërë në kundërshtitë e paraqitura për Aktin e konstatimit, duke mos dhënë asnjë argument të ri apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë. **3.** Njësoj si pika 2 më sipër. Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë. **4.** Njësoj si pika 2 më sipër. Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë. **5.** Njësoj si pika 2 më sipër. Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë. **6.** Njësoj si pika 2 më sipër. Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

2. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, Lagja Sallmone***		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 741 Prot., datë 25.02.2019 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e Hapur – Punë Publike"	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 3222 Prot., datë 11.09.2018 E. O., kryetare, juriste O. M., anëtare, ing. hidroteknike E. D., anëtar, ing. ndërtimi	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 742 Prot., datë 25.02.2019 N. K. kryetar D. Ç. anëtar E. V. anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 45,504,101 lekë REF-11448-03-01-2019	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "A. A.&A. K." 42,863,662 lekë. Kontrata nr. 2070, datë 17.06.2020, me afat 109 ditë	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2,640,439 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 09.04.2019	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 10 OE **b)** Skualifikuar 9 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**-Nr. 862 Prot., datë 11.03.2019 Nr. 1618 Prot., datë 14.05.2019; **APP**–s'ka; **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Nr. 862/1 Prot., datë 13.03.2019 Nr. 1618/2 Prot., datë 21.05.2019	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: s'ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 3222 prot., datë 11.09.2018, ka dalë urdhëri nr. 347 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*". Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit.

Nga njësia e prokurimit, është mbajtur procesverbal mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, pa numër protokolli, datë 21.11.2018.

Në datën 01.03.2019 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.

Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 171, datë 22.07.2019.

Me nr. 862 Prot., datë 11.03.2019, është depozituar ankesa e shoqërisë "V. E", në lidhje me kërkesën për mjetin "*Trencher për hapje kanali*".

Me shkresën nr. 862/1 Prot., datë 13.03.2019, nga AK i është kthyer përgjigje shoqërisë "V. E", nëpërmjet së cilës është refuzuar ankesa me argumentin se është zbatuar kërkesa në preventiv.

Në datën 03.04.2019, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit, pas rekomandimeve nga APP. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 04.04.2019 është bërë 09.04.2019.

Në datën 09.04.2019, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 10 ofertuesve.

Në datën 07.05.2019 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.

Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.
Me nr. 1618 Prot., datë 14.05.2019, është depozituar ankesa e shoqërisë "H.", me nr. 69 Prot., datë 13.05.2019, në lidhje me skualifikimin e ofertës.
Me nr. 72 dhe nr. 1618/1 Prot., datë 15.05.2019 ka dalë Urdhëri për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit të ankesave. Me shkresën nr. 1618/2 prot., datë 21.05.2019 nga AK i kthehet përgjigje ankesës së OE "H.", e cila është pranuar si e rregullt dhe është refuzuar me argumentet përkatëse, mbështetur në projekt dhe në relacionin përkatës.
Në datën 05.06.2019, me nr. 1925 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Kontrata është lidhur në datën 17.06.2019, me nr. prot. 2070, për vlerën 42,863,662 lekë pa TVSH dhe 51,436,394 lekë me TVSH. Me nr. 2070/3 Prot., datë 24.07.2019 është bërë amendimi i kontratës, në lidhje me nenin 7 "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", ku është përcaktuar se për vitin 2019 do të paguhet vlera 19,166,666 lekë, për vitin 2020 do të paguhet vlera 18,004,166 lekë dhe për vitin 2021 do të paguhet vlera 583,333 lekë.
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G. dhe B. T. dhe KVO, e përbërë nga: N. K., D. Ç. dhe E. V..
Vlerësimi i fondit limit:Fondi limit është me të ardhurat e Bashkisë Shijak, për vlerën 45,504,101 lekë, i miratuar me VKB nr. 68, datë 20.12.2018, "*Mbi Miratimin e Buxhetit Afatmesëm 2019-2021*".
Nga auditimi i dokumentacionit dhe nga ballafaqimi me NjP, u konstatua se projekti, preventivat dhe specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinierët e AK, Drejtoria e Urbanistikës, pjesëtarë të njësisë së prokurimit, të cilët janë të pajisur me liçencat profesionale sipas profilit të secilit, në bashkëpunim me studion "*Z.*". Ky bashkëpunim ka qenë pa pagesë për AK Bashkia Shijak, por nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje apo dokument tjetër i cili të vërtetojë bashkëpunimin. Relacioni përshkruan vendndodhjen dhe gjendjen ekzistuese të objektit që do të ndërtohet.
Vlerësimi i kritereve:Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2018 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që

vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Vlerësimi i ofertës fituese: **1.** Vlera e xhiros së OE A. A. dhe OE A. K. e tejkalon 50% të vlerës së fondit limit që prokurohet, konkretisht, xhiro e OE A. A. për vitin 2017 është 488,152,552 lekë dhe për vitin 2018 është 278,882,731 lekë, ndërsa xhiro e OE A. K. për vitin 2017 është 105,656,878 lekë dhe për vitin 2018 është 85,527,242 lekë.
Sa më sipër, është në kundërshtim me DST dhe kërkesat e VKM-së nr. 914 "*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 6., germa a) dhe b), si dhe në kundërshtim me DST, pika 2.2. "*Kapaciteti teknik*".
2. OE A. A. ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga Bashkia Durrës, Rrogozhinë dhe Shijak, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkia Kavajë, për adresën sekondare të hapur në datën 19.11.2018, si dhe në bashki të tjera, ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari, si Tiranë dhe Fier.
OE A. K. ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga Bashkitë Maliq, Durrës, Rrogozhinë, Shijak, Kavajë dhe Fier, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkia Korçë, ku ka edhe selinë kryesore dhe nga bashkia Tiranë.
Sa më sipër është në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*".
3. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.
4. Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për ekskavatorët me zinxhirë nuk është i plotë, pasi për njërin ekskavator, të blerë në Itali në vitin 2010 nga A. C., deklarata doganore është e palexueshme, ndërsa ekskavatori tjetër, për të cilin ka kontratë qeraje është importuar në vitin 2001. Dokumentacioni i blerjes nuk është në gjuhën shqipe dhe nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë/disponimin e tyre. Për makinerinë e nguljes së palankolave nuk ka deklaratë zhdoganimi. Vetëm një ekskavator me zinxhirë, mjeti në pronësi të OE A. K., i markës Caterpillar, është i pajisur me targë, në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor.
5. Për makinerinë e nguljes së palankolave, ka kontratë qeraje por nuk ka deklaratë zhdoganimi, fatura e blerjes nuk është në gjuhën shqipe dhe nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë/disponimin e saj.
6. Për makinerinë trencher, ka kontratë qeraje dhe deklaratë zhdoganimi të vitit 2015, por është e patarguar dhe nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë/disponimin e saj.
7. Betonieret e paraqitura me faturë nuk janë në kapacitetin e kërkuar 500 l.
8. Për frezën e asfaltit, ka deklaratë zhdoganimi të vitit 2018, por nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë/disponimin e saj.
9. Nga 4 Rrula për të cilët është paraqitur dokumentacion, vetëm një rrul me vibrim është i pajisur me dokumentacion të plotë dhe me targa (AB MT 41), sipas kerkesave ligjore dhe në DST. Për makineritë e tjera nuk vërtetohet pronësia/disponimi, dokumentacioni teknik është në gjuhë të huaj dhe i palexueshëm.
10. Për Autobitumatriçen, nga BOE është paraqitur bitumatriçe e ngarkuar mbi kamion dhe jo Autobitumatriçe, sipas kërkesave në DST.

11. Për Asfaltoshtruesen, ka deklaratë zhdoganimi të vitit 2012, por nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë/disponimin e saj.
12. Për vinçin kullë, disponohet kontratë qeraje, por nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë e tij.
13. Makineritë teknologjike nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, çertifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "*Makinat teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*".
Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".
Konkluzion:Kualifikimi i kësaj oferte është bërë në mospërputhje me kërkesat e LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.
Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "*A. A.&A. K.*", i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. AK duhet të kishte anuluar tenderin, të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret për të rritur numrin e pjesëmarrësve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.
Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., O. M. dhe E. D. dhe KVO, i përbërë nga: N. K. kryetar, D. Ç. anëtar dhe E. V. anëtar.
Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K. kryetar, D. Ç. anëtar dhe E. V. anëtar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Për pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 10, 11 dhe 13 të objeksioneve, për të cilat janë paraqitur kundërshti në lidhje me Akt Konstatimet e lëna nga grupi i auditimit, KVO thjesht është shprehur që "Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht" ose thjesht "është marrë në konsideratë", pa dhënë asnjë koment apo kundërshti.*
2. *7. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se për makinerinë e nguljes së palankolave, ka kontratë qeraje por nuk ka deklaratë zhdoganimi, fatura e blerjes nuk është në gjuhën shqipe dhe nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë/disponimin e saj. ...SQAROJMË se për makinerinë e nguljes së palankolave model "O&K RH9" është paraqitur kontratë qiraje me nr. 3407 Rep. dhe nr. 1382/1 Kol., ku bashkëlidhur është vërtetimi i zhdoganimit, duke plotësuar kriterin e DST. Ky fakt vërtetohet edhe me deklaratën e zhdoganimit dhe dokumentin e transportit bashkëngjitur kontratës së qirasëajisjen për nguljen e palankolave. Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.*
3. *8. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se për makinerinë trencher, ka kontratë qeraje dhe deklaratë zhdoganimi të vitit 2015, por është e patarguar dhe nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë/disponimin e saj. ...SQAROJMË se për makinerinë trencher, është*

paraqitur kontrata e qirasë me nr. 3406 Rep. dhe nr. 1381/1 Kol., datë 24.12.2018 dhe është paraqitur deklarata doganore R 58620, datë 17.08.2015, e cila vërteton pronësinë e këtij mjeti. Ky mjet me zinxhirë, klasifikohet në kategorinë e mjeteve teknologjike që është e ndaluar rreptësisht të vetëqarkullojnë në rrugë dhe transporti nga një destinacion në një tjetër bëhet me rimorkio. Pra, në asnjë rast ligji nuk i detyron pronarët e këtyre mjeteve teknologjike që t'i regjistrojnë ato pranë DPSHTRR, për sa kohë këto mjete përdoren vetëm në kantierin e ndërtimit dhe transportohen me mjete të tjera. ...KVO e kundërshton këtë fakt, pasi detyrimi ligjor që makineritë teknologjike të jenë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion lind vetëm në rastet kur mjetet teknologjike qarkullojnë në mënyrë vetëlëvizëse në rrugë. Pra, në asnjë rast ligji nuk i detyron pronarët e mjeteve teknologjike që t'i regjistrojnë ato pranë DPSHTRR, për sa kohë këto mjete përdoren vetëm në kantierin e ndërtimit dhe transportohen me mjete të tjera. Mjetet teknologjike të kërkuara në DST, si: ekskavatori me zinxhirë, rruli vibrues, asfaltoshtruesja etj., klasifikohen në kategorinë e mjeteve teknologjike që është e ndaluar rreptësisht të vetëqarkullojnë në rrugë dhe transporti nga një destinacion në një tjetër bëhet me rimorkio, siç të gjithë e kemi ndeshur nëpër akset e ndryshme rrugore të vendit tonë, për t'ju drejtuar kantiereve të ndërtimit. Për sa më sipër, konstatimi i audituesit nuk qëndron.

4. *9. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se betonieret e paraqitura me faturë nuk janë në kapacitetin e kërkuar 500 l. ...SQAROJMË se ky konstatim nuk qëndron pasi jo të gjitha karakteristikat e makinerive mund të paraqiten në faturën e shitjes së tyre. Karakteristikat e betonieres së kantierit, në këtë rast, jepen në katalogun apo në ndonjë pjastër metalike të vendosur mbi pajisjen. KVO duke iu referuar fotove të bashkëlidhura faturës së shitjes, ka qenë i mendimit se betonieret e paraqitura në fotot bashkëlidhur kanë betoniere kantieri 0.5 m3. Madje dhe numri i paraqityr i tyre është më i madh nga ai i kërkuar në DST. ...Për sa më sipër, konstatimi i audituesit nuk qëndron.*

5. *12. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se për Autobitumatriçen, nga BOE është paraqitur bitumatriçe e ngarkuar mbi kamion dhe jo Autobitumatriçe, sipas kërkesave në DST. ...SQAROJMË se përderisa mjeti me targë AA 210 TD, është i pajisur me certifikatën e kontrollit teknik të vlefshme, kjo do të thotë se ky mjet e ka kaluar kontrollin teknik nga institucioni i certifikuar për të lëshuar këtë certifikatë. KVO e ka verifikuar këtë problematikë, por duke vlerësuar realizimin e procesit të punës nga ky mjet, e ka pranuar, pasi qëllimi i prokurimit është të realizohet puna.*

6. *14. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se për vinçin kullë, disponohet kontratë qeraje, por nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë e tij. ...SQAROJMË se për vinçin kullë, disponohet kontratë qiraje, gjithashtu ka dhe dokumentacion që vërteton pronësinë e tij. ...Ju bëjmë me dije se, kjo gjë është e pavërtetë sepse bashkëngjitur kontratës së qirasë është deklarata e zhdoganimit për mjetin vinç kullë. Gjithashtu, në pasqyrën kontabël të inventarit të aseteve në bilancin e vitit 2018 të dorëzuar nga OE, paraqitet inventari i automjeteve në pronësi të subjektit. ...Vinçi kullë nuk është një pajisje në pronësi, por është e marrë me qira. ...Për sa më sipër, konstatimi i audituesit nuk qëndron.*

7. *15. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se makineritë teknologjike nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike", ku përcaktohet: ..."Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit." ...Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "Kapaciteti teknik". ...SQAROJMË se KVO e kundërshton këtë fakt, pasi sipas dy neneve të sipërcituara, detyrimi ligjor që makineritë teknologjike të jenë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion lind vetëm në rastet kur mjetet teknologjike qarkullojnë në mënyrë vetëlëvizëse në rrugë. Pra, në asnjë rast ligji nuk i detyron pronarët e mjeteve teknologjike që t'i regjistrojnë ato pranë DPSHTRR, për sa kohë këto mjete përdoren vetëm në kantierin e ndërtimit dhe transportohen me mjete të tjera. Mjetet teknologjike të kërkuara në DST, si: ekskavatori me zinxhirë, rruli vibrues, asfaltoshtruesja etj., klasifikohen në kategorinë e mjeteve teknologjike që është e ndaluar rreptësisht të*

vetëqarkullojnë në rrugë dhe transporti nga një destinacion në një tjetër bëhet me rimorkio, siç të gjithë e kemi ndeshur nëpër akset e ndryshme rrugore të vendit tonë, për t'ju drejtuar kantiereve të ndërtimit. ...KVO ka kryer verifikimet në dokumentacionin e depozituar në SPE nga BOE dhe rezulton se të gjitha mjetet dhe pajisjet me dokumentacionin përkatës janë të përkthyer, të noterizuar dhe origjinal. ...Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

8. *16. Në lidhje me konstatimin e bërë nga ana juaj, në lidhje me tejkalimin e afatit prej 15 ditësh të vlerësimit të procedurave të prokurimit nga ana e KVO-së, ju bëjmë me dije se, anëtarët e KVO përveç detyrës funksionale që kanë si specialistë të sektorëve të ndryshëm të institucionit, gjithashtu edhe nga mungesa e një sektori të veçantë të prokurimeve, ngarkohen me një detyrë tjetër shtesë, siç është ajo e anëtarit të KVO. ...Përveç kësaj, tërmeti i 26 nëntorit 2019, nga i cili u godit edhe Bashkia Shijak, solli si pasojë angazhimin në detyra të tjera në ndihmë të komunitetit, të gjithë stafin e institucionit tonë, duke sjellë vonesa edhe në drejtim të vlerësimit të procedurave të prokurimit. ...Po ashtu, edhe situata e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 solli vonesat e veta.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.

Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.

2. Komentet dhe objeksionet e bëra janë justifikime të paargumentuara. Objeksioni dhe komentet e paraqitura janë të njëjta me trajtimin e bërë në kundërshtitë e paraqitura për Aktin e konstatimit, duke mos dhënë asnjë argument të ri apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

3. Njësoj si pika 2 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

4. Njësoj si pika 2 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

5. Njësoj si pika 2 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

6. Njësoj si pika 2 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

7. Njësoj si pika 2 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

8. Njësoj si pika 2 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "Adem Sabli" Borakë***		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1358 Prot., datë 23.04.2019	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 1139 Prot., datë 02.04.2019 E. O., kryetare, juriste J. G., anëtare, ing. ndërtimi Gj. Ç., anëtar, ing. ndërtimi	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 1359 Prot., datë 23.04.2019 N. K. kryetar D. Ç. anëtare E. V. anëtar
2. Lloji i Procedurës **"**Procedurë e Hapur – Punë Publike"		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 60,993,255 lekë REF- 19477-04-24-2019	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "E. A.&V. K." 59,985,423 lekë. Kontrata nr. 3009, datë 26.08.2020, me afat 259 ditë	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 1,007,832 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 03.06.2019	**9. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 8 OE **b)** Skualifikuar 7 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**-1436 Prot., datë 30.04.2019; Nr. 1448 Prot., datë 02.05.2019;	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Nr. 1436/1 Prot., datë 02.05.2019 Nr. 1448/1 prot., datë 06.05.2019	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: s'ka Vendim nr. 474/2019 datë

Nr. 1486 Prot., datë 06.05.2019; Nr. 2288 Prot., datë 02.07.2019; Nr. 2291 Prot., datë 02.07.2019; Tërheqje ankese – Nr. 2291/1 Prot. datë 05.07.2019 Nr. 2323 Prot., datë 04.07.2019; Nr. 2423 prot., datë 11.07.2019; Tërheqje ankese – Nr. 2423/1 prot., datë 12.07.2019 **APP**–s'ka; **KPP**-s'ka	Nr. 1486/1 prot., datë 07.05.2019 Nr. 2310/1 Prot., datë 08.07.2019 Nr. 2323/1 Prot., datë 08.07.2019	22.07.2019

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 1139 prot., datë 02.04.2019, ka dalë urdhëri nr. 127 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*". Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit.
Nga njësia e prokurimit, është mbajtur procesverbal mbi përcaktimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, pa numër protokolli, datë 12.04.2019, i cili miraton projektin, preventivin dhe analizat e çmimeve të hartuara nga ing. Gj. Ç. dhe ark. B. T..
Në datën 19.04.2019 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.
Me shkresën nr. 29 Prot., datë 26.04.2019, protokolluar në bashkinë Shijak me nr. 1436 Prot., datë 30.04.2019, është depozituar ankesa e OE "*N. S.*", ku ka kërkuar modifikim të kërkesave për kualifikim.
Me shkresën nr. 33 Prot., datë 02.05.2019, protokolluar në bashkinë Shijak me nr. 1436/1 Prot., datë 02.05.2019, OE "*N. S.*", ka depozituar tërheqjen nga ankesa.
Me nr. 1436/2 prot., ka dalë vendimi nr. 1 i titullarit, për mosshqyrtimin e ankesës së OE "*N. S.*", bazuar në tërheqjen e tij nga ankesa.
Me shkresën pa numër protokolli, datë formulari 30.04.2019, protokolluar në bashkinë Shijak me nr. 1448 Prot., datë 02.05.2019, është depozituar ankesa e OE "*Sh.*", ku ka kërkuar modifikim të kërkesave për kualifikim.
Me shkresën nr. 1448/1 prot., datë 06.05.2019 nga AK i kthehet përgjigje ankesës së OE "*Sh.*", e cila është pranuar si e rregullt dhe është refuzuar duke dhënë argumentet përkatëse bazuar në projet dhe në relacionin shoqërues.
Me shkresën pa numër protokolli, datë formulari 02.05.2019, protokolluar në bashkinë Shijak me nr. 1486 Prot., datë 06.05.2019, është depozituar ankesa e OE "*A. K.*", ku ka kërkuar modifikim të kërkesave për kualifikim.
Me shkresën nr. 1486/1 prot., datë 07.05.2019 nga AK i kthehet përgjigje ankesës së OE "*A. K.*", e cila është refuzuar si jashtë afatit ligjor. Shkresa është hartuar nga NjP dhe është nënshkruar nga titullari i AK.
Ankesat e refuzuara si më sipër, nuk i janë drejtuar APP-së për rishqyrtim.
Njoftimi i kontratës është bërë në datën 24.04.2019, njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së është shpallur më datë 25.04.2019, ndërsa publikimi është bërë në Buletinin nr. 17, datë 30.04.2019.
Në datën 08.05.2019, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 27.05.2019 është bërë 03.06.2019.
Në datën 03.06.2019, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 8 ofertuesve.
Në datën 26.06.2019 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.

Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.
Me nr. 2288 prot., datë 02.07.2019, është depozituar ankesa e BOE "*E. A.&V. K.*", pa numër protokolli të BOE, në lidhje me skualifikimin e ofertës pasi mjeti grejder ishte i papajisur me targa dhe mungon një hekurkthyes.
Me nr. 2291 prot., datë 02.07.2019, është depozituar ankesa e OE "*Sh.*", me nr. 70 prot. nga OE, në lidhje me skualifikimin e ofertës.
Me nr. 226 dhe nr. 2310 prot., datë 03.07.2019 ka dalë Urdhëri për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit të ankesave, ku janë përcaktuar anëtarët: R. D., Kryetar, me detyrë Specialist, inxhinier ndërtimi, A. M., Anëtarë, me detyrë Specialiste në sektorin juridik dhe P. A., anëtare, me detyrë Drejtor i Drejtorisë ekonomike.
Me shkresën nr. 2310/1 prot., datë 08.07.2019, nga KSHA ka dalë Vendimi nr. 1/2019, për shqyrtimin e ankesës së BOE "*E. A.&V. K.*", duke e pranuar si të rregullt, duke e kualifikuar dhe shpallur fitues.
Me nr. 2291/1 prot., datë 05.07.2019, nga OE "*Sh.*" është depozituar shkresa për tërheqjen e ankimimit, pa numër protokolli të OE.
Me nr. 2291/2 prot., datë 08.07.2019 ka dalë Vendimi nr. 4 për mosshqyrtimin e ankesës së OE OE "*Sh.*" për shkak të tërheqjes nga ankimimi.
Me nr. 2323 prot., datë 04.07.2019, është depozituar ankesa e OE "*I.*", pa numër protokolli nga OE, datë 03.07.2019, në lidhje me skualifikimin e ofertës për mungesën e një automakinisti.
Me nr. 2323/1 prot., datë 08.07.2019, i është kthyer përgjigje OE "*I.*", nëpërmjet së cilës i refuzohet ankesa, me argumentin se nuk ka respektuar afatet ligjore, pasi në AK ka mbërritur në datën 04.07.2019. Në gjykimin e grupit të auditimit, qëndron arsyeja e mospranimit të ankesës për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor.
Me nr. 2310/2 prot., datë 08.07.2019 ka dalë Urdhëri nr. 234 për vazhdimin e procedurës së prokurimit.
Në datën 09.07.2019 nga KVO është mbajtur PV për rivlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Me nr. 2423 prot., datë 11.07.2019, është depozituar ankesa e OE "*R. C.*", pa numër protokolli nga OE, me datë 10.07.2019, në lidhje me skualifikimin e ofertës.
Me nr. 2423/1 prot., datë 12.07.2019, nga OE "*R. C.*" është depozituar shkresa për tërheqjen e ankimimit, pa numër protokolli të OE.
Me nr. 2423/2 prot., datë 12.07.2019 ka dalë Vendimi nr. 5 për mosshqyrtimin e ankesës së OE OE "*R. C.*" për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor dhe tërheqjes nga ankimimi.
Në datën 17.07.2019, me nr. 2525 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Me nr. 2652 prot., datë 24.07.2019, është protokolluar në bashkinë Shijak Vendimi nr. 474/1 prot., datë 22.07.2019 i KPP, në lidhje me ankesën e OE "*I.*", nëpërmjet të cilit i refuzon ankesën për të njëjtën arsye që e ka refuzuar edhe AK.
Kontrata është lidhur në datën 26.08.2019, me nr. prot. 3009, për vlerën 59,985,423 lekë pa TVSH dhe 71,982,508 lekë me TVSH. Në nenin 7 të Kontratës, "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", është përcaktuar që për vitin 2019 do të paguhet vlera 25,846,769 lekë ndërsa për vitin 2020 do të paguhet vlera e mbetur 46,135,739 lekë.
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit

"*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit:Ky investim është nga buxheti i shtetit, me fond limit 60,993,255 lekë, i miratuar me VKM nr. 2, datë 27.03.2019 "*Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja e parë për vitin 2019, grantet "Arsimi bazë", "Arsimi i mesëm"*". Për vitin e parë do të financohet vlera 19,772,460. Vlera e bashkëfinancimit nga të ardhurat e veta, sipas VKM-së do të jetë 10% ose 7,323,133 lekë.
Me shkresën nr. 1179 datë 05.04.2019 është dërguar në MASR kalendari i fazave të prokurimit për objektin në fjalë.
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Projekti është nënshkruar nga ing. Gj. Ç. dhe ark. B. T., të cilët janë punonjës të Bashkisë Shijak, ndërsa si ing. Hidroteknik është O. M., e cila ka nënshkruar sistemin e instalimeve hidrosanitare, shkarkimin e ujrave dhe kanalizimet. Si Drejtore e Drejtorisë së planifikimit të territorit, shërbimeve dhe infrastrukturës publike, ka nënshkruar ing. D. I.. Punimet topografike janë nënshkruar nga topografi i bashkisë, R. Sh.. Projekti elektrik, sistemi i ngrohjes, mbrojtja nga zjarri, etj., janë nënshkruar nga ing. Gj. Ç. dhe ark. B. T., të cilët nuk janë të liçencuar profesionalisht për hartimin e projekteve elektrike, të ngrohjes, mbrojtjes nga zjarri, etj.
Në dosje nuk disponohet urdhëri i posaçëm për caktimin e detyrës së projektimit.
Në dokumentacionin e projektit u konstatua se për një pjesë të punimeve, llogaritjet nuk janë sipas manualit, por sipas analizave të bëra nga projektuesi.
Leja e zhvillimit është miratuar me vendimin nr. 166 datë 17.07.2019.
Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 11, datë 30.08.2019.
Hartimi i këtij projekti nga persona jo të pajisur me liçencat profesionale përkatëse, është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, neni 5 dhe ligjin nr. 8402, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" datë 10.09.1998, i ndryshuar, neni 4.
Vlerësimi i kritereve:Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...",* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për punë publike*" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
3. Kërkesa për mjek të punësuar është e tepërt dhe në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.

4. Kërkesa për "*Punonjës me dëshmi trajnimi si "Specialist për sigurinë dhe shëndetin në punë, 2 të punësuar'*"", nga grupi i auditimit gjykohet e tepërt, është e paargumentuar dhe nuk ka mbështetje ligjore.
5. Kërkesa për 3 ekskavatoristë, ndërkohë që kërkohet vetëm 1 ekskavator dhe për 2 buldozieristë, kur nuk kërkohet buldozier, nga grupi i auditimit gjykohet e tepërt.
6.Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit",* të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., O. M. dhe Gj. Ç..
Vlerësimi i ofertës fituese: Nga KVO nuk është specifikuar në procesverbal që:
1. Makineritë teknologjike nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, çertifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "*Makinat teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*".
2. Për pajisjet të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.
3. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.
Konkluzion: Pavarësisht se nga KVO fillimisht janë skualifikuar të gjithë ofertuesit dhe rivlerësimi është bërë në bazë të ankesës së OE të shpallur fitues, për mangësitë e konstatuara nga auditimi AK mund të kishte anuluar tenderin, në mbështetje të kërkesave të LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G. dhe Gj. Ç. dhe KVO, i përbërë nga: N. K., D. Ç. dhe E. V..
Për hartimin e fondit limit dhe projektit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G., dhe B. T., si dhe hartuesit të cilët kanë nënshkruar në cilësinë e punonjësve të Bashkisë Shijak, ing. Gj. Ç., ark. B. T., ing. O. M., ing. D. I. dhe ing. R. Sh..
Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K. kryetar, D. Ç. anëtar dhe E. V. anëtar.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se: ...1. Makineritë teknologjike nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike", ku përcaktohet: ..."Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit." ...2. Për pajisjet e tjera, të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara. ...3. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar. ...Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
1. Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.
Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.

4. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Hardhishtë-Rreth*		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1249 Prot, datë 12.04.2019 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e Hapur – Punë Publike"	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** 1106 Prot., datë 29.03.2019 E. O., kryetare, juriste O. M., anëtare, ing. hidroteknike Gj. Ç., anëtar, ing. ndërtimi	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 1250 Prot., datë 12.04.2019 N. K. kryetar D. Ç. anëtare E. V. anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 52,163,759 lekë REF-19029-04-19-2019	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "E. A.&V. K." 51,789,577 lekë. Kontrata nr. 3171, datë 09.09.2020, me afat 219 ditë	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 374,182 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 29.05.2019	**9. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 12 OE **b)** Skualifikuar 11 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**- Nr. 1427 Prot., datë 30.04.2019; **AK**- Nr. 2289 Prot., datë 02.07.2019; **AK**- Nr. 2290 Prot., datë 02.07.2019; **APP**–s'ka; **KPP-**s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Nr. 1427/1 prot., datë 03.05.2019 Nr. 2311/1 Prot., datë 08.07.2019 Tërheqje ankese – Nr. 2290/1 Prot. datë 05.07.2019	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: s'ka

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Situata: Zhvillimi i procedurës: Në datën 12.04.2021 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit pa numër protokolli.
Në datën 19.04.2021 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Me nr. 1427 Prot., datë 30.04.2019, është depozituar ankesa e shoqërisë "N. S.", ku ka kërkuar modifikim të kërkesave për kualifikim, në lidhje me përcaktimin nëse do të pranohet apo jo nënkontraktimi, heqjen e kërkësës që në rastet e BOE, secili nga OE të disponojë çertifikatat ISO në përputhje me zërat e punimeve sipas aktmarrëveshjes, kërkesën për jo më pak se 61 punonjës për periudhën maj 2018-prill 2019 dhe afatin prej 219 ditësh, pasi nuk është llogaritur puna me dy turne.
Me shkresën nr. 1427/1 prot., datë 03.05.2019 nga AK i kthehet përgjigje ankesës së OE "N. S.", e cila është pranuar si e rregullt. Sipas grupit të auditimit ankesa qëndron pjesërisht.
Në datën 22.05.2019, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 23.05.2019 është bërë 29.05.2019.
Në datën 29.05.2019, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 12 ofertuesve.
Në datën 26.06.2019 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.
Me nr. 2289 Prot., datë 02.07.2019, është depozituar ankesa e BOE "*E. A.&V. K.*", pa numër protokolli të BOE, në lidhje me skualifikimin e ofertës pasi mjeti grejder ishte i papajisur me targa.
Me nr. 2290 Prot., datë 02.07.2019, është depozituar ankesa e OE "*Sh.*", me nr. 68 Prot. nga OE, në lidhje me skualifikimin e ofertës.
Me nr. 227 dhe nr. 2311 Prot., datë 03.07.2019 ka dalë Urdhëri për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit të ankesave, ku janë përcaktuar anëtarët: R. D., Kryetar, me detyrë Specialist, inxhinier ndërtimi, A. M., Anëtarë, me detyrë Specialiste në sektorin juridik dhe P. A., anëtare, me detyrë Drejtor i Drejtorisë ekonomike.
Me shkresën nr. 2311/1 prot., datë 08.07.2019, nga KSHA ka dalë Vendimi nr. 2/2019, për shqyrtimin e ankesës së BOE "*E. A.&V. K.*", duke e pranuar si të rregullt, duke e kualifikuar dhe shpallur fitues.
Me nr. 2290/1 Prot., datë 05.07.2019, nga OE "*Sh.*" është depozituar shkresa për tërheqjen e ankimimit, pa numër protokolli të OE.
Me nr. 2290/2 Prot., datë 08.07.2019 ka dalë Vendimi nr. 3 për mosshqyrtimin e ankesës së OE OE "*Sh.*" për shkak të tërheqjes nga ankimimi.
Me nr. 2311/2 Prot., datë 08.07.2019 ka dalë Urdhëri nr. 235 për vazhdimin e procedurës së prokurimit.
Në datën 09.07.2019 nga KVO është mbajtur PV për rivlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Në datën 17.07.2019, me nr. 2524 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Kontrata është lidhur në datën 09.09.2019, me nr. prot. 3171, për vlerën 51,789,577 lekë pa TVSH dhe 62,147,492 lekë me TVSH. Në nenin 7 të Kontratës, "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", është përcaktuar që për vitin 2019 do të paguhet vlera 25,000,000 lekë ndërsa për vitin 2020 do të paguhet vlera e mbetur 37,147,492 lekë.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit:Ky investim është nga buxheti i shtetit, në vlertën 52,163,759 lekë, i miratuar me VKM nr. 170, datë 27.03.2019 "*Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1,000,000,000 (një miliard) lekë në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit"*".
Me nr. 1106 prot., datë 29.03.2019, ka dalë urdhëri nr. 124 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*". Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit.
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit. Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se projekti, preventivi, specifikimet teknike, relacioni janë hartuar nga shoqëria "*E. shpk*" dhe janë nënshkruar nga titullari i AK.
Nga ballafaqimi me NjP, u konstatua se projekti, preventivat dhe specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinierët e AK, pjesëtarë të njësisë së prokurimit, të cilët kanë bashkëpunuar me studion "*E. shpk*" për punime të caktuara. Ky bashkëpunim ka qenë pa pagesë për AK. Relacioni përshkruan vendndodhjen dhe gjendjen ekzistuese të objektit që do të ndërtohet.
Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 161, datë 16.07.2019.
Vlerësimi i kritereve:Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...",* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për punë publike*" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
3. Kërkesa për mjek të punësuar është e tepërt, pasi nuk ka punime gjeologjike dhe kërkesa për mjek është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.
4.Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.

Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit",* të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertës fituese:Nga KVO nuk është specifikuar në procesverbal që:

1. Makineritë teknologjike nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, çertifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "*Makinat teknologjike*" dhe neni 113 "*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*".

2. Për pajisjet të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.

3. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.

Konkluzion: Pavarësisht se nga KVO fillimisht janë skualifikuar të gjithë ofertuesit dhe rivlerësimi është bërë në bazë të ankesës së OE të shpallur fitues, për mangësitë e konstatuara nga auditimi AK mund të kishte anuluar tenderin, në mbështetje të kërkesave të LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., O. M. dhe Gj. Ç. dhe KVO, i përbërë nga: N. K., D. Ç. dhe E. V..

Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K., D. Ç. dhe E. V..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se: ...1. Makineritë teknologjike nuk janë të pajisura me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikatë të kontrollit teknik dhe siguracion, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 "Makinat teknologjike" dhe neni 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike", ku përcaktohet: ..."Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e*

regjistrimit." ...2. Për pajisjet e tjera, të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara. ...3. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar. ...Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht.

Qëndrimi i grupit të Auditimit:
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
1. Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.
Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.

5. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Shijakut***		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1586 Prot., datë 14.04.2020 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e hapur – Punë Publike"	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 1439 Prot., datë 24.03.2020 E. O., kryetare, juriste Gj. Ç., anëtar, ing. ndërtimi N. S., anëtar, ing.hidroteknik /Ekspert i jashtëm (i fushës)	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 1587 Prot., datë 14.04.2020 Sh. D., kryetare J. G., anëtare A. M., anëtare
5. Fondi Limit (pa tvsh) 291,715,652 lekë REF- 56289-04-16-2020	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "K. K. Sh.P.K &K. sh.p.k" 276,533,198.6 lekë Kontrata nr. 5878, datë 27.07.2020 me afat 10 muaj	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 15,182,453.4 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 26.05.2020	**9. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 5 OE **b)** Skualifikuar 4 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**-Nr. 2030 Prot., datë 23.04.2020 **AK**-Nr. 4305 Prot., datë 22.06.2020 **Tërheqje ankese**- Nr. 4305/2 Prot. datë 26.06.2020 **APP**–ska; **KPP**-ska	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK Ska	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: ska

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Situata: Zhvillimi i procedurës: Në datën 14.04.2020 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit pa numër protokolli.
Në datën 16.04.2020 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.
Me nr. 2030 Prot., datë 23.04.2020, është depozituar ankesa e shoqërisë "*K. K.*", ku ka kërkuar modifikim të kërkesave për kualifikim, në lidhje me kategoritë e liçencave të kërkuara dhe numrin e punonjësve.
Me shkresën nr. 2030/1 Prot., datë 23.04.2020 është pezulluar procedura e prokurimit dhe është ngritur KSHA, i përbërë nga O. M., A. B. dhe D. Ç..
Me shkresën nr. 2030/2 Prot., datë 27.04.2020 nga AK i kthehet përgjigje ankesës së OE "*K. K.*", e cila është pranuar si e rregullt dhe është refuzuar. Sipas mendimit të grupit të auditimit, AK ka pasur pjesërisht të drejtë në refuzimin e kërkesës.
Me shkresën nr. 2030/3 Prot., datë 27.04.2020 ka vazhduar procedura e prokurimit.

Në datën 17.05.2020, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit, në bazë të ankesës dhe korrespondencës me APP-në. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 18.05.2019 është bërë 26.05.2019.
Në datën 26.05.2020, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 5 ofertuesve.
Në datën 15.06.2019 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.
Me nr. 4305 Prot., datë 22.06.2020, është depozituar ankesa e OE "*A. K.*", pa numër protokolli të BOE, në lidhje me skualifikimin e ofertës, pasi në kontratat e qerasë së mjeteve nuk është specifikuar objekti në fjalë, nuk është paraqitur çertifikatë e pronësisë për mjetin 17.1 ton, nuk disponohet vibrator dhe vibrator i thellësisë, autobitumatrice, gazogjen dhe elektrosaldatrice.
Me nr. 120 dhe nr. 4305/1 Prot., datë 23.06.2020 ka dalë Urdhëri për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit të ankesave, ku janë përcaktuar anëtarët: N. K., Kryetar, me detyrë zv. Kryetar i bashkisë, F. Gj., Anëtar, me detyrë Specialist në sektorin e projekteve dhe Xh. K., anëtare, me detyrë Specialiste në sektorin juridik.
Me nr. 4787 Prot., datë 29.06.2020, nga OE "*A. K.*" është depozituar shkresa për tërheqjen e ankimimit, me nr. 1063 Prot. të OE.
Me nr. 4305/2 Prot., datë 29.06.2020 ka dalë Vendimi nr. 1 për mosshqyrtimin e ankesës së OE OE "*A. K.*" për shkak të tërheqjes nga ankimimi.
Në datën 01.07.2020, me nr. 1587/1 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Kontrata është lidhur në datën 27.07.2020, me nr. prot. 5878, për vlerën 276,533,199 lekë pa TVSH dhe 331,619,838 lekë me TVSH. Në nenin 7 të Kontratës, "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", është përcaktuar që për vitin 2020 do të paguhet vlera 70,000,000 lekë, për vitin 2021 do të paguhet vlera 69,134,567 lekë, për vitin 2022 do të paguhet vlera 69,134,567 lekë dhe në vitin 2023 do të paguhet vlera e mbetur 123,350,704 lekë, ndërkohë që në DST (në shtojcë) është përcaktuar që për vitin 2020 do të paguhet vlera 58,333,333 lekë, për vitin 2021 do të paguhet vlera 57,612,139 lekë, për vitin 2022 do të paguhet vlera 57,612,139 lekë dhe në vitin 2023 do të paguhet 118,158,041 lekë.
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të "*Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit:Ky investim është nga buxheti i shtetit, në vlerën 291,715,652 lekë, i miratuar me shkresën nr. 433 Prot., datë 11.02.2020 nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve "*Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Shijakut*", për vlerën totale 354,976,241 lekë. Detajimi i buxhetit është dërguar me shkresën nr. 479 Prot., datë 14.02.2020.
Me nr. 1439 prot., datë 24.03.2020, ka dalë urdhëri nr. 81 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*". Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit, E. O., kryetare, juriste, Gj. Ç., anëtar, ing. ndërtimi dhe N. S., anëtar, ing. hidroteknik, Ekspert i jashtëm (i fushës), i cili është punonjës i UKD.
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.

Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se projekti, preventivi, specifikimet teknike, relacioni janë hartuar nga ing. V. Gj. dhe janë nënshkruar nga titullari i AK.
Nga observacionet e paraqitura nga subjekti në fazën e hartimit të projekt Raportit, u konstatua se projekti i është dhuruar bashkisë Shijak me kontratën e datës 28.01.2020. Projekti nuk është bërë hyrje në magazinë dhe nuk është kontabilizuar, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*".
Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 286, datë 14.07.2020.
Vlerësimi i kritereve:Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...",* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për punë publike*" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
3. Kërkesa për mjek është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.
4. Kërkesa për "*Inxhinier, ... koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me çertifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) ... për të cilin duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë e dhënë nga një organizëm i akredituar, liçencuar/çertifikuar çertifikimi shqiptar ose i huaj.*", është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*", neni 10 "*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*", pika 5.
5. Kërkesa që në rastin e makinerive të cilat janë marrë me qera, manovratorët "*nuk duhet të jenë të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë*" është e papërshtatshme, pasi në kontratat e qerasë specifikohet vetëm marrja me qera e makinerive dhe jo e manovratorëve. Punonjësit nuk janë objekt qeraje dhe rrjedhimisht specifikimi për mënyrën e përdorimit të makinerive me qera e bën të paqartë mënyrën e realizimit të kontratës.
6. Kërkesa që "*për mjetet me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe kohëzgjatja e saj*", nga grupi i auditimit konsiderohet e papërshtatshme dhe nuk është e mbështetur në ligj.
7.Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që

vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Vlerësimi i ofertës fituese: **1.** OE K. K.ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga bashkitë Tiranë, Shijak, Vorë, Kolonjë, Konispol dhe Shkodër, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Durrës, Skrapar, Fier dhe Vlorë, ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari i paregjistruar në organet tatimore vendore.
OE K.ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga bashkitë Tiranë dhe Kamëz, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Librazhd, Durrës, Sarandë, Korçë, Lezhë, etj., ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari i paregjistruar në organet tatimore vendore.
Sa më sipër janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*".
2. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.
3. Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për disa nga makineritë teknologjike është në gjuhë të huaj, nuk është i lexueshëm dhe makineritë janë të patarguara. Për shkak të distancave të veprës që do të ndërtohet, këto mjete duhet të qarkullojnë nga një pikë në tjetrën dhe duhet të ishin të pajisura me targa.
4. Për pajisjet të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.
Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".
5. Pavarësisht se OE kanë paraqitur deklaratën mbi kontratat e lidhura ose në proces sipas shtojcës 11, nga KVO nuk është bërë asnjë verifikim në lidhje me këtë pikë dhe nuk garantohet që OE e plotësojnë këtë kriter, duke pasur parasysh që nga kontratat e deklaruara, si dhe nga verifikimi i pagesave në degën e thesarit, të dy pjesëmarrësit në BOE kanë kontrata në mjaft institucione.
Konkluzion:Kualifikimi i kësaj oferte është bërë në mospërputhje me kërkesat e LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3 .
Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "*K. K.&K.*", i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. AK duhet të kishte anuluar tenderin, të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret për të rritur numrin e pjesëmarrësve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.

Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.
Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., Gj. Ç. dhe N. S., si dhe KVO, i përbërë nga: Sh. D., J. G. dhe A. M..
Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: Sh. D., J. G. dhe A. M..

6. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *Rikualifikim i rrugës ish SMT, deri te Shala Group dhe ndërtimi i rrjetit KUZ në rrugën Xhelal Memoci*		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 4680 Prot., datë 26.06.2020 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e hapur – Punë Publike"	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 813 Prot., datë 17.02.2020 E. O., kryetare, juriste J. G., anëtare, ing.ndërtimi Gj. Ç., anëtar, ing. ndërtimi	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 4681 Prot., datë 26.06.2020 N. K., kryetar D. Ç., anëtare F. Gj., anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 82,993,339 lekë REF- 63021-06-26-2020	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "A. A. Sh.P.K &A. K. sh.p.k" 73,616,798 lekë Kontrata nr. 9107, dt. 28.09.2020, 350 ditë	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 9,376,541 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 30.07.2020	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 12 OE **b)** Skualifikuar 10 OE, **c)** Kualifikuar 2OE
11. Ankimime **AK**-ska **APP**–ska; **KPP**-ska	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ska	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: ska

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 813 prot., datë 17.02.2020, ka dalë urdhëri nr. 43 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*".
Në datën 26.06.2020 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit pa numër protokolli.
Në datën 26.06.2020 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.
Në datën 30.07.2020, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 12 ofertuesve.
Në datën 09.09.2020 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.
Në datën 17.09.2020, me nr. 4681/1 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Kontrata është lidhur në datën 28.09.2020, me nr. prot. 9107, për vlerën 73,616,798 lekë pa TVSH dhe 88,340,157 lekë me TVSH. Në nenin 7 të Kontratës, "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", është përcaktuar që pagesa do të kryhet brenda tre viteve buxhetore.
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit

"*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit:Ky investim është nga buxheti i bashkisë, në vlerën 82,993,339 lekë, i miratuar me VKB nr. 4523/4, datë 31.12.2019 "*Mbi miratimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022*", nga ku për vitin 2020 do të financohet vlera 12,680,000 lekë, për vitin 2021 do të financohet vlera 35,000,000 lekë dhe për vitin 2022 do të financohet vlera 52,244,000 lekë.
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit. Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se projekti, preventivi, specifikimet teknike, relacioni janë hartuar nga ing. J. G., ing. Gj. Ç. dhe ing. O. M. dhe janë nënshkruar nga ish titullari i Bashkisë Shijak, z. E. A..
Vlerësimi i kritereve:Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...",* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për punë publike*" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
3. Kërkesa për mjek është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.
4.Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
5. Kërkesa që "*Mjeti autobitumatrice të jetë i pajisur me çertifikatë për transport mallrash të rrezikshme*" është e papërshtatshme dhe e pambështetur në ligjin nr. 118/2012 "*Për transportin e mallrave të rrezikshme*", neni 23 "*Llojet e mallrave për autorizim*", pika 1.
Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Vlerësimi i ofertës fituese: **1.** OE A. K.ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga bashkitë Maliq dhe Korçë, por nuk ka paraqitur

vërtetime nga Bashkitë Durrës dhe Tiranë, ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari i paregjistruar në organet tatimore vendore.
OE A. A.ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga bashkitë Durrës, Rrogozhinë, Shijak, Kavajë, dhe Korçë, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë e tjera, ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari i paregjistruar në organet tatimore vendore, si Tiranë, Fier, etj.
Sa më sipër është në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*".
2. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.
3. BOE nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave në DST për makineritë.
Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për makineritë është në gjuhë të huaj, nuk është i lexueshëm dhe makineritë janë të patarguara. Për këtë arsye, sipas gjykimit të grupit të auditimit nuk vërtetohet disponimi i këtyre mjeteve. Gjithashtu, nga AK nuk është kërkuar disponimi i të paktën një rimorkiatori, i cili të bëjë transportin e mjeteve të cilat janë të patarguara dhe nuk lejohet të qarkullojnë në rrugë. Për shkak të distancave të veprës që do të ndërtohet, këto mjete duhet të qarkullojnë nga një pikë në tjetrën dhe duhet të ishin të pajisura me targa ose të disponohej një rimorkiator.
4. Për pajisjet të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.
Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".
Konkluzion: Për sa më sipër, AK mund të kishte anuluar tenderin, sipas kërkesave të LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.
Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G. dhe Gj. Ç., si dhe KVO, i përbërë nga: N. K., D. Ç. dhe F. Gj..
Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K., D. Ç. dhe F. Gj..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Për pikat 1, 2, 3 dhe 4 të objeksioneve, për të cilat janë paraqitur kundërshti në lidhje me Akt Konstatimet e lëna nga grupi i auditimit, KVO thjesht është shprehur që "Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht" ose thjesht "është marrë në konsideratë", pa dhënë asnjë koment apo kundërshti.*

2. *5. Në lidhje me konstatimin e bërë nga ana juaj, në lidhje me tejkalimin e afatit prej 15 ditësh të vlerësimit të procedurave të prokurimit nga ana e KVO-së, ju bëjmë me dije se, anëtarët e KVO përveç detyrës funksionale që kanë si specialistë të sektorëve të ndryshëm të institucionit, gjithashtu edhe nga mungesa e një sektori të veçantë të prokurimeve, ngarkohen me një detyrë tjetër shtesë, siç është ajo e anëtarit të KVO. ...Përveç kësaj, tërmeti i 26 nëntorit 2019, nga i cili u godit edhe Bashkia Shijak, solli si pasojë angazhimin në detyra të tjera në ndihmë të komunitetit, të gjithë stafin e institucionit tonë, duke sjellë vonesa edhe në drejtim të vlerësimit të procedurave të prokurimit. ...Po ashtu, edhe situata e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 solli vonesat e veta.* **Qëndrimi i grupit të Auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: **1.** Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit. <u>Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.</u> **2.** Komentet dhe objeksionet e bëra janë justifikime të paargumentuara. Objeksioni dhe komentet e paraqitura janë të njëjta me trajtimin e bërë në kundërshtitë e paraqitura për Aktin e konstatimit, duke mos dhënë asnjë argument të ri apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit. <u>Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.</u>

7. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave***		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 6219 Prot., datë 06.08.2020 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e hapur – Shërbime"	**3.1 Hartuesit e termave të referencës dhe kritereve për kualifikim** Nr. 522 Prot., datë 30.01.2020 J. G., kryetare, ing.ndërtimi' S. B., anëtare, ekonomiste T. P., anëtare, juriste E. L., anëtare, supervizore e pastrimit H. Xh., anëtare, supervizore e shërbimit të varrimit **3.2 Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 6219 Prot., datë 06.08.2020 E. O., kryetare, juriste P. A., anëtare, ekonomiste E. Z., anëtare, ekonomiste	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 6220 Prot., datë 06.08.2020 Sh. D., kryetar D. Ç., anëtare A. M., anëtare
5. Fondi Limit (pa tvsh) 31,707,810 lekë REF- 69339-08-20-2020	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "A. sh.p.k" 30,911,969 lekë Kontrata nr. 11232, dt. 23.12.2020, 12 muaj	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 795,841 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 22.09.2020	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 1 OE **b)** Skualifikuar 0 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**-ska; **APP**–ska; **KPP-**ska	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ska	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: ska

<u>Titulli i gjetjes:</u>Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Situata:<u>Zhvillimi i procedurës:</u> Fondet për këtë prokurim janë miratuar me VKB nr. 4523/4, datë 31.12.2019 "*Mbi miratimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022*", në bazë të planit vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Shijak, konfirmuar nga Prefekti Durrës me shkresën nr. 1101/1 prot., datë 06.01.2017.

Me nr. 522 prot., datë 30.01.2020, ka dalë urdhëri nr. 31 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për ngritjen e grupit të punës për përllogaritjen e kostos së shërbimit të pastrimit, gjelbërimit dhe*

mirëmbajtjes së varrezave". Me këtë detyrë janë ngarkuar J. G., përgjegjëse sektori PKZHT, kryetare, S. B., përgjegjëse sektori TTV, T. P., Specialiste dektori juridik, E. L., Supervizor i pastrim-gjelbërimit dhe H. Xh., Supervizor i mirëmbajtjes së varrezave, të cilët kanë nënshkruar edhe preventivin. Bashkëlidhur gjenden llogaritjet e fondit limit, ku për bazë janë përdorur të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas censusit të vitit 2011.
Në datën 05.08.2020 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit pa numër protokolli.
Në datën 20.08.2020 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Në datën 22.09.2020, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 1 ofertuesi.
Në datën 19.10.2020 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Në datën 28.10.2020, me nr. 6220/1 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Kontrata është lidhur në datën 23.12.2020, me nr. prot. 11232, për vlerën 30,911,969 lekë pa TVSH dhe 37,094,363 lekë me TVSH.
Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi KVO, e përbërë nga: Sh. D., D. Ç. dhe A. M..
Vlerësimi i fondit limit: Fondi vjetor për pastrimin e Bashkisë Shijak për vlerën 31,707,810 lekë pa TVSh, për një periudhë 12 muaj është miratuar me VKB nr. 4523/4, datë 31.12.2019 "*Mbi miratimin e buxhetit afatmesëm 2020-2022*",
Bashkia Shijak në përcaktimin e fondit limit është bazuar në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", në ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996 "*Për largimin të mbeturinave*", në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës në RSH*", me ndryshime, në ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*", me ndryshime dhe në VKM-në nr. 809, datë 26.12.2018 "*Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi*".
Vlerësimi i kritereve: Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se janë të argumentuara dhe në përputhje me nevojat e shërbimit që prokurohet.
Vlerësimi i ofertës fituese:Dokumentacioni i paraqitur për makineritë me qera është fotokopje i palexueshëm, në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".
Konkluzion: Për sa më sipër, AK mund të kishte anuluar tenderin, sipas kërkesave të LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë

në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.
Për zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G. dhe Gj. Ç., si dhe KVO, i përbërë nga: Sh. D., D. Ç. dhe A. M..
Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: Sh. D., D. Ç. dhe A. M..

<table>
<tr><th colspan="3">8. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rehabilitimi i sistemit ujitës, Njësia Administrative Gjepalaj</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi:
Nr. 10184 Prot., datë 05.11.2020</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e D. Tenderit:
Nr. 4811 Prot., datë 30.06.2020
E. O., kryetare, juriste
O. M., anëtare, ing.hidroteknik
M. G., anëtar, agronom</td><td rowspan="2">4. Komisioni i V. Ofertave:
Nr. 10185 Prot., datë 05.11.2020
N. K., kryetar
Gj. Ç., anëtar
A. B., anëtare</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës
“Procedurë e hapur- Punë publike”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa tvsh)
12,151,102 lekë
REF-77861-11-06-2020</td><td>6. Oferta fituese (pa tvsh)
“V. H. sh.p.k” 11,543,244 lekë
Kontrata nr. 2263, dt. 08.04.2020, 151 ditë</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 607,857.68 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Data e hapjes: 14.12.2020</td><td>9. Burimi Financimit
Buxheti i shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
a) Pjesëmarrës në tender 9 OE
b) Skualifikuar 7 OE,
c) Kualifikuar 2 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
AK- Nr.1030 Prot., datë 15.02.2021
Tërheqje ankese – Nr. 1030/2 Prot., datë 17.02.2021
APP–ska; KPP-ska</td><td>12. Përgjigje Ankesës nga AK
Ska</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: ska</td></tr>
</table>

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 4811 prot., datë 30.06.2020, ka dalë urdhëri nr. 130 i titullarit të Bashkisë Shijak “*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*”. Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit, E. O., kryetare, juriste, O. M., anëtar, ing. hidroteknik, eksperte e fushës dhe M. G., anëtar, Agronom, ekspert i fushës.
Në datën 28.07.2020 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit pa numër protokolli.
Në datën 16.11.2020 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.
Në datën 07.12.2020, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 09.12.2020 është bërë 14.12.2020.
Në datën 14.12.2020, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 9 ofertuesve.
Në datën 09.02.2021 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, pika 2.
Me nr. 1030 Prot., datë 15.02.2021, është depozituar ankesa e OE “*N.*”, pa numër protokolli të BOE, në lidhje me skualifikimin e ofertës, pasi mungojnë 3 autobetoniere dhe 2 autovetëshkarkuese.
Me nr. 54 dhe nr. 1030/1 Prot., datë 15.02.2021 ka dalë Urdhëri për pezullimin e procedurës së prokurimit dhe ngritjen e Komisionit të ankesave, ku janë përcaktuar anëtarët: Sh. D.,

Kryetar, me detyrë zv. Kryetar i bashkisë, J. G., Anëtar, me detyrë Drejtore në Drejtorinë e PTSHIP dhe T. P., anëtare, me detyrë Specialiste në sektorin juridik.
Me nr. 1030/2 Prot., datë 17.02.2021, nga OE "*N.*" është depozituar shkresa për tërheqjen e ankimimit, me nr. 167 Prot. të OE.
Me nr. 1030/3 Prot., datë 17.02.2021 ka dalë Vendimi nr. 1 për mosshqyrtimin e ankesës së OE OE "*N.*" për shkak të tërheqjes nga ankimimi.
Nga titullari i institucionit ka dalë Urdhëri nr. 58, me nr. 1030/4 Prot., datë 18.02.2021 për vazhdimin e procedurës së prokurimit.
Në datën 18.02.2021, me nr. 1134 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Kontrata është lidhur në datën 08.04.2021, me nr. prot. 2263, për vlerën 11,543,244 lekë pa TVSH dhe 13,851,893 lekë me TVSH. Në nenin 7 të Kontratës, "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", është përcaktuar që pagesa do të kryhet në bazës të ecurisë së punimeve, me shtrirje në dy vite buxhetore.
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit:Ky investim është miratuar me VKM nr. 488, datë 17.06.2020 "*Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit prej 950,295,959 lekësh, në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit"*", për vlerën totale 14,983,766 lekë, nga e cila për vitin 2020 do të financohet vlera 10,000,000 lekë dhe për vitin 2021 do të financohet vlera 4,983,766 lekë.
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit. Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se projekti, preventivi, specifikimet teknike, relacioni janë hartuar nga Drejtoria e planifikimit dhe kontrollit të territorit, të nënshkruara nga titullari i AK, ing. J. G. në cilësinë e drejtorit dhe nga ing. Gj. Ç., ing. O. M. dhe ing. R. Sh. në cilësinë e grupit të punës.
Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 1394, datë 06.11.2020.
Vlerësimi i kritereve:Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e këstit të parë të detyrimeve vendore për vitin 2020 , në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas të dhënave përkatese të ekstraktit të QKR-së.*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende apo periudha të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh.
2. Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ..."* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për punë publike*" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.

3. Kërkesa për "*Specialist, minimalisht 1 të punësuar , i cili përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve...*", është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*", neni 10 "*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*", pika 5.

4.Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.

Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertës fituese: **1.** Duke paraqitur vërtetime për vitin 2020, OE nuk garanton se nuk ka detyrime të papaguara për periudhat e mëparshme në vende të tjera ku ka ushtruar veprimtari biznesi. Vetëm me vërtetimin e paraqitur nuk përmbushen kërkesat e parashtruara në LPP, neni 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).

2. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE ka paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.

3.Makineritë teknologjike janë të patarguara dhe pavarësisht se është paraqitur deklarata e zhdoganimit, dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së është në gjuhë të huaj. Për këtë arsye, sipas gjykimit të grupit të auditimit nuk garantohet disponimi i këtyre mjeteve. Për shkak të distancave të veprës që do të ndërtohet, këto mjete duhet të qarkullojnë nga një pikë në tjetrën dhe duhet të ishin të pajisura me targa.

Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".

Konkluzion: Për sa më sipër, AK mund të kishte anuluar tenderin, sipas kërkesave të LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., O. M. dhe M. G., si dhe KVO, i përbërë nga: N. K., Gj. Ç. dhe A. B..

Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K., Gj. Ç. dhe A. B..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Për tre nga konstatimet e grupit të auditimit, për të cilat janë paraqitur kundërshti në lidhje me Akt Konstatimet e lëna nga grupi i auditimit, KVO thjesht është shprehur që "Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht", pa dhënë asnjë koment apo objeksion.*

2. *Në lidhje me konstatimin e bërë nga ana juaj, në lidhje me tejkalimin e afatit prej 15 ditësh të vlerësimit të procedurave të prokurimit nga ana e KVO-së, ju bëjmë me dije se, anëtarët e KVO përveç detyrës funksionale që kanë si specialistë të sektorëve të ndryshëm të institucionit, gjithashtu edhe nga mungesa e një sektori të veçantë të prokurimeve, ngarkohen me një detyrë tjetër shtesë, siç është ajo e anëtarit të KVO. ...Përveç kësaj, tërmeti i 26 nëntorit 2019, nga i cili u godit edhe Bashkia Shijak, solli si pasojë angazhimin në detyra të tjera në ndihmë të komunitetit, të gjithë stafin e institucionit tonë, duke sjellë vonesa edhe në drejtim të vlerësimit të procedurave të prokurimit. ...Po ashtu, edhe situata e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 solli vonesat e veta.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.

Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.

2. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

9. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Rikonstruksion i tubacionit së dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V=2000 m³ Shijak, rrjet shpërndarës të fshatrave Maminas – Kareç – Bilalas – Karpen – Bodinak, Loti I***		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1470 Prot., datë 05.03.2021 **2. Lloji i Procedurës** **"**Procedurë e hapur – Punë Publike"	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 1363 Prot., datë 03.03.2021 E. O., kryetare, juriste J. G., anëtare, ing. ndërtimi/ Ekspert i fushës H. K., anëtar, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve (jurist)	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 1471 Prot., datë 05.03.2021 dhe Nr.2994 Prot., datë 12.05.2021 N. K., kryetar D. Ç., anëtare Gj. Ç., anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 209,836,547 lekë REF-91570-03-29-2021	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** BOE K. K.&K. 207,561,238 lekë Kontrata nr. 5086, datë 25.08.2021, me fat 6 muaj	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2,275,309 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 06.05.2021	**9. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 2 OE **b)** Skualifikuar 1 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**-ska, **APP**–ska; **KPP**-ska	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ska	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: ska

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 1366 prot., datë 03.03.2021, ka dalë urdhëri nr. 77 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit*

limit". Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit, E. O., kryetare, juriste, J. G., anëtare, ing. ndërtimi, eksperte e fushës dhe H. K., anëtar, përgjegjës i sektorit të shërbimeve.
Në datën 05.03.2021 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit pa numër protokolli.
Në datën 29.03.2021 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.
Në njoftimin e kontratës përcaktohet që fondi total është 209,836,547 lekë dhe financimi do të bëhet për 4 vite, konkretisht 41,666,667 lekë për vitin 2021, 16,666,667 lekë për vitin 2022, 16,666,667 për vitin 2023 dhe diferenca për vitin 2024, me afat 6 muaj nga nënshkrimi nga të dyja palët.
Në datën 29.04.2020, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 29.04.2021 është bërë 06.05.2021.
Në datën 06.05.2020, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 2 ofertuesve.
Me nr. 2994 Prot., datë 12.05.2021, ka dalë urdhëri nr. 126 për zëvendësimin e një anëtari të KVO. A. B. zëvendësohet me D. Ç..
Me shkresën nr. 1471/1, datë 08.06.2021, i kërkohet BOE K. K. dhe K. të vënë ne dispozicion dokumentacionin.
Me nr. 1471/2, datë 11.06.2021 nga BOE paraqitet dokumentacioni i kërkuar. Dokumentacioni i paraqitur është fotokopje e panoterizuar, në kundërshtim me DST dhe LPP.
Në datën 14.06.2021 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.
Në datën 23.06.2021, me nr. 3962 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.
Kontrata është lidhur në datën 25.08.2021, me nr. prot. 5086, për vlerën 207,561,238 lekë pa TVSH dhe 247,129,485 lekë me TVSH. Në nenin 7 të Kontratës, "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", është përcaktuar që pagesa do të kryhet në bazës të ecurisë së punimeve, me shtrirje në katër vite buxhetore.
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit:Ky investim është nga buxheti i shtetit, i miratuar me shkresën nr. 217 dhe 217/1 Prot., datë 28.01.2021, "*Miratimi i objektit në programin "Furnizimi me ujë dhe kanalizime"*", për objektin "*Rikonstruksion i tubacionit së dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V=2000m3 Shijak, rrjet shpërndarës të fshatrave Maminas – Kareç – Bilalas – Karpen – Bodinak, Loti I*" në vlerën totale 254,143,833 lekë, përfshirë mbikëqyrjen, nga e cila për vitin 2021 do të financohet vlera 50,000,000 lekë, për vitin 2022 vlera 20,000,000 lekë dhe për vitin 2022 do të financohet vlera 20,000,000 lekë.
Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit. Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se projekti, preventivi, specifikimet teknike, relacioni janë hartuar nga ing. V. Gj. dhe janë nënshkruar nga titullari i AK.
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.

Nga observacionet e paraqitura nga subjekti në fazën e hartimit të projekt Raportit, u konstatua se projekti i është dhuruar bashkisë Shijak me kontratën e datës 15.10.2020. Projekti nuk është bërë hyrje në magazinë dhe nuk është kontabilizuar, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*".
Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 721, datë 05.11.2021.
Vlerësimi i kritereve: Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2020, në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas të dhënave përkatese të ekstraktit të QKR-së*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...",* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për punë publike*" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
3. Kërkesa për 10 manovratorë për mjete të rënda është e tepërt, pasi, nuk kërkohen 10 mjete të rënda dhe gjithashtu nuk parashikohet që të gjitha mjetet të punojnë njëkohësisht.
4. Kërkesa për mjek është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.
5. Kërkesa që në rastin e makinerive të cilat janë marrë me qera, manovratorët "*nuk duhet të jenë të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë*" është e papërshtatshme, pasi në kontratat e qerasë specifikohet vetëm marrja me qera e makinerive dhe jo e manovratorëve. Punonjësit nuk janë objekt qeraje dhe rrjedhimisht specifikimi për mënyrën e përdorimit të makinerive me qera e bën të paqartë mënyrën e realizimit të kontratës.
6.Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
7. Nga AK nuk është kërkuar disponimi i të paktën një rimorkiatori, i cili të bëjë transportin e mjeteve të cilat janë të patarguara dhe nuk duhet të qarkullojnë në rrugë.
Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të*

tenderit”, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.
Vlerësimi i ofertës fituese: **1.** OE K. K.ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga bashkitë Tiranë, Vorë, Shijak dhe Konispol, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Durrës, Kolonjë, Skrapar, Shkodër, Fier dhe Vlorë, ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari i paregjistruar në organet tatimore vendore.
OE K.ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga bashkitë Tiranë dhe Kamëz, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkitë Librazhd, Durrës, Sarandë, Korçë, Lezhë, etj.
Sa më sipër janë në kundërshtim me kërkesat në DST, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”.
2. Çertifikata e trajnimit për sigurinë në punë, e ing. R. B. është nga AQSCERT, subjekt i cili nuk është i akreditуar për çertifikimin e punonjësve.
Çertifikata e trajnimit për sigurinë në punë, e ing. I. K./D. është nga HSE Manegement, subjekt i cili nuk është i akreditуar për çertifikimin e punonjësve.
3. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.
4. Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për disa nga makineritë teknologjike është në gjuhë të huaj, nuk është i lexueshëm dhe makineritë janë të patarguara. Për shkak të distancave të veprës që do të ndërtohet, këto mjete duhet të qarkullojnë nga një pikë në tjetrën dhe duhet të ishin të pajisura me targa, në kundërshtim me Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, neni 58 “*Makinat teknologjike*” dhe neni 113 “*Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike*”.
Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, “*Kapaciteti teknik*”.
5. Për pajisjet të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.
Konkluzion:Kualifikimi i kësaj oferte është bërë në mospërputhje me kërkesat e LPP, neni 24 “*Anulimi i një procedure prokurimi*”, pika 1, neni 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika 1 dhe neni 53, “*Shqyrtimi i ofertave*” pika 3.
Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE “*K. K.&K.*”, i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. AK duhet të kishte anuluar tenderin, të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret për të rritur numrin e pjesëmarrësve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.
Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G. dhe H. K., si dhe KVO, i përbërë nga: N. K., Gj. Ç. dhe A. B..

Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K., D. Ç. dhe Gj. Ç..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Për pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5të objeksioneve, për të cilat janë paraqitur kundërshti në lidhje me Akt Konstatimet e lëna nga grupi i auditimit, KVO thjesht është shprehur që "Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht" ose thjesht "është marrë në konsideratë", pa dhënë asnjë koment apo kundërshti.*

2. *6. Në lidhje me konstatimin e audituesve të KLSH-së se Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për disa nga makineritë teknologjike është në gjuhë të huaj, nuk është i lexueshëm dhe makineritë janë të patarguara. Gjithashtu, nga AK nuk është kërkuar disponimi i të paktën një rimorkiatori, i cili të bëjë transportin e mjeteve të cilat janë të patarguara dhe nuk duhet të qarkullojnë në rrugë. Për shkak të distancave të veprës që do të ndërtohet, këto mjete duhet të qarkullojnë nga një pikë në tjetrën dhe duhet të ishin të pajisura me targa ose të disponohej një rimorkiator. ...Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "Kapaciteti teknik". ...Për pajisjet e tjera, të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara. ...**SQAROJMË se** kjo pikë nuk qëndron dhe KVO është në përputhje me kërkesat e DST dhe legjislacionit tatimor shqiptar. MakI.të teknologjike janë me dokumenta çdoganimi të shoqëruara dhe njihen si blerje nga legjislacioni shqiptar. Në rastet kur sillen importet e mjeteve teknologjike mjafton vetem fleta e doganës e cila është plotësuar pasi janë përkthyër fatura e shitjes dhe dokumentacioni shoqërues. Në fletën e importit janë të përkthyera dhe të interpretuara në këtë fletë doganore të gjitha të dhënat. Mjafton dhe vetëm fleta doganore që të njihët blerja e këtij mjeti dhe të vërtetojë pronësinë e tij. Referohuni fletës doganore që ka të qarta për tu lexuar me nr. reference doganore dhe datë zhdoganimi, vlerë fature, shitësi etj. si dhe për makineritë që janë të patarguara referuar Ligjit nr 8378 datë 22.07.1998 "Kodi rrugor i Republikes së Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 58, pika 1, makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë, pra sipas specifikës mund të jenë të targuara ose të patarguar. Ne kantieret e ndertimit nuk eshte i detyrueshem dhe i arsyeshem targimi i mjeteve teknologjike, mjeteve te renda te kantierit pasi merren masa me sinjalistike ndriçuese dhe jondricuese dhe kufizime te vendeve ku punohet. ...Mjafton vetëm Fleta Doganore ku në të cilën hidhen gjithë të dhënat teknike-ekonomike, financiare dhe ligjore për blerjen përkatëse. Për sa më sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.*

3. *7. Në lidhje me konstatimin e bërë nga ana juaj, në lidhje me tejkalimin e afatit prej 15 ditësh të vlerësimit të procedurave të prokurimit nga ana e KVO-së, ju bëjmë me dije se, anëtarët e KVO përveç detyrës funksionale që kanë si specialistë të sektorëve të ndryshëm të institucionit, gjithashtu edhe nga mungesa e një sektori të veçantë të prokurimeve, ngarkohen me një detyrë tjetër shtesë, siç është ajo e anëtarit të KVO. ...Përveç kësaj, tërmeti i 26 nëntorit 2019, nga i cili u godit edhe Bashkia Shijak, solli si pasojë angazhimin në detyra të tjera në ndihmë të komunitetit, të gjithë stafin e institucionit tonë, duke sjellë vonesa edhe në drejtim të vlerësimit të procedurave të prokurimit. ...Po ashtu, edhe situata e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 solli vonesat e veta.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.

<u>Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.</u>

2. Komentet dhe objeksionet e bëra janë justifikime të paargumentuara. Pronësia e një mjeti vetëlëvizës vërtetohet vetëm në bazë të dispozitave të "*Kodit Rrugor*", Pjesa III, neni 92 dhe

93. Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë. **3.** Njësoj si pika 1 më sipër. Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

10. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *Sistemim, asfaltim i rrugëve lagja Rrubjekë*		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1132 Prot., datë 18.02.2021 **2. Lloji i Procedurës** "Procedurë e hapur – Punë publike"	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 665 Prot., datë 28.01.2021 E. O., kryetare, juriste J. G., anëtare, ing. ndërtimi/Ekspert i fushës H. K., anëtar, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve (jurist)	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 1133 Prot., datë 18.02.2021 N. K., kryetar A. B., anëtare Gj. Ç., anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 62,538,053 lekë REF-87784-02-20-2021	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "A. A.&A. K." 58,451,650 lekë Kontrata nr. 3452 datë 01.06.2021, me afat 126 ditë	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 4,086,403 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 29.03.2021	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 4 OE **b)** Skualifikuar 3 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**-ska; **APP**–ska; **KPP**-ska	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ska	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: ska

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 665 prot., datë 28.01.2021, ka dalë urdhëri nr. 35 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*". Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit.

Në datën 18.02.2021 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit pa numër protokolli.

Në datën 19.02.2021 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.

Në njoftimin e kontratës datë 19.02.2021 përcaktohet që fondi limit është 62,538,053 lekë dhe financimi do të bëhet për 3 vite, konkretisht 16,666,667 lekë për vitin 2021, 20,833,333 lekë për vitin 2022 dhe diferenca për vitin 2023, me afat 126 ditë nga nënshkrimi nga të dyja palët.

Në datën 23.03.2021, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 24.03.2021 është bërë 29.03.2021.

Në datën 29.03.2020, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 4 ofertuesve.

Në datën 07.04.2021 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.

Në datën 15.04.2021, me nr. 1133/1 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i AK.

Kontrata është lidhur në datën 01.06.2021, me nr. prot. 3452, për vlerën 58,451,650 lekë pa TVSH dhe 70,141,980 lekë me TVSH. Në nenin 7 të Kontratës, "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", është përcaktuar që pagesa do të kryhet me shtrirje në tre vite buxhetore.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.

Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit

"*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit:Nga auditimi i dokumentacionit, u konstatua se projekti, preventivi, specifikimet teknike, relacioni janë hartuar nga shoqëria "*L.& C.*".
Ky investim është nga buxheti i bashkisë, i miratuar me VKB nr. 93, datë 02.10.2020, "*Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023, të rishikuar*".
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Nga ballafaqimi me NjP, u konstatua se projekti, preventivat dhe specifikimet teknike janë hartuar nga inxhinierët e AK, pjesëtarë të njësisë së prokurimit, të cilët kanë bashkëpunuar me studion "*L.& C.*" për punime të caktuara. Projekti është nënshkruar nga titullari i institucionit dhe drejtori i drejtorisë së planifikimit të territorit, shërbimeve dhe infrastrukturës publike. Ky bashkëpunim ka qenë pa pagesë për AK. Relacioni përshkruan vendndodhjen dhe gjendjen ekzistuese të objektit që do të ndërtohet.
Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 278, datë 11.05.2021.
Në dokumentacionin e projektit u konstatua se për një pjesë të punimeve, llogaritjet nuk janë sipas manualit, por sipas analizave të bëra nga projektuesi, të cilat nuk gjenden bashkëlidhur projektit.
Vlerësimi i kritereve:Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2020 , në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas të dhënave përkatese të ekstraktit të QKR-së*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...",* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për punë publike*" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
3. Kërkesa që në rastin e makinerive të cilat janë marrë me qera, manovratorët "*nuk duhet të jenë të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë*" është e papërshtatshme, pasi në kontratat e qerasë specifikohet vetëm marrja me qera e makinerive dhe jo e manovratorëve. Punonjësit nuk janë objekt qeraje dhe rrjedhimisht specifikimi për mënyrën e përdorimit të makinerive me qera e bën të paqartë mënyrën e realizimit të kontratës.
4. Në DST kërkohet: "*Mjek, 1 të punësuar.Kontratë individuale të punës dhe diplomë*". Kërkesa për mjek është e tepërt, nuk ka lidhje me asnjë nga përcaktimet e kontratës dhe është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.
5.Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që

vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
6. Nga AK nuk është kërkuar disponimi i të paktën një rimorkiatori, i cili të bëjë transportin e mjeteve të cilat janë të patarguara dhe nuk lejohet të qarkullojnë në rrugë.
Vlerësimi i ofertës fituese: **1.** OE A. A. ka vënë në dispozicion vërtetime për pagesat e detyrimeve tatimore nga DPT dhe nga Bashkia Durrës, Kavajë, Vau i Dejës, Korçë, dhe Shijak, por nuk ka paraqitur vërtetime nga bashkia Fier dhe Rrogozhinë, sipas adresave sekondare në ekstraktin e QKB-së, ku konstatohet se ka ushtruar veprimtari i paregjistruar në organet tatimore vendore.
Sa më sipër janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kriteret e veçanta të kualifikimit*".
2. Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.
3.Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për makineritë është në gjuhë të huaj, nuk është i lexueshëm dhe shumica e makinerive janë të patarguara. Për këtë arsye, sipas gjykimit të grupit të auditimit nuk vërtetohet disponimi i këtyre mjeteve. Për shkak të distancave të veprës që do të ndërtohet, këto mjete duhet të qarkullojnë nga një pikë në tjetrën dhe duhet të ishin të pajisura me targa.
4. Për pajisjet të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.
Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".
Konkluzion:Kualifikimi i kësaj oferte është bërë në mospërputhje me kërkesat e LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.
Për sa më sipër, KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE "*A. A.&A. K.*", i cili nuk plotëson kriteret e DST dhe nuk duhet t'i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tij. AK duhet të kishte anuluar tenderin, të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret për të rritur numrin e pjesëmarrësve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.
Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.
Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G. dhe H. K., si dhe KVO, i përbërë nga: N. K., A. B. dhe Gj. Ç..
Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K., A. B. dhe Gj. Ç..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Për pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6dhe 7 të objeksioneve, për të cilat janë paraqitur kundërshti në lidhje me Akt Konstatimet e lëna nga grupi i auditimit, KVO thjesht është shprehur që "Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht" ose thjesht "është marrë në konsideratë", pa dhënë asnjë koment apo kundërshti ose pa paraqitur fakte dhe dokumente të reja, të panjohura nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.*
2. **Në lidhje me konstatimin e bërë nga ana juaj, në lidhje me tejkalimin e afatit prej 15 ditësh të vlerësimit të procedurave të prokurimit nga ana e KVO-së, ju bëjmë me dije se, anëtarët e KVO përveç detyrës funksionale që kanë si specialistë të sektorëve të ndryshëm të institucionit, gjithashtu edhe nga mungesa e një sektori të veçantë të prokurimeve, ngarkohen me një detyrë tjetër shtesë, siç është ajo e anëtarit të KVO. ...Përveç kësaj, tërmeti i 26 nëntorit 2019, nga i cili u godit edhe Bashkia Shijak, solli si pasojë angazhimin në detyra të tjera në ndihmë të komunitetit, të gjithë stafin e institucionit tonë, duke sjellë vonesa edhe në drejtim të vlerësimit të procedurave të prokurimit. ...Po ashtu, edhe situata e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 solli vonesat e veta.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.

Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.

2. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

11. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Ndërtim i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak***		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 1130 Prot., datë 18.02.2021 **2. Lloji i Procedurës** "Procedurë e hapur – Punë publike"	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 664 Prot., datë 28.01.2021 E. O., kryetare, juriste J. G., anëtare, ing. ndërtimi/ Ekspert i fushës H. K., anëtar, Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve (jurist)	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 1131 Prot., datë 18.02.2021 N. K., kryetar A. B., anëtare Gj. Ç., anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 43,605,497 lekë REF-87783-02-20-2021	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "A. A.&K. K." 40,796,399 lekë Kontrata nr. prot. 3453, datë 01.06.2021, me afat 4 muaj	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 2,809,098 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 29.03.2021	**9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 3 OE **b)** Skualifikuar 2 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**-ska; **APP**–s'ka; **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ska	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: ska

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 664 prot., datë 28.01.2021, ka dalë urdhëri nr. 34 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e Fondit limit*".

Në datën 18.02.2021 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit pa numër protokolli.

Në datën 19.02.2021 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.

Në njoftimin e kontratës datë 19.02.2021, përcaktohet që fondi total është 43,605,497 lekë dhe financimi do të bëhet për 3 vite, konkretisht 13,506,667 lekë për vitin 2021, 12,500,000

lekë për vitin 2022 dhe diferenca për vitin 2023, me afat 4 muaj nga nënshkrimi nga të dyja palët.
Në datën 23.03.2021, pa numër protokolli është hartuar Shtojcë nr. 1, për modifikimin e dokumenteve të tenderit. Afati i dorëzimit dhe data e hapjes së ofertave nga 24.03.2021 është bërë 29.03.2021.
Në datën 29.03.2020, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 3 ofertuesve.
Në datën 07.04.2021 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.
Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.
Në datën 15.04.2021, me nr. 2416 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga titullari i institucionit.
Kontrata është lidhur në datën 01.06.2021, me nr. prot. 3453, për vlerën 40,796,399 lekë pa TVSH dhe 48,955,678 lekë me TVSH. Në nenin 7 të Kontratës, "*Mënyra dhe afatet e pagesës*", është përcaktuar që pagesa do të kryhet me shtrirje në tre vite buxhetore.
Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".
Vlerësimi i fondit limit:Fondi limit është me të ardhurat e Bashkisë Shijak, për vlerën 43,605,497 lekë, i miratuar me VKB nr. 93, datë 02.10.2020, "*Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 të rishikuar*".
Urdhëri i prokurimit është konfirmuar nga Dega e Thesarit Durrës.
Me përllogaritjen e fondit limit janë ngarkuar anëtarët e njësisë së prokurimit, E. O., kryetare, juriste, J. G., anëtare, ing. ndërtimi, eksperte e fushës dhe H. K., anëtar, përgjegjës i sektorit të shërbimeve.
Nga observacionet e paraqitura nga subjekti në fazën e hartimit të projekt Raportit, u konstatua se projekti është hartuar nga studio e liçencuar "*I. K.*" sh.p.k. në bazë të prokurimit, kundrejt rregullave në fuqi. Relacioni përshkruan vendndodhjen dhe gjendjen ekzistuese të objektit që do të ndërtohet.
Leja e ndërtimit është miratuar me vendimin nr. 221, datë 16.04.2021.
Vlerësimi i kritereve:Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:
1. Kriteri "*Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020 nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit*", nuk i plotëson kërkesat e LPP, pasi nuk është gjithëpërfshirëse dhe shteruese, duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e OE i zhvillojnë punimet për interesa publike jashtë njësive vendore ku kanë të regjistruar selinë. Nëpërmjet kësaj kërkese, AK heq mundësinë e verifikimit të detyrimeve që OE mund të kenë në adresat sekondare ose në vende të tjera ku ushtrojnë aktivitet për interesa publike apo private, të paregjistruar në organet tatimore vendore. AK në këtë rast duhet të kërkojë vërtetime pa e ndryshuar/modifikuar kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 45 "*Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë*", pika 1, germa dh).
2.Kriteri *"Përvojë e suksesshme në: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë* ***jo më të vogël se 50%*** *e vlerës ..., ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është* ***jo më e vogël se dyfishi*** *i vlerës ...",* është në kundërshtim me pikën 6, germa b) të nenit 26 "*Kontratat për*

punë publike" të VKM-së nr. 914, datë 27.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.
3. Kërkesa që në rastin e makinerive të cilat janë marrë me qera, manovratorët "*nuk duhet të jenë të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë*" është e papërshtatshme, pasi në kontratat e qerasë specifikohet vetëm marrja me qera e makinerive dhe jo e manovratorëve. Punonjësit nuk janë objekt qeraje dhe rrjedhimisht specifikimi për mënyrën e përdorimit të makinerive me qera e bën të paqartë mënyrën e realizimit të kontratës.
4. Kërkesa për "*Specialist, minimalisht 1 të punësuar , i cili përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizmit të punimeve...*", është e tepërt dhe në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 312, datë 05.05.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"*", neni 10 "*Kërkesat profesionale të koordinatorit të projektit dhe të koordinatorit për realizimin e punimeve*", pika 5.
5. Kërkesa për mjek është në kundërshtim me VKM-në nr. 632, datë 09.02.2015, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*", pika 1.
6. Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike kërkohet paraqitja e dokumenteve që vërtetojnë pronësinë e tyre (fatura tatimore shitje ose dokument/akt zhdoganimi). Kjo kërkesë nuk është e mjaftueshme, pasi, pavarësisht se një OE mund t'i ketë blerë brenda apo jashtë vendit pajisjet dhe makineritë, ai mund t'i ketë shitur sërish ato. Dokumenti i vetëm që vërteton disponimin e automjeteve dhe veglave të punës, është pasqyra e inventarit, pjesë e pasqyrave financiare të Operatorit Ekonomik.
Kriteret e mësipërme janë të paargumentuara plotësisht dhe jo në përputhje me natyrën, zërat dhe volumet e punës. Ato nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*", pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar dhe neni 31 "*Kriteret për vlerësimin e ofertës*", neni 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5 dhe neni 61 *"Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit"*, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Vlerësimi i ofertës fituese:**1.** Nga auditimi i listëpagesave, u konstatua se nga KVO nuk është verifikuar kodi i profesioneve në listëpagesa. Pavarësisht se OE kanë paraqitur kontrata pune dhe dëshmi kualifikimi për punonjësit, në listëpagesa jo të gjithë punonjësit korrespondojnë me profesionet për të cilat janë kontraktuar.
2. Dokumentacioni i ngarkuar në sistemin e APP-së për ekskavatorët, grejderin, sondat, etj., është në gjuhë të huaj, nuk është i lexueshëm dhe makineritë janë të patarguara. Për këtë arsye, sipas gjykimit të grupit të auditimit nuk vërtetohet disponimi i këtyre mjeteve. Për shkak të distancave të veprës që do të ndërtohet, këto mjete duhet të qarkullojnë nga një pikë në tjetrën dhe duhet të ishin të pajisura me targa.
3. Për pajisjet të cilat nuk kanë detyrim pajisjen me targa dhe leje qarkullimi, nuk vërtetohet disponimi, pasi faturat e blerjes janë shumë të vjetra dhe nga KVO nuk është verifikuar disponimi i tyre në listën e inventarit bashkëlidhur bilanceve të depozituara.
Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".
Konkluzion: Për sa më sipër, AK mund të kishte anuluar tenderin, sipas kërkesave të LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.
Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës

fituese.

Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për hartimin e kritereve dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit, ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit, e përbërë nga: E. O., J. G. dhe H. K., si dhe KVO, i përbërë nga: N. K., A. B. dhe Gj. Ç..

Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: N. K., A. B. dhe Gj. Ç..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Për pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të objeksioneve, për të cilat janë paraqitur kundërshti në lidhje me Akt Konstatimet e lëna nga grupi i auditimit, KVO thjesht është shprehur që "Observacioni i argumentuar nga ana e KVO është marrë në konsideratë pjesërisht" ose thjesht "është marrë në konsideratë", pa dhënë asnjë koment apo kundërshti ose pa paraqitur fakte dhe dokumente të reja, të panjohura nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.*
2. *8. Në lidhje me konstatimin e bërë nga ana juaj, në lidhje me tejkalimin e afatit prej 15 ditësh të vlerësimit të procedurave të prokurimit nga ana e KVO-së, ju bëjmë me dije se, anëtarët e KVO përveç detyrës funksionale që kanë si specialistë të sektorëve të ndryshëm të institucionit, gjithashtu edhe nga mungesa e një sektori të veçantë të prokurimeve, ngarkohen me një detyrë tjetër shtesë, siç është ajo e anëtarit të KVO. ...Përveç kësaj, tërmeti i 26 nëntorit 2019, nga i cili u godit edhe Bashkia Shijak, solli si pasojë angazhimin në detyra të tjera në ndihmë të komunitetit, të gjithë stafin e institucionit tonë, duke sjellë vonesa edhe në drejtim të vlerësimit të procedurave të prokurimit. ...Po ashtu, edhe situata e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 solli vonesat e veta.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Nga KVO nuk janë paraqitur komente apo objeksione, të cilat të përmbajnë fakte, argumente apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit gjatë zhvillimit të auditimit.

Sa më sipër, konstatimi nga grupi i auditimit konsiderohet i mirëqënë.

2. Njësoj si pika 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

12. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Sipërmarrja e pastrimit, gjelbërimit e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në bashkinë Shijak***		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 7295 Prot., datë 22.12.2021	**3.1. Hartuesit e termave të referencës dhe kritereve për kualifikim** Nr. 6406 Prot., datë 02.11.2021 Sh. D., kryetare, agronome S. B., anëtare, ekonomiste Gj. Ç., anëtar, ing.ndërtimi E. Z., anëtare, ekonomiste E. L., anëtare, supervizore e pastrimit	**4. Komisioni i V. Ofertave:** Nr. 7296 Prot., datë 22.12.2021 dhe Nr. 391, datë 22.12.2021 Nr. 303, dt. 20.01.2022 I. Gj., kryetar A. M., anëtare H. Xh., anëtare
2. Lloji i Procedurës **"**Procedurë e hapur – Shërbime"		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 30,993,923 lekë/vit (92,981,769 lekë/3 vjet)	**3.2. Hartuesit e D. Tenderit:** Nr. 7295 Prot., datë 22.12.2021 T. P., kryetare, juriste P. A., anëtare, ekonomiste	**7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** 359,664 lekë

REF-16288-12-23-2021	R. Sh., anëtar, ing.topograf	
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes: 19.01.2022	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** "A. sh.p.k" 30,634,259 lekë/vit 92,981,769 lekë/3 vjet **9. Burimi Financimit** Buxheti i bashkisë	**10. Operatorët Ekonomikë** **a)** Pjesëmarrës në tender 1 OE **b)** Skualifikuar 0 OE, **c)** Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime **AK**-ska; **APP**–ska; **KPP-**ska	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK ska	**13. Përgjigje** Ankesës nga APP apo KKP: ska

Titulli i gjetjes: Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Situata: Zhvillimi i procedurës: Me nr. 6406 prot., datë 02.11.2021, ka dalë urdhëri nr. 339 i titullarit të Bashkisë Shijak "*Për ngritjen e grupit të punës për përllogaritjen e kostos së shërbimit të pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave*". Me këtë detyrë janë ngarkuar Sh. D., kryetare, agronome, S. B., anëtare, ekonomiste, Gj. Ç., anëtar, ing. ndërtimi, E. Z., anëtare, ekonomiste dhe E. L., anëtare, supervizore e pastrimit, të cilët kanë nënshkruar edhe preventivin. Bashkëlidhur gjenden llogaritjet e fondit limit, ku për bazë janë përdorur të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile, sipas censusit të vitit 2011.

Në datën 09.11.2021 është mbajtur PV për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit me nr. 6406/1 prot.

Në datën 23.12.2021 është mbajtur PV për hartimin e DST pa numër protokolli.

Në datën 08.02.2022, me nr. 663 prot., nga KVO është kërkuar dorëzimi i dokumentacionit nga ofertuesi "A." shpk, i cili është protokolluar në Bashkinë Shijak me nr. 663/1, datë 09.02.2022.

Në datën 29.03.2020, nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli, ku është konstatuar pjesëmarrja e 3 ofertuesve.

Në datën 19.01.2022 nga KVO është mbajtur PV për hapjen e ofertave, pa numër protokolli.

Në datën 08.02.2022 nga KVO është mbajtur PV për vlerësimin e ofertave, pa numër protokolli.

Sa më sipër, vlerësimi i ofertave është bërë në tejkalim të afatit ligjor prej 15 ditë, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.

Në datën 08.02.2022, me nr. 7296/1 protokolli, nga AK Bashkia Shijak ka dalë Raporti Përmbledhës i KVO, i miratuar nga ish titullari i institucionit.

Kontrata është lidhur në datën 16.02.2022, me nr. prot. 797, për vlerën 30,634,259 lekë pa TVSH dhe 36,761,111 lekë me TVSH, për secilin vit kalendarik.

Për monitorimin e zbatimit të kontratës është ngritur komisioni me urdhërin nr. 928/1 prot., datë 22.02.2022, në bazë të së cilit ka dalë plani i zbatimit të kontratës, me shkresën nr. 928 prot., datë 22.02.2022.

Asnjë nga procesverbalet dhe formularët e mbajtura nga komisionet gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk është protokolluar, në kundërshtim me nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*".

Vlerësimi i fondit limit: Fondet për këtë prokurim janë nga buxheti i bashkisë, i miratuar me VKB nr. 93, datë 02.10.2020 "*Mbi miratimin e buxhetit afatmesëm 2021-2023*", në bazë të planit vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Shijak.

Fondi vjetor për pastrimin e Bashkisë Shijak për vlerën 30,993,923 lekë/vit (92,981,769 lekë/3 vjet) pa TVSh, është miratuar me VKB nr. 93, datë 02.10.2020 "*Mbi miratimin e buxhetit afatmesëm 2021-2023*",,

Bashkia Shijak në përcaktimin e fondit limit është bazuar në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", në ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996 "*Për largimin të mbeturinave*", në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës në RSH*", me ndryshime, në ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për mbrojtjen e mjedisit*", me ndryshime dhe në VKM-në nr. 809, datë 26.12.2018 "*Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi*". Për periudhën 3 vjeçare është bazuar në VKM-në nr. 319, datë 21.06.1994 "*Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave*", ku përcaktohet në mënyrë specifike afati 3-5 vjet.

Vlerësimi i kritereve: Nga shqyrtimi i kritereve për kapacitetin teknik, u konstatua se është kërkuar:

1. Kërkesa që Bilancet të jenë të shoqëruara me auditimin ligjor është e pambështetur në ligj.

2. Përcaktimi që vërtetimi për shlyerjen e energjisë elektrike të jetë brenda 5 ditësh nga kërkesa e OE, është i papërshtatshëm, pasi kjo kërkesë është për furnitorin e energjisë elektrike, i cili e ka detyrim lëshimin e vërtetimit brenda 5 ditëve. AK nuk ka asnjë lidhje me kërkesën e bërë nga OE për këtë vërtetim.

3. Kërkesa që OE të paraqesë një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit, e cila duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe liçencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës, nga grupi i auditimit gjykohet e papërshtatshme dhe nuk gjen mbështetje ligjore. Për t'i dhënë kuptim kësaj kërkese, minimalisht AK duhet të kishte specifikuar profesionet e nevojshme, pasi lista emërore e personelit është listëpagesa.

4. Kërkesa që automjetet të jenë jo më pak se Euro 4 është e pambështetur në ligj. Autoritetet kompetente kanë ndaluar importin e automjeteve me klasifikim më pak se Euro 4, por përdorimi i këtyre mjeteve nuk është ndaluar.

Vlerësimi i ofertës fituese:**1.** OE nuk ka paraqitur vërtetim apo deklarata për xhiron vjetore të vitit 2021.

2. Kopjet e bilanceve të paraqitura nuk janë të konfirmuara me shkresë përcjellëse nga tatimet, sipas nenit 12 të "*Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*", si dhe nuk kanë bashkëlidhur raportet e auditimit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesën në DST.

Sa më sipër, janë në kundërshtim me kërkesat në DST, "*Kapaciteti teknik*".

Konkluzion: Për sa më sipër, AK mund të kishte anuluar tenderin, sipas kërkesave të LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, etj., të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mosnjohja e kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe moszbatimi i kuadrit ligjor specifik për zhvillimin e procedurës së prokurimit, hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertës fituese.

Ndikimi/Efekti: Ulje e numrit të OE pjesëmarrës në procedura, krijimi i hapësirave që OE të kryejnë punimet pa u regjistruar në organet tatimore vendore, mosgarantimi i kryerjes së punimeve sipas kushteve të kontratës, etj.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi: Njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave, duhet të veprojnë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për zhvillimin e procedurës dhe mënyrën e mbajtjes së procesverbaleve, ngarkohet me përgjegjësi NjP, e përbërë nga: T. P., P. A., dhe R. Sh., si dhe KVO, i përbërë nga: I. Gj., A. M. dhe H. Xh..

Për hartimin e kritereve të vlerësimit, ngarkohet me përgjegjësi grupi për hartimin e termave të referencës dhe kritereve për kualifikim, i përbërë nga: Sh. D., S. B., Gj. Ç., E. Z. dhe E. L..

Për vlerësimin e ofertave, ngarkohet me përgjegjësi KVO, i përbërë nga: I. Gj., A. M. dhe H. Xh.i.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar, Njësia e prokurimit dhe Komisioni i vlerësimit të ofertave, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. *Kërkesa që bilancet të jenë të shoqëruara me auditimin ligjor është e pambështetur në ligj. ...Sqarojmë se: ...Njësia e Prokurimit në vendosjen e këtij kriteri është mbështëtur në : ...1. Nenin 41 të ligjit 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe kontabilist te miratuar". ...2. VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021) Neni 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiar"ku citohet - Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit . ... 3. Argument tjetër është se kjo procedurë do jetë për një afat kohor për 3 vite kalendarike kështu kemi vlerësuar që ky kriter te jetë: ..."Operatori duhet te paraqese Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve ushtrimore 2018, 2019, 2020 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse shoqeruar me Auditim Ligjor ne perputhje me Nenin 41 të ligjit 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe kontabilist te miratuar". ...Konstatimi juaj nuk qëndron.*
2. *Përsa i përket konkluzionit me përshkrimin, ...Përcaktimi që vërtetimi për shlyerjen e energjisë elektrike të jetë brënda 5 ditësh nga kërkesa e OE është i papërshtatshëm, pasi kjo kërkesë është për furnitorin e energjisë elektrike , i cili e ka detyrim lëshimin e vërtetimit brënda 5 ditëve. AK nuk ka asnjë lidhje me kërkesën e bërë nga OE për këtë vërtetim. ...Sqarojmë se: ...Njësia e Prokurimit bazuar në VKM Nr. 914 date 29.12.2014 sek ll neni 26 pika 7 /c Që citon konkretisht(një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.) ka kërkuar : Vërtetim për shlyerjen e të gjithe detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjise që ka operatori në të gjithë Republikën e Shqiperisë ,mos shlyerja e detyrimeve te energjisë përben shkak për skualifikimin e operatorit. Vërtetim i leshuar jo më vonë se 5 ditë nga depozitimi i kërkesës nga operatori ekonomik. ...Sqarojmë se kriteret e vecanta janë monitoruar dhe nga APP-ja.në datën 6.01.2022, ...dhe nuk ka rekomandime për ndryshim në këtë pike.*

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:

1. Komentet dhe objeksionet e bëra janë justifikime të paargumentuara. Objeksioni dhe komentet e paraqitura janë të njëjta me trajtimin e bërënëkundërshtitë e paraqitura për Aktin e konstatimit, duke mos dhënë asnjë argument të ri apo bazë ligjore të panjohur nga grupi i auditimit.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

2. Sqarimet janë të njëjta me pikën 1 më sipër.

Sa më sipër, ky objeksion nuk merret në konsideratë.

- **Likuidimi i kontratave:**

Nga të dhënat e Drejtorisë së Financë/Buxhetit, në lidhje me likuidimin e kontratave të lidhura për periudhën objekt auditimi, likuidimet janë bërë sipas Pasqyrave bashkëlidhur në Anekse, sipas viteve të audituara.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në lidhjen dhe monitorimin e kontratave. Mosmarrje në dorëzim e punimeve të përfunduara.

Situata: Për kontratat e lidhura nga Bashkia Shijak, nga vlera totale prej 968,516,245 lekë është mundësuar likuidimi i vlerës prej 581,868,388 lekë ose 60.1% e vlerës së kontratave të lidhura, duke mbetur për pagesë vlera 386,647,857 lekë.

Likuidimi i pjesës tjetër nuk është bërë pasi në Vendimet e KB dhe më pas në kontrata është përcaktuar likuidimi në disa vite buxhetore, e cila ka shkaktuar që kontratat të lidhen në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.

Nga auditimi, u konstatua se nga ana e titullarëve të Bashkisë Shijak nuk janë ngritur komisionet për marrjen në dorëzim të punimeve dhe rrjedhimisht punimet nuk janë marrë në dorëzim, duke shkaktuar mosregjistrimin e aseteve në kontabilitet, moskthimin e garancisë së punimeve për objektet e përfunduara dhe amortizimin e tyre para se të bëhen pjesë e inventarëve të Bashkisë Shijak. Nga intervista me personelin, u konstatua se këto objekte nuk janë marrë në dorëzim kryesisht për shkak të dëmtimeve që kanë pësuar nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe për personelin e Bashkisë Shijak ka qenë e vështirë të përcaktohet se cilat dëme janë shkaktuar nga tërmeti dhe cilat mund të kenë qenë për shkak të mangësive/defekteve dhe problemeve me cilësinë e punimeve.

Për objektet e financuara nga qeveria ose nga institucione të tjera, si AKUM-i, FZHR, etj., likuidimet nuk kanë përfunduar jo për faj të AK, por për mungesën e likuidimeve nga institucionet përkatëse.

Autoriteti Kontraktor, gjatë periudhës së audituar, nuk ka kryer monitorim për zbatimin e kushteve të kontratave të lidhura duke i dokumentuar me procesverbal, njëkohësisht nuk ka përgatitur e hartuar raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Në të gjitha kontratat e përpiluara dhe të miratuara, nuk ka të përcaktuar personin, ose strukturën organizative përgjegjëse në emër të palës, për të ndjekur realizimin e kushteve të kontratës të lidhura me kontraktorët, veprim në mospërputhje me Kreun IX "*Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës*", neni 77 "*Mbikëqyrja e kontratës*", pikat 3 dhe 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe kriteri i parashikuar në kontratën e lidhur me palët, neni përkatës "*Përfaqësimi i palëve*".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 70 "*Lidhja e kontratës*", ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij; UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*": etj.

Shkaku: Neglizhencë në trajtimin e pasurisë publike. Mosnjohje e legjislacionit specifik për menaxhimin buxhetor dhe menaxhimin e aktiveve në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Mosrespektim i disiplinës buxhetore.

Ndikimi/Efekti: Risk i lartë për dëmtimin e pasurisë publike dhe përfundim i afateve të garancisë pa u marrë objektet në dorëzim. Mundësi që AK të gjendet në vështirësi financiare për shak të lidhjes së kontratave pa pasur të gjitha fondet në dispozicion, krijim i detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia:E lartë

Rekomandimi 1: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në të ardhmen, të mos bëhen prokurime pa pasur në dispozicion paraprakisht të gjitha fondet e nevojshme për realizimin e punimeve, si dhe të mos bëhen prokurime të reja pa likuiduar më parë të gjitha faturat dhe situacionet e paraqitura nga OE.
Rekomandimi 2: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK dhe Njësia e Prokurimit në Bashkinë Shijak të marrin masa dhe të analizojnë situatën, me qëllim që në të ardhmen, nga personi ose struktura organizative e caktuar si përgjegjës në emër të Autoritetit Kontraktor, të hartohen raporte të hollësishme për korrektësinë, cilësinë dhe realizimin e suksesshëm të kontratave të lidhura.
Rekomandimi 3: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë urdhërat për krijimin e komisioneve/grupeve të punës për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të të gjitha objekteve për të cilat kanë përfunduar punimet, duke bërë verifikimet përkatëse për zbatimin e projekt-preventivave dhe specifikimeve teknike të miratuara, si dhe dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, t'i shërbejnë sa më mirë dhe sa më shpejt komunitetit.

Blerjet e Vogla:
Për vitin 2019: Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël është krijuar me Urdhërin nr. 14 të titullarit të Autoriteti Kontraktor, z. A. K., protokolluar me nr. 192, datë 17.01.2019, i përbërë nga A. M., S. B. dhe E. Z..
Me Urdhërin nr. 86, protokolluar me nr. 906, datë 12.03.2019, komisioni është përbërë nga A. M., P. D.dhe E. Z..
Me Urdhërin nr. 179, protokolluar me nr. 1703, datë 20.05.2019, komisioni është përbërë nga A. M., P. D.dhe B. O..
Me Urdhërin nr. 11 të titullarit të Autoriteti Kontraktor, z. E. A., protokolluar me nr. 2845, datë 09.08.2019, komisioni është përbërë nga E. O., O. M. dhe B. O..
Me Urdhërin nr. 52, protokolluar me nr. 3207, datë 11.09.2019, komisioni është përbërë nga T. P. Koçi, B. O. dhe O. M..
Për vitin 2020: Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël është krijuar me Urdhërin nr. 25, protokolluar me nr. 388, datë 23.01.2020, i përbërë nga P. A., O. M. dhe Xh. K..
Për vitin 2021: Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël është krijuar me Urdhërin nr. 06, protokolluar me nr. 49, datë 06.01.2021, i përbërë nga P. A., O. M. dhe Xh. K..
Me Urdhërin nr. 363, protokolluar me nr. 6859, datë 01.12.2021, komisioni është përbërë nga P. A., F. Gj. dhe Xh. K..

Nga auditimi i **zonës së llogarisë 602**, për blerjet me vlera të vogla, rezultoi se për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar blerje me vlerë të vogël si vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për tu audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Në % ndaj totalit
2019	26	11,874,358	5	2,717,200	22.8
2020	21	8,293,945	5	2,798,232	33.7
2021	29	12,669,423	12	6,373,392	50.3
Totali	**76**	**32,837,726**	**22**	**11,888,824**	**36.2**

Burimi: *Bashkia Shijak*

Bazuar tek vlerësimi i riskut janë përzgjedhur për t'u audituar në total 22 procedura prokurimi me vlerë të vogël, në shumën prej 11,888,824 lekë ose 36.2 % e vlerës.
Procedurat e prokurimit me blerje me vlera të vogla, të audituara me të dhënat specifike sipas UMF nr. 57, datë 12,06.2014, "*Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*", paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

- Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit "*Blerje me vlerë të vogël*", fondi limit nuk ka qenë mbi 800,000 lekë pa TVSH, (për periudhën 2019-2020 dhe për vitin 2021 nuk ka qenë në asnjë rast mbi 1,000,000 lekë pa TVSH), pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për rregullat e prokurimit publik*", kreu II, pika 2 si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 "*Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla*" të ndryshuar.
- Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.
- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.
-Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 (pesë) operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e Urdhërit të prokurimit.
- Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.
- Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).
Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Në rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emali-ve të kryera nga AK (njoftimi) dhe OE (përgjigja).
- Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin Faturat Tatimore Shitje, të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.
- Në të gjitha rastet AK ka bërë përllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.
- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje te vogla, është bërë inventarizimi i dosjeve dhe arkivimi, sipas Udhëzimit nr. 3 datë 03.04.2014,"*Për zhvillimin e Prokurimeve me vlerë të vogël në sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomikë*", ku thuhet shprehimisht që: "*Autoriteti kontraktor duhet të bëjë arkivimi e procedurës së prokurimit brenda 1 ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues",* pasi faza e arkivimit të kontratës është e papërfunduar.
- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.
Konkluzion: Nga auditimi i pagesave për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se procedurat në përgjithësi ishin të plotësuara dhe dokumentacioni bashkëlidhur përbën gjurmën e auditimit të këtyre procedurave në të gjitha fazat dhe hapat e kryera për realizimin e këtyre procedurave deri në momentin e kontabilizimit të tyre në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për rregullat e prokurimit publik*" i ndryshuar, kreu II, Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 "*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*", pika 2 dhe me UMF nr. 57 datë 12,06.2014 "*Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).

2.4.4. Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

1. Auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës së lidhur midis AK Bashkia Shijak dhe sipërmarrësit E. A. sh.p.k. & V. K. sh.p.k., me kontratë nr. 3009, datë 26.08.2019, me objekt "*Ndërtimi i shkollës 9 vjecare Adem Sabli*", fshati Borakë me këto të dhëna:

Të dhëna për:			
Kontratën e zbatimit		**Mbikëqyrjen**	**Kolaudimin**
Nr.3009 Prot, datë 26.08.2019	Afati zbatimit të kontratës 259 ditë	kontrata nr.prot,2472 datë 30.07.2019	kontrata nr.prot,2472/1 datë 30.07.2019
Vlera e kontratës 71,982,508 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së defekteve – 12 muaj	"G." ShPK, nr. licence MK.2812/3 Administrator administrator G. B.	Kontraktor –A. nr. Licence MK 2892/1 me administrator E. M.
Kontraktori E. A. sh.p.k&V. K. sh.p.k	Punimet kanë filluar me datë 20.09.2019	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 660,439.5 lekë me TVSH.	Vlera e kontratës së kolaudimit është 93,000 lekë me TVSH.
	Punimet kanë përfunduar 30.10.2020		

Nga auditimi i dosjes tekniko-ligjore, i situacionit përfundimtar dhe kontrolli i punimeve të kryera në objekt, rezultoi:

Titulli i Gjetjes: Projekti arkitektonik nuk është realizuar nga arkitekt i licencuar për projektimin arkitektonik.
Situata: Nga auditimi i dosjes së zbatimit rezulton se projekti nuk është realizuar nga arkitekt i licencuar për projektim.
Kriteri: VKM nr. 408 datë 13.05.2015, Neni 15
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Projektet e realizuara nga persona të pa licencuar për projektim arkitektonik kanë riskt të lartë për të qenë projekte jo të saktë dhe jo cilësore në kundërshtim me kushteve teknike të projektimit
Shkaku: Neglizhencë nga ana e investitorit, Bashkisë Shijak.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Shijak të merren masa menjëherë të realizohen projekte nga persona të liçencuar me liçencat përkatëse sipas llojit të projektit.

Titulli i Gjetjes:Zëri An. Analizë, "*Punime dyer dhe dritare*"
Situata:Zëri An. Analizë, Punime dyer dhe dritare nga matjet në terren rezulton se janë vendosur 197 m^2 vetrata dopio xhami, ndërsa në situacionin përfundimtar për zërat F.V dritare profil plastik me dopio xham me gaz të ngj. Bardhë është 208 m^2,Diferenca 208 m^2 - 197 m^2 =11 m^2 *14,900 lekë / m^2 =163,900 lekë.
Kriteri: Ligji nr.8402 datë 10.09.1988 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2 pika 3, Kontrata e sipërmarrjes së punimeve nr. 3009 datë 26.08.2019; Kontrata e mbikqyrjes me nr. 2472 datë 30.07.2019.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Vlera prej 163,900 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Shijak.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikqyrsit të punimeve.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **163,900 lekë** përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak dhe duhet të kthehet kjo shumë. Nga ana e mbikqyrsit të merren masa për të realizuar çdo zë pune sipas projektit të miratuar.

Titulli i Gjetjes: Nga matjet e objektit në terren rezulton se sipërfaqja e tarracës së bashku me pjesën ballore të strehës së hyrjës së objektit ka një sipërfaqe 485 m^2.
Situata: Nga matjet e objektit në terren rezulton se sipërfaqja e tarracës së bashku me pjesën

ballore të strehës së hyrjes së objektit ka një sipërfaqe 485 m^2.
- Për zërat e punimeve Punime izolimi tarrace zëri me numër analize An. 2.197 Izolim dy duar katrama,Tarrace është situacionuar 550 m^2. Perimetri i tarracës dhe strehës së betonit në hyrjen e shkollës është 90 m dhe 17 m në total 107 m* 0.1 m (10 cm pjesa e ngritur e katramasë në parapet) del 10,7 m^2 në total 485 m^2 + 10.7 = 495.7 m^2. Diferenca 550 m^2 – 495.7 m^2 = 54.3 m^2 * 1,230 lek/m^2=66,789 lekë.
- Izolim 1 k Katrama Ṿc+h/izolim primer në kuotën 0.00. Duke qënë se objekti vjen në formë të rregullt pa dalje anësore sipërfaqja e soletës është e njejtë me atë të kuotës 0.00. Në situacion është vendosur 557 m^2. Sipërfaqja reale është 485 m^2 Diferenca 557 m^2 – 485 m^2 = 72 m^2 * 690 lekë/m^2 = 49,680 lekë.
- Llustër cimento tarrace është situacionuar 506 m^2. Diferenca 506 m^2 – 485 m^2 = 21 m^2 * 690 lek/m^2 = 14,490 lekë.
- Llustër cimento tarrace (shtresa mbrojtse) është situacionuar 506 m^2. Diferenca 506 m^2 – 485 m^2 = 21 m^2 * 690 lek/m^2 = 14,490 lekë.

Kriteri: Ligji nr. 8402 datë 10.09.1988 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2 pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve nr. 3009 datë 26.08.2019; Kontrata e mbikqyrjes nr. 2472 datë 30.07.2019.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Vlera prej **145,449** lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Shijak.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **145,449** lekë përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak dhe duhet të kthehet kjo shumë. Nga ana e mbikëqyrësit të merren masa për të realizuar çdo zë pune sipas projektit të miratuar.
Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi G. B..

2. Auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës së lidhur midis AK Bashkia Shijak dhe sipërmarrësit E. A. sh.p.k &V. K. sh.p.k, me kontratë nr. 3447, datë 27.09.2018, me objekt "*Rindërtimi i shkollës 9 vjecare Muharrem Dollaku*", Shijak me këto të dhëna:

<table>
<tr><th colspan="4">Të dhëna për:</th></tr>
<tr><th colspan="2">Kontratën e zbatimit</th><th>Mbikëqyrjen</th><th>Kolaudimin</th></tr>
<tr><td>Nr.3447 Prot, datë 27.09.2018</td><td>Afati zbatimit të kontratës 6 muaj</td><td>kontrata nr.prot, 3447/1datë 27.09.2018</td><td>kontrata nr.prot,3447/2 datë 27.09.2018</td></tr>
<tr><td>Vlera e kontratës 78,584,961.80 lekë me TVSH</td><td>Periudha e garancisë së defekteve – 12 muaj</td><td>"GB" ShPK, nr. licence MK.2812/3 Administrator administrator G. B.</td><td>Kontraktor –A. nr. Licence MK 2892/1 me administrator E. M.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Kontraktori E. A. sh.p.k&V. K. sh.p.k</td><td>Punimet kanë filluar me datë 11.12.2018</td><td rowspan="2">Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 907,649.4 lekë me TVSH.</td><td rowspan="2">Vlera e kontratës së kolaudimit është 108,917.916 lekë me TVSH.</td></tr>
<tr><td>Punimet kanë përfunduar 29.08.2019</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes tekniko-ligjore, i situacionit përfundimtar dhe kontrolli i punimeve të kryera në objekt, rezultoi:

Titulli i Gjetjes: Projekti arkitektonik nuk është realizuar nga arkitekt i licencuar për projektimin arkitektonik.
Situata: Nga auditimi i dosjes së zbatimit rezulton se projekti nuk është realizuar nga arkitekt i licencuar për projektim.
Kriteri: VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, "*Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi*", pika ë).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Projektet e realizuara nga persona të pa liçencuar për projektim arkitektonik kanë riskt të lartë për të qenë projekte jo të saktë dhe jo cilësore në kundërshtim me kushteve teknike të projektimit.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e investitorit, Bashkisë Shijak.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Shijak të merren masa menjëherë të realizohen projekte nga persona të liçencuar me liçencat përkatëse sipas llojit të projektit.

Titulli i Gjetjes: Zëri An. Analizë, "*Punime dyer dhe dritare*"
Situata: Zëri An. Analizë, "*Punime dyer dhe dritare*" nga matjet në terren rezulton se janë vendosur 193 m^2 vetrata dopio xhami, ndërsa në situacionin përfundimtar për zërat F.V dritare profil plastik me dopio xham me gaz të ngj. Bardhë është 200 m^2,Diferenca 200 m^2 - 193 m^2 = 7 m^2 * 14,900 lekë/m^2 = 104,300 lekë
Kriteri: Ligji nr. 8402 datë 10.09.1988 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve nr. 3447 datë 27.09.2018; Kontrata e mbikëqyrjes nr. 3447/1 datë 27.09.2018.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Vlera prej 104,300 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Shijak.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **104,300 lekë** përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Shijak dhe duhet të kthehet kjo shumë. Nga ana e mbikëqyrësit të merren masa për të realizuar çdo zë pune sipas projektit të miratuar.

Titulli i Gjetjes: 2.267/b "*Shtresë me pllkaka gress porcelanat 40x40 cm*"
Situata: Nga matjet e kryera në objekt rezultoi se për zërin e punës me nr. An. 2.267/b "*Shtresë me pllkaka gress porcelanat 40x40 cm*" sipërfaqja totale e këtij zëri pune është 1,381 m^2. Në situacionin përfundimtar është 1462 m^2. Diferenca 1462.5 m^2 – 1,381m^2 = 81.5 m^2 * 2440 lek/m^2**= 198,860 lekë.**
Kriteri: Ligji nr. 8402 datë 10.09.1988 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve nr. 3447 datë 27.09.2018; Kontrata e mbikëqyrjes nr. 3447/1 datë 27.09.2018.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Vlera prej **198,860** lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Shijak.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **198,860** lekë përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak dhe duhet të kthehet kjo shumë. Nga ana e mbikëqyrësit të merren masa për të realizuar çdo zë pune sipas projektit të miratuar.
Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi G. B..

3. Auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës së lidhur midis AK Bashkia Shijak dhe sipërmarrësit A. A. sh.p.k dhe K. K. sh.p.k, me kontratë nr. 3453 Prot, datë 01.06.2021 me objekt "*Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*", me këto të dhëna:

Të dhëna për:			
Kontratën e zbatimit		**Mbikëqyrjen**	**Kolaudimin**
Nr.3453 Prot, datë 01.06.2021	Afati zbatimit të kontratës 4 muaj	kontrata nr.prot.3449datë 01.06.2021	-
Vlera e kontratës 48,995,678 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së defekteve – 1 vit	"H. E. C." sh.p.k me nr. liçence MK.3730/1 Administrator administrator E. Q. dhe "BN PROJECT" me administrator A. A.	-
Kontraktori A. A. sh.p.k dhe K. K. sh.p.k	Punimet kanë filluar me datë 02.06.2021 Punimet kanë përfunduar 07.12.2021	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 453,933.22 lekë me TVSH.	-

Nga auditimi i dosjes tekniko-ligjore, i situacionit përfundimtar dhe kontrolli i punimeve të kryera në objekt, rezultoi:

Titulli i Gjetjes: Objekt "*Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*" nuk është realizuar kolaudimi.
Situata: Nga auditimi i dosjes së zbatimit rezulton se objekti "*Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*" nuk është realizuar kolaudimi.
Kriteri: Ligji 8402 datë 10.09.1998 neni 12.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Moskryerja e kolaudimit të objektit nga persona fizikë apo juridikë të pajisur me liçencën përkatëse, vë në diskutim saktësinë dhe korrektësinë e zbatimit të projektit dhe zbatueshmërinë e kontratës mes dy palëve, investitorit dhe sipërmarrësit.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e investitorit, Bashkisë Shijak.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Shijak të merren masa menjëherë, për të realizuar kolaudimin e investimit me objekt "*Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*".

Titulli i Gjetjes: Rezultojnë diferenca volumesh në disa zëra pune si më poshtë
Situata:
- 2- Zëri An. 164/1b Shtresë cakelli mbeturinë kave t = 30 cm e përhapur e ngjeshur me maineri. Rruga "*Pusi i Vjetër*" është situacionuar 85 m^3. Duke e kthyer në sipërfaqe 85 m^3 /0.3m=283.3 m^2. Nga matjet rezulton se rruga ka një gjatësi 62 m dhe gjerësi 3.7 m. Sipërfaqja reale rezulton 230 m^2. Diferenca 283.3 m^2 – 230 m^2 = 53.3 m^2 * 1,800 lek/m^2 =95,940 lekë;
- Zëri 3. 222/2 Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm me makineri. Rruga "*Pusi i Vjetër*" është situacionuar 277 m^2. Sipërfaqja reale rezulton 230 m^2. Diferenca 277 – 230 = 47 m^2 * 1,200 lekë/m^2 = 56,400 lekë;
- Zëri 3. 226/1 Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm me makineri Rruga "*Pusi i Vjetër*" është situacionuar 277 m^2. Sipërfaqja reale rezulton 230 m^2. Diferenca 277 – 230 = 47 m^2 * 1,000 lekë/m^2 = 47,000 lekë
- Zëri 3. 222/2 Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm me makineri. Rruga "*Latif Keci*" është situacionuar 1,120 m^2. Sipërfaqja reale rezulton 1,043.25 m^2 (240 m * 4.1 m + 59.25 m^2). Diferenca 1,120 m^2 – 1,043.25 m^2 = 76.75 m^2 * 1,200 lekë/m^2 = 92,100 lekë.
- Zëri 3. 226/1 Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm me makineri Rruga "*Latif Keci*" është situacionuar 1,120 m^2. Sipërfaqja reale rezulton 1,043.25 m^2 (240 m * 4.1 m + 59.25 m^2) Diferenca 1,120 m^2 – 1,043.25 m^2 = 76.75 m^2 * 1000lekë/m^2 = 76,750 lekë

Shuma totale është **368,190** lekë dhe përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak.
Kriteri: Ligji nr. 8402 datë 10.09.1988 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të*

ndërtimit", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve nr. 3453 datë 01.06.2021; Kontrata e mbikqyrjes nr. 3449 datë 01.06.2021.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Vlera prej **368,190** lekë përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak.
Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Nga ana e sipërmarrësit të punimeve vlera prej **368,190** lekë përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak dhe duhet të kthehet kjo shumë. Nga ana e mbikëqyrësit të merren masa për të realizuar çdo zë pune sipas projektit të miratuar.
Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi BOE "H. E. C" sh.p.k. & "B. P." sh.p.k., e përfaqësuar ligjërisht nga Ing. E. Q..

4. Auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës së lidhur midis AK Bashkia Shijak dhe sipërmarrësit K. K. sh.p.k. dhe K. sh.p.k., me kontratë nr. 5878 Prot, datë 27.07.2020 me objekt "*Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit për qytetin Shijak*", me këto të dhëna:

Të dhëna për:			
Kontratën e zbatimit		**Mbikëqyrjen**	**Kolaudimin**
Nr.5878 Prot, datë 27.07.2020	Afati zbatimit të kontratës 10 muaj	kontrata nr.prot.5878/1datë 27.07.2020	-
Vlera e kontratës 331,619,198.6 lekë me TVSH	Periudha e garancisë së defekteve – 2 vit	G. C. E. sh.p.k me me nr Licence MK-2812/4 me administr.G. B.	-
KontraktoriK. K. sh.p.k dhe K. sh.p.k	Punimet kanë filluar me datë 02.06.2021	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 3,738,527,79 lekë me TVSH.	-
	Punimet kanë përfunduar -		

Nga auditimi dosjes tekniko-ligjore, i situacionit të fundit dhe kontrolli i punimeve të kryera në objekt, rezultoi:

Titulli i Gjetjes: Nga ana e mbykëqyrësit të punimeve të jepet argumentim inxhinierik se përse janë këto diferenca në volume sipas situacionit nr. 4, projektit dhe librezës së masave.
Situata: Nga auditimi i dosjes së zbatimit pra projektit inxhinierik, librezës së masave si dhe situacionit nr. 4 rezultoi se kishte diferenca në volume, gjatësi sipas disa zërave të punës. Konkretisht në furnizim,vendosje të disa rakorderi ujësjellsi me diametër të ndryshëm të cilat nuk ishin në rakordim mes projektit inxhinierik, librezës së masave dhe situacionit nr. 4.
Kriteri: Ligji nr. 8402 datë 10.09.1988 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 "*Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontrata e sipërmarrjes së punimeve nr. 5878 datë 27.07.2020; Kontrata e mbikëqyrjes nr. 5878/1 datë 27.07.2020.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 75-177 të Projektraportit të Auditimit).
Ndikimi/Efekti: Ky mosrakordim i volumeve në disa prej zërave të punës sipas situacionit nr. 4 riskon të kemi diferenca në volume në fund të projektit pra në mbylljen e punimeve dhe situacionit përfundimtar.
Shkaku: Mosrakordim të projektit, librezës së masave dhe situacionit nr. 4.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Meqenëse punimet ende vazhdojnë dhe nuk është realizuar situacioni përfundimtar, është detyrë e mbikëqyrësit të punimeve të realizojë rakordimin e këtyre diferencave në volume.
Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi G. B..

2.5. Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar.

2.5.1. Auditimi mbi zbatimin e procedurave ligjore në hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Plani i detajuar vendor;

Bashkia Shijak është në procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Për periudhën e auditimit 01.01.2019-31.12.2021, nuk është miratuar Plani i Përgjithshëm Vendor. Pas komunikimeve me AKPT e cila ka sugjeruar lidhjen e një kontrate të re me studion e projektimit, për shkak se bashkia Shijak nuk ka fonde të mjaftueshme për të përballuar këto kosto, nuk është arritur të lidhet kontrata e re.

2.5.2. Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e regjistrit të territorit. Organizimi dhe funksionimi i Sistemit GIS;

Përsa i përket regjistrit të Territorit, ky regjistër në Bashkinë Shijak nuk ka funksionuar.
Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e sistemit GIS, bashkia Shijak nuk ka sektor të menaxhimit të gjeoinformacionit, rrjedhimisht nuk e disponon këtë sistem, si dhe ka mangësi stafi të kualifikuar për përdorimin e tij.

2.5.3. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në marrjen e vendimeve për leje zhvillimore ndërtimi në pronë private dhe publike;

Nga auditimi rezultoi se të gjitha lejet zhvillimore ndërtimi në prona private dhe publike aplikohen dhe shqyrtohen nëpërmjet sistemit elektronik të e-lejeve. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm aplikohet nga projektuesit të autorizuar në sistemin elektronik. Shqyrtimi dhe zbardhja ose vendimi i arsyetuar i refuzimit të lejes kryhet nga specialistët përkatës të sektorit të Planifikimit të Territorit.

2.5.4. Auditim mbi zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve të përdorimit, hartimi dhe firmosja e procesverbaleve të kolaudimit nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve;

Nga auditimi rezultoi se të gjitha Çertifikatat e Përdorimit aplikohen dhe shqyrtohen nëpërmjet sistemit elektronik të e-lejeve, ku dhe kontrollohet dokumentacioni përkatës, i cili duhet të jetë i firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve për objektet mbi 250 m^2, si dhe kolaudatori i objektit.
Sektori i Planifikimit kryen konformitetet e akt kontrolleve të objekteve të cilat kolaudohen nga koludatorë të licensuar, të cilat depozitohen me kërkesë nga sipërmarrësit e punimeve të objekteve, pranë zyrës së protokollit në bashki.

2.5.5. Auditimi mbi mandatpagesat dhe ballafaqimi me fletën e përllogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

Përllogaritja e taksës së infrastrukturës bëhet nga Sektori i Planifikimit të territorit në bazë të legjislacionit në fuqi dhe pasi bëhet pagesa nga qytetari, ajo depozitohet nga aplikuesi i praktikës në sistemin elektronik të e-lejeve dhe më pas konfirmohet nga përdoruesi si llogaritar (punonjës i drejtorisë së financës) në sistem. Pra i gjithë dokumentacioni mbi pagesat e infrastrukturës ndodhet në sistem. Drejtoria e financës bën rakordimet e këtyre pagesave me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave. Për lejet e ndërtimit të audituara, nuk kanë rezultuar diferenca në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritjes së pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar.
Për vitin 2019 janë shqyrtuar 290 aplikime në sistemin elektronik të e-lejeve për Leje

Zhvillimi, Leje Ndërtimi, Çertifikata Përdorimi, Deklarata paraprake etj. Nga këto janë miratuar 215 vendime, si më poshtë vijon:
28 Çertifikata përdorimi;
4 Deklarata paraprake;
3 Leje infrastrukture;
22 Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m^2;
18 Leje ndërtimi për ndërtim të ri , me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2;
1 Leje ndërtimi për prishje ndërtimi ekzistues;
2 Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni;
1 Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe deri në 250 m^2;
2 Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe me te madhe se 250 m^2;
3 Leje për ndryshimin e funksionit;
5 Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit;
56 Leje zhvillimi;
29 Autorizime për punime mirëmbajtje;
35 Njoftim për fillim punimesh;
1 Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues;
4 Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m^2 e përshpejtuar;
1 Leje ndërtimi, riparimi, restaurimi me procedurë të përshpejtuar për emergjenca civile.

Për vitin 2019 janë audituar këto leje ndërtimi me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2:
1. Sipas Regjistrit elektronik nr. 1137, në emër të zhvilluesit "K. K." shpk me përfaqësues ligjor z. V. J., me nr. aplikimi AN 010420190040, datë aplikimi 01.04.2019, sipërfaqe ndërtimi 3013.9 m^2, numër pasurie 51/32, Vol. 02, Fq. 81, sip 14,075 m^2, në pronësi të "K. K." shpk. Është dhënë leja zhvillimit me nr. 16 datë 24.01.2019, Vendimi për Lejen e Ndërtimit me nr. 65 datë 02.05.2019 dhe Leja e Ndërtimit nr. 1455/1 prot, datë 07.06.2019 për objektin "*Kapanon 1-2 kat për përpunimin e fruta perimeve*".
Nga auditimi i ushtruar në sistemin elektronik E-leje rezulton se disponohet Oponenca teknike për objektin e sipërcituar në përputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Neni 6.
Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin elektronik E-leje, rezulton se është marrë mendimi i institucioneve si më poshtë vijon:
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 368 datë 29.05.2019 i cili ka miratuar ndryshimin e statusit të kësaj prone nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall;
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit, konfirmon praktikën me shkresën nr. 1127 prot, datë 19.04.2019;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural konfirmon praktikën me shkresën nr. 3398 datë 24.04.2019
- OSHEE Durrës, konfirmon praktikën me shkresën me nr. 69 prot, datë 23.04.2019;
- PMNZSH Shijak, konfirmon praktikën me shkresën 30.04.2019;
- ZVRPP Durrës, konfirmon praktikën me shkresën më datë 30.04.2019;
- UK Durrës (sektori Shijak), konfirmon në heshtje;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit konfirmon praktikën me shkresën datë 23.04.2019;

Saktësia në llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
Sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Shijak për vitin 2019, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të përllogaritet *në masën 3% të vlerës së investimit.*
Sa më sipër, vlera e investimit është 155,656,681 lekë dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë në për këtë leje ndërtimi në bashkinë Shijak del në shumën prej 4,669,701 lekë. Vlera e paguar nga subjekti "K. K." shpk, me njoftim kreditimi në bankën C. Bank të datës 05.06.2019 është 4,699,701 lekë.

2. Sipas Regjistrit elektronik nr. 1038, në emër të zhvilluesit "B. O." sh.a., me përfaqësues ligjor z. A. B., me nr. aplikimi AN 230320190001 datë aplikimi 23.03.2019, sipërfaqe ndërtimi 1756 m^2, në pasurinë me nr. 326/28, ZK. 3796, Vol. 01, faqe 112, sip. e pronës 4,924.20 m^2 toke truall dhe 910 m^2 ndërtesë; Në pasurinë me nr. 326/26, ZK. 3796, Vol. 01, faqe 114, sipërfaqja e pronës 3,651.6 m^2; Në pasurinë me nr. 326/29, ZK. 3796, Vol. 01, faqe 113, sipërfaqja e pronës 1,745.8 m^2. Në pronësi të "B.-O." sh.a. është dhënë leja e zhvillimit me nr. 45 datë 21.03.2019, Vendim për Lejen e Ndërtimit nr. 70 datë 03.05.2019 si dhe leje ndërtimi nr. 1475/1 prot, datë 03.05.2019 për objektin "*Objekt industrial 1 dhe 2 kate*".
Nga verifikimi në sistemin elektronik E-leje, rezulton se është marrë mendimi i institucioneve si më poshtë vijon:

- Agjencia e Zhvillimit të Territorit, konfirmon praktikën me shkresën nr. 1115 prot, datë 18.04.2019;
- OSHEE Durrës, konfirmon praktikën me shkresën me nr. 59 prot, datë 10.04.2019;
- PMNZSH Shijak, konfirmon praktikën me shkresën 23.11.2018;
- ZVRPP Durrës, konfirmon praktikën me shkresën më datë 19.04.2019;
- UK Durrës (sektori Shijak), konfirmon në heshtje.

Saktësia në llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë:
Sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Shijak për vitin 2019, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të përllogaritet *në masën 3% të vlerës së investimit.*
Sa më sipër, për preventivin me vlerë 40,984,289 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë, në bashkinë Shijak del në shumën prej 1,229,529 lekë.
Vlera e paguar nga subjekti "B. O." sh.a., me njoftim kreditimi në B. K.T. të datës 25.04.2019 është 1,229,529 lekë.

3. Sipas Regjistrit elektronik nr. 1632, në emër të zhvilluesit "V." sh.p.k me përfaqësues ligjor z. F. Xh., me nr. aplikimi AN150520190152, datë aplikimi 15.05.2019, sipërfaqe ndërtimi 1,320.8 m^2, në pasurinë me nr. 346/57, ZK 3852, Vol. 22, faqe 113, sip. e tokës 11640 m^2, nga kjo 3,100 m^2 dhe 1,035 m^2 ndërtesë, në pasurinë me nr. 346/58, ZK 3852, Vol. 22, faqe 114, sip. e tokës 500 m^2 "truall" dhe 158 m^2 ndërtesë, në pasurinë me nr. 346/59, ZK 3852, Vol. 22, faqe 115, sip. e tokës 500 m^2 "truall" dhe 158 m^2 ndërtesë, në pronësi të "V." sh.p.k. Është dhënë leje zhvillimi nr. 74 datë 07.05.2019, Vendim i Lejes së Ndërtimit nr. 115 datë 17.06.2019, Vendim për lejen e Ndërtimit nr. 2076/1, datë 17.06.2019 si dhe leje ndërtimi nr. 2076/1 prot, datë 17.06.2019 për objektin "*Shtesë anësore 1 kat e kapanonit ekzistues*".
Nga verifikimi në sistemin elektronik E-leje, rezulton se është marrë mendimi i institucioneve si më poshtë vijon:

- Agjencia e Zhvillimit të Territorit, konfirmon praktikën me shkresën nr. 1475 prot, datë 30.05.2019;
- OSHEE Durrës, konfirmon praktikën me shkresën me nr. 95 prot, datë 22.05.2019;
- PMNZSH Shijak, konfirmon në heshtje;
- ZVRPP Durrës, konfirmon praktikën me shkresën më datë 29.05.2019;
- UK Durrës (sektori Shijak), konfirmon me shkresën nr. 1014/1 datë 24.05.2019.
- AKM, konfirmon praktikën me shkresën më datë 22.05.2019.

Saktësia në llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë:
Sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Shijak për vitin 2019, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të përllogaritet *në masën 3% të vlerës së investimit.*
Sa më sipër, për preventivin me vlerë 23,572,275.6 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë, në bashkinë Shijak del në shumën prej 707,168 lekë.
Vlera e paguar nga subjekti "V." sh.p.k., me njoftim kreditimi në bankën I. S. P. Bank të

datës 07.06.2019 është 707,168.0 lekë.

4. Sipas Regjistrit elektronik nr. 1878, në emër të zhvilluesit "Sh. T." sh.p.k., me nr. AN 310520190003, datë aplikimi 31.05.2019, sipërfaqe ndërtimi 5,262 m^2, Në pasurinë 18/107, vol 25, faqe 140, Zona Kadastrale 3852, me siperfaqe 38,873 m^2 nga kjo 9,980 m^2 truall dhe 8,824 m^2 ndërtesë, në pronësi të znj. D. dhe z. M. Sh..
Është dhënë leja e zhvillimit nr. 100 datë 30.05.2019, Vendim për Lejen e Ndërtimit nr. 109 datë 13.06.2019, si dhe leje ndërtimi nr. 2007/1 prot, datë 13.06.2019 për objektin "*Kapanon industrial 1-2 kate*".
Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin elektronik E-leje, rezulton se është marrë mendimi i institucioneve si më poshtë vijon:
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit, konfirmon praktikën me shkresën nr. 1518 prot, datë 06.06.2019;
- OSHEE Durrës, konfirmon praktikën me shkresën me nr. 110 prot, datë 03.06.2019;
- PMNZSH Shijak, konfirmon praktikën me shkresën 05.06.2019;
- ZVRPP Durrës, konfirmon praktikën me shkresën më datë 29.05.2019;

Saktësia në llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë:
Sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Shijak për vitin 2019, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të përllogaritet *në masën 3% të vlerës së investimit.*
Sa më sipër, për preventivin me vlerë 84,138,199 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë, në Bashkinë Shijak del në shumën prej 2,524,146 lekë.
Vlera e paguar nga subjekti "Sh. T." sh.p.k., me njoftim kreditimi në bankën R. Bank të datës 08.06.2019 është 2,524,146 lekë.

5. Sipas Regjistrit elektronik nr. 1446, në emër të zhvilluesit F. B., me datë aplikimi 30.04.2019, sipërfaqe ndërtimi 146 m^2 ekzistuese + 146 m^2 e re = 292 m^2, në Pasurinë me nr. 15/7, ZK 2675, Vol. 3, Fq. 132, në pronësi të F. B. me status "arë+truall" me sipërfaqe totale 3,444 m^2, nga kjo 500 m^2 truall dhe 149 m^2 ndërtesë, në pronësi të F. B.. Është dhënë leja zhvillimore si dhe leje ndërtimi nr. 2040/1 prot, datë 14.06.2019 për objektin "*Shtesë vertikale 1 kat në objektin ekzistues 1 kat*".
Nga verifikimi në sistemin elektronik E-leje, rezulton se është marrë mendimi i institucioneve si më poshtë vijon:
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit, konfirmon praktikën me shkresën nr. 1427 prot, datë 28.05.2019;
- OSHEE Durrës, konfirmon praktikën me shkresën me nr. 87 prot, datë 20.05.2019;
- PMNZSH Shijak, konfirmon praktikën me shkresën 22.05.2019;
- ZVRPP Durrës, konfirmon praktikën me shkresën më datë 28.05.2019;

Saktësia në llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë:
Sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Shijak për vitin 2019, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të përllogaritet *në masën 3% të vlerës së investimit.*
Sa më sipër, për preventivin me vlerë 4,968,491 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë, në bashkinë Shijak del në shumën prej 149,055 lekë.
Vlera e paguar nga zhvilluesi F. B., me njoftim kreditimi në bankën R. Bank të datës 05.06.2019 është 154,605 lekë.

6. Sipas Regjistrit elektronik nr. 3966, në emër të zhvilluesit L. K., me datë aplikimi 02.11.2018, me nr. AN 021120180107, sipërfaqe ndërtimi 110.5 m^2, në Pasurinë me nr. 206/26, ZK 1727, Vol. 07, Fq. 232 në pronësi të L. K., me status tokë "arë" me sipërfaqe totale 1350 m^2, në pronësi të L. K.. Është dhënë leja zhvillimore nr. 200 datë 31.10.2018, si dhe Vendimi për Lejen e Ndërtimit me nr. 217 datë 07.012.2018, leje ndërtimi nr. 4362/1

prot, datë 07.12.2018 për objektin "*Banese vetjake 1 kat*".
Nga verifikimi në sistemin elektronik E-leje, rezulton se është marrë mendimi i institucioneve si më poshtë vijon:
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit, konfirmon praktikën me shkresën nr. 2973 prot, datë 05.12.2018;
- OSHEE Durrës, konfirmon praktikën me shkresën me nr. 68 prot, datë 04.12.2018;
- PMNZSH Shijak, konfirmon praktikën me shkresën 26.11.2018;
- ZVRPP Durrës, konfirmon praktikën me shkresën më datë 04.12.2018;

Saktësia në llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë:
Bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*", të ndryshuar, ku citohet se: "*1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*".
Në paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Shijak për vitin 2019, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të përllogaritet në këtë mënyrë si më poshtë vijon:
Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1 më lart, do të jetë në masën 3% të vlerës së investimit. Ose sipas Çmimit të referencës për m^2, të marrë nga Udhëzimi nr. 3 datë 28.12.2016 "Për miratimin e Kostos mesatare të ndërtimit" nga Enti Kombëtar i Banesave, me vlerë 32,105 lekë/m^2.
Sa më sipër, për preventivin me vlerë 3,557,354 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë, në bashkinë Shijak del në shumën prej 106,721 lekë. Ndërsa sipas Entit kombëtar të banesave vlera është 106,428 lekë.
Vlera e paguar nga zhvilluesi L. K., me njoftim kreditimi në bankën U.B.A të datës 07.12.2018 është 106,721 lekë.

7. Sipas Regjistrit elektronik nr. 2565, në emër të zhvilluesit A. Gj., me datë aplikimi 19.07.2019, me nr. AN 190720190018, sipërfaqe ndërtimi 90.59 m^2, në Pasurinë me nr. 261/9, ZK 2585, Vol. 01, Fq. 51 në pronësi të A. Gj., me status tokë "pem + truall" me sipërfaqe totale 2,565 m^2 dhe 80 m^2 ndërtesë, në pronësi të A. Gj.. Është dhënë leja zhvillimore nr. 154, datë 10.07.2019 dhe Vendimi për Lejen e Ndërtimit me nr. 20 datë11.09.2019, leje ndërtimi nr. 3182/1 prot, datë 11.09.2019 për objektin "*Banese individuale 1 kat me çati*".
Nga verifikimi në sistemin elektronik E-leje, rezulton se është marrë mendimi i institucioneve si më poshtë vijon:
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit, konfirmon praktikën me shkresën nr. 2210 prot, datë 14.08.2019;
- OSHEE Durrës, konfirmon praktikën me shkresën me nr. 176 prot, datë 02.08.2019;
- PMNZSH Shijak, konfirmon në heshtje;
- ZVRPP Durrës, konfirmon praktikën me shkresën më datë 09.08.2019;

Saktësia në llogaritjen e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë:
Bazuar në nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*", të ndryshuar, ku citohet se: "*1. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore*".
Në paketën fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak Shijak për vitin 2019, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të përllogaritet në këtë mënyrë si më poshtë vijon:
Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 1 më lart, do të jetë në masën 3% të vlerës së investimit. Ose sipas Çmimit të referencës për m^2, të marrë nga

Udhëzimi nr. 3 datë 28.12.2016 "Për miratimin e Kostos mesatare të ndërtimit" nga Enti Kombëtar i Banesave, me vlerë 32,105 lekë/m^2.
Sa më sipër, për preventivin me vlerë 3,188,874 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë, në bashkinë Shijak del në shumën prej 95,666 lekë. Ndërsa sipas Entit Kombëtar të Banesave vlera është 87,252 lekë.
Vlera e paguar nga zhvilluesi A. Gj., me njoftim kreditimi në bankën R. të datës 30.12.2019 është 95,666 lekë.
Konkluzion: Nga auditimi i disa prej lejeve të ndërtimit me sipërfaqe me të madhe se 250 m^2, të lëshuara gjatë vitit 2019, rezulton se lejet e dhëna janë në përputhje me ligjin nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*". Nga bashkia Shijak përpara lëshimit të çdo leje ndërtimi është marrë më parë mendimi i institucioneve, është kryer pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe më pas është lëshuar leja e ndërtimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 177-187 të Projektraportit të Auditimit).

Për vitet 2020 dhe 2021, për leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m^2 u shqyrtua dokumentacioni i dosjeve në sistem dhe rezultoi sa më poshtë vijon:

Nr.	Data	Emri i subjektit	Objekti	Vendndodhja
1	12.01.2020	E. Sh.	Kapanon industrial frigoriferik	Nj. A. Xhafzotaj
2	12.01.2020	J. Sh.	Kapanon industrial frigoriferik	Nj. A. Xhafzotaj
3	14.01.2020	H. D.	Prishje e kapanonit ekzistues dhe ndërtimi i ri i kapanonit 1 kat	Nj. A. Xhafzotaj
4	18.06.2020	D. Sh.	Struktura banimi 1 kat	Lagjja Populllore
5	26.06.2020	A.	Magazinë grumbullimi dhe përpunimi të produketeve bujqësore	Bilalas, Nj. A. Maminas
6	04.08.2020	B. T. A.	Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat (+ zyra 2 kat)	Nj. A. Xhafzotaj
7	13.08.2020	R.	Kapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate	Nj. A. Xhafzotaj
8	29.12.2020	H.S.	3 Objekte banimi 1 dhe 2 kat me 1 kat parkim nëntokë	Nj. A. Xhafzotaj
9	04.02.2021	A. H.	Strukturë magazinimi dhe zyra 2 kat me mur rrethues dhe sistemim i sheshit	Borake, Nj. A. Xhafzotaj
10	03.04.2021	A. I.	Magazinë inputesh Nr. 2 (Në Kompleksin tregtar dhe shërbime agro-bujqësore)	Vlashaj, Nj. A. Maminas
11	21.04.2021	D. A.; A.	Kapanon industrial 1 kat + zyra 3 kat	Fllakë, Nj. A. Xhafzotaj
12	21.04.2021	B.H.	Kapanon me funksion bujqësor 1 kat dhe zyra 2 kat	Sallmone, Nj. A. Xhafzotaj
13	11.05.2021	G.N.	Shtëpi individuale banimi 2 kate	Guzaj, Nj. A. Xhafzotaj
14	23.06.2021	N. Gj.	Magazinë 1 kat	Maminas, Nj. A. Maminas
15	24.08.2021	F.V.	Strukturë banimi 2 kat (kati përdhe garazh)	Xhafzotaj, Nj. A. Xhafzotaj
16	14.12.2021	F. K.	Kapanon industrial 1 kat	Vlashaj, Nj. A. Maminas
17	14.12.2021	H.	Kapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kat + mur rrethues + kabinë elektrike dhe vendroje	Sallmone, Nj. A. Xhafzotaj

Leja e ndërtimit me objekt: Magazinë frigoriferike dhe ambalazhimi 1 kat (+ zyra 2 kat).me zhvillues z. R. Xh. dhe investitorit: shoq. "*B. T. Albania.*" sh.p.k., në Shijak.
Leja e ndërtimit është miratuar në datë 10.09.2020.
Leja e ndërtimit me objekt: Kapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate me zhvillues z. B.C. dhe z. G. S., Njësia Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak
Leja e ndërtimit është miratuar në datë 10.09.2020.

Titulli i Gjetjes: Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se planvendosja nuk përmban të gjitha detajet e nevojshme. Pra në planvendosje nuk janë reflektuar numrat e kateve të objekteve përreth.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 177-187 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri:VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, pika c "*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP*".
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Shijak
Ndikimi/Efekti: Mungesa e të disa prej elementëve të nevojshëm tek planvendosja si numri i kateve të objekteve kufitare përbën risk në mosrespëktim të distancave të lejuara nga objektet e tjera përreth.
Rëndësia:E mesme
Rekomandimi: Nga DPKZHT Shijak të merren masa për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi planvendosje pa të gjithë elementet e nevojshëm.

Leja e ndërtimit me objekt "*Kapanon industrial 1 kat + zyra 3 kat*" me zhvillues shoq. "D. A." sh.p.k Xhafzotaj, Shijak.
Leja e ndërtimit është miratuar në datë 25.05.2021.
Gjendja e dokumentacionit sipas sistemit e-leje krahasuar me bazën ligjore, paraqitet si më poshtë:

Titulli i Gjetjes: Mungon vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi sipas VKM nr. 1162, datë 24.12.2020.
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mungon vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi i cili përfshin studimin gjeologjik, sizmik, kundër rrezatimit, studimin hidrik të zonave ku do ndërtohet.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 177-187 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri:VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ leje ndërtimi*".
Shkaku: Mund të jenë zona me sizmicitet të lartë, formacione toke jo të qëndrueshme, zona me rrezatim të lartë, zona të rrezikuara nga përmbytjet etj.
Ndikimi/Efekti:Lëshimi i lejeve të ndërtimit pa u pajisur me "*Vërtetim për Riskun*" rrezikon të lejohen ndërtime në zona të cilat sipas studimive gjeologjike, sizmike, hidrike apo rrezatimit mund të jenë të zona jo të përshtatshme për t'u zhvilluar.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Nga DPZHT Bashkia Shijak të merren masa mos të lëshohen leje ndërtimi pa u pajisur fillimisht me Vërtetim për Riskun.

Leja e ndërtimit me objekt: "*Struktura banimi 1 kat*",me zhvillues "*D. Sh.*", Bashkia Shijak.
Leja e ndërtimit është miratuar në datë 03.08.2020.

Titulli i Gjetjes: Nga ana e DPZHTK Shijak të saktësohet fatura e TNI ose të argumentohet mëyra e përllogaritjes së saj.
Situata: Nga auditimi i sistemit e-leje u konstatua leja e ndërtimit me objekt "*Struktura banimi 1 kat*", me zhvillues "D. Sh.", me adresë Bashkia Shijak. Në këtë praktikë u vu re se janë më shumë se një strukturë banimi. TNI për këtë praktikë është përllogaritur si objekt për përdorim vetjak. Nga ana e grupit të auditimit u kërkua të saktësohej fatura ose të argumentohej mënyra e përllogaritjes.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 177-187 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri: Paketa fiskale e miratuar nga Bashkia Shijak për vitin 2020; Ligji 107/2014, Neni 46 "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*"
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPZHTK Shijak
Ndikimi/Efekti: Mossaktësimi i mënyrës së përllogaritjes së taksës dhe i kategorizimit të saj riskon të kemi vlera të ndryshmë ne pagesën që përfituesi i lejes duhet të paguaj për TNI për një leje të caktuar.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Nga ana e DPZHTK Shijak të merren masa të llogariten saktë ose të argumentohen mënyrat e përllogaritjes, të bëhet kategorizimi i lejes sipas paketës fiskale për TNI të miratuar për vitin përkatës.

Leja e ndërtimit me objekt: Kapanon industrial 1 kat dhe zyra 2 kate me zhvillues z. B. C. dhe z. G. S., Njësia Administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak.
Leja e ndërtimit është miratuar në datë 10/ 09/ 2020.

Titulli i Gjetjes: Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese
Situata: Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se planvendosja nuk përmban të gjitha detajet e nevojshme.Nuk përmban numrin e kateve të objekteve kufitar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 177-187 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri:VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, pika c, "*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP*"
Shkaku: Neglizhencë nga ana e DPKZHT Shijak
Ndikimi/Efekti: Mungesa e të disa prej elementëve të nevojshëm tek planvendosja si numri i kateve të objekteve kufitar përbën risk në mosrespëktim të distancave të lejuara nga objektet e tjera përreth.
Rëndësia:E mesme
Rekomandimi: Nga DPKZHT Shijak të merren masa për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi planvendosje pa të gjithë elementet e nevojshëm si numrat e kateve të objekteve përreth, distancat nga kufiri i pronës apo nga objektet që janë përreth.

2.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

Titulli i Gjetjes: Mos arkëtim i të gjitha gjobave të vendosura nga IMTV.
Situata: Grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 2020-2021, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë dosjet e procedurave të mbajtura nga IMT, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga k/inspektori. Aktet e nxjerra nga IMTV për periudhën objekt auditimi, janë paraqitur në **Pasqyrën IMTV1**, në Anekset bashkëlidhur.
Për vitin 2020, janë mbajtur 13 procesverbale konstatimi dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 13 vendime me gjobë në vlerën 4,050,000 lekë, nga të cilat 7 gjoba me vlerë 3,500,000 lekë, 5 gjoba me vlerë 500,000 lekë si dhe 1 gjobë me vlerë 50,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit.
Për të njëjtën periudhë, IMT ka nxjerrë 38 vendime për prishje objektesh, nga të cilat rezultojnë se 31 pallate, plus 7 objekte arsimore si pasojë e procesit te rindërtimit me vendime

për prishje objektesh të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike.
Nga auditimi i të dhënave për penalitetet e ndryshme të vendosura nga IMTV në Bashkinë Shijak, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë vendosur gjithsej 13 gjoba, për një vlerë totale 4,050,000 lekë, sipas **Pasqyrës IMTV2**, në Anekset bashkëlidhur.
Struktura e IMTV gjatë vitit 2020 është paraqitur në **Pasqyrën IMTV3**, në Anekset bashkëlidhur.
Për vitin 2021, janë mbajtur 31 procesverbale konstatimi dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 20 vendime me gjobë në vlerën 5,775,000 lekë nga të cilat 8 gjoba me vlerë 4,000,000 lekë, 8 gjoba me vlerë 1,550,000 lekë si dhe 4 gjoba me vlerë 225,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit. Për vitin 2021 IMTV Shijak ka mbajtur tre vendime prishje si pasojë e fatkeqësisë natyrore, të cilat janë ekzekutuar me procesverbal ekzekutimi.
Për të njëjtën periudhë, IMTV ka nxjerrë 23 vendime për prishje objektesh, nga të cilat rezulton se 20 janë për punime ndërtimi për të cilat nevojitet leje ndërtimi, si dhe 3 vendime për prishje objektesh të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike.
Nga auditimi i të dhënave për penalitetet e ndryshme të vendosura nga IMTV në Bashkinë Shijak, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë vendosur gjithsej 20 gjoba, për një vlerë totale 5,775,000 lekë, sipas sipas **Pasqyrës IMTV4**, në Anekset bashkëlidhur.
Struktura e IMTV gjatë vitit 2021 është paraqitur në **Pasqyrën IMTV5**, në Anekset bashkëlidhur.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 187-188 të Projektraportit të Auditimit).
Kriteri:neni 4, neni 5, germa a) dhe neni 11 i ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", i ndryshuar; neni 51 "*Inspektimi*" i ligjit nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*" i ndryshuar, neni 24 dhe neni 30, pika 3, i ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*"; nenet 151 dhe 152 të "*Kodit të Procedurës Civile në RSH*"; pika 2 e VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*".
Shkaku: Mosushtrimi i përgjegjësive për kontrollin e territorit.
Ndikimi/Efekti: Efekt negativ në miratimin e lejeve sipas planeve rregulluese dhe kontrollin e territorit për ndërtimet pa leje. Mungesë të ardhurash nga mosarkëtimi i gjobave.
Rëndësia:E lartë
Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, veçanërisht nga ana e K/Inspektorit të IMTV-së, të merren masa në lidhje me përgatitjen e informacionit periodik 3-mujor për IKMT, mbi masat e marra. Gjithashtu, K/Inspektori të miratojë aktet e kontrollit për objektet e pajisura me leje Ndërtimi. Drejtoria Juridike në lidhje me gjobat e pa arkëtuara duhet t'i drejtohet Gjykatës Administrative për kthimin e gjobave në tituj ekzekutivë. Nga Drejtoria Juridike, të kërkohet në Gjykatën Administrative rivendosja në afat e vendimeve me gjobë të vendosura gjatë viteve të mëparshme. Për personat e dënuar me gjobë të aplikohet kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë,për mosderdhje në afat të gjobës deri në një muaj.

2.7. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

1. Me shkresën e datës 14.12.2020, protokolluar në KLSH me nr. 1233 prot., ka paraqitur ankesë z. B. Ç. në lidhje me problematikën e tij ku shprehet për: "*bllokimin e rrugës me nr. Pasurie 46/15, vol. 10, fq. 114, ZK. 3852, sip. 2,184 m^2, Durrës. Rruga është bllokuar nga ndërtime pa leje dhe bllokimi i saj më pengon për të shkuar dhe për të punuar tokën bujqësore*".
Në lidhje me ankesën e paraqitur më sipër, me shkresën nr. 67 prot., datë 14.04.2022, rezulton se kjo çështje është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me nr. 31138-00092-82-2018 (893), datë 24.01.2018, me paditës Prefektin e

Qarkut Durrës, palë të paditur z. Q. Ç., etj; person i tretë Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, me objekt: "*Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të aktit administrativ; Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 724, datë 07.04.1996 të shtetasit A. Q. Ç., për një sipërfaqe prej 2,825 m^2 në parcelën 46/13, anulimin e pjesshëm të tij dhe kthimin e pronës në pronësi të shtetit për pjesën e anuluar*".
Duke qenë se kjo çështje është në proces gjyqësor si më sipër, në bazë të nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit "*Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata*", grupi i auditimit në Bashkinë Shijak, nuk mund të shprehet për këtë ankesë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 188-189 të Projektraportit të Auditimit).

2. Me shkresën e datës 25.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 532 prot., datë 27.05.2022, ka paraqitur ankesë z. H. K., në lidhje me problematikën e tij, ku ndër të tjera në mënyrë të përmbledhur parashtron sa më poshtë vijon:

"*Këshilli i Ministrave me vendim kalon në vitin 2005, një sipërfaqe dikur ish repart ushtarak, në pronësi të bashkisë Shijak. Këtë pronë bashkia nuk lejohej të ja kalonte kujt në pronësi, ta tjetërsonte, ta jepte në përdorim apo çdo lloj veprimi tjetër dhe do ta përdorte vetëm për ndërtimin e godinës së re për administratën bashkiake. Bashkia që nga viti 2005 e deri në fund të vitit 2020 nuk bën asnjë veprim mbi këtë pronë.*
Fakti i mosveprimit lidhet me pretendimet e pronësisë që ne si pronarë të vjetër kemi. Disponojmë një vendim të organeve kompetente për njohjen e pronësisë (Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vendim nr. 40, datë 28.05.1994), dhe kemi të kthyer një pjesë që është kufitare me pronën objekt ankimi, kthim që e kemi të regjistruar në regjistrat hipotekorë të vitit 1994.
Duke shfrytëzuar fatkeqësinë natyrore të vitit 2019, që mos ardhtë kurrë më ishallah, bashkia vihet në lëvizje për gllabërimin e kësaj prone. Duke shfrytëzuar fatkeqësinë natyrore dhe nën ombrellën e strehimit të të pastrehëve bashkia kryen të gjitha veprimet e regjistrimit e të tjetërsimit të saj brenda një viti. Nuk jam kundër strehimit të banorëve apo politikave për strehim, por jo në kundërshtim të ligjit, abuzim të tij dhe në kurriz të pronës sime, të mohimit të së drejtës së kërkimit të saj e të parablerjes së saj".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton si më poshtë vijon:
Në vendimin nr. 40, datë 28.05.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nga pasuria totale prej 26,000 m^2, pjesa prej 5,000 m^2 i kthehen në natyrë kurse sipërfaqja prej 21,000 m^2 është vendosur t'i kompensohet sipas ligjit.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga bashkia Shijak, rezulton se përsa i përket pretendimit në lidhje me sipërfaqen e pronës së kaluar në pronësi të bashkisë Shijak me VKM nr. 38, datë 13.01.2005, ndryshuar me VKM nr. 220, datë 21.03.2017, sipërfaqja e pronës ka pësuar ndryshime dhe është 3320 m^2. Për këtë sipërfaqe prone, bashkia Shijak ka aplikuar dhe është pajisur me çertifikatë pronësie nga ASHK Durrës. Origjina e pronës sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ASHK Durrës ka qenë gjithmonë tokë shtet.
Në lidhje me kalimin e pronës në pronësi të EKB, Këshilli Bashkiak i bashkisë Shijak, me vendimin nr. 118 datë 23.12.2020, ka vendosur për "*Miratimin e detyrimit ligjor që duhet të përmbushet nga NJQV si palë e marrëveshjes së bashkëpunimit për të realizuar ndërtimin e banesave me kosto të ulët që financohen me fondet e EKB*", duke vendosur miratimin e përdorimit të pasurisë truall me sipërfaqe 3320 m^2 ku do të ndërtohet objekti i banimit, me qëllimin ndërtimin e godinave të banimit për strehim social. Këshilli Bashkiak Shijak, ka autorizuar Kryetarin e Bashkisë për nënshkrimin e marrëveshjes dhe kontratës së dhurimit të truallit ku do të ndërtohet objekti i banimit për strehim social. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar.
Me VKM nr. 320, datë 18.05.2022, është vendosur për "*…një ndryshim në vendimin nr. 45, datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave, për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë*

administrative Shijak, Bashkia Shijak, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese…". Harta dhe koordinatat që i bashkëlidhen vendimit nr. 45, datë 22.01.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen përkatësisht me hartën dhe koordinatat që i bashkëlidhen këtij vendimi. Përsa trajtuar më sipër, nuk u konstatuan veprime që kanë cënuar të drejtën e pronësisë së z. H. K. nga ana e Bashkisë Shijak.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7., faqe 188-189 të Projektraportit të Auditimit).

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë në nivelin "mjaftueshëm", përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si: Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka asnjë plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara në sektorë të ndryshëm. Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara si dhe plan-veprimi për monitorimin e Sistemit MFK. E gjithë kjo procedurë është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Shijak e miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë, me shkresën nr. 3989 prot., datë 11.11.2019 për vitin 2020 dhe shkresën nr. 550 prot., datë 19.09.2021 për vitin 2021.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 39-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Shijak, të marren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të sigurohen programe kompjuterike të liçencuara në shërbim të njësisë. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherë te programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistem komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: KLSH ka konstatuar se në njësinë e auditimit të brendshëm, asnjë nga audituesit nuk është i çertifikuar dhe nuk ka eksperiencë pune, si dhe mungon trajnimi i tyre. Në dosjet e auditimeve të kryera mungojnë: letrat e punës së audituesve, si dhe vlerësimet e cilësisë. Në raportet e auditimit nuk janë përshkruar në mënyrë të plotë e të qartë gjetjet e konstatuara dhe nuk janë përcaktuar përgjegjësitë si dhe rekomandimet janë të

karakterit të përgjithshëm dhe nuk i referohen konkretisht çdo gjetjeje. Nuk janë kryer auditime të thelluara në sektorët me risk të lartë si prokurimet, planifikimi e zhvillimi i territorit, menaxhimi i aseteve, sektori i bujqësisë, burimet njerëzore, etj. Nuk është kontrolluar dhe dokumentuar si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme të veprimtarisë së bashkisë dhe në njësitë e varësisë. Nuk ka program angazhimi për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga auditi i brendshëm. E gjithë kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*" neni 11, 20, me MAB të miratuar me Urdhërin nr. 100 të MFE, datë 25.10.2016 pika 2.6, nënpika (c) dhe pika 3.5, kapitulli III, kapitulli IV, pikat 4.1.7 - 4.1.12, kapitulli IV, pika 4.1.1; kapitulli VI, pika 6.1 "*Niveli i dokumentimit*"; Kapitulli VI,I pika 7.1.1 dhe Dokumentet Standarte.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 39-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për çertifikimin dhe trajnimin e audituesve të rinj, për rritjen e aftësisë profesionale të tyre. Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve, përcaktimit të përgjegjësive si dhe formulimit konkret të rekomandimeve. Njësia e auditimit të brendshëm të kryejë vlerësimin e brendshëm të cilësisë nëpërmjet procesit të vetëvlerësimit periodik. Të planifikohet dhe realizohet program angazhimi për ndjekjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme. Veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari që mbështet menaxhimin e kësaj njësie vendore për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019, 2020 dhe 2021 referuar VKB-ve, rezulton se buxheti vjetor i çdo viti respektiv, nuk është miratuar me vendim të veçantë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 9 të Kreut I në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore*";

Bashkia Shijak nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh për t'i kushtuar rëndësi *programit 042* "Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia" në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 "*Për pyjet dhe kullotat*" i ndryshuar me Ligjin nr.57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; *për programet 051* "*Menaxhimi i mbetjeve*", *programin 052* "*Menaxhimi i ujërave të zeza*" dhe *programin 062* "*Shërbimi publik vendor*" (veçanërisht ai urban), planifikimi në rënie i fondeve nga ana e bashkisë tregon për një shërbim ku është cenuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj, përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 23/2,6,10, neni 26/1, neni 27/5 etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Në Bashkinë Shijak, Drejtoria Ekonomike dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për të miratuar me Vendim të veçantë në Këshillin Bashkiak Planin vjetor të buxhetit, të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e strategjive kombëtare kryesisht të mjedisit, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: 1. Niveli i realizmit të treguesve të buxhetit varion në masën 43% deri 92.1%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Shijak dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara;
2. Vlera totale e buxhetit ka ardhur në rritje, ndërsa po t'i referohemi zërave të veçantë, vlerat e tyre ndryshojnë nga viti në vit me trend në rënie. Përjashtim bën vetëm "*Fonde të deleguara*" që paraqitet në të njëjtat vlera.
3. Buxheti është planifikuar: *për vitin 2019*në vlerën 1,055,580 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 622,585 mijë lekë me një diferencë prej 432,995 mijë lekë; *për vitin 2020* është planifikuar në vlerën 2,437,648 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,659,663 mijë lekë me një diferencë prej 777,985 mijë lekë; *për vitin 2021* është planifikuar në vlerën 2,248,457 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,932,240 mijë lekë me një diferencë prej 316,217 mijë lekë.
4. Nga Bashkia Shijak për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është krijuar fond për emergjencat civile, duke mos zbatuar kështu Ligjin nr. 45/2019 "*Për mbrojtjen civile*" neni 65/1;
5. Realizmi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta, ku *për vitin 2019* është realizuar me një diferencë prej 359,004 mijë lekë ose 29%; *në vitin 2020* me një diferencë më të vogël në vlerë se viti 2019 prej 299,511 mijë lekë ose prej 43%; ndërsa në vitin 2021 me një diferencë më të vogël se dy vitet paraardhëse prej 116,063 mijë lekë ose 76.2%;
6. Realizimi i të ardhurave vjen duke u ulur dhe *planifikimi i të ardhur*ave ka ardhur duke u rritur nga viti në vit: me 4,132 mijë lekë nga 2019 në 2020; me 7,874 mijë lekë nga 2020 në 2021 ose me 52.5% më shumë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1. Rekomandimi: Në Bashkinë Shijak, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2020, të ardhurat nga 223,198,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën prej 156,174,000 lekë ose 69.97 %, pra me një mosrealizim në shumën prej 67,024,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga Taksa e ndërtesës - 4,993,000 lekë; Taksa e tokës bujqësore - 7,338,000 lekë; Taksa e ndikimit në infrastrukturë - 45,488,000 lekë; Tarifa e shërbimeve - 10,606,000 lekë.
Për vitin 2021, të ardhurat nga 230,936,000 lekë të planifikuara janë realizuar në shumën prej 159,495,000 lekë ose 69.1%, pra me një mosrealizim në shumën 71,441,000 lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga Taksa e tokës bujqësore - 15,530,000 lekë; Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja - 47,105,000 lekë; Taksa e mjeteve të përdorura - 2,214,000 lekë; Tarifa e shërbimeve - 13,892,000 lekë.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*" i ndryshuar, neni 5, "*Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore*", neni 54, "*Raportimi financiar*" nënpika c, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave Lokale*", i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV "*Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave*" pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, gjatë hartimit të projektit/planit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Shijak, u konstatua se në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, nuk është krijuar një bazë e plotë dhe e saktë të dhënash, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Shijak, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit Durrës.
Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 7 "*Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit*" dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 15 "*Parapagimi*", si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 "*Për taksat Kombëtare.*
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.,) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: 1. Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 3,333,757,720 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 2,992,785,725 lekë, me një diferencë prej 340,971,995 lekë më shumë në PF të Bashkisë Shijak. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 488,155,972 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 172,782,052 lekë, me një diferencë prej 315,373,920 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 "*Disponibilitete në Thesar*", në PF në subjekt ka vlerën 286,520,157lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.
2.Nga auditimi, u konstatua se Llogaria 202 "*Studime dhe kërkime*" në Bashkinë Shijak në datën 31.12.2020 përbëhet nga 16 studime e projektime në vlerën 61,651,348 lekë, të cilat i përkasin investimeve nga të ardhurat e veta të Bashkisë Shijak e cila ka prokuruar dhe lidhur kontratat e zbatimit për 6 projekte. Nga dokumentacioni në zyrën e urbanistikës, u konstatua se disponohen gjithsej 139 projekte, një pjesë e të cilave janë trashëguar nga ish komunat e bashkuara me Bashkinë Shijak. Këto projekte janë të painventarizuara dhe të pakontabilizuara.
3.Gjendja e llogarisë 212 "*Ndërtesa e Konstruksione*" në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 602,126,502 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 101,401,121 lekë nga vitit

paraardhës. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 192,384,096 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
4.Gjendja e llogarisë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 38,877,609 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 66,311,229 lekë, me një shtesë në vlerën 27,433,620 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 38,238,078 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 28,073,151 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale.
5.Gjendja e llogarisë 215 "*Mjete transporti*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 45,102,001 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 47,999,056 lekë, me një shtese në vlerën 2,897,055 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 25,551,223 lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 22,447,833 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Gjithashtu, nga auditimi i zërave të veçantë të kësaj llogarie, u konstatua se mjetet e punës, si ekskavatorë, skrepa, etj., janë pasqyruar në mënyrë të gabuar në këtë llogari, pasi duhet të ishin pasqyruar në llogarinë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*".
6.Gjendja e llogarisë 218 "*Inventar ekonomik*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 28,678,471 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 29,019,247 lekë, me një shtese në vlerën 340,776 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie, u konstatua se vlera neto është 9,974,016lekë. Në bilanc kjo llogari është paraqitur e nënlerësuar për vlerën 19,045,231 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale. Për sa më sipër, kjo llogari nuk paraqet gjendjen reale.
7.Nga verifikimi i regjistrave, u konstatua se për llogaritë 214 "*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*" dhe 215 "*Mjete transporti*", paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 68-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Shijak, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.
7.2. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.
7.3. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 "*Toka, troje terrene*"; 211 "*Pyje, Kullota, Plantacione*"; 212 "*Ndërtime e konstruksione*"; 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*"; 214 "*Instalime teknike, makineri e pajisje*" dhe 215 "*Mjete transporti*". Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivit përkatës.

7.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 "*Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit*".

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve financiare dhe verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se Bashkia Shijak, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31.12.2021 paraqitet si:

- Aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a., me NUIS L62401502P e cila është shoqëri aksionare me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*". Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 35,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën **3,500,000 lekë**. Kjo shoqëri është themeluar në datën 07.11.2016.
- Aksionare me 11.6% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a., me NUIS J61819502V e cila është shoqëri aksionare me objekt "*Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm...*". Numri total i aksioneve është 446,968 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerën 446,968,000 lekë. Kjo shoqëri është themeluar në datën 30.08.2000. Bashkia Shijak zotëron 51848.2880 aksione me të drejtë vote, në vlerën totale **51,848,288 lekë**.

Për sa më sipër, llogaria 26 "*Pjesëmarrje në kapitalet e veta*" nuk paraqet vlerën reale për shumën **55,348,288 lekë** (3,500,000 lekë nga Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a. dhe 51,848,288 lekë nga Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a.), në kundërshtim me UMFE nr. 64 datë 22.07.2014 "*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara*", me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "*Aktivet afatgjata materiale dhe Aktivet afatgjata jo materiale*" pikat 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 "*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 68-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të shoqërive: **1.** "*Ujësjellës Kanalizime Shijak Sh.a.*", me NUIS L62401502P, për 100% të aksioneve, në vlerën **3,500,000 lekë**; **2.** "*Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.a.*", me NUIS J61819502V, për 11.6% të aksioneve në vlerën **51,848,288 lekë**, si dhe regjistrimin e kapitalit aksionar të këtyre shoqërive prej **55,348,288 lekë**në debi të llogarisë 26 "*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Në mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 16,256,336 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 30,270,542 lekë ose me rritje në vlerën 14,014,206 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme dhe gjendjen e pullave që janë likuiduar në muajin janar të vitit 2022.

Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Shijak me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", në sistemin e Thesarit vlera është 30,311,342, pra me një diferencë në vlerën 40,800 lekë.

Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Shijak, nuk është bërë zhbllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet

për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.
Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, Kap II "*Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit*", të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 "*Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit*" i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 "*Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike*" i ndryshuar pikat 42 – 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 68-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2021 janë lidhur dhe zbatuar 31 kontrata në vlerën totale 1,162,219,494 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizmit të aktivit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet nëllogarinë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*". Për këto investime nuk janë kryer veprimet kontabël sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike.
Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" Aneksi 1 "*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*", Kreu I, "*Të përgjithshme*", pika 8, Kreu II, "*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, "*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", pika 32.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 68-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
10.1. Rekomandimi:Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*" dhe në kredi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*".

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situcion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*" dhe në kredi të llogarisë 404 "*Furnitorë për investime*".
Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 "*Furnitorë për investime*" dhe në kredi të llogarisë 520 "*Disponibilitete në thesar*".
Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proçes, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*", në kredi të llogarisë 720 "*Grant korrent i brendshëm*" dhe në kredi të llogarisë 4342, "*Operacione me shtetin (të drejta)*" për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.
Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 "*Aktive afatgjata materiale*" dhe në kredi të llogarisë 231 "*Investime për aktive afatgjata materiale*".
Me kapitalizmin e aktivit,(për aktivet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 "*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*", në kredi llogarisë 105 "*Grante të brendshme kapitale*" për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 "*Shtesa të fondit bazë*" dhe në debi të llogarisë 105 "*Grante të brendshme kapitale*" për vlerën e aktiveve të blera.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: 1. Në praktikat e Inventarizimit Fizik të aktiveve mungon Raporti përmbyllës hartuar dhe nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Verifikimit Fizik të Inventarëve, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" Kapitulli IV pika 85/a, b, c;
2. Komisioni i Verifikimit Fizik të Inventarëve (aktiveve) përbëhet nga të njëjtët anëtarë për 2 (dy) vite të njëpasnjëshme, në kundërshtim kjo me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" Kapitulli IV pika 84;
3. Grupi i Menaxhimit Strategjik funksionon pa hartuar një plan vjetor dhe grafik takimesh ku të përfshihen edhe hartimi e miratimi i strategjive për menaxhimin e aktiveve dhe minimizimin e risqeve të tyre.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 68-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues, Nëpunësi zbatues dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Shijak të marrin masa për të zbatuar plotësisht procedurat standard të Inventarizimit të aktiveve të bashkisë me gjithë dokumentacionin e domosdoshëm raportues si dhe në miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Deri më 31.12.2022

12. Gjetje nga auditimi:1. Grupi nga Ministria e Brendshme, që ka zhvilluar inspektimin në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 293 datë 08.09.2020, në shkresën bashkëshoqëruese me Titull "*Protokoll Inspektim - Për vlerësimin e veprimtarisë së strukturave të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi*", ku përshkruhen në mënyrë të detajuar gjithë hapat e kësaj procedure: baza ligjore, subjektet që do të inspektohen, tematika e inspektimit, metodologjia e inspektimit, nga auditimi rezulton se në përfundim të Inspektimit, nuk ka asnjë raport përfundimtar, ku të përshkruhet situata dhe një vlerësim mbi veprimtarinë dhe performancën e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, duke mos

përmbushur misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara (përcaktuar te paragrafi i fundit i shkresës) si edhe ato të Ligjit nr. 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*" neni 7, pika 2, neni 25 "*Kriteret për fitimin e gradës*" dhe neni 26 "*Arsimimi dhe trajnimi për fitimin e gradës*", rezulton të mos ketë përmbushur detyrat funksionale të përcaktuara në ligj.

2. Lidhur me arsimin/llojin e diplomimit e personelit përbërës të Njësisë së IVMT-së, rezulton se personeli i saj nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit 183/2014 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme*", si dhe riskon performancën e aktivitetit të saj, referuar edhe përcaktimeve të VKM-së nr. 894 datë 04.11.2015 "*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*";

3. Nga auditimi mbi fondet e pagave, rezulton se nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk është planifikuar në planet vjetore dhe ato afatmesme "*fond për shpërblime*" mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve (vlerësimi 6 dhe 12 mujor); gjithashtu për punonjësit me Kod Pune nuk zbatohet VKM nr. 68/2018 "*Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore*".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 68-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijakdhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për të zbatuar plotësisht kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të dispozitave ligjore, për emërimin e punonjësve në njësitë e strukturës së Bashkisë, për të realizuar me efektivitet funksionet e saj në dobi të komunitetit.

12.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në fazën e përgatitjes së projekt buxhetit vjetor dhe PBA-ve, të shikojë mundësinë e krijimit të një fondi në buxhet për shpërblim financiar bazuar në vlerësimin 6 dhe 12 mujor në Formularin e performancës për punonjësit me "*Statusin e nëpunësit civil*" dhe përcaktimeve të VKM nr. 68/2018 për punonjësit me "*Kod pune*", me qëllim motivimin e punonjësve për realizimin me efektivitet të objektivave institucionale.

12.3/a. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme, të tregojë vëmendjen e duhur në zbatimin e detyrave funksionale për inspektimin, koordinimin, trajnimin dhe logjistikën e shërbimit të MZSH-së, në përmbushje të misionit të saj për inspektim e parandalim, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

12.3/b. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së pranë Ministrisë së Brendshme të tregojë vëmendjen e duhur në zbatimin e detyrave funksionale për arsimimin/kualifikimin dhe trajnimin e personelit zjarrfikës për fitimin e gradës, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2019-31.12.2021), në drejtim të mënyrës së zhvillimit të procedurave të prokurimit, janë konstatuar shkelje të akteve ligjore/nënligjore, të cilat paraqiten si vijon:

- Asnjë nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe KVO nuk vërtetohet të kenë kryer trajnime të ndryshme;
- Nuk janë inventarizuar dhe numëruar të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit dhe nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit;
- Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet Përmbledhëse të cilat janë miratuar nga Titullari i AK, nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit;

- Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet dhe DST nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Shijak;
- Nuk ka urdhër të Titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve/preventivave (të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinën e bashkisë), kontratave të punimeve/shërbimeve dhe blerjes së mallrave.
- Personat që kanë përgatitur projektet, relacionet, preventivat dhe grafikët e punimeve nuk janë në të gjitha rastet të liçencuar nga autoritetet teknike përkatëse për kryerjen e projektimeve në fusha të caktuara specifike.

Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 23, *"Specifikimet teknike",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, neni 52 "*Hapja e ofertave*", neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3, neni 59, pika 4, "*Përllogaritja e vlerës limit të kontratës*", pikat 1 dhe 2: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 26, pika 5, "*Kontratat për punë publike*", neni 61, pika 2, "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*", ligji nr. 9154, datë 06.11.03 "*Për Arkivat*" dhe aktet ligjore në zbatim të tij, nenet 13 dhe 18 të aktit "*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*"; UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu III, "*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*": etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar.

13.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit në përputhje me aktet ligjore/nënligjore, me qëllim planifikimin e saktë të fondit dhe përdorimin me efektivitet dhe eficencë të tij.

13.3. Rekomandimi: Sektori i Procedurave të Prokurimit, të marrë masat për inventarizimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit dhe të zbatimit të përfunduara dhe dorëzimin e tyre në Sektorin e Arkivës, Bashkia Shijak.

13.4. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Shijak dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

13.5. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që asnjë pjesë e projekteve të mos bëhet nga punonjës të pakualifikuar dhe të papajisur me liçencat profesionale përkatëse, sipas fushës specifike të profesionit. Në rast se nuk është mundësia për të prokuruar projektet e investimeve, të merren masa për të kontraktuar specialistë të jashtëm, të cilët të kenë kualifikimet e nevojshme për të bërë projektet, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave me vlera të larta, në 11 raste janë konstatuar shkelje në aplikimin e kritereve, jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me me natyrën e objektit që prokurohet, si dhe nuk janë argumentuar hollësisht në procesverbalet përkatëse, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, etj.

Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: "*Hapësirë rekreative,*

park i qytetit Shijak", me vlerë të fondit limit 45,387,152 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019; "*Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, Lagja Sallmone*", me vlerë të fondit limit 45,504,101 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019; "*Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "Adem Sabli" Borakë*", me vlerë të fondit limit 60,993,255 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019; "*Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Hardhishtë-Rreth*", me vlerë të fondit limit 52,163,759 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019; "*Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Shijakut*", me vlerë të fondit limit 291,715,652 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; "*Rikualifikim i rrugës ish SMT, deri te Shala Group dhe ndërtimi i rrjetit KUZ në rrugën Xhelal Memoci*", me vlerë të fondit limit 82,993,339 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; "*Rehabilitimi i sistemit ujitës, Njësia Administrative Gjepalaj*", me vlerë të fondit limit 12,151,102 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; "*Rikonstruksion i tubacionit së dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V=2000 m^3 Shijak, rrjet shpërndarës të fshatrave Maminas – Kareç – Bilalas – Karpen – Bodinak, Loti I*", me vlerë të fondit limit 209,836,547 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; "*Sistemim, asfaltim i rrugëve lagja Rrubjekë*", me vlerë të fondit limit 62,538,053 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; "*Ndërtim i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*", me vlerë të fondit limit 43,605,497 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; "*Sipërmarrja e pastrimit, gjelbërimit e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në bashkinë Shijak*", me vlerë të fondit limit 30,993,923 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar hollësisht në procesverbalet përkatëse, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në hartimin e kritereve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "*Për rregullat e prokurimit publik*", i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST, si dhe për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Njësia e Prokurimit, në hartimin dhe miratimin e kritereve të kërkesave për kualifikim, pjesë integrale e DST, të argumentojë me hollësi çdo kriter të kërkesave kualifikuese, bazuar mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave sipas manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, liçencave, etj, duke i pasqyruar në procesverbalin përkatës, i cili të jetë pjesë e dosjes së prokurimit.

14.2. Rekomandimi: Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Shijak, të marrë masa për shmangien e kritereve të tepërta dhe të paargumentuara, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu, Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezultoi se në 10 procedura, KVO ka kryer vlerësimin e ofertave në tejkalim të afatit prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 "*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*", pika 2.;

- Nga auditimi, rezultoi se në rastet e mëposhtme të procedurave të prokurimit publik, janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret

e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:
1. "*Hapësirë rekreative, park i qytetit Shijak*", me vlerë të fondit limit 45,387,152 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues BOE "S.&E. K." ShPK;
2. "*Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza, Lagja Sallmone*", me vlerë të fondit limit 45,504,101 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues OE "A. A.&A. K." ShPK;
3. "*Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Shijakut*", me vlerë të fondit limit 291,715,652 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues BOE "K. K.&K." ShPK;
4. "*Rikualifikim i rrugës ish SMT, deri te Shala Group dhe ndërtimi i rrjetit KUZ në rrugën Xhelal Memoci*", me vlerë të fondit limit 82,993,339 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues BOE "A. A. Sh.P.K &A. K." ShPK;
5. "*Rikonstruksion i tubacionit së dërgimit DN 400 mm nga mbikalimi i Vorës deri në depo V=2000 m^3 Shijak, rrjet shpërndarës të fshatrave Maminas – Kareç – Bilalas – Karpen – Bodinak, Loti I*", me vlerë të fondit limit 209,836,547 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "K. K.&K." ShPK;
6. "*Sistemim, asfaltim i rrugëve lagja Rrubjekë*", me vlerë të fondit limit 62,538,053 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "A. A.&A. K." ShPK;
7. "*Ndërtim i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*", me vlerë të fondit limit 43,605,497 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues BOE "A. A.&K. K." ShPK;
- Në rastet e mëposhtme të procedurave të prokurimit publik, operatorë ekonomikë të cilët janë kualifikuar dhe shpallur fitues, nga KVO janë konsideruar si me mangësi të vogla, por kjo gjë nuk është specifikuar në Raportin Përfundimtar dhe pavarësisht kësaj, KVO mund të kishte anuluar tenderin, sepse OE nuk i plotësojnë të gjitha kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:
1. "*Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "Adem Sabli" Borakë*", me vlerë të fondit limit 60,993,255 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues BOE "E. A.&V. K." ShPK;
2. "*Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Hardhishtë-Rreth*", me vlerë të fondit limit 52,163,759 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2019, është shpallur fitues OE "E. A.&V. K." ShPK;
3. "*Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave*", me vlerë të fondit limit 31,707,810 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues OE "A." ShPK;
4. "*Rehabilitimi i sistemit ujitës, Njësia Administrative Gjepalaj*", me vlerë të fondit limit 12,151,102 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues OE "V. H." ShPK;
5. "*Sipërmarrja e pastrimit, gjelbërimit e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave në bashkinë Shijak*", me vlerë të fondit limit 30,993,923 lekë/vit (92,981,769 lekë/3 vjet) pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues OE "A." ShPK.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtimme kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, germa ç), neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1, neni 53 "*Shqyrtimi i ofertave*", pika 3 dhe pika 5, neni 55, "*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*", pika 1, germa a).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
15.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë në kushtet e mosplotësimit të kritereve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit apo shërbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për kontratat e lidhura nga Bashkia Shijak, nga vlera totale prej 968,516,245 lekë është mundësuar likuidimi i vlerës prej 581,868,388 lekë ose 60.1% e vlerës së kontratave të lidhura, duke mbetur për pagesë vlera 386,647,857 lekë.
Likuidimi i pjesës tjetër nuk është bërë pasi në Vendimet e KB dhe më pas në kontrata është përcaktuar likuidimi në disa vite buxhetore, e cila ka shkaktuar që kontratat të lidhen në kundërshtim me nenin 70 "*Lidhja e kontratës*" të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.
Nga auditimi, u konstatua se nga ana e titullarëve të Bashkisë Shijak nuk janë ngritur komisionet për marrjen në dorëzim të punimeve dhe rrjedhimisht punimet nuk janë marrë në dorëzim, duke shkaktuar mosregjistrimin e aseteve në kontabilitet, moskthimin e garancisë së punimeve për objektet e përfunduara dhe amortizimin e tyre para se të bëhen pjesë e inventarëve të Bashkisë Shijak. Nga intervista me personelin, u konstatua se këto objekte nuk janë marrë në dorëzim kryesisht për shkak të dëmtimeve që kanë pësuar nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe për personelin e Bashkisë Shijak ka qenë e vështirë të përcaktohet se cilat dëme janë shkaktuar nga tërmeti dhe cilat mund të kenë qenë për shkak të mangësive/defekteve dhe problemeve me cilësinë e punimeve.
Për objektet e financuara nga qeveria ose nga institucione të tjera, si AKUM-i, FZHR, etj., likuidimet nuk kanë përfunduar jo për faj të AK, por për mungesën e likuidimeve nga institucionet përkatëse.
Autoriteti Kontraktor, gjatë periudhës së audituar, nuk ka kryer monitorim për zbatimin e kushteve të kontratave të lidhura duke i dokumentuar me procesverbal, njëkohësisht nuk ka përgatitur e hartuar raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Në të gjitha kontratat e përpiluara dhe të miratuara, nuk ka të përcaktuar personin, ose strukturën organizative përgjegjëse në emër të palës, për të ndjekur realizimin e kushteve të kontratës të lidhura me kontraktorët, veprim në mospërputhje me Kreun IX "*Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës*", neni 77 "*Mbikëqyrja e kontratës*", pikat 3 dhe 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe kriteri i parashikuar në kontratën e lidhur me palët, neni përkatës "*Përfaqësimi i palëve*". ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij; UMF nr. 30, datë 27.12.11, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 36 dhe 42 "*Marrja në dorëzim i aktiveve të furnizuara*": etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në të ardhmen, të mos bëhen prokurime pa pasur në dispozicion paraprakisht të gjitha fondet e nevojshme për realizimin e punimeve, si dhe të mos bëhen prokurime të reja pa likuiduar më parë të gjitha faturat dhe situacionet e paraqitura nga OE.
16.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK dhe Njësia e Prokurimit në Bashkinë Shijak të marrin masa dhe të analizojnë situatën, me qëllim që në të ardhmen, nga personi ose struktura organizative e caktuar si përgjegjës në emër të Autoritetit Kontraktor, të hartohen raporte të hollësishme për korrektësinë, cilësinë dhe realizimin e suksesshëm të kontratave të lidhura.
16.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shijak, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë urdhërat për krijimin e komisioneve/grupeve të punës për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të të gjitha objekteve për të cilat kanë përfunduar punimet, duke bërë verifikimet përkatëse për zbatimin e projekt-preventivave dhe specifikimeve teknike të miratuara, si dhe dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtuara me financim nga Bashkia, t'i shërbejnë sa më mirë dhe sa më shpejt komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi:1. Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Adem Sabli, fshati Borakë*", Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike në vlerën 309,349 lekë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3009, datë 26.08.2019 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 2472, datë 30.07.2019.
Gjetje nga auditimi: 2. Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Muharrem Dollaku, Shijak*", Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike në vlerën 302,900 lekë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3447 datë 27.09.2018 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3447/1 datë 27.09.2018.
Gjetje nga auditimi: 3. Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*", Bashkia Shijak, u konsatuan diferenca në volume. Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike në vlerën 368,190 lekë, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3453 datë 01.06.2021 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3449 datë 01.06.2021.
Sa më sipër, krahas kontratave përkatëse, është në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3;
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1. Rekomandimi: Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve të merren masa për të zbatuar me përpikmëri kontrollin dhe mbikëqyrjen e punimeve, situacionimin e saktë sipas volumeve të punimeve të kryera në terren në përputhje me legjislacionin e mësipërm dhe kontratës së lidhur mes tij dhe investitorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga kontrolli i dosjes teknike të ndërtimit të objektit "*Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit për qytetin Shijak*", Bashkia Shijak, u konstatuan mospërputhje mes projektit, librezës së masave dhe situacionit nr. 4, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5878 datë 27.07.2020 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 5878/1 datë 27.07.2020. Punimet vazhdojnë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1. Rekomandimi: Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, të merren masa për të bërë rakordimin mes situacionit të radhës, atij përfundimtar me librezat e masave dhe projektit të azhornuar të përmendur në observacionin e dërguar.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se mungon "*Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi*" sipas VKM nr. 1162, datë 24.12.2020, "*Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/leje ndërtimi*". VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, pika c, "*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 160-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
19.1. Rekomandimi:Në bazë të Vendimit nr. 1162, datë 24.12.2020 "*Për percaktimin e procedurave dhe afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të*

pajisen me leje ndërtimi/zhvillimi", nga ana e DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak të merren masa që subjektet të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi me pajisjen me "*Vërtetim për riskun*".

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Planvendosja e pranuar nga DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak nuk është e detajuar me të gjithë elementet e nevojshëm si numrat e kateve të objekteve përreth, në bazë të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, neni 15, pika c, "*Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP*".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 160-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1. Rekomandimi: Nga ana e DPT (Drejtoria e Planifikimit të Territorit) Bashkia Shijak të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi pa planvendosje të detajuar me të gjithë elementet e nevojshëm që janë: distancat nga kufiri i pronës dhe objektet përreth në të katër orientimet, numrat e kateve të objekteve përreth.

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit e-leje u konstatua leja e ndërtimit me objekt "*Struktura banimi 1 kat*", me zhvillues "D. Sh.", me adresë Bashkia Shijak. Në këtë praktikë u vu re se janë më shumë se një strukturë banimi. TNI për këtë praktikë është përllogaritur si objekt për përdorim vetjak. Nga ana e grupit të auditimit u kërkua të saktësohej fatura ose të argumentohej mënyra e përllogaritjes.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 160-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1. Rekomandimi: Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë të llogaritet në bazë të tipologjisë së lejes së ndërtimit, e cila mund të jetë për objekte shërbimi, shitje ose përdorim vetjak, pasi TNI për tipologji të ndryshme merr vlera të ndryshme. Këto tipologji duhet të përcaktohen saktë që edhe TNI të llogaritet saktë.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të IMTV-së Bashkia Shijak, u konstatua se:

Për vitin 2020, janë mbajtur 13 procesverbale konstatimi dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 13 vendime me gjobë, në vlerën 4,050,000 lekë, nga të cilat 7 gjoba me vlerë 3,500,000 lekë, 5 gjoba me vlerë 500,000 lekë dhe 1 gjobë me vlerë 50,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit. Për këtë periudhë, IMTV Shijak ka nxjerrë 38 vendime për prishje objektesh, nga të cilat 31 pallate dhe 7 objekte arsimore, si pasojë e procesit të rindërtimit, me vendime për prishje objektesh, të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike. Nga auditimi i të dhënave për penalitetet e ndryshme të vendosura nga IMTV në Bashkinë Shijak, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë vendosur gjithsej 13 gjoba, për një vlerë totale 4,050,000 lekë.

Për vitin 2021, janë mbajtur 31 procesverbale konstatimi dhe në zbatim të tyre janë nxjerrë 20 vendime me gjobë, në vlerën 5,775,000 lekë, nga të cilat 8 gjoba me vlerë 4,000,000 lekë, 8 gjoba me vlerë 1,550,000 lekë dhe 4 gjoba me vlerë 225,000 lekë, për punime në fasadë jashtë lejes së ndërtimit. Për këtë periudhë, IMTV Shijak ka nxjerrë 3 vendime për prishje objektesh, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, të cilat janë ekzekutuar me procesverbal ekzekutimi. Gjithashtu, po për këtë periudhë, IMTV ka nxjerrë 23 vendime për prishje objektesh, nga të cilat rezulton se 20 janë për punime ndërtimi për të cilat nevojitet leje ndërtimi, si dhe 3 vendime për prishje objektesh të cilat janë nxjerrë në zbatim të investimeve të ndryshme publike.

Nga auditimi i të dhënave për penalitetet e ndryshme të vendosura nga IMTV në Bashkinë Shijak, rezultoi se gjatë periudhës objekt auditimi janë vendosur gjithsej 20 gjoba, për një vlerë totale 5,775,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 168-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, kryesisht nga ana e K/inspektorit të IMTV-së, të merren masa për përgatitjen e informacionit periodik 3-mujor për IKMT-në, në lidhje me masat e marra. Gjithashtu, K/Inspektori të miratojë aktet e kontrollit për objektet e pajisura me leje Ndërtimi.

22.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike, në lidhje me gjobat e pa arkëtuara duhet t'i drejtohet Gjykatës Administrative për kthimin e gjobave në tituj ekzekutivë. Nga Drejtoria Juridike, të kërkohet në Gjykatën Administrative rivendosja në afat e vendimeve me gjobë, të vendosura gjatë viteve të mëparshme. Për personat e dënuar me gjobë, të aplikohet kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, për mos derdhje në afat të gjobës deri në një muaj.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15 "*Të drejtat e KLSH*", shkronja (b) dhe (c) dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkia Shijak, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 1,493,439 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit, u konstatua se për vitet 2019, 2020 dhe 2021, nga Drejtoria e Financës (tani Drejtoria Ekonomike) në Bashkinë Shijak shefi i sektorit të MZSH-së, z. A. Xh. është trajtuar me nivelin e pagës të gradës "*kryeinspektor*", ndërkohë që në strukturë, si Shefit i Sektorit të MZSH-së, ka gradën "*Inspektor zjarrfikës*". Trajtimi i tij me pagë si "*shef i sektorit zjarrfikës dhe emergjencave civile*" është bërë në kundërshtim me Urdhërin nr. 195 datë 28.04.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së "*Për emërim në detyrë si Shef i Sektorit të MZSH-së me gradën "Inspektor"*"; Shkresën e emërimit në punë me nr. 1341/1 datë 03.05.2020 nga Kryetari i Bashkisë Shijak; Urdhërin nr. 99 datë 10.01.2019 të Drejtorit të MZSH pranë Ministrisë së Brendshme "*Për gradimin e punonjësit të shërbimit të MZSH-së z. A. Xh. në funksionin e Shefit të Sektorit të Shërbimit të MZSH-së Bashkia Shijak t'i jepet grada "Inspektor Zjarrfikës"*", ku përcaktohet baza ligjore/nënligjore referuese (specifikimet e reja sipas Ligjit nr. 152/2016*)*, në zbatim të VKM nr. 895 datë 21.12.2016 "*Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën*" pika 1, 2 dhe Lidhja 1; VKM nr. 350 datë 19.04.2017 "*Për trajtimin me pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*" Lidhja 1. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë shkaktuar përfitimin në mënyrë të padrejtë të vlerës prej 9,000 lekë në muaj (në total **513,000 lekë** deri në datën 30.09.2022).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 68-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masat për trajtimin me nivelin e pagës sipas akt-emërimeve dhe akteve ligjore si dhe të arkëtojnë nga z. A. Xh. vlerën e përfituar pa të drejtë si "*kryeinspektor zjarrfikës*", emëruar në detyrë me gradën "*inspektor zjarrfikës*", në masën prej

9,000 (nëntë mijë) lekë çdo muaj, nga data e fillimit të përftimit të pagës (01.01.2018), në vlerën totale **513,000 lekë** (deri në datën 30.09.2022). Gjithashtu, në vijim, z. A. Xh. të trajtohet me nivelin e pagës "*inspektor zjarrfikës*", sipas emërimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Ndërtimi i shkollës 9 vjeçare Adem Sabli, fshati Borakë*", Bashkia Shijak, realizuar nga BOE "*E. A.&V. K.*", u konsatuan diferenca në volume konkretisht për zërat e punës, "*Punime dyer dhe dritare*" dhe "*Punime izolimi tarrace*". Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është 309,349 lekë, e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3009, datë 26.08.2019 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 2472, datë 30.07.2019.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **309,349 lekë** nga BOE "*E. A.&V. K.*", shumë kjo e shkaktuar nga situacionimi më tepër i zërave të punës si më sipër.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare Muharrem Dollaku, Shijak*", Bashkia Shijak, realizuar nga BOE "*E. A.&V. K.*", u konsatuan diferenca në volume konkretisht për zërat e punës "*Punime dyer dhe dritare*" dhe "*Punime izolimi tarrace*". Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është 302,900 lekë e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3447 datë 27.09.2018 dhe kontratën e mbikëqyrjes nr. 3447/1 datë 27.09.2018.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **302,900 lekë** nga BOE "*E. A.&V. K.*", shumë kjo e shkaktuar nga situacionimi më tepër i zërave të punës si më sipër.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga matjet e gjendjes faktike në terren si dhe kontrolli i dosjes teknike të objektit "*Ndërtimi i rrugëve të brendshme në lagjen e vjetër Shijak*", Bashkia Shijak, realizuar nga BOE "*A. A.&K. K.*", u konsatuan diferenca në volume, konkretisht për zërat e punës "*Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=30 cm e përhapur e ngjeshur me makineri*", "*Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm me makineri*", "*Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm me makineri*". Janë situacionuar volume punimesh më shumë se gjendja faktike. Vlera e diferencave të konstatuara është **368,190** lekë e cila përbën **dëm ekonomik** shkaktuar Bashkisë Shijak, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1988, "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*", i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001, "*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim*", Kreu 2, pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3453 datë 01.06.2021 dhe Kontratën e mbikëqyrjes nr. 3449 datë 01.06.2021.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 95-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **368,190 lekë** nga BOE "*A. A.&K. K.*", shumë kjo e shkaktuar nga situacionimi më tepër i zërave të punës si më sipër.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Shijak nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Shijak për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësi të mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

Nga auditimi i taksës së ndërtesës, u konstatua një vlerë debitore prej **14,849,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës deri në datën 31.12.2021.

Nga auditimi i tarifës së pastrimit, u konstatua një vlerë debitore prej **12,872,000 lekë**, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak, nga mos arkëtimi i tarifës së pastrimit deri në datën 31.12.2021.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, kreu VIII "*Vlerësimi tatimor*", ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "*Për Taksat Kombëtare*", i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, "*Për Taksat Kombëtare*", etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Bashkia Shijak të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Shijak ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

1.2. Rekomandim: Bashkia Shijak të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifat vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitore prej **14,849,000** lekë nga mos arkëtimi i taksës së ndërtesës dhe **12,872,000 lekë** nga mos pagesa e tarifës së pastrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 "*Për tokën*", janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5171 familje për sipërfaqen toke prej 5,452 hektarë, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës. Mesatarisht, për të gjithë periudhën objekt auditimi, taksa e tokës është arkëtuar rreth 41.23 %. Nga 5171 familje të trajtuara me tokë bujqësore, 3,532 familje ose më shumë se gjysma janë debitorë për këtë lloj takse. Shumë pak pagesa bëhen në mënyrë vullnetare, por kryesisht paguajnë familjet të cilat janë paraqitur në zyrat e Bashkisë për probleme të ndryshme administrative dhe u është kërkuar kryerja e pagesës në këmbim të marrjes së shërbimit.

Nga auditimi i taksës së tokës, rezultoi vlera totale debitore **47,802,000 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak. Kjo vlerë debitore është e pakontabilizuar.
Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 "*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "*Për tokën*", i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 "*Për tokat bujqësore të pandara*", VKM nr. 531, datë 21.08.1998 "*Për tokat bujqësore të pandara*", i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, UKM nr. 1, datë 18.07.2012 "*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*", etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet tarifat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj. Të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Shijak, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, et,) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese e të dhënave.
2.2. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Shijak dhe Qarku Durrës). Për familjet fermere debitore, të kontabilizohet vlera debitore **47,802,000 lekë,** të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën dhe vlerën e papaguar dhe për mospagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë dhënë 111 leje legalizimi për 25,124 m^2 ndërtim, me vlerë investimi 479,591,000 lekë, për një vlerë totale detyrimi 3,851,000 lekë, nga e cila nuk është arkëtuar vlera 2,161,311 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Shijak. Kjo vlerë debitore është e pa kontabilizuar.
Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, "*Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*" i ndryshuar, neni 23, me VKM-në nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*", pika 5, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për Sistemin e Taksave vendore*", i ndryshuar, neni 27 "*Taksa e ndikimit në infrastrukturë*", pika 2/1, si dhe me VKB vjetore përkatëse për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Shijak, etj.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Durrës, që të mos lëshojë dhe të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Shijak. Drejtoria e financës të kontabilizojë vlerën debitore dhe Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e vlerës **2,161,311 lekë** nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Anekset bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, rezultoi se në Bashkinë Shijak ka 336 subjekte debitorë nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesi si në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u ulur, kështu në fund të vitit 2018 numri i debitorëve ishte 549 subjekte në vlerën prej 17,888,557 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve ishte 336 subjekte në vlerën prej 39,179,217 lekë. Vlera progresive në fund të vitit 2021 ka qenë **39,179,217 lekë**, e cila përfaqëson taksat dhe tarifat vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Shijak.

Nga auditimi, u konstatua se nuk është llogaritur vlera e gjobës (kamatëvonesës) në masën 0,06% për çdo ditë vonesë, deri në 365 ditë. Sa më sipër, nuk gjen zbatim ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni 89 "*Njoftimi dhe kërkesa për të paguar*"

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore, strukturat tatimore të bashkisë Shijak, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008. Gjithashtu nga strukturat tatimore të bashkisë Shijak për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar kallëzim penalbazuar në nenin 181, "*Mos pagimi i taksave dhe tatimeve*", të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore*", me ndryshime, Kreut XI, "*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*", me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "*Kodi Penal i RSh*" me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar neni 9 "*Të drejtat dhe përgjegjësitë*" pika 1.3., neni 35, "*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*", me ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën prej **39,217,179lekë** duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme.

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Shijak, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se për periudhën 2019-2021 kanë zhvilluar aktivitet në fushën e ndërtimit dhe janë pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Shijak 89 subjekte në vlerën 1,764,610 lekë për llogari të subjekteve private si rikonstruksione objektesh të ndryshme, ndërtime të reja banimi dhe për qëllime biznesi, ndërtime të tjera si shtesa kati ose shtesa anësore objekti, punime për ndryshime destinacionet të veprimtarive të objekteve, etj., nga të cilët kanë paguar detyrimet9 subjekte në vlerën **623,433 lekë**, duke mbetur pa u arkëtuar vlera **1,222,997 lekë** për 80 subjekte, **vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak,** sipas listimit në Pasqyrat **A22, A23 dhe A24** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore*" neni 40, "*Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare*", pika 1, neni 43 "*Përditësimi i të dhënave të regjistrimit*" pika 1/1; ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*", i ndryshuar, neni 22, "*Detyrimi për regjistrim*", pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, VKB, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Sektori i taksave dhe tarifave vendore të saktësojë listat e bizneseve të pajisura me leje ndërtimi, për projektet e investimeve të prokuruara për vitet 2019-2020, si dhe për subjektet private ose biznese, pavarësisht nëse zbatuesit e këtyre ndërtimeve e kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Shijak por ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor dhe të nxjerrë njoftim detyrimet për taksat dhe tarifat vendore. Sipas listimit në Pasqyrat **A22, A23 dhe A24** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej **1,222,997 lekë** nga këto detyrime vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Shijak ushtrojnë aktivitetin 30 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi, u konstatua se është licencuar 1 subjekt i cili tregëton karburante ndërsa 27 subjektet e tjera nuk janë licencuar, duke ushtruar aktivitetin të papajisur me licencë dhe pa paguar tarifën përkatëse.

Subjekte të liçencuar për tregtimin e lëndëve djegëse janë dy, R. G. me vendndodhje në Pjezë dhe R. G. me vendndodhje në Maminas.

Vlera prej 27,000,000 lekë, e cila nuk është paguar nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Shijak, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shijak.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 44-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, si dhe të arkëtohet shuma debitore prej **27,000,000 lekë,** ngasubjektet të cilat ushtrojnë aktivitet për tregtimin me pakicë të hidrokarbureve, pa u pajisur me licencën përkatëse nga Bashkia Shijak, sipas Pasqyrës A25, në Anekset bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 15, shkronja (c), të Ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 58 të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*" i ndryshuar, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 "*Masa Disiplinore*", nëVKM-në nr.115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe auditin e brendshëm:

1. Znj. P. A., me detyrë Drejtor Ekonomik, me statusin e nëpunësit civil;
2. Znj. S. B., Përgjegjëse e Njësisë së Auditit të Brendshëm, me statusin e nëpunësit civil;
3. Z. R. H., audites në Njësinë e Auditit të Brendshëm, me statusin e nëpunësit civil;
4. Znj. A. R., audituese në Njësinë e Auditit të Brendshëm, me statusin e nëpunësit civil;
5. Znj. E. Sh., me detyrë Drejtore e burimeve njerëzore, me statusin e nëpunësit civil;

Për problemet e konstatuara në lidhje me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare:

6. Znj. P. A., me detyrë Drejtor Ekonomik, nëpunës zbatues, me statusin e nëpunësit civil;
7. Znj. R. K., me detyrë specialiste finance, me statusin e nëpunësit civil;
8. Znj. B. O., me detyrë specialiste finance, me statusin e nëpunësit civil;

Për problematikat e konstatuara në lidhje me të ardhurat, si më poshtë vijon:

9. Znj. S. B., me detyrë Përgjegjëse e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, me statusin e nëpunësit civil;
10. Znj. E. T., me detyrë Specialiste në sektorin e taksave dhe tarifave vendore, me statusin e nëpunësit civil;

Për problematikat e konstatuara në lidhje me IMTV:

11. Znj. E. O., me detyrë përgjegjëse e sektorit juridik, me statusin e nëpunësit civil;
12. Znj. A. M., me detyrë Kryeinspektore e IMTV, me statusin e nëpunësit civil;

Për problematikat e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit:

13. Znj. J. G., me detyrë Drejtore e DPKTZH, me statusin e nëpunësit civil;
14. Znj. A. B., me detyrë Specialiste në DPKTZH, me statusin e nëpunësit civil;
15. Z. B. T., me detyrë Specialist në DPKTZH, me statusin e nëpunësit civil;
16. Z. R. Sh., me detyrë Topograf në DPKTZH, me kontratë pune;

Për anëtarët e Njësisë së prokurimit, Komisionit për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si më poshtë vijon:

17. Znj. E. O., me detyrë përgjegjëse e sektorit juridik, me statusin e nëpunësit civil;
18. Znj. J. G., me detyrë Drejtore e DPKTZH, me statusin e nëpunësit civil;
19. Z. B. T., me detyrë Specialist në DPKTZH, me statusin e nëpunësit civil;
20. Z. N. K., me detyrë Nënkryetar i bashkisë, me kontratë pune;
21. Z. E. V., me detyrë Specialist i Sektorit të PKZHT, me statusin e nëpunësit civil;
22. Z. Gj. Ç., me detyrë Specialist i Sektorit të Shërbimeve, me statusin e nëpunësit civil;
23. Z. R. Sh., me detyrë Topograf në DPKTZH, me kontratë pune;
24. Znj. Sh. D., me detyrë Nënkryetare e bashkisë, me kontratë pune;

25. Znj. A. M., me detyrë Kryeinspektore e IMTV, me statusin e nëpunësit civil;
26. Z. F. Gj., me detyrë arkitekt në sektorin e projekteve, me statusin e nëpunësit civil;
27. Z. M. G., me detyrë Drejtor i drejtorisë së bujqësisë, me statusin e nëpunësit civil;
28. Znj. A. B., me detyrë Specialiste në DPKTZH, me statusin e nëpunësit civil;
29. Z. H. K., me detyrë Përgjegjës i sektorit të shërbimeve, me statusin e nëpunësit civil;
30. Znj. S. B., me detyrë Përgjegjëse e sektorit të taksave dhe tarifave vendore, me statusin e nëpunësit civil;
31. Znj. E. Z., me detyrë specisliste ekonomiste, me statusin e nëpunësit civil;
32. Znj. E. L., me detyrë supervizore në sektorin e shërbimeve, me kontratë pune;
33. Z. I. Gj., me detyrë me detyrë Nënkryetar i bashkisë, me kontratë pune;
34. Znj. H. Xh., me detyrë supervizore në sektorin e shërbimeve, me kontratë pune.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e poshtëpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.
1. Znj. D. Ç., me detyrë Përgjegjëse e Financës, larguar nga puna;
2. Znj. O. M., me detyrë përgjegjëse e sektorit të projekteve, larguar nga puna;
3. Z. E. D., me detyrë ish inxhinier në sektorin e projekteve, larguar nga puna;
4. Znj. D. I., me detyrë Drejtore e Urbanistikës, larguar nga puna;

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Shënim:
Të gjithë punonjësve që atakohen në këtë Raport Auditimi, duhet t'u bëhen prezente mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t'u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT